RAPORT PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË NË INSTITUCIONIN BASHKIA KONISPOL

Nr.	PËRMBEJTJA	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2-7
II	HYRJE.....	3-4
a	Objektivat …….....	4-4
b	Identifikimi i çështjeve …….....	4-5
c	Përgjegjësitë e drejtimit ……	5-5
d	Përgjegjësitë e audituesit …….....	6-6
e	Kriteret e vlerësimit …….....	6-7
f	Standardet e auditimit …….....	7-7
III	PËRMBAJTJA E PUNËS SË KRYER.....	7-113
1	Testimi i funksionimit të kontrolleve kryesore të entitetit, përfshirë zbatimin e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin.	7-10
2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit dhe në ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017", me ndryshimet e tij.	10-34
3	Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797 datë 29.12.2017.....	34-95
4	Mbi administrimin e aseteve, procedurën e dhënies me qira të aseteve të qëndrueshme në varësi të bashkisë dhe shitja e trojeve publike.	95-103
5	Mbi vlerësimin e auditimit të brendshëm publik.	103-105
6	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve në auditimin e mëparshëm.	105-110
7	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	110-110
IV	GJETJET NGA AUDITMI	111-126
VI	Konkluzione dhe Opinione.....	127-127
VII	ANEKSET.....	128-131

Tiranë, Qershor 2018

Mbi zbatimin e auditimit të përputhshmërisë në Bashkinë KONISPOL.
Përgatitur nga data 30.04.2018 deri më 26.06.2018.
Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 247/1, datë 05.03.2018 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 05.03.2018 deri në datë 20.04.2018, në subjektin Bashkia Konispol u krye auditimi për periudhën 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017 mbi "Mbi auditim i përputhshmërisë".

Auditimi është kryer nga:
1-R.Xh. (*përgjegjës grupi*),
2-H.A. anëtar,
3-J.L. anëtar,
4-S.M. anëtar

Auditimi ka filluar më 05.03.2018
Auditimi ka përfunduar më 20.04.2018

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vijim KLSH),* auditoi Bashkinë Konispol, në bazë të programit të auditimit nr. 247/1, datë 05.03.2018 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.
Për gjetjet e konstatuara nga audituesit, janë mbajtur 19 akte konstatimi dhe 1 akt verifikimi të cilat janë dorëzuar në protokollin e Subjektit të auditimit brenda datës 20.04.2018 në përputhjen me afatin e auditimit sipas programit të miratuar. Lidhur me aktkonstatimet e mbajtura, subjekti ka dërguar observacionet përkatëse të cilave ju dhanë përgjigje në këtë Projektraport (shkresa nr. 267/1, datë 25.04.2018).
Bazuar në këto akte verifikimi dhe akte konstatimi, është përpiluar Projekt Raporti i Auditimit i cili është dërguar në Bashkinë Konispol me nr. 247/3, datë 05.05.2018.
Bashkia Konispol, me shkresën nr. 276/3, datë 05.06.2018, administruar në KLSH me nr. 247/4, datë 08.06.2018, ka kthyer projektraportin e auditimi dhe dërguar kundërshtimet për ato pika të trajtuara në Projektraport për të cilat palët ndajnë mendime/qëndrime të ndryshme.
Më datë 14.06.2018 është zhvilluar në ambientet e KLSH-së takimi përmbyllës, takim i organizuar në zbatim të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH" dhe Rregullores të KLSH nr. 107, datë3 0.08.2017

I. Hyrja.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi veprimtarinë e Bashkinë Konispol, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në menaxhimin financiar dhe kontrollin, në Hartimin dhe zbatimin e buxhetit, në miratimin e respektimin e strukturës organike dhe të nivelit të pagave sipas klasifikimit të funksioneve, në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, në administrimin e vlerave materiale e monetare, në prokurimin e fondeve publike etj.
Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 247/1, datë 05.03.2018 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 05.03.2018 deri në datë 20.04.2018, në subjektin Bashkia Konispol u krye auditimi për periudhën 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017 mbi "Mbi auditim i përputhshmërisë", nga grupi i auditimit i përbërë nga:

1-Z. R.Xh. (*përgjegjës grupi*),
2-Z. H.A. anëtar,
3-Z. J.L. anëtar,
4-Z. S.M. anëtar

Auditimi u krye me zgjedhje për pasqyrat financiare të vitit 01.01.2016, deri 31.12.2017.

Bazuar të dhënave të marra në subjekt, fondet e trajtuar, botimet në mediat e shkruara, ndjeshmërinë publike dhe të grupeve të interesit, riskun, u identifikuan fushat e auditimit të cilat janë;

a. planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar;

b. marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, krijimi dhe përdorimi i fondit të veçantë, etj.;

c. Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në përputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007. Ligjshmëria dhe saktësia e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit;

d. planifikim dhe realizimi i prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime;

e. menaxhimi financiar dhe kontrollit, Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informim komunikimi, monitorimi, mbi bazën e të cilave u hartua edhe programi i auditimit.

f. krijimi i të ardhurave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve

g. Dhënia me qira subjekteve private të aseteve (ambienteve, trojeve e tokave bujqësore), respektimi i tarifave të qirasë si dhe ndjekja e arkëtimit të të ardhurave nga qiratë.

<u>Informacion i përgjithshëm:</u>

Bashkia Konispol është person juridik, publik, buxhetor. Bashkia e Konispolit ka si aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe blegtorinë si dhe tregtinë ndërkufitare me Greqinë. Bujqësia është e përqendruar te agrumet, ullinjtë dhe vreshtat ndërsa zona është e famshme edhe për kullota dimërore për bagëtinë e imët.

Bashkia e Konispolit kufizohet në veri me Bashkinë Finiq, në perëndim me Sarandën dhe në jug me Greqinë dhe ka për kryeqendër qytezën e Konispolit. Bashkia përbëhet nga 3 Njësi Administrative, Konispol, Xarrë dhe Markat. Sipas regjistrit civil ka rreth 14 mijë banorë nga të cilët rreth 8200 jetojnë e punojnë në Konispol. Sipërfaqja e bashkisë është 221.88 km^2. Sipas të dhënave densiteti i popullsisë është 37.1 banorë për kilometër katror ndërsa sipas regjistrit civil densiteti është 61.91 banorë/km^2.

Bashkia Konispol është përgjegjëse për drejtimin, menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të territorit nën administrim në të gjitha aspektet.

a- Objektivat dhe qëllimi

Objektivat e auditimit, janë sipas programit të auditimit: "*Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë financiare me kuadrin rregullator në fuqi për periudhën 2016-*

2017, duke përfshirë këtu, vlerësimin në se të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Qëllimi i auditimit është në përputhje me llojin e auditimit të rregullshmërisë:
Vlerësimi nëse aktivitetet dhe informacionet e raportuara në pasqyrat financiare dhe në zbatimin e buxhetit, janë në çdo aspekt material në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet.
Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.
Nga Grupi i Auditimit të KLSH-së u përpilua ky Raporti i Auditimit i cili do ti përcillet Bashkisë Konispol.
Mbi gjetjet e pasqyruara në këtë Projekt Raport Auditimi, nga Konispol do të bëhen observacionet e nevojshme nëse do të ketë dhe do ti kthehet i firmosur KLSH-së për të përgatitur Raportin Përfundimtar të Auditimit.
Auditimi u krye sipas Standardeve të Auditimit dhe në përputhje me kodin e etikës.

b- Indetifikimi i çështjes

Veprimtaria e Bashkisë Konispol si Njësi e Vetëqeverisjes Vendore, bazohet në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
Nga ana jonë, veprimtari me risk, është konstatuar momenti i bashkimit të ish Komunave në zbatim të ligjit nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
Me risk janë vlerësuar veçanërisht, prokurimi i fondeve publike nga Bashkia e Konispol.
Për vitet 2016-2017, nga Bashkia Konispol, janë zhvilluar gjithsej 26 procedura tenderimi me fondin limit gjithsej 547,424 mijë lekë pa tvsh nga të cilat;
Në vitin 2016, janë zhvilluar 12 procedura tenderimi me fond limit 273,499 mijë lekë pa tvsh dhe për vitin 2017, janë zhvilluar 14 procedura tenderimi me fondin limit 273,925 mijë lekë pa tvsh.

c- Përgjegjësitë e drejtimit.

Administratori i Përgjithshëm (Nëpunësi autorizues) z. SH.B. Kryetar i Bashkisë Konispol dhe (Nëpunësi zbatues) z. E.D. Drejtor i Drejtorisë së Financës, janë përgjegjës për shpenzimet e fondeve publike, administrimin e aseteve dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirë funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.
Administratori i përgjithshëm dhe Drejtori i Drejtorisë së Financës janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Konispol.
Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 34, pika 6. "Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore".
Neni 91. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:
a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
b)vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për Hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.
Neni 65; "Administrata e njësisë administrative", pika 1. "Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori".

d- Përgjegjësitë e audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të mund të shprehë një opinionin mbi saktësinë, vërtetësinë, rregullshmërinë e transaksioneve financiare dhe besueshmërinë e raportimit të pasqyrave financiare.

Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, sipas INTOSAI.

Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse transaksionet financiare janë në përputhje me ligjet, të japë vlerësim të arsyeshëm nëse sistemi i kontrollit garanton kontrollin e nevojshëm për aktivitetin ekonomik dhe financiar dhe nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesi vlerëson nivelin e kontrollit të brendshëm që është relevant në entitet, në mënyrë që të programojë procedura auditimit që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

e- Kriteret e vlerësimit

Kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu janë referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit janë ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";

-Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar;

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik".

-UMF nr. 14, datë 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre", i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

-Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

-Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë *pragun e materialitetit prej 2%, për vlerën 6514000 lekë për vitin 2016 dhe 8499000 lekë për vitin 2017* për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

f- **Standardet e auditimit**

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

-ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

-ISSAI 200 - (Parimet themelore të auditimit financiar) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare,

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve IFAC,

-Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve,

-Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin financiar",
-Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS),
Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:
Kontrolli aritmetik.
Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.
Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.
Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
Kontrolli i vlerësimit.
Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
Konfirmim nga të tretët,
Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
Kontrolli sipas një treguesi.
Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

I. PËRMBLEDHJE E PUNËS SË KRYER

Përmbledhja evidenton në mënyrë të përgjithshme të gjitha problematikat që kanë dalë gjatë ushtrimit të auditimit si dhe që janë materiale, duke i radhitur dhe grupuar ato sipas prioriteteve dhe çështjeve e nën çështjeve të përcaktuara në Programin e Auditimit. Në të përfshihen të gjitha gjetjet e auditimit të vlerësuara përsa i përket materialitetit, ligjshmërisë dhe evidencës faktike. Trajtimi i çështjeve do të ndjekë rrjedhën e përcaktuar në Programin e Auditimit.
Në vijim sipas pikave të programit të auditimit po paraqesim një përmbledhje të punës së kryer:

A. 3.1. Testimi i funksionimit të kontrolleve kryesore të entitetit, përfshi zbatimin e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Nga auditimi mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të entitetit Bashkia Konispol në përputhje me kërkesat ligjore, u konstatua:
1-Mjedisi i kontrollit (Në zbatim të kërkesave të nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).
-Bashkia e Konispolit, *nuk ka miratuar kodin e etikës profesionale* për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të njësisë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit në pa pajtueshmëri me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit" pika 40 dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19 dhe neni 16 pika 2.
-Rregullorja mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së bashkisë Konispol dhe Njësive Administrative, është miratuar me vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 1, datë 05.01.2017

Lidhur me rekrutimin e punonjësve në marrëdhëniet e punës:
Për vitin 2016
Struktura Organizative e Bashkisë Konispol, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjin nr.115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore", ligjit nr. 152/2013 ''Për Nëpunësin Civil'' si dhe aktet të tjera nënligjore, është miratuar me vendime të Këshillit të Bashkisë VKB nr.1, dt. 18.01.2016, dhe VKB, nr. 23, dt. 12.05.2016, për numrin maksimal të punonjësve.
Numri total i punonjësve është miratuar për 108 punonjës përfshi numrin e punonjësve në Njësitë Administrative, nga të cilat:
Administrata e Bashkisë përbëhet nga 32 punonjës, Njësitë Administrative:10 punonjës, Drejtoria e Shërbimeve, 52 punonjës, Arsimi 9 punonjës dhe Policia Bashkiake 5 punonjës.
Nga totali prej 108 pozicione pune, 22 janë pozicione të shërbimit Civil dhe 86 trajtohen me Kod Pune.
Duke u mbështetur edhe ne Planifikimin vjetor të pranimeve në punë, nga këto 22 pozicione të Shërbimit Civil, kanë ngelur të paplotësuar 5 pozicione, (4 kategori e ulet drejtuese dhe 1 kategori ekzekutive), ndërsa 86 pozicionet e tjera që trajtohen me Kod Pune janë plotësuar gjate vitit.

Për vitin 2017
Struktura Organizative e Bashkisë Konispol, mbështetur në ligjin.Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjin Nr.115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore", ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" si dhe aktet të tjera nënligjore, është miratuar me vendime të Këshillit të Bashkisë VKB.Nr. 51, dt. 08.12.2016, për numrin maksimal të punonjësve.
Numri total i punonjësve është miratuar për 121 punonjës përfshi numrin e punonjësve në Njësitë Administrative, nga të cilat:
Administrata e Bashkise përbëhet nga 35 punonjës, Njësitë Administrative, 10 punonjës, Drejtoria e Shërbimeve, 61 punonjës, Arsimi 10 punonjës dhe Policia Bashkiake 5 unonjes.
Nga 24 pozicione pune me statusin e Nëpunësit Civil, kane ngelur të pa plotësuar 6 pozicione pune, (4 kategori e ulet drejtuese dhe 2 kategori ekzekutive), ndërsa 97 pozicionet e tjera trajtohen me Kod Pune të cilat janë plotësuar përgjatë vitit.
Emërimet në punë, janë kryer me procedurat e ligjit Nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" duke ndjekur procedurat e lëvizjes paralele, pranimit në kategorinë ekzekutive, transferimit dhe ngritjes në detyrë për pozicionet e shërbimit Civil dhe në Ligjin. Nr.7961 dt. 12.07.1995 ''Kodi i Punës" për 97 pozicionet e tjera.
2- Menaxhimi i riskut (Në zbatim të kërkesave të nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).
Nga titullari i Njësisë Administrative, nuk është caktuar koordinatori i riskut dhe për rrjedhojë nuk janë identifikuar sistemet e kontrollit me më shumë risk dhe nuk është miratuar strategjia për menaxhimin e tij.
Nuk është hapur regjistri i riskut dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij.
Megjithatë, nga ana e subjektit Bashkia Konispol, është përpiluar pyetësori i vetëvlerësimit mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit si dhe Raporti mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.
Ky vetëvlerësim i është dërguar Ministrisë së Financave me shkresën nr. 394 prot., datë 12.04.2017.

3-Veprimtaritë e kontrollit (Në zbatim të kërkesave të nenin 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Nga ana e Titullarit të Bashkisë Konispol, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit, por njësitë organizative kanë të përcaktuar detyrat e tyre në rregulloren e funksionimit të brendshëm të institucioni.

Në përputhje më kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 27 është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), krijuar me urdhër të titullarit të bashkisë nr. 11, datë 20.03.2017.

GMS, është krijuar me 7 anëtarë me kryetar z. SH.B.i- Kryetar i bashkisë Konispol dhe anëtarë: K.K., E.D., A.B., M.S., H.K. dhe L.T.

Me këtë urdhër, janë krijuar edhe 4 grupet sipas programeve përkatëse:

-Programi i Planifikim Menaxhim Administrim,

-Programi i shërbimeve publike,

-Programi i Menaxhimit të Infrastrukturës dhe Planifikimit të Territorit,

-Programi i Infrastrukturës Sociale (Arsim, sporti, kultura dhe kujdesi social)

Veprimtaria e GMS, nuk ka qenë në përputhje me kërkesat ligjore, për arsye se:

-GMS, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet, kërkesë e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 32.

-GMS, nuk ka miratuar programe buxhetore afat mesëm 2- vjeçare, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat e përgatitjes së Buxhetit afatmesëm", kap. V, pikat 93-116.

4- Informacioni dhe komunikimi (Në zbatim të kërkesave të nenin 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Informimin dhe komunikimi, realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm.

Përveç kësaj mënyre, informimi realizohet edhe nëpërmjet publikimeve dhe njoftimeve të adresuara për publikun veçanërisht lidhur me vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". Ky lloj komunikimi me shkrim ose në mënyrë elektronike për rastet e shërbimeve nga Zyra e Urbanistikës, në zbatim të kërkesave ligjore, ligji nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit".

5-Monitorimi (Në zbatim të kërkesave të nenin 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010).

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisionet përkatëse si për marrjen në dorëzim të punimeve të kontraktuara, në rastet e identifikimit të detyrimeve për tatim taksat lokale etj.

Një formë e monitorimit, është deklarata e vetëvlerësimit të sisteme të kontrollit të brendshëm.

Por u konstatua se për monitorimin e sistemeve dhe vlerësimin e funksionimit të tyre, për periudhën e viteve 2016 dhe 2017, nuk ka funksionuar dhe nuk është organizuar struktura e auditimit të brendshëm megjithëse është parashikuar krijimi i saj në strukturën organizative, me argumentimin për mungesë personeli.

<u>Në përfundim</u>:

Nga Bashkia Konispol, nuk janë marrë masat e nevojshme për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar:

-Bashkia e Konispolit, nuk ka miratuar kodin e etikës profesionale për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të njësisë.

-Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit.

-Nga titullari i Njësisë Administrative, nuk është caktuar koordinatori i riskut dhe për rrjedhojë nuk janë identifikuar sistemet e kontrollit me më shumë risk dhe nuk është miratuar strategjia për menaxhimin e tij. Nuk është hapur regjistri i riskut dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij.

-Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), por ai nuk ka funksionuar. GMS-ja nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet.

Mosveprime në kundërshtim me kërkesat e nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", nenet 4, 16, 20, 21, UMF nr. 2, datë 6.02.2012 "Për procedurat standart të zbatimit të buxhetit" pika 40, ligjit nr. 68-2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 32 dhe UMF nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat e përgatitjes së Buxhetit afatmesëm", kap. V, pikat 93-116.
Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. SH.B.I me detyrë Kryetar i Bashkisë Konispol dhe zj. K.K. me detyrë zv. Kryetare e Bashkisë.

B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit dhe në ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017", me ndryshimet e tij.
1.1. Programimi i PBA 2017-2019 dhe programimi i buxhetit të vitit 2016, 2017.
1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet e tij gjatë vitit sipas Akteve Normative.
1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruar në raportet e monitorimit.
1.4. Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të institucionit dhe të njësive të varësisë, si dhe zbatimi i dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre.
B.1.1, 1.2, 1.3 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit dhe në ligjin nr. 130-2016, datë 17.12.2016 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017.
Për auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Vendimet e këshillit të bashkisë mbi miratimin e buxheteve të viteve 2016 dhe 2017.
Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet e viteve 2016 dhe 2017.
Evidenca mbi realizimin faktik të investimeve për vitet 2016 dhe 2017.
Të tjera dokumente pune. Etj.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
Për vitin 2016.
-Për vitin 2016, buxheti i Bashkisë Konispol, është miratuar me vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 7, datë 23.02.2016, konfirmuar me shkresën e Prefektit të Qarkut Vlorë me nr. 756 prot., datë 11.03.2016.
-Të ardhurat e veta të bashkisë për vitin 2016, janë programuar gjithsej 124,523 mijë lekë, nga të cilat:
-Të ardhurat nga tatim taksat lokale për vitin 2016 janë 43,907 mijë lekë,
-Të ardhura të trashëguara nga viti 2015, janë 13,660 mijë lekë,
-Transferta e pa kushtëzuar (Granti) 57,887 mijë lekë dhe
-Mjete në ruajtje (Garanci punimesh) 9,069 mijë lekë.
Realizimi i tregueseve të buxhetit, sipas aktit të rakordimit me degën e thesarit, janë si në pasqyrën që vijon:

Realizimi i buxhetit sipas natyrës së shpenzimeve paraqitet në 000 lekë

Nr	Emërtimi i A...Ikullit të shpenzimeve	Viti 2016		
		Plani	Fakti	%
1	600 Shpenzime për pagat	47,772	40,266	84
2	601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore	7,664	6,693	87
3	602 Shpenzime operative	35,669	35,720	100
4	604 Ndihmat ekonomike	43,544	43,544	100
5	606 Shpërblim lindje	3,353	270	8
6	230 Studime projektime	500	462	92
7	231 Investime objekte	326,203	198,449	61
8	466 Mjete në ruajtje	10,278	301	34
	TOTAL	474,983	325,705	69

Planifikimi i shpenzimeve nga granti i pa kushtëzuara dhe nga të ardhurat lokale janë si në pasqyrën që vijon:

Nr	Emërtimi	000/Lekë

1	600	46,302
2	601	7,419
3	602	32,292
4	604	1,483
5	466	9,069
6	609 (F. Rezervë)	1,600
7	230	500
8	231	25,858
	Shuma	124,523

Planit të investimeve (miratuar me miratuar me vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 7, datë 23.02.2016) nga grandi i pa kushtëzuara dhe të ardhurat lokale sipas objekteve, janë si në pasqyrën që vijon:

Nr	Emërimi I objekteve	A...Ikulli 230	231	Shuma 000/lekë
1	Studim projektim	500	0	500
2	Blerjë pajisje		3,907	1907
3	Blerjë pajisje		200	200
4	Blerje pajisje për zyrë		350	350
5	Rikonstr. Rruge të brendshme		20,721	20,721
6	Rikonstr. Pastrim kullota		680	680
	Shuma	500	25,178	26,358

-Me vendim të këshillit të bashkisë nr. 9, datë 23.02.2016, janë miratuar projektet prioritare të investimeve për vitin 2016, janë miratuar 10 projekte sipas objekteve, nga të cilat 5 prej tyre nuk janë shoqëruar me çmimet përkatëse. Vendimi është konfirmuar nga Prefekti Qarkut Vlorë me shkresën nr. 756 prot., datë 11.03.2016 me të dhënat sipas pasqyrës që vijon:

Nr	Emërtimi	Vlera Lekë
1	Rikonstr. Sistemit të furnizimit me ujë Konispol	192,881,131
2	Reabilitim I unëzës ekonomike, B. Konispol	226,395,639
3	Reabilitim Rrugëve ndërmjet parcelave të Rahut	91,715,550
4	Reabilitim Kanaleve Vaditëse	24,061,710
5	Pastrim Kanalesh Kulluese	61,100,000
6	Rikonstruksion rrugëve të brendshme të fshatrave	0
7	Rikonstr. Shkollës së mesme Përgjithshme Bido Sejko Konispol	0
8	Ndërtim kopështi fëmijëve fsahti Shëndëlli (Njësia Xarrë)	0
9	Investim në Ujësjellësa Shalës, Shëndëlli dhe Disaht	0
10	Ndërtim Depo Uji fsahti Xarë (Njësia Xarë)	0
	Shuma	596,154,030

-Me vendim të këshillit të bashkisë nr. 21 datë 12.05.2016, janë miratuar objekte të tjera për investime për vitin 2016 në nivel grupi titulli dhe A...Ikulli në të cilën theksohet se fondi i investimeve është miratuar me vendim të këshillit të bashkisë nr. 7 datë 23.02.2016. Më hollësisht pasqyra si vijon:

Nr	Emërtimi I objektit	A...I kull	Vlera objektit	Nga	
				Grandi	Të ardhurat
1	Blerje kompjutera dhe fotokopje	231	700,000	700,000	
2	Blerje makinë për administratën	231	3,850,000	2,643,000	1,207,000
3	Blerje instrumenti topografik	231	560,000	560,000	
4	Blerje Skrepi dhe makine për shërbime publike	231	4,200,000	4,200,000	
5	Sistemim varëza fshati Markat	231	954,421	954,421	
6	Sistemim varëza fshati Janjar	231	955,583	955,583	
7	Sistemim I ujrave të zeza fshati Xarë	231	959,616	959,616	
8	Sistemim I varezave fshati Shalës	231	2,029,359	2,029,359	
9	Rikonstruksion rruge fshati Ninat (rruga e varezave)	231	1,652,574	1,652,574	
10	Rikonstruksion I rrugës Shalës- Dishat	231	2,100,000	2,100,000	
11	Rikonstruksion rruge fshati Markat	231	414,119	414,119	
12	Rikonstr. rruge fshati Xarë përgjatë fushës së futbollit	231	1,437,915	1,437,915	
13	Rikonstr. rruge fshati Mursit (Qendër diga e Liqenit)	231	2,708,281	2,708,281	
14	Rikonstruksion rrugës lagja e re postobllok Konispol	231	442,370	92,370	350,000
15	Rikonstruksion rruga (ABello-F Bace) Pjesore	231	2,773,762	2,773,762	
	Totali		25,178,000	23,621,000	1,557,000

Pasqyra mbi realizimin faktik të shpenzimeve për investime sipas objekteve për vitin 2016, është si vijon:

Nr	Emërtimi I objektit	A...Ikull	Plani	Realizimi	%
1	Rikonstruksion ujësjellësi Markat	231	6,972,539	6,972,539	100
2	Rikonstruksion Ujësjellësi Konispol	231	42,301,558	40,171,461	95
3	Rikonstruksion Qendra Konispol	231	52,524,830	52,510,701	100
4	Rikonstruksion Shkolla Konispol	231	80,287,992	80,284,464	100
5	Rikonstruksion Unaza Ekonomike Shkallë Murzi	231	60,267,044	0	0
6	Blerje Skrepi bujqësie	231	16,347,131	0	0
7	Reabilitim Kanaleve vaditëse Rraha	231	33,015,148	0	0

8	Reabilitim Kanale Vaditëse Shalës	231	14,100,000	0	0
9	Studime projektime	230	500,000	461,955	92,4
	Shuma		306,316,242	180,365,120	58,8

-Treguesit e buxhetit faktik janë miratuar me vendim të këshillit të bashkisë nr. 10, datë 21.02.2017, I konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 504 prot., datë 13.03.2017. Sipas këtij miratimi të ardhurat nga tatim taksat lokale janë programuar në shumën 43,907 mijë lekë dhe janë realizuar në fakt për vlerën 44,004 mijë lekë ose realizuar në masën 100,2 %.
-Për vitin 2016, është respektuar kushti që jo më pak se 40% e transfertës së grandit të pa kushtëzuar të përdoret për investime. Transferta e pa kushtëzuar është 58,040,000 lekë, miratuar për investime vlera 25,858,000 lekë ose 44,5% e grandit, në përputhje me UMF nr. 1, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016".
Për vitin 2016, fondi rezervë është programuar për vlerën 700,000 lekë por nuk është përdorur gjatë vitit. Fondi i kontigjencës është programuar në shumën 900,000 lekë.
Gjatë vitit, Bashkisë Konispol, i janë alokuar fonde për investime sipas objekteve nga Buxheti i shtetit në 6 raste sipas të dhënave si më poshtë:

Akordimi i fondeve nga buxheti i shteti , grandi i kushtëzuar për vitin 2016:
1-Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 3989/2 prot., datë 30.03.2016, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve.
Çelja llog. 231, Objekti: "Rikonstruksion I sheshit qendër të qytetit". Vlera e plotë e projektit 54,594,958 lekë, vlera e kontratës 43,764,730 lekë, vlera e financimit për vitin 2015 për 5,459,496 lekë, financimi për vitin 2016 për 38,305,234 lekë.
2-Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 14880/2prot., datë 4.11.2015, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve.
Çelja llog. 231, Objekti: "Rikonstruksion I sheshit qendër të qytetit". Vlera e plotë e projektit 54,594,958 lekë, vlera e financimit për vitin 2015 per 5,459,496 lekë, financimi për vitin 2016 për 49,135,462 lekë.
3-Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 1191/2 prot., datë 7.03.2016, çelje fondi për investime.
Çelja llog. 231, Objekti: "Rikonstruksion I sistemit të furnizimit me ujë, Konispol". Vlera e plotë e projektit 41,800,000 lekë.
Çelja llog. 231, Objekti: "Ndërtim ujësjellësi Markat-Ninat dhe rrjeti i brendshëm Loto 1" Konispol". Vlera e plotë e projektit 6,912,239 lekë.
Çelja llog. 231, Objekti: "Supervizion punimesh për objektin "Ndërtim ujësjellësi Markat-Ninat dhe rrjeti I brendshëm Loto 1" Komuna Markat. Vlera e plotë 60,300 lekë.
Çelja llog. 231, Objekti: "Supervizion punimesh për objektin "Rikonstruksion I sistemit të furnizimit me ujë" Konispol". Vlera e plotë 501,558 lekë.
4- Vendimi nr. 47, datë 5.12.2016 I Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, botuar në gazetën Zyrtare nr. 238 viti 2016.
Celja llog. 231, Objekti: "Rikonstruksion ndërtim palestre e shkollës së bashkuar "Bejko Sejko" Konispol.". Vlera e plotë e projektit 80,379,965 lekë, vlera e kontratës 80,287,992 lekë, vlera e financimit për vitin 2016 për 40,189,983 lekë, vlera e fondit që i shtohet financimit të vitit 2016.
5-Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 6712/1, datë 19.05.2016, çelje fondi për investime.
Çelja llog. 231, Objekti: "Rikonstruksion + ndërtim i palestrës së shkollës së bashkuar "Bejko Sejko", Konispol (FZHR). Vlera për tu financuar për vitin 2016 është 40,189,983 lekë.
6- Mungon referenca thuhet nga viti 2017.
Çelja llog. 231, Objekti: "Rikonstruksion I kanalit ujitës 17-s2 (Lugjeve)" vlera lekë 16,975,200 lëkë.
Çelja llog. 231, Objekti: "Skema ujitëse SR-U-2, kanali V55, vlera lekë 11,666,660 lekë.

-Gjatë vitit 2016, janë kryer procedura prokurimi me tender me financime nga të ardhurat lokale të Bashkisë Konispol si dhe nga grandet e kushtëzuar sipas të dhënave të pasqyrës që vijon:

Nr	Objektiprokuruar	Burimi i financimit		Dt. Zhvillim tenderi	Fondi limit pa tvshnë 000/lek	Vlera ofertës fitues pa tvsh në 000/lek	Diferenca nga fondi limit në 000/lek	Vl. Kontrate pa tvsh në 000/lek
		Tëardhurat e Bashkisë	Grande					
1	Rikonstruksion +ndertim i ipalestres "BidoSejko" Konispol		Grandii arsimit	28.6.2016	66,983,304	66906660	76,644	66906660
2	Rikonstruksion i irrjetit te furnizimit me uje te qytetit Konispol		M.Transportit dhe Infrastrukt.	21.10.2016	158,339,371	155750971	2,588,400	155750971
3	Rikonstruksioni I rrjetit te furnizimit me uje te qytetit Konispol		M.Transportit dhe Infrastrukt.	11.11.2016	1,624,302	1460000	164,302	1460000
4	Rehabilitimi i infrastruktures vaditese Sherret-Rraha		Ministria e Bujqesise	18.11.2016	27,108,226	26583238	524,988	26583238
5	Blerje Automjeti Fuoristrade	Teardhurat e Bashkise		13.06.2016	3,200,000	2920000	280,000	2920000
6	Blerje Automje te pune	Teardhurat e Bashkise		13.06.2016	3,500,000			
7	Blerje Automjet e pune	Teardhurat e Bashkise		07.07.2016	3,500,000			
8	Blerje Automjet e pune	Teardhurat e Bashkise		04.11.2016	3,500,000	3,500,000	-	3,500,000
9	Rikonstruksion rruge Fshati Mursi (Diga e Liqenit)	Teardhurat e Bashkise		19.08.2016	2,402,116	2303980	98,136	2303980
10	Sistemim dhe rrethim i siperfa qe shteset e varrezave ne Fshatin Shales	Teardhurat e Bashkise		25.7.2016	1,691,132	1641320	49,812	1641320
11	Rikonstruksion rruga e re lagjia e shkolles Konispol	Teardhurat e Bashkise		07.10.2016	3,584,395	3417200	167,195	3417200
12	Rikonstruksion i rrugeve te fshatit Ninat (rruga e Varrezave)	Teardhurat e Bashkise		9.10.2016	1,377,145	1375980	1,165	1375980
13	Rikonstruksion i rrugeve te fshatit xarre (Fusha e Sportit)	Teardhurat e Bashkise		07.10.2016	1,198,263			
14	Rikonstruksion I rrugeve te fshatit xarre (Fusha e Sportit)	Teardhurat e Bashkise		14.11.2016	1,198,263	1174900	23,363	1174900
15	Blerje karburanti per automjetet e Bashkise per vitin 2016	Teardhurat e bashkise			2,077,000			
16	Blerje karburanti per automjetet e Bashkise per vitin 2016	Teardhurat e bashkise			2,077,000	marzh 10.3%		
	TOTALI 2016				282,162,254			

-Nga të dhënat e pasqyrave si më sipër, konstatohet:
Se në dy raste, janë prokuruar objekte me financime nga grandet e kushtëzuara, nga buxheti i shtetit (Ministria e e Bujqësisë), të cilat nuk kanë kaluar për miratim në këshillin e Bashkisë:
Objekti: "Rikonstruksion plus ndërtimi i palestrës "Bido Sejko" Konispol. Fondi limit pa tvsh 66,983,304 lekë, data e zhvillimit të tenderit 19.07.2016. Ky investim është miratuar në këshillin e bashkisë si objekt pa vlerë.
Objekti: "Reabilitim i infrastrukturës vaditëse Sheret-Rraha. Fondi limit 27,108,226 lekë pa tvsh, data e zhvillimit të tenderit 27.12.2016.

Si përfundim, në programimin dhe zbatimin e buxhetit për vitin 2016, u konstatuan këto shkelje ligjore:
1-Buxheti është miratuar me vendim të këshillit të Bashkisë datë nr. 7, datë 23.02.2016, gjë e cila nuk është brenda afateve ligjore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006

"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar neni 32, ku përcaktohet afati brenda muajit Nëntor të vitit paraardhës dhe UMF nr. 8, datë 29.3.2012 "Procedurat e përgatitjes së buxhetit afatmesëm", kap. V, pika 92.
2-Nuk është raportuar në Këshillin e Bashkisë brenda muajit Qershor mbi zbatimin e buxhetit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar neni 47.
3-Nuk janë miratuar brenda muajit Qershor në këshillin e Bashkisë kërkesat buxhetore afat mesëm për periudhën 3 vjeçare, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 29.3.2012 "Procedurat e përgatitjes së buxhetit afatmesëm", kap. IV, pika 76, kap. V pika 94, UMF nr. 4-1, datë 29.02.2016 "Për përgatitjen e buxhetit vendor" kap. II, IV.
4-Në dy raste të investimeve nga grandet e kushtëzuara për vlerë të fondit limit 94,091,530 lekë, nuk janë paraqitur në Këshillin e Bashkisë për miratim të objekteve, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat e përgatitjes së buxhetit afatmesëm" kap. I, pika 5, germa b ku citohet: "Kërkesat buxhetore të çdo njësie të qeverisjes së përgjithshëm përmbajnë; shpenzimet kapitale, listën e projekteve të investimeve për çdo program me: koston e plotë të projekteve, ... vlerën e parashikuar për tu financuar në vitin buxhetor ...".
5-Të gjitha objektet e tenderuara për vitin 2016, nuk janë miratuar më parë me nga Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe në kuadër të miratimit të Programeve Buxhetore Afatmesëm, në kundërshtim me kërkesat e UMF Plotësues me nr. 1, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016", pika 12-e.

V. 2017
-Për vitin 2017, buxheti i Bashkisë Konispol, është miratuar me vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 11, datë 21.02.2017, konfirmuar me shkresën e Prefektit të Qarkut Vlorë me nr. 504 prot., datë 13.03.2017.
Të ardhurat e veta të bashkisë për vitin 2017, janë programuar në shumën 297,586 mijë lekë nga të cilat:
-Të ardhurat nga tatim taksat lokale për vitin 2017 janë 66,270 mijë lekë,
-Të ardhura të trashëguara nga viti 2016, janë 137,957 mijë lekë,
-Transferta e pa kushtëzuar (Granti) 74,584 mijë lekë dhe
-Mjete në ruajtje (Garanci punimesh) 18,775 mijë lekë.
Realizimi i treguesve të buxhetit sipas akt rakordimit me degën e thesarit, janë si në pasqyrën që vijon:
Në 000 lekë.

Nr	Emërtimi i A...Ikullit të shpenzimeve	Viti 2017		
		Plani	Fakti	%
1	600 Shpenzime për pagat	60,883	55,713	92
2	601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore	9,781	9,304	95
3	602 Shpenzime operative	60,422	47,368	78
4	604 Ndihmat ekonomike	46,447	46,022	99
5	606 Shpërblim lindje	31,481	420	13
6	230 Studime projektime	500	311	62
7	231 Investime objekte	255,444	260,019	102
8	466 Mjete në ruajtje	18,775	5,817	31
	TOTAL	483,733	424,974	88

Të dhënat mbi planifikimin e shpenzimeve nga granti i pa kushtëzuara dhe nga të ardhurat lokale, janë si në pasqyrën që vijon:

Nr	Emërtimi	000/Lekë
1	600	58,687
2	601	9,414
3	602	53,299
4	604	0
5	466	18,775
6	609 (F. Rezervë)	1,800
7	230-231	155,611
	Shuma	297,586

I. Pasqyra e planit të investimeve v. 2017 (sipas miratimin në planin e buxhetit) nga grandi i pa kushtëzuara dhe të ardhurat lokale janë sipas objekteve:

Nr	Emërimi I objekteve	A...Ikulli 230	231	Shuma 000/lekë
1	Studim projektim	500		500
2	Blerje paisje për Aparatin		1,192	1,192
3	Rikonstruksion Vorreza, Ujësjellës		6,346	6,346
4	Rikonstr. Kopështe Shkolla		3,340	3,340
5	Rikonstr. Rrugë të brenshme		20,200	20,200
6	Rikonstr. Pastrim kullota		300	300
7	Reabilitim kanal vaditës		47,105	47,105
8	Blerje skrep bordi I kullimit		16,347	16,347
9	Unaza ekonomike Shkallë-Murzi		60,267	60,267
10	Rikostruksion Qendër Konispol		14	14
	Shuma	500	155,111	155,611

II. Me vendim të këshillit të bashkisë nr. 14, datë 30.03.2017, janë miratuar projektet prioritare të investimeve për vitin 2017, janë miratuar 13 projekte objektesh nga të cilat 2 prej tyre nuk janë shoqëruar me çmimet përkatëse. Vendimi është konfirmuar nga Prefekti Qarkut Vlorë me shkresën nr. 715 prot., datë 13.04.2017. Pasqyra si vijon:

Nr	Emërtimi	Vlera Lekë
1	Rikonstr. Shkollës së mesme Mehmet Xhaferi, Xarë.	69,518,321
2	Ndërim Qendrës Shëndetësore Vrinë.	3,162,339
3	Ndaërtim pusetave kolektive në ujësjellësin fshati Shalës.	4,845,478
4	Rikualifikim urban Konispoli faza e dytë.	78,837,246
5	Reabilitim infrastrukturës dhe mobilim urban Vrinë	42,973,525
6	Riabilitim kanalit vaditës V55 në fshatin Vrinë	17,944,780
7	Riabilitim I unazës ekonomike Bashkia Konispol Loti 2	166,128,595
8	Ndërtim kopështi Shëndëlli	2,999,879
9	Ndërtim ura kalimi dhe tombino Janjar	1,593
10	Rikonstruksion rrugë të brendshëm të fshatrave	0
11	Sistemime në kopështe dhe shkolla në fshatrat e Bashkisë Konispol.	0
12	NdA...Im I linjës së ujësjellësit Depo-Tharese Mursi.	10,012,303
13	Ndërtim I rjetit shpërndarës Ninat.	26,016,774
	Shuma	422,440,833

III. Plani i investimeve në total për vitin 2017 sipas objekteve dhe vlerave (të miratuara me treguesit e buxhetit për vitin 2017) , është si në pasqyrën që vijon:

Nr	Emërtimi I objektit	Art	Vlera lekë
1	Studime dhe kërkime	230	500,000
2	Blerje automjeti policia bashkiake	231	1,192,000
3	Sistemim I bllokut të banimit Xarë	231	4,891,109
4	Rikonstruksion rruge Xarë	231	905,173
5	RikonstruksionRruge Ciflik	231	926,927
6	Rikonstruksion rruge Markat	231	429,393
7	Sistemim sheshi Qendër Janjar	231	722,118
8	Rikonstruksion rruge të brendshme Janjar	231	1,593,375
9	Rikonstruksion rruge Konispol	231	1,982,698
10	Rikonstruksion rruge Shalës	231	4,483,949
11	Rikonstruksion Qenra Konispol (Trashëguar nga 2016)	231	364,000
12	Rikonstruksion Rrugë Konispol (Trashëguar nga 2016)	231	2,563,420
13	Rikonstruksion rruge Ninat (Trashëguar nga 2016)	231	1,651,175
14	Ndërhyrje në varezat publike Mursi	231	957,661
15	Ndërhyrje në depon e ujit Ciflik	231	597,012
16	Ndërhyrje në vareza Janjar	231	543,036
17	Ndërhyrje në ujësjellësin Shalës	231	4,248,466
18	Rrethim kopështi Ciflik	231	340,330
19	Ndërtim kopështi Shëndëlli	231	2,999,879
20	Rehabilitimi I infrastrukturës vaditëse Rraha	231	33,005,148
21	Reabilitimi I kanaleve vaditëse Shalës Markat	231	14,100,000
22	Blerje skrep bordi I Kullimit	231	16,347,131
23	Unaza ekonomike Shkallë Mursi	231	60,267,000
	Shuma Totale		155,611,000

Pasqyra mbi realizimin e shpenzimeve për investime sipas objekteve për vitin 2017, është si vijon:

Nr	Emërtimi I objektit	A...Ikulli	Plani	Realizimi	%
1	Rikonstruksion ujësjellësi Konispol	231	40,815,000	40,630,383	99,5

2	Rikonstruksion Ujësjellësi Ninat	231	5,722,000	5,600,000	97,9
3	Rikonstruksion Ujësjellësi Mursi	231	2,095,000	0	0
4	Rikonstruksion Qendra Konispol	231	15,266,580	15,266,580	0
5	Rikonstr. Unaza Ekonomike Shkallë Murzi	231	60,267,044	57,550,524	95,5
6	Blerje Skrepi bujqësie	231	16,347,131	16,347,131	0
7	Reabilitim Kanaleve vaditëse Rraha	231	33,005,148	31,897,725	96,6
8	Reabilitim Kanale Vaditëse Shalës	231	14,100,000	13,130,523	93,1
9	Rikonstruksion shkolla Xarrë	231	27,807,328	27,807,328	100
	Shuma		215,425,231	208,230,194	96,6

Akordimi i fondeve nga buxheti i shtetit , grandi i kushtëzuar për vitin 2017:
1-Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 1727/1 prot., datë 29.12.2016, çelje fondesh.
Celja llog. 231, Objekti: "Riabilitim i kanalit Shalës-Markat". Vlera e plotë e projektit 14,100,000 lekë.
2-Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 14123/1 prot., datë 26.10.2016, celje fondesh.
Celja llog. 231, Objekti: "Riabilitim I infrastrukturës vaditëse të fushës së Rahut" Vlera e plotë e projektit 33,005,148 lekë.
3-Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 14781/1 prot., datë11.11.2016, celje fondesh.
Celja llog. 231, Objekti: "Blerje eskavator me zinxhir" Vlera e plotë e projektit 16,347,131 lekë.
4-Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 17585 prot., datë28.12.2016, celje fondesh.
Celja llog. 231, Objekti: "Reabilitim I unazës ekonomike Loti 1 shkallë Mursi" Vlera e plotë e projektit 60,267,044 lekë.
5-Me shkresën e Ministrisë sëTransportit nr. 964/3 prot., datë8.03.2017, celje fondesh.
Celja llog. 231, Objekti: "Rikonstruksion I sistemit të furnizimit me ujë, Konispol", buxheti viti 2017 për 40,000,000 lekë, për vitin 2018 për 97,005,592 lekë dhe për vitin 2019 për 12,830,193 lekë.
Celja llog. 231, Objekti: "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat", buxheti viti 2017 për 5,600,000 lekë, për vitin 2018 për 10,000,000 lekë dhe për vitin 2019 për 12,152,651 lekë.
Celja llog. 231, Objekti: "Ndërtim I linjës së ujësjellësit (depo tharëse) fshati Mursi", buxheti viti 2017 për 2,050,000 lekë, për vitin 2018 për 8,106,343 lekë dhe për vitin 2019 për 0 lekë.
Celja llog. 231, Objekti: "Supervizim punimesh Rikonstruksion I sistemit të furnizimit me ujë Konispol", buxheti viti 2017 për 815,000 lekë, për vitin 2018 për 1,215,378 lekë dhe për vitin 2019 për 0 lekë.
Celja llog. 231, Objekti: "Supervizim punimesh për objektin "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat", buxheti viti 2017 për 122,000 lekë, për vitin 2018 për 200,000 lekë dhe për vitin 2019 për 286,550 lekë.
Celja llog. 231, Objekti: "Supervizim punimesh për objektin "Ndërtim i linjës së ujësjellësit (depo tharëse) fshati Mursi", buxheti viti 2017 për 45,000 lekë, për vitin 2018 për 175,270 lekë dhe për vitin 2019 për 0 lekë.
6-Me shkresën e Ministrisë sëFinancave nr. 4287/2 prot., datë 07.4.2017, celje fondesh.
Celja llog. 231, Objekti: "Rjetëzimi i asamblit urban të qendrës, Konispol", celje 2017 për 23,493,862 lekë.
7-Me shkresën e Ministrisëe Zhvillimit Urban nr. 2420 prot., datë19.04.2017, celje fondesh.
Celja llog. 231, Objekti: "Rjetëzimi i asamblit urban të qendrës, Konispol", celje 2017 për 23,493,862 lekë.
8-Me shkresën e Ministrisësë Financave nr. 4292/3 prot., datë14.4.2017, celje fondesh.
Celja llog. 231, Objekti: "Rikonstruksion I shkollës 9 vjecare "Mehmet Xhaferi" + kopësht", vlera e plotë e projektit 69,518,321 lekë, për tu financuar në vitin 2017 për 27,807,328 lekë.
9-Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 1848/6 prot., datë 28.04.4.2017, celje fondesh.
Celja llog. 604, Objekti: "Ndërhyrje emergjente argjinatura, lumi Pavëll", vlera e plotë e projektit 28,618,375 lekë, për tu financuar në vitin 2017.
-Për vitin 2017, fondi rezervë është krijuar në shumën 500,000 lekë kurse fondi i kontigjencë është në shumën 900,000 lekë.

Fondi rezervë është përdorur me VKB nr. 37 datë 2.11.2017 për blerje pajisje zyrash në shumën 400,000 lekë.
Mbi miratimin me vendime të Këshillit të Bashkisë të investimeve me procedurë tenderi.
Të gjitha objektet e tenderuara për vitet 2016 dhe 2017, nuk janë miratuar më parë me nga Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe në kuadër të miratimit të Programeve Buxhetore Afatmesëm, në kundërshtim me kërkesat e UMF Plotësues me nr. 1, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016", pika 12-e.

Objektet e tenderuara për vitin 2017, janë si në pasqyrën që vijon:

Nr	Objektiprokuruar	Burimi i financimit		Dt. Zhvillim tenderi	Fondi limit pa tvshnë 000/lek	Vlera ofertës fitues pa tvsh në 000/lek	Diferenca nga fondi limit në 000/lek	Vl. Kontrate pa tvsh në 000/lek
		Të ardhurat e Bashkisë	Grande					
1	Ndertimi i linjes se ujesjellesit depo tharese fshati Mursi		Buxheti ishtetit	05.06.2017	8,371,120			
2	Ndertimi i linjes se ujesjellesit depo tharese fshati Mursi		Buxheti I shtetit	27.08.2017	8,371,120	8279310	91,810	8279310
3	Rikonstruksion i ishkolles Mehmet Xhaferi Xarre		Buxheti ishtetit	29.05.2017	57,931,934	57863092	68,842	57863092
4	Nderhyrje Emergjente ne Argjinaturen e Lumit Pavell		Drejtoria e Emergjencave Civile	05.05.2017	23,848,646	23833041	15,605	23833041
5	Ndertimiilinjes se ujesjellesit ne fshatin Ninat		Buxheti ishtetit	05.06.2017	23,134,125	22942320	191,805	22942320
6	Rikonstruksioni I Kanalit furnizues V 55 ne Fushen e Vrines		Buxheti ishtetit	10.11.2017	9,722,221	9399999	322,222	9399999
7	RijetezimiiAnsamblit Urban teQendresKonispol		Buxhet iishtetit	29.05.2017	65,697,705	64665200	1,032,505	64665200
8	Rehabilitimi i Unazes Ekonomike (loti I) Shkalle – Mursi		Buxhet iishtetit	12.02.2017	50,222,533	49005820	1,216,713	49005820
9	Ndertim puseta shkolektive ne fshatin Shales	Teardhurat e bashkise		22.04.2017	4,037,898	3929668	108,230	3929668
10	Rehabilitimi i kanalit vadites Shales-Markat		Buxhet iishtetit	16.02.2017	11,750,000	10,945,425	804,575	10,945,425
11	Blerjekarburanti	Teardhurat e bashkise		20.04.2017	9,475,000	marzh 6.8%		
12	Blerjeautomjeti	Teardhurat e bashkise		17.04.2017	960,000			
13	Blerjeautomjeti	Teardhurat e bashkise		20.05.2017	960,000	910000	50,000	910000
14	Rikonstruksioni rrugevete fshatit Xarre dhe Ciflik	Teardhurat e bashkise		17.04.2017	5,698,449	5519303	179,146	5519303
15	Ndertimi Ure kalimi dhe vendosje tombino ne Fsahtin Janjar	Teardhurat e bashkise		16.05.2017	1,327,812	1303587	24,225	1303587
16	Rikonstruksion rruget e brendeshme Konispol	Teardhurat e bashkise		10.11.2017	1,747,632	1498591	249,041	1498591
	Shuma v. 2017				319,256,195			

-Nga të dhënat e pasqyrave si më sipër, konstatohet:
Se në 1 rast, është prokuruar objekti me financime nga grandet e kushtëzuara, nga buxheti i shtetit (Ministria e e Transportit dhe infrastrukturës), i cili nuk ka kaluar për miratim në këshillin e Bashkisë:
Objekti: "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat". Fondi limit pa tvsh 23,134,125 lekë, data e zhvillimit të tenderit 24.07.2017.

Si përfundim, në programimin dhe zbatimin e buxhetit për vitin 2017, u konstatuan këto shkelje ligjore:
1-Buxheti është miratuar me vendim të këshillit të Bashkisë datë nr. 11, datë 21.02.2017, gjë e cila nuk është brenda afateve ligjore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar neni 32, ku përcaktohet afati brenda muajit Nëntor të vitit paraardhës, UMF nr. 8, datë 29.3.2012 "Procedurat e përgatitjes së buxhetit afatmesëm", kap. V, pika 92 dhe ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 33.
2-Nuk është raportuar në Këshillin e Bashkisë brenda muajit Qershor mbi zbatimin e buxhetit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
3-Nuk janë miratuar brenda muajit Qershor në këshillin e Bashkisë kërkesat buxhetore afat mesëm për periudhën 3 vjeçare, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 29.3.2012 "Procedurat e përgatitjes së buxhetit afatmesëm", kap. IV, pika 76, kap. V pika 94, UMF nr. 4-1, datë 29.02.2016 "Për përgatitjen e buxhetit vendor" kap. II, IV.
4-Në 1 rast të investimit nga grandet e kushtëzuara për vlerë të fondit limit 23,134,125 lekë, nuk është paraqitur në Këshillin e Bashkisë për miratim të objektit, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat e përgatitjes së buxhetit afatmesëm" kap. I, pika 5, germa b ku citohet: "Kërkesat buxhetore të çdo njësie të qeverisjes së përgjithshëm përmbajnë; shpenzimet kapitale, listën e projekteve të investimeve për çdo program me: koston e plotë të projekteve, ... vlerën e parashikuar për tu financuar në vitin buxhetor ...".
6- Për vitin 2017, nuk është miratuar nga këshilli i bashkisë buxheti faktik, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7776, datë 22.12.1993 "Për buxhetin lokal" i ndryshuar neni 25.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
-z. SH.B.i me detyrë kryetar i bashkisë Konispol dhe
-z. E.D. me detyrë përgjegjës i financës.

A. 3.2. Saktësia e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare.

Nga auditimi i llogarive të pasqyrave financiare, u konstatua:
-Plotësimi i pasqyrave financiare.
Nga Bashkia Konispol, janë nxjerrë pasqyrat financiare për periudhën vitin 2016 dhe 2017.
Për vitin 2016, pasqyrat financiare, i janë përcjellë Degës së Thesarit Sarandë sipas shkresës me nr. 317 prot., datë 28.02.2017 dhe për vitin 2017 dhe për vitin 2017, pasqyrat financiare, i janë përcjellë Degës së Thesarit Sarandë sipas shkresës me nr. 248-2 prot., datë 28.02.2018 dhe është brenda afatit ligjor në zbatim të UMF nr. 14 datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive qe varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar Kap. I, pika 3.
-Bashkëngjitur akt konstatimit janë pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe vitit 2017.
Për vitin 2017.
Nga Bashkia Konispol, në përputhje me kërkesat e UMF nr. 14 datë 28.12.2006 i ndryshuar me nr. 26, datë 27.12.2007, janë përgatitur pasqyrat financiare si vijon:
Format nr. 1 –Aktivi i Bilancit.
Format nr. 2 –Pasivi i Bilancit.
Format nr. 3/1 –Shpenzime të ushtrimit.
Format nr. 3/2 –Të ardhura të ushtrimit.
Format nr. 4 –Burimet dhe Shpenzimet të lidhura me investimet.
Format nr. 5 –Pasqyra e Lëvizjes në "Cash".
Format nr. 6 –Gjendja dhe ndryshimi i Aktiveve të Qëndrueshme.

Format nr. 7 –Pasqyra e Amortizimit të Aktiveve të Qëndrueshme.
Format nr. 8 –Pasqyra e Lëvizjes së Fondeve.
-Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike.
U auditua vërtetësia e gjendjes së llogarive inventariale, nëse ato ekzistojnë efektivisht, nëse janë kryer inventarizime në fund të vitit dhe nëse vlera e inventarëve është e njëjtë me vlerën e çdo aktivi të nxjerr në bilanc.
Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale.

-Dhënia e opinionit për saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare. Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar.
Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomiko financiar 01.01.2016 deri më datën 31.12.2016.

Mbi saktësinë e llogarive inventariale të aktivit të bilancit:
Për vitin 2017.
-Llogaria 202. "Studime dhe kërkime". Për vlerën kontable të bilancit për 5,263,601 lekë.
Nga të cilat vlera 4,470,467 lekë përfaqësojnë vlerën e studimeve dhe projekteve për 5 objekte kurse pjesa tjetër në vlerën 793,134 përfaqëson shpenzime në vite për mbikëqyrje të punimeve të investuara.
Nuk janë kryer invetarizime fizike të këtyre studimeve dhe projektimeve.
Mungesa e inventariale për sa janë regjistruar në debi të kësaj llogarie studime dhe projektime, është praktikë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, neni 7- "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve" ku citohet: "1. Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse.
2. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave te miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet te paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri ne pasqyrat financiare vjetore."
dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73.
-Llogaria 210 "Toka troje terrene". Për vlerën kontable të bilancit 24,011,454 lekë.
Për këtë llogari, nuk ka të dhëna analitikë mbi përmbajtjen e kësaj llogarie, nuk disponohen të dhëna se çfarë vlera inventariale përfaqëson vlera debitore e kësaj llogarie.
-Llogaria 212 "Ndërtime konstruksione". Për vlerën kontable të bilancit 392,239,426 lekë.
Kjo llogari është e analizuar për 12 objekte të Bashkisë Konispol për vlerën 201,475,367 lekë. Në këtë vlerë kontable vjetore, është përfshirë edhe llogaria 212 sipas bilancit të ish Komunës Xarë për vlerën kontable prej 31,586,314 lekë për 17 objekte. Diferenca prej (392,239,426-233,061,681)= 96,177,745 lekë përfaqëson vlerën e kësaj llogarie për Ndërtime dhe konstruksione sipas bilancit financiar të ish Komunës Markat për vitin 2015 për të cilën nuk ka regjistër analitik të objekte që I përket kësaj vlere kontabël.
Nuk janë hapur regjistra përkatëse për çdo objekte ku të jenë shënuar viti i prodhimit, vlera kontable, vlera e rikonstruksioneve të bëra në vite, amortizimi i objekteve etj., në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30 dhe ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
Këto objekte nuk janë të regjistrua në ZVRPP Sarandë në pronësi të Bashkisë Konispol.

-Llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore". Për vlerën kontabile të bilancit 966,864,955 lekë. Kjo llogari është e analizuar për 33 objekte të Bashkisë Konispol për vlerën 586,053,470 lekë dhe për ish Komunën Xarrë për vlerën 109,451,649 lekë e analizuar për 21 objekte.

Diferenca prej 271,359,836 lekë përfaqëson vlerën kontabile të kësaj llogarie të trashëguar nga ish Komuna Markat për të cilën nuk disponohen të dhëna analitike të objekteve që i përkasin.
-Llogaria 214 'Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune". Për vlerën kontabile të bilancit 37,970,915 lekë. Kjo llogari është analizuar për 18 objekte pajisje dhe makineri në Bashkinë Konispol për vlerën 34,928,880 lekë, në ish Komunën Xarrë për vlerën 3,042,035 lekë për 7 objekte, kurse në ish Komunën Markat nuk ka pasur vlerë kontabël në këtë llogari. Në këtë llogari bëjnë pjesë edhe 5 zëra makineri e pajisje të dhuruar nga binjakëzimi me Bashkinë Afjon (Turqi) të vlerësuara me komision në shumën 9,881,299 lekë.
-Llogaria 215 "Mjete transporti" Për vlerën kontabile të bilancit 21,166,910 lekë analizuar në 12 lloje mjete transporti ku përfshihet dhe një autoambulancë me vlerë 7,000,000 lekë dhuruar nga Bashkia Afjon (Turqi). Ky automjet, më pas është transferuar tek Qendra Shëndetësore Konispol me vendim të këshillit të bashkisë.
-Llogaria 218 "Inventar ekonomik". Për vlerën kontabile te bilancit 19,459,238 lek. Për Bashkinë Konispol është e analizuar në 258 zëra. Këtu përfshihen dhe 12 zëra të dhuruar nga Bashkia Afjon në vlerën 677,000 lekë të vlerësuara me komision. Për ish Komunën Xarrë në vlerën 4,161,416 lekë analizuar në 85 zëra referuar inventarit fizik të vitit 2015. Për ish Komuna Markat në me vlerën 1,096,672 por që nuk disponohen të dhëna analitike të objekteve dhe as kartela inventariale. Në vitin 2016 është bërë inventari fizik vetëm përsa u gjendën fizike, mungon inventarizimi kontabël dhe vlerësimi i inventarëve nuk është bërë me çmime.
-Llogari 31 "Materiale". Për vlerën kontabile 689,163 lekë për të cilën për vitet 2016 dhe 2017, nuk është kryer inventarizimi fizik i tyre.
-Llogaria 32 "Objekte inventari" Për vlerën kontabël 4,120,879 lekë për të cilën për vitet 2016 dhe 2017, nuk është kryer inventarizimi fizik i tyre.

Llogaria 468 'Debitorë të ndryshëm" për vlerën kontabile të bilancit 101,270,551 lekë, shumë kjo e analizuar ne 6 kategori si debitore nga mos pagesa e tokës ish–kooperativa, debitore nga akt- kontrollet, debitorë taksa të papaguara, debitorë nga pagesa e tarifës ujit etj, në mënyrë të përmbledhur sipas sipas të dhënave të pasqyrës që vijon:

	Emërtimi	Nga V. 2016	Lik/Shtesë v. 2017	Deb. V. 2017 Lekë
1	Debitorë për pag. e tokës për objek. e shitura nga ish koop. bujqësore	424,832	0	424,832
2	Debitor për ndalesa nga Akt-kontrolli (KLSH)	83,649,623	-105,750	83,543,873
3	Debitor për ndalesa nga Akt-kontrolli N/Prefekt.	1,149,938	0	1,149,938
4	Debitor për taksa të papaguara familjet	12,717,419	1,917,432	14,634,851
5	Debitor për taksa të papaguara Bizneset	1,816,727	-299,670	1,517,057
6	Debitor nga pagesa e ujit pijshem	3,915,910	-3,915,910	0
	S H U M A	103,674,449	-2,403,898	101,270,551

Në mënyrë analitikë më të detajuara sipas lloji të debisë dhe subjekteve përkatëse, jepen në pasqyrat si vijon:
Debitorët sipas rekomandimeve të KLSH-së nga auditimet e kryera në vite, si më poshtë:

Nr.	Subjekti	Debitor nga Rekom. E KLSH-së v. 2016	Shuma lekë	Arkë tuar	Gjendja debit. v. 2017 Lekë
1	M...A	ARAPI	210221		
2	T...A	ÇOKALLI	132680		
3	D...S	ZOTE	94680		
4	M...O	MANE	7918215		
5	S...M	BEQIRI	30000		
6	I...I	SELMANI	1889476		
7	E...D	RUMANI	1858156		
8	E...A	MURTO	1858156		

9	I...L	MURTO	4957026		
10	N...A		58355550		
11	KESHILLTARET MARKAT		181500		
12	I...M	BASTRI	2961985		
13	KRYEPLEQTE MARKAT		181500		
14	A...R	IDRIZI	9000		
15	A...I		337600		
16	E... E CO		97288		
17	E...I		50000		
18	T...A - D		796538		
19	F...A	BEQIRI	72708		
20	KESHILLTARET KONISPOL		923515		
21	A...A I...L		289150		
	SHUMA		83204944	-67570	83,137,374
22	Sipas rekom. KLSH-ë V. 2013				406,499
	Totali				83,543,873

Debitorët nga mos pagimi i qerasë së truallit nga privatizimi i objekteve të ish kooperativave bujqësore sipas të dhënave të pasqyrës që vijon:

Nr	Subjekti	Objekti	Vlera e debisë			Totali debitorë
			Vl. Truall objekt	Qera v. 2005-2006	Gjithsej	
1	T.B.	Vlere tokës së obj. dhe qera	207,360	41,472	248,832	248,832
2	S.S.	Vlere tokës së obj. dhe qera	80,000	8,000	88,000	88,000
3	A.P.	Vlere tokës së obj. dhe qera	80,000	8,000	88,000	88,000
		SHUMA	367,360	57,472	424,832	424,832

-Debitore për taksat familjare të pa paguara nga: 1534 familje në vlerën 14,634,851 lekë.
-Debitore për taksa të pa paguara nga biznes: 77 subjekte në vlerën 1,517,057 lekë.
-Llogaria 520 "Disponobilitete në thesar" për vlerën kontabile 50,231,002 lekë analizuar si më poshtë: trashëgim i të ardhurave 25,904,828 lek, pulla gjendje civile 63,000 dhe garanci punimesh në vlerën 24,263,174 lekë. Sipas akt rakordimit me thesarin.
-Llogaritë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për vlerë kontabël 7,982,547 lekë e analizuar për furnitorë të pa paguar në vlerën 7,430,699 lekë sipas pasqyrës analitike më poshtë vijon, për shpërblimi i këshilltarëve 165,961 lekë dhe detyrimi i pa paguar për kuotën e K. Qarkut Vlorë në vlerën 385,887 lekë.

Pasqyra mbi furnitorët e pa paguar në vlerën 7,430,699 lekë e analizuar në 32 subjekte si vijon:

Nr.	Emëri furnitorit	Nipt Q.K.B.	Data e detyrimit faturës	Nr. seria faturës	Shuma Lekë	Arsyhet e mos pagesës së detyrimit
1	F.P.		08.02.2010	Kontr.qera	23400	Mungese NIPT-i
2	F.P.		08.02.2010	kopeshti	23400	dhe llog.bankare
3	B.D.	L 64130801 E	17.09.2010	10	32250	"
4	D.L.	K 94209802 E	10.12.2010	23	67500	Mungese fondesh
5	B.Ç.		10.02.2011	4	389610	MungNIPT,llog.bank
6	B.Ç.		15.04.2011	22	191442	"
7	Z.A.	K 84511802 A	18.04.2011	6	209790	Mungese fondesh
8	L.M.		24.10.2011	14	16500	Mung.NIPT,llog.bank
9	S.K.	K 04814851 T	01.03.2012	33	474000	Mungese fondesh

10	P...I	L24117801 E	Vend.Gjyk.	7188	461950	Mung.Fondesh
11	H...O ALB	K62420006T	11.07.2016	312	175200	"
12	O...E	K72410014 H	FAT.DHJ.17		341511	"
13	P...A	J 61924007 N	"		70176	Dhjetor 2017
14	A...M	K 33714809 A	"		13858	"
15	Z.A.	K 84511802 A	29.08.2017	8	210000	"
16	V.B.	L 23724801 J	27.12.17	6 , 7	372000	"
17	SH.R.	K 33714887 R	23.12.17	14-15	197250	"
18	A.R.	K 33707824I	03.11.17	1	81500	"
19	K...I	J 64228811 C	19.12.17	256	737953	"
20	E.D.	K 93802804 B	22.12.17	13 , 14	190000	"
21	E...D.	C 34618801	29.12.17	10	437000	"
22	A...D	K 24010212 N	30.11.17	146	1150437	"
23	B...D.	L 64130801 E	28.08.17	11	97000	"
24	R...A	L 73906802 H	28.12.17	946	108936	"
25	I...I	J94824811 D	08.08.2017	22	154835	"
26	L.B.	L 47411203 R	FatJ-Dhj.17		385457	"
27	B.B.	K 33710978 E			17500	"
28	V.Gj.	K 53725821 H		4	215000	"
29	E.D.	J 91909004 J	21.11.17	765	25380	"
30	H...O	K62420006T	22.11.17	1714	55510	"
31	S.B.	L 44126810 E		8	99900	"
32	K...I	J 64228811 C	20.12.17	257	404454	"
			TOTALI		7,430,699	

-Llogaria 42 "Personeli dhe llogari të lidhura me to" për vlerën kontabile të bilancit 4,188,440 analizuar sipas listë pagesës për pagat e pa paguara Dhjetor 2017. (Sipas listë pagesës muaj dhjetor)
-Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" për vlerën kontabile të bilancit 24,263,174 analizuar në 20 subjekte fituese në procedurat e prokurimi.

Nga sa më sipër, për pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2017, konstatohet:
1-Pasqyrat financiare, paraqesin gjendjen financiare, performancën, rrjedhjen e parasë, gjendjen dhe lëvizjen e aktiveve të qëndrueshme vetëm për aktivitetin menaxhues të bashkisë pa njësitë vartëse.
2-Llogaria 202. "Studime dhe kërkime". Për vlerën kontabile të bilancit për 5,263,601 lekë.
Nga të cilat vlera 4,470,467 lekë përfaqësojnë vlerën e studimeve dhe projekteve për 5 objekte kurse pjesa tjetër në vlerën 793,134 përfaqëson shpenzime në vite për mbikëqyrje të punimeve të investuara.
Nuk janë kryer inventarizime fizike të këtyre studimeve dhe projektimeve.
Mungesa e inventariale për sa janë regjistruar në debi të kësaj llogarie studime dhe projektime, është praktikë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, neni 7- "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve" ku citohet: "1. Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse.
2. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave te miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet te paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri ne pasqyrat financiare vjetore."

dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73.
3-Llogaria 212 "Ndërtime konstruksione". Për vlerën kontabile të bilancit 392,239,426 lekë.
Kjo llogari është e analizuar për 12 objekte të Bashkisë Konispol për vlerën 201,475,367 lekë. Në këtë vlerë kontabile vjetore, është përfshirë edhe llogaria 212 sipas bilancit të ish Komunës Xarë për vlerën kontabile prej 31,586,314 lekë për 17 objekte. Diferenca prej (392,239,426-233,061,681)= 96,177,745 lekë përfaqëson vlerën e kësaj llogarie për Ndërtime dhe konstruksione sipas bilancit financiar të ish Komunës Markat për vitin 2015 për të cilën nuk ka regjistër analitik të objekte që i përket kësaj vlere kontabël.
Nuk janë hapur regjistra përkatëse për çdo objekt të investuar ku të jenë shënuar viti i prodhimit, vlera kontabile, vlera e rikonstruksioneve të bëra në vite, amortizimi i objekteve etj., në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30 dhe ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
Këto objekte nuk janë të regjistrua në ZVRPP Sarandë në pronësi të Bashkisë Konispol.
4-Llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore". Për vlerën kontabile të bilancit 966,864,955 lekë. Kjo llogari është e analizuar për 33 objekte të Bashkisë Konispol për vlerën 586,053,470 lekë dhe për ish Komunën Xarë për vlerën 109,451,649 lekë e analizuar për 21 objekte.
Diferenca prej 271,359,836 lekë përfaqëson vlerën kontabile të kësaj llogarie të trashëguar nga ish Komuna Markat për të cilën nuk disponohen të dhëna analitike të objekteve që i përkasin, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30.
5-Llogaria 214 'Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune". Për vlerën kontabile të bilancit 37,970,915 lekë. Kjo llogari është analizuar për 18 objekte pajisje dhe makineri në Bashkinë Konispol për vlerën 34,928,880 lekë, në ish Komunën Xarrë për vlerën 3,042,035 lekë për 7 objekte, kurse në ish Komunën Markat nuk ka pasur vlerë kontabël në këtë llogari. Në këtë llogari bëjnë pjesë edhe 5 zëra makineri e pajisje të dhuruar nga binjakëzimi me Bashkinë Afjon (Turqi) të vlerësuara me komision në shumën 9,881,299 lekë.
6-Llogaria 215 "Mjete transporti" Për vlerën kontabile të bilancit 21,166,910 lekë analizuar në 12 lloje mjete transporti ku përfshihet dhe nje autoambulancë me vlerë 7,000,000 lekë dhuruar nga Bashkia Afjon (Turqi). Ky automjet, më pas është transferuar tek Qëndra Shendetësore Konispol me vendim të këshillit të bashkisë. Nuk ka kartelë inventariale se kush i ka në administrim këto mjete, në kundësrhtim me kërkesat e e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30 dhe ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
7-Llogaria 218 "Inventar ekonomik". Për vlerën kontabile te bilancit 19,459,238 lek. Për Bashkinë Konispol është e analizuar në 258 zëra. Këtu përfshihen dhe 12 zëra të dhuruar nga Bashkia Afjon në vlerën 677,000 lekë të vlerësuara me komision. Për ish Komunën Xarrë në vlerën 4,161,416 lekë analizuar në 85 zëra referuar inventarit fizik të vitit 2015. Për ish Komuna Markat në me vlerën 1,096,672 por që nuk disponohen të dhëna analitike të objekteve dhe as kartela inventariale. Në vitin 2016 është bërë inventari fizik vetëm përsa u gjendën fizike, mungon invetarizimi kontabël dhe vlerësimi i invetarëve nuk është bërë me çmime.
8-Llogari 31 "Materiale". Për vlerën kontable 689,163 lekë për të cilën për vitet 2016 dhe 2017, nuk është kryer inventarizimi fizik i tyre.
9-Llogaria 32 "Objekte inventari" Për vlerën kontabël 4,120,879 lekë për të cilën për vitet 2016 dhe 2017, nuk është kryer inventarizimi fizik i tyre.
10-Për vitin 2016 dhe 2017, nuk është bërë inventarizimi fizik i aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese të dhënat janë kontable.
Mos kryerja e inventarizimit fizik të aktiveve është në shkelje të kërkesave të ligjit nr.
9228, date 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 74.
-Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

-z. SH.B.i me detyrë kryetar i bashkisë Konispol dhe
-z. E.D. me detyrë Përgjegjës i Financës.

1.4. Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të institucionit dhe të njësive të varësisë, si dhe zbatimi i dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre.

Në auditimin e kryer mbi parashikimin, realizimin dhe përdorimin e taksave vendore sipas llojeve, rezervat në planifikim, rezulton se:

-Për vitin 2016, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 43,907 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 44,004 mijë lekë me tejkalim në vlerën 97 mijë lekë, ose 100,2%.

-Për vitin 2017, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 66,270 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 43,532 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 22,738 mijë lekë, ose 65,7%.

Detyrimet debitore të taksave për bizneset gjendje me 31.12.2016 janë në vlerën 1,524 mijë lekë nga 21 subjekte me 31.12.2017 janë në vlerën 1,038 mijë lekë nga 24 subjekte. Detyrimet debitore të taksës së tokës bujqësore dhe taksave e tarifave familjare, gjendje më 31.12.2016 janë në vlerën 3,288 mijë lekë nga 607 familje, më 31.12.2017 janë në vlerën 13,799 mijë lekë nga 1203 familje.

Njësia Administrative Xarrë, -Për vitin 2016, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 11,521 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 14,064 mijë lekë me tejkalim në vlerën 2,543 mijë lekë, ose 122%. -Për vitin 2017, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 14,690 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 11,193 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 3,497 mijë lekë, ose 76,2%.

Njësia Administrative Markat. -Për vitin 2016, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 8,352 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 7,527 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 825 mijë lekë, ose 90%. Për vitin 2017, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 13,614 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 8,295 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 5,319 mijë lekë, ose 60%.

Në vijim po paraqesim në formë tabele evidencën e gjendjes së numrit të bizneseve dhe ndryshimet gjatë periudhës së viteve 2016 dhe vitin 2017.

Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2017.

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2016	155	1	3	153
		2017	158	6	6	158
2	Biznesi Madh	2016	7	1	3	5
		2017	6	0	0	6
(1+2)	Gjithsej	2016	162	2	6	158
		2017	164	6	6	164

Sa më sipër konstatohet se numri i bizneseve gjendje në fillim të çdo viti ka ardhur duke u rritur për çdo vit nga viti 2016 deri në vitin 2017, regjistrimet e reja të bizneseve dhe bizneset që kanë mbyllur aktivitetin janë në numër të njëjtë.

Realizimi i të ardhurave është në nivele të ultë në vitin 2017, ku janë programuar të ardhura nga tatim taksat gjithsej 66,270 mijë lekë, realizuar 43,532 mijë lekë ose në masën 65,7%.

Ndikim të madh në mos realizimin e të ardhurave nga tatim taksat lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, e cila është programuar në masën 14,469 mijë lekë, realizuar në masën 10,096 mijë lekë ose 69,8%. Mosrealizimi është në masën (14,469 mijë lekë – 10,096 mijë lekë)= 4,373 mijë lekë, me ndikim në mosrealizim në masën 10%.

Ndikim negativ ka edhe në mos realizimin e të ardhurave nga tatim taksat lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga tarifat administrative, e cila është programuar në masën 23,403 mijë

lekë, realizuar në masën 19,424 mijë lekë ose 83%. Mosrealizimi është në masën (23,403 mijë lekë – 19,424 mijë lekë)= 3,979 mijë lekë, me ndikim në mosrealizim në masën 9,1%. Të ardhurat janë rakorduar me Degën e Thesarit çdo muaj dhe në mënyrë progresive për vitet 2016 dhe vitin 2017.

Në auditimin e kryer për krijimin e regjistrit të tatim paguesve në mënyrë manuale dhe elektronike, për grumbullimin e taksave, administrimin e dosjeve të subjekteve, inventarizimin e tyre, konstatohet se, janë hapur regjistrat në mënyrë manuale dhe elektronike, nga zyra e tatim taksave dhe tarifave vendore Njësia Administrative Konispol, Xarë dhe Markat, ku janë regjistruar të gjithë tatim paguesit që kanë detyrimin për pagimin e taksave dhe tarifave vendore.

Në auditimin e kryer për administrimin, inventarizimin e dosjeve të subjekteve për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2016 deri 31.12.2017 konstatohet se:

-Nga inspektorët e taksave dhe tarifave vendore nuk është vepruar për dërguar shkresë për secilin subjekt që kanë sipas ndarjes administrative territoriale, ku të përcaktohej detyrimi për çdo taksë apo tarifë vendore që tatim paguesi detyrohet për të paguar për llogari të bashkisë. Kjo praktikë nuk është zbatuar dhe nuk është në praktikën e punës së çdo inspektori që në fillim të çdo viti të njoftojë të gjithë subjektet taksa pagues për llojet e detyrimeve dhe afatin ose kohën e pagesës që duhet të kryej në bankat e nivelit të dytë. Pra nga administrata tatimore e bashkisë dhe e Njësive Administrative nuk janë plotësuar njoftimet e detyrimit dhe nuk u janë dërguar në rrugë postare subjekteve tatimpagues, që kanë detyrimin ligjor për të paguar, taksat dhe tarifat vendore si, për tarifën e pastrimit urban, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, taksën e tabelës dhe për taksën mbi ndërtesat dhe për pasojë nuk janë arkëtuar detyrimet ligjore nga subjektet taksapagues. Veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Neni 23 Mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin, pika 2 ku citohet: "*Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare, drejtuar tatimpaguesit, i dërgohen në adresën e shënuar në dosjen e tatimpaguesit, duke përdorur shërbimin postar rekomande".*

-Nga administrata tatimore e bashkisë, nuk është bërë miradministrimi i informacionit tatimor, të subjekteve tatimpagues të Biznesit të Vogël, të biznesit të madh dhe të taksa paguesve familjar, për të gjitha detyrimet tatimore dhe nuk janë vendosur në dosjen e çdo tatim paguesi, ka mangësi përditësimi të dhënave dhe mungesë të dokumentacionit, ku regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit. Veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Neni 29 Dosja e detyrimeve tatimore, pika 1.

-Nga administrata tatimore e bashkisë, nuk është vepruar për inventarizimin e dokumentacionit që ndodheshin në dosjet e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore ku nga auditimi u konstatuan me mangësi e konkretisht:

-të gjitha praktikat nuk shoqërohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit.

-i gjithë dokumentacioni i subjektit mbahet në një dosje qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë.

-praktikat e përfunduara të viteve të mëparshëm nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit, veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" neni 24 dhe me rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave "Për normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë" kapitulli II-Rregulla për punën me dokumentet administrative në subjektet shtetërore dhe jo shtetërore, neni 21dhe neni 27.

Në auditimin e kryer për gjendjen e debitorëve për taksat vendore, në numër dhe vlerës, sipas bizneseve, taksës tokës, taksat e popullatës, etj.konstatohet se:

Bazuar në të dhëna e evidencave të paraqitur nga inspektorët e taksave dhe tarifave vendore, rezulton se gjendja e debitorëve për periudhën 2016 -2017, Njësia Administrative Konispol paraqitet sipas pasqyrës si vijon:

Pasqyra e gjendjes së debitorëve në fund të çdo viti 2016 dhe 2017. Në 000 / lekë

EMËRTIMI	31.12.2016		31.12.2017	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Biznesi i Vogël	23	1,496	59	926
Biznes i Madh	1	28	3	112
TOTALI	**24**	**1,524**	**62**	**1,038**

Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2017.

Nr	Emërtimi	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund
	Totali	**2016**	162	2	6	158
1	**Bizneseve**	**2017**	164	6	6	164

Përmbledhja e debitorëve për familjarët sipas NjA periudha 2016-2017, pasqyra e debitorëve për familjet për taksën e tokës bujqësore, banesave, pastrimit, ndriçim dhe gjelbrin sipas fshatrave Bashkia Konispol, periudha 2016-2017 dhe pasqyra e debitorëve për bizneset vitet 2010 – 2017. janë bashkangjitur Projekt Raportit të Auditimit.
Sipas evidencave të paraqitura nga Zyra e Tatim Taksave Vendore për detyrimet e papaguara për taksat dhe tarifat për familjet sipas Njësive Administrative të Bashkisë Konispol jën në pasqyrën në vijim:

Përmbledhja e debitorëve për familjarët sipas Njësive Administrative vitet 2016-2017

Nr	Njësia Adminstrative	Viti 2016		Viti 2017	
		Nr Fam	Vlera 000/lekë	Nr Fam	Vlera 000/lekë
1	Bashkia Konispol	198	1,044	331	2189
2	Nj A Xarrë	0	0	467	7,006
3	Nj A Markat	409	2,244	405	4,064
	Totali	**607**	**3,288**	**1,203**	**13,799**

Për vjeljen e detyrimeve për tatim taksat nga bizneset, nga ana e inspektorëve të tatim taksave, nuk u janë bërë njoftim subjekteve dhe nuk u janë dërguar shkresa për bllokimin e llogarive Bankare, për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, as nuk u janë dërguar shkresa në ZVRPP për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit. Për debitorët sipas Nj.A, nuk janë mara masa administrative shtrënguese për arkëtimin e tyre.
-Në se ndaj subjekteve debitorë të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, janë llogaritur kamat vonesat gjobë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë, bazuar në nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar.
Sipas evidencave të taksave dhe tarifave vendore si dhe nga verifikimi në zyrën e kontabilitetit të sektorit të taksave konstatohet se, për detyrimet të cilat nuk janë paguar në afatet e përcaktuara në ligj dhe në Vendimet e Këshillit Bashkiak, për periudhën e viteve 2016-2017, nuk është llogaritur dhe arkëtuar gjoba prej 0.06% për qind të shumës së detyrimit të papaguar. Për detyrimet të cilat nuk janë paguar në afatet e përcaktuara në ligj dhe në Vendimet e Këshillit Bashkiak, nuk është llogaritur dhe arkëtuar gjoba prej 0.06% për qind të shumës së detyrimit të papaguar gjendje 31.12.2016, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 114, pika 1, nga përllogaritjet e kryera rezulton, (detyrim bizneset 1,038,000 lekë + detyrim familjarët 13,799,000 lekë = 14,837,000 lekë *0.06% * 365 ditë= 3,249,303 lekë), me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Konispol, në vlerën 3,249,303 lekë.
Veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Neni 114 Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit pika 1.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Programimi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, për vitin 2016, është miratuar në vlerën 43,907 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 44,004 mijë lekë me tejkalim në vlerën 97 mijë lekë, ose 100,2%. Për vitin 2017, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 66,270 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 43,532 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 22,738 mijë lekë, ose 65,7%.

Detyrimet debitore të taksave për bizneset gjendje me 31.12.2016 janë në vlerën 1,524 mijë lekë nga 21 subjekte me 31.12.2017 janë në vlerën 1,038 mijë lekë nga 24 subjekte.

Detyrimet debitore të taksës së tokës bujqësore gjendje më 31.12.2016 janë në vlerën 3,288 mijë lekë nga 607 familje, më 31.12.2017 janë në vlerën 13,799 mijë lekë nga 1203 familje.

Njësia Administrative Xarrë, për vitin 2016, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 11,521 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 14,064 mijë lekë me tejkalim në vlerën 2,543 mijë lekë, ose 122%, për vitin 2017, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 14,690 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 11,193 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 3,497 mijë lekë, ose 76,2%.

Njësia Administrative Markat, për vitin 2016, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 8,352 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 7,527 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 825 mijë lekë, ose 90%, për vitin 2017, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 13,614 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 8,295 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 5,319 mijë lekë, ose 60%.

-Nga administrata tatimore e bashkisë, nuk janë plotësuar njoftimet e detyrimit, nuk u janë dërguar në rrugë postare të gjithë subjekteve tatimpagues, që kanë detyrimin ligjor për të paguar, taksat dhe tarifat vendore si, për tarifën e pastrimit urban, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, taksën e tabelës dhe për taksën mbi ndërtesat dhe për pasojë nuk janë arkëtuar detyrimet ligjore nga subjektet taksapagues, veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 23, pika 2.

-Nga administrata tatimore e bashkisë, nuk është bërë miradministrimi i informacionit tatimor, të subjekteve tatimpagues të Biznesit të Vogël, për të gjitha detyrimet tatimore dhe nuk janë vendosur në dosjen e çdo tatim paguesi, ka mangësi përditësimi të të dhënave dhe mungesë të dokumentacionit, ku regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë",neni 29, pika 1.

-Nga administrata tatimore e bashkisë, nuk është vepruar për inventarizimin e dokumentacionit që ndodheshin në dosjet e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore ku nga auditimi u konstatuan me mangësi si të gjitha praktikat nuk shoqërohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit, i gjithë dokumentacioni i subjektit mbahet në një dosje qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë, praktikat e përfunduara të viteve të mëparshëm nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" neni 24, dhe me Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, kapitulli II, nenet 21,27.

-Nga administrata tatimore e bashkisë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura, të taksave dhe tarifave vendore, nuk u janë bërë njoftim subjekteve dhe nuk u janë dërguar shkresa për bllokimin e llogarive Bankare, për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, në ZVRPP për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe nuk është vazhduar me marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008" Për Procedurat tatimore në R.SH" i ndryshuar.

-Nga administrata tatimore e bashkisë, për detyrimet të cilat nuk janë paguar në afatet e përcaktuara në ligj dhe në Vendimet e Këshillit Bashkiak, nuk është llogaritur dhe as arkëtuar gjoba prej 0.06% për qind të shumës së detyrimit të papaguar gjendje 31.12.2016, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 114, pika 1, nga përllogaritjet e kryera rezulton, (detyrimi 14,837,000 lekë *0.06% * 365 ditë= 3,249,303 lekë), me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Konispol, në vlerën **3,249,303 lekë.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z.SH.B.i me detyrë, Kryetar i Bashkisë Konispol.

Z.H.S. me detyrë, specialist i tatim taksave vendore për periudhën 01.01-30.10.2016.

Znj.L.T. me detyrë specialiste e tatim taksave vendore për periudhën 30.10.2016 deri 31.12.2017.

Znj.V.Xh. me detyrë specialiste e tatim taksave vendore Njësia Administrative Xarrë.

Z.A.D. me detyrë specialiste e tatim taksave vendore Njësia Administrative Markat.

Për Organizimin dhe Mbajtjen e Kontabilitetit Bashkia Konispol.

Në auditimin e kryer në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të institucionit dhe të njësive të varësisë, si dhe zbatimi i dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre, organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit sipas planit unik kontabël për institucionet, azhurnimi i tij në librat përkatës, ditar, pA...Itar, libri i madh ose centralizatori, ditari i veprimeve të ndryshme etj., u konstatua se:

Kontabiliteti është azhurnuar në ditarë të mbajtura në mënyrë manuale dhe me programin Excel dhe nuk është azhurnuar me ndonjë program i veçantë finance. Janë plotësuar ditarët e kontabilitetit dhe përmbledhja e llogarive vjetore sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe "Planin kontabël publik". Janë të kuadruar ditarët dhe centralizatori. Për mbylljen e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, nuk u konstatuan veprime të gabuara duke kryer azhurnimet. Veprimet e kryera dhe të regjistruara në ditarët përkatës të llogarive janë në përputhje me kërkesat e VKM nr.248 datë 10.04.1998 "Plani kontabël për institucionet buxhetore", i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë tëhuaj", të ndryshuar me Udhëzimet e MF nr. 26, datë 27.12.2007 e Nr. 10, datë 27.02.2008.

-Transaksionet financiare nëpërmjet arkës. Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se, me arkë janë kryer transaksione financiare vetëm për arkëtimin e taksave dhe tarifave, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuara me të gjitha ekstremitet dhe për pagesat janë prerë mandat-pagesat përkatëse në bazë të dokumenteve justifikues. Veprimet me arkë kryehn në Njësitë Administrative Xarrë, Markat dhe në Bashkinë Konispol. Vlerat e arkëtuar nga Nj A derdhen në çdo 10 ditë në arkën e Bashkisë dhe kjo e fundit i arkëton në bankë. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkë, po kështu është mbajtur ditari arkës në formën klasike kontabël. Përfshirja e shumës të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me ligjin nr. 9228,datë 29.04.2004"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar,VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël", si dhe të UMF nr. 26,datë 27.12.2007. Nga Sektori i Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit për të ardhurat. Gjithashtu të gjitha të ardhurat e arkëtuara janë bërë derdhje në Bankë në mënyrë periodike dhe arka rezulton me gjendje 0 në fund të muajit.

-Administrimi vlerave monetare në bankë. Transaksionet e kryera nëpërmjet veprimeve të bankës rezultuan të jenë konform akteve ligjore. Hartimi i urdhër shpenzimeve është bërë mbi bazën e një dokumentacioni mbështetës e justifikues, formati i tyre është sipas UMF dhe në të është aplikuar rregullisht sistemi i firmës së dyfishtë duke u nënshkruar nga nëpunësi autorizues

dhe ai zbatues. Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktoheshin qartë objekti i shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikues. Urdhër shpenzimet ishin konfirmuar dhe nga Specialistët e Degës së Thesarit dhe ishin likuiduar brenda limiteve të përcaktuara nga çelja e fondeve.

Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet magazinës. Në auditimin e ushtruar për rregullshmërinë e plotësimit dhe përpunimit te dokumentacionit të magazinës, rezulton se: Lëvizja e mallrave, materialeve e inventarëve nëpërmes magazinës është shoqëruar me flete hyrje dhe fletë dalje sipas sektorëve përkatës. Nga zyra e financës është kuadruar në sasi dhe vlerë për gjendjen kontabile të magazinës. Në auditimin e kryer për periudhën objekt auditimi hyrja e aktiveve është dokumentuar me fletëhyrje sipas aktiveve të dokumentuara në faturën e furnitorit në sasitë dhe vlerat respektive.

Fletëhyrjet e lëshuara nga magazinierja nuk janë shoqëruar me procesverbalin e marrjes në dorëzim të aktiveve, i cili lidhet me verifikim fizik të sasisë, cilësisë, çmimit. Hyrja e materialeve në magazinë nuk është bërë e specifikuar sipas llojit të mallit, sidomos për pajisjet kompjuterike. Si parregullsi konstatohet fakti se nuk lihet gjurmë për marrjen në dorëzim të aktiveve. Mungojnë akt marrjet në dorëzim të mallit. Në shumicën e rasteve mungon prania e komisionit të marrjes në dorëzim çka vërtetohet me mungesën e dokumentit që hartohet në të tilla raste. Daljeve të magazinës jo në çdo rast janë të pajisura me urdhër dorëzimi. Jo në çdo rast dhe jo çdo aktiv i bërë dalje nga magazina është shoqëruar me urdhërdorëzimi, Hyrje daljet bëhen menjëherë gjatë muajit në përputhje me Kreun III-pika 38-59 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Kontabiliteti është azhurnuar në ditarë të mbajtura në mënyrë manuale dhe me programin Excel dhe nuk është azhurnuar me ndonjë program i veçantë finance. Janë plotësuar ditarët e kontabilitetit dhe përmbledhja e llogarive vjetore në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe "Planin kontabël publik". Janë të kuadruar ditarët dhe centralizatori. Për mbylljen e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, nuk u konstatuan veprime të gabuara duke kryer azhurnimet.

-Me arkë janë kryer transaksione financiare të kufizuara vetëm për arkëtimin e tarifave, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuara me të gjitha ekstremitet dhe për pagesat janë prerë mandat-pagesat përkatëse në bazë të dokumenteve justifikues. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkë, po kështu është mbajtur ditari arkës në formën klasike kontabël.

-Transaksionet e kryera nëpërmjet veprimeve të bankës rezultuan të jenë konform akteve ligjore, Hartimi i urdhër shpenzimeve është bërë mbi bazën e një dokumentacioni mbështetës e justifikues, formati i tyre është sipas UMF dhe në të është aplikuar rregullisht sistemi i firmës së dyfishtë duke u nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe ai zbatues. Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktoheshin qartë objekti i shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikues. Urdhër shpenzimet janë nënshkruar nga dega e Thesarit dhe ishin likuiduar brenda limiteve të përcaktuara nga çelja e fondeve.

Lëvizja e mallrave, materialeve e inventarëve nëpërmes magazinës është shoqëruar me fletë hyrje dhe fletë dalje sipas sektorëve përkatës. Nga zyra e financës është kuadruar në sasi dhe vlerë për gjendjen kontabile të magazinës. Në auditimin e kryer për periudhën objekt auditimi hyrja e aktiveve është dokumentuar me fletëhyrje sipas aktiveve të dokumentuara në faturën e furnitorit në sasitë dhe vlerat respektive.

Fletëhyrjet e lëshuara nga magazinierja nuk janë shoqëruar me procesverbalin e marrjes në dorëzim të aktiveve, i cili lidhet me verifikim fizik të sasisë, cilësisë, çmimit. Hyrja e materialeve në magazinë nuk është bërë e specifikuar sipas llojit të mallit, sidomos për pajisjet kompjuterike. Si parregullsi konstatohet fakti se nuk lihet gjurmë për marrjen në dorëzim të aktiveve, mungojnë akt marrjet në dorëzim të mallit, në shumicën e rasteve mungon prania e komisionit të marrjes në dorëzim çka vërtetohet me mungesën e dokumentit që hartohet në të tilla raste.

Fletë daljeve të magazinës jo në çdo rast janë të pajisura me urdhër dorëzimi, jo në çdo rast dhe jo çdo aktiv i bërë dalje nga magazina është shoqëruar me urdhërdorëzimi.

Veprimet e mësipërme janë në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
-Ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, .i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006;
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar
-VKM nr. 248, date 10.4.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre " i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
-VKM nr.783,datë 22.11.2006 " Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël";
-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Për pagesat për shpenzime udhëtim e dieta të Bashkisë Konispol.

Në auditimin e kryer të dokumenteve të bankës u përzgjodhën për auditim të gjitha veprimet e likuidimit të shpenzimeve për udhëtim e dieta për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2017 konstatohet se:
-Me urdhër shpenzimi nr. 163, datë 26.05.2016, janë likuiduar shpenzime për udhëtim e dieta për punonjësit e Bashkisë për ditët e shtuna dhe të diel të cilat janë ditë pushimi konkretisht:
z.SH.B.i me detyrë Kryetar Bashkie, është dërguar me shërbim jashtë qendrës së punës, është paguar: për datën 06.02.2016 e cila është ditë e shtunë, pra ditë pushimi zyrtar, paguar gabim tepër për një ditë dietë, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 2,500 lekë.
për datën 27,28.02.2016 të cilat janë përkatësisht ditë e shtunë dhe ditë e diel, pra ditë pushimi zyrtar, paguar gabim tepër për një ditë dietë, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 2,500 lekë.
për datën 25.12.2016 e cila është ditë e diel dhe njëkohësisht dita e festës së Krishtlindjeve, pra ditë pushimi zyrtar, paguar gabim tepër për një ditë dietë, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 2,500 lekë.
për datën 16.04.2016 e cila është ditë e shtunë, pra ditë pushimi zyrtar, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 2,500 lekë.
-Me urdhër shpenzimi nr. 163, datë 26.05.2016, janë likuiduar shpenzime për udhëtim e dieta për punonjësit e Bashkisë për ditët e shtuna dhe të diel të cilat janë ditë pushimi konkretisht:
z.D.Z. me detyrë shofer, është dërguar me shërbim jashtë qendrës së punës, është paguar:
për datën 06.02.2016 e cila është ditë e shtunë, pra ditë pushimi zyrtar, paguar gabim tepër për një ditë dietë, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 2,500 lekë, për datën 27 dhe 28.02.2016 të cilat janë përkatësisht ditë e shtunë dhe ditë e diel, pra ditë pushimi zyrtar, paguar gabim tepër për një ditë dietë, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 2,500 lekë, për datën 25.12.2016 e cila është ditë e diel dhe njëkohësisht dita e festës së Krishtlindjeve, pra ditë pushimi zyrtar, paguar gabim tepër për një ditë dietë, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 2,500 lekë, për datën 16.04.2016 e cila është ditë e shtunë, pra ditë pushimi zyrtar, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 2,500 lekë.
-Me urdhër shpenzimi nr. 254, datë 25.07.2016, janë likuiduar shpenzime për udhëtim e dieta për punonjësit e Bashkisë për ditët e shtuna dhe të diel të cilat janë ditë pushimi konkretisht: z.A.Sh. është dërguar me shërbim jashtë qendrës së punës, në Vlorë, është paguar për datën 05.12.2015 e cila është ditë e shtunë, pra ditë pushimi zyrtar, paguar gabim, është paguar 2,500 lekë, duhej paguar ½ ditë në vlerën 1,000 lekë, diferenca 1,500 lekë, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 1,500 lekë.
-Me urdhër shpenzimi nr. 455, datë 21.11.2016, janë likuiduar shpenzime për udhëtim e dieta për punonjësit e Bashkisë për ditët e shtuna dhe të diel të cilat janë ditë pushimi konkretisht:
z.SH.B.i është dërguar me shërbim jashtë qendërës së punës, është paguar: për datën 04.06.2016 e cila është ditë e shtunë, pra ditë pushimi zyrtar, paguar gabim tepër për një ditë dietë, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 2,500 lekë.
z.D.Z. është dërguar me shërbim jashtë qendrës së punës, është paguar:
për datën 04.06.2016 e cila është ditë e shtunë, pra ditë pushimi zyrtar, paguar gabim tepër për një ditë dietë, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 2,500 lekë.

Veprimi është jo në përputhje me përcaktimet dhe kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997 datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", kapitulli I, ku citohet se "*Punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të cilët gjatë ditëve zyrtare të punës shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit"* me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 26,500 lekë.

Si përfundim konstatohet se:

-Janë kryer pagesa për shpenzime udhëtimi e dieta, për punonjësit e Bashkisë, për ditët e shtuna dhe të diela të cilat janë ditë pushimi zyrtar. Veprimi është jo në përputhje me përcaktimet dhe kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997 datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", kapitulli I, ku citohet se "*Punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të cilët gjatë ditëve zyrtare të punës shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit",* me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 26,500 lekë, sipas aneksit nr.1.4.1, bashkangjitur.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Janë kryer pagesa për shpenzime udhëtimi e dieta, për punonjësit e Bashkisë, për ditët e shtuna dhe të diela të cilat janë ditë pushimi zyrtar, jo në përputhje me përcaktimet dhe kërkesat e VKM nr. 997 datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", kapitulli I, sipas aneksit nr.B/1.4.1, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën **26,500 lekë.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z.SH.B.i me detyrë, Kryetar i Bashkisë Konispol.

Z.E.D. me detyrë, Përgjegjës i Zyrës së Financës.

<u>Për pagesat e shpenzimeve për organizimin e festave nga llogaria 602 të Bashkisë Konispol</u>.

Në auditimin e kryer të dokumenteve të bankës, për pagesat e shpenzimeve për organizimin e festave të ndryshme, për periudhën e vitit 2016 dhe vitit 2017 u konstatua se:

-Me Urdhër shpenzimi nr.251, datë 20.07.2016 vlera 206,000 lekë, shpenzime për organizimin e festave nga e cila: Vlera 33,600 lekë shpenzime kokteji për festën e 5 Majit, fatura nr.2, datë 06.05.2016. Vlera 20,000 lekë shpenzime kokteji për festën e 7 Marsit, fatura nr.1, datë 08.03.2016. Vlera 20,000 lekë shpenzime kokteji për festën e 8 Marsit, fatura nr.1, datë 08.03.2016, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 73,600 lekë.

-Me Urdhër shpenzimi nr.332, datë 14.09.2016 vlera 25,000 lekë, shpenzime për pritje përcjellje nga e cila: Vlera 14,000 lekë shpenzime kokteji për projektin "Miza e Ullirit" në fshatin Xarrë, fatura nr.1, datë 11.06.2016, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 14,000 lekë.

-Me Urdhër shpenzimi nr.343, datë 20.09.2016 vlera 290,000 lekë, shpenzime për 72 vjetorin e çlirimit të Konispolit nga e cila vlera prej 40,000 lekë shpenzime për kokteji, fatura nr.1, datë 08.03.2016, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 40,000 lekë.

-Me Urdhër shpenzimi nr.63, datë 22.02.2017 vlera 135,000 lekë, shpenzime për aktivitetin e Çetës Çamëria, nga e cila vlera prej 30,000 lekë shpenzime për kokteji me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 30,000 lekë.

-Me Urdhër shpenzimi nr.339, datë 24.08.2017 vlera 263,400 lekë, shpenzime për organizimin e festave nga e cila: Vlera 12,000 lekë shpenzime kokteji për festën e 5 Majit, fatura nr.3, datë 05.05.2017. Vlera 23,000 lekë shpenzime kokteji për festat e 7-8 Marsit, fatura nr.2, datë 08.03.2017, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 35,000 lekë.

Si përfundim konstatohet se:

Sa më sipër shpenzimet e kryera për organizim kokteil, ku fondi i përdorur për përballimin e këtyre shpenzimeve nuk është nga fondi rezervë ose fondi i kontingjencës, i cili miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore në vendimin e buxhetit vjetor, deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, pra nuk është miratuar në këshillin Bashkiak, por

është përdorur A...Ikulli i llogarisë "602" shpenzime operative, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 147/2015, datë 17.12.2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Ligjin nr. 130/2016, datë 15.12.2016, "Për buxhetin e vitit 2017", Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", i ndryshuar me VKM nr. 258 datë 3.6.1999 "Për një ndryshim ne vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, date 15.5.1995 "Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja" pasqyrat nr.1,2,3, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 192,600 lekë. Lejohen vetëm shpenzime për pritjen e delegacioneve të huaja dhe të planifikuara, të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë për vitin ushtrimor, siç është përcaktuar në VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", i ndryshuar me VKM nr. 258 datë 3.6.1999.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Janë kryer shpenzime për organizime festash me rastin e festave te ndryshme, si me rastin e festës së 5 majit, festës së çlirimit të Konispolit,të festave të 7-8 marsit, aktivitetet për Çetën Çamëria, ku janë likuiduar me bankë për shpenzime për koktej, ku fondi i përdorur për përballimin e këtyre shpenzimeve nuk është nga fondi i veçantë, por është përdorur A...Ikulli nr.602, shpenzime operative, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 147/2015, datë 17.12.2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Ligjin nr. 130/2016, datë 15.12.2016, "Për buxhetin e vitit 2017", Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", i ndryshuar me VKM nr. 258 datë 3.6.1999 "Për një ndryshim ne vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, date 15.5.1995 "Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja" pasqyrat nr.1,2,3, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën **192,600 lekë.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Z.SH.B.i me detyrë, Kryetar i Bashkisë Konispol.
Znj.E.D. me detyrë, përgjegjës i zyrës së Financës.

Komente nga subjekti i audituar: *Në kundërshtimet me nr.276/3, datë 05.06.2018 të z.E.D. me detyrë Drejtor i Financës, ku citohet se:*
1.Sipas vkm nr.1173, datë 6.11.2009 pika 2 thuhet se ....Titullari i Bashkisë urdhëron me shkrim, blerjen e shërbimit të mallrave për zhvillimin, prodhimin apo bashkëprodhimin e programeve kulturore .....shpenzimet për koktej janë llogaritur në masën 200 lekë / personi.....gjykojme se shpenzimet për aktivitete kulturore dhe pritje përcjellje janë zbatuar në mënyrë të drejtë.
Qëndrimi i grupit të auditimit: *Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit nuk merren në konsideratë pasi:*
1.Shpenzimet për zhvillimin e programeve kulturore ne nuk i kemi trajtuar në material.
2.Për shpenzime për koktej në vlerën 192,600 lekë janë në shkelje të kërkesave të Ligjit nr. 147/2015, datë 17.12.2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Ligjin nr. 130/2016, datë 15.12.2016, "Për buxhetin e vitit 2017", Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", i ndryshuar me VKM nr. 258 datë 3.6.1999 "Për një ndryshim ne vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, date 15.5.1995 "Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja" pasqyrat nr.1,2,3. Nuk lejohen të kryhen pagesa për shpenzime për dreka, darka dhe kokteje me fonde buxhetore, pasi janë shklje e kërkesave të akteve ligjore e nën ligjore të mësipërme.

Për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Konispol.

Në auditimin e kryer për arkëtimin e taksës së lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, në Bashkinë Konispol, sipas evidencës së

paraqitur nga specialistët e tatim taksave, lidhur me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e bashkisë Konispol dhe në Njësitë Administrative në vartësi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", si dhe të VKM nr.170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4 ndryshuar VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 10, konstatua se:
Nga zyra shërbimeve sektori i transportit, nuk kanë pajisur subjektet, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe as nuk janë arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr.170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 10.
Në vijim paraqiten subjektet e tregtimit të karburanteve, sipas vendndodhjes ku ushtrojnë aktivitetin e tyre të biznesit dhe sipas Njësive Administrative, vlera e tarifës së pa likuiduar për çdo subjekt, sipas Aneksit nr.B/1.4.2, bashkangjitur.
Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
Nga Bashkia Konispol, nuk kanë vepruar për të pajisur subjektet, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe as nuk janë arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, të trajtuara në aneksin nr.B/1.4.2. jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr.170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 10, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Konispol, në vlerën **300,000 lekë.**
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Z.SH.B.i me detyrë, Kryetar i Bashkisë Konispol.
Z.H.S. me detyrë, specialist i tatim taksave vendore për periudhën 01.01-30.10.2016.
Znj.L.T. me detyrë specialiste e tatim taksave vendore për periudhën 30.10.2016 deri 31.12.2017.
Znj.V.Xh. me detyrë specialiste e tatim taksave vendore Njësia Administrative Xarrë.
Z.A.D.me detyrë specialiste e tatim taksave vendore Njësia Administrative Markat.

Për* realizimin e të ardhurave nga gjobat e Policisë Bashkiake *të Bashkisë Konispol.
Në auditimin e kryer në lidhje me realizimin e të ardhurave nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake, pasqyrimi i tyre në Regjistrin e gjobave, dërgimi i listës gjobave në fund të secilit vit në Zyrën e financës, masat e mara për arkëtimin e tyre dhe llogaritja e kamat vonesave për mos pagimin e tyre në afat, konstatohet se:
Nga punonjësi e policisë, në veprimtarinë e tyre të punës kanë konstatuar shkelje të ndryshme nga qytetarët, për lidhje të paligjshme të ujit të pijshëm, për zjarr vënie kullote, për të cilat kanë mbajtur procesverbale, ndaj subjekteve për shkeljet e konstatuara ndaj personave të ndryshëm, janë vendosur gjoba si dhe janë orientuar subjektet shkelëse në mos përsëritjen e veprimeve si dhe ndjekjen dhe zbatimin e procedurave dhe detyrimeve ligjore, në të ardhmen.

Për periudhën objekt auditimi janë vendosur gjoba nga Policia Bashkiake, për shkelje të ndryshme në vlerë të përgjithshme prej 142,000 lekë, për 21 raste nga të cilat janë arkëtuar 18,500 lekë ose 13% e vlerës. Nga vlera e gjobave të vendosura janë të pa arkëtuara vlera 123,500 lekë, për 16 raste sipas aneksit nr.B/1.4.3 bashkangjitur Projekt Raportit të Auditimit.
Sa më sipër konstatohet se nga Policia Bashkiake, nuk është vepruar për të arkëtuar vlerën e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara ndaj subjekteve, për shkeljet e konstatuara ndaj personave të ndryshëm, për lidhje të paligjshme të ujit të pijshëm, për zjarrvënie kullote, për arkëtimin e tyre, nuk është ndjekur rruga ligjore me padi në gjykatë, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" nenet 20, 30, me pasojë dëmin ekonomik në buxhetin e Bashkisë, në vlerën **123,500 lekë,** për 16 raste, sipas aneksit nr.B/1.4.3, bashkangjitur.
Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
-Nga Policia Bashkiake, nuk është vepruar për të arkëtuar vlerën e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara ndaj personave të ndryshëm, për lidhje të paligjshme të ujit të pijshëm, për zjarr vënie kullote, nuk është ndjekur rruga ligjore me padi në gjykatë, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" nenet 20, 30, sipas aneksit B/1.4.3 me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, në vlerën **123,500 lekë.**
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Z.SH.B.i me detyrë, Kryetar i Bashkisë Konispol.
Z.H.K. me detyrë, Inspektor i Policisë Bashkiake.

Për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e infrastrukturës të ndërtimeve informate që ndodhen në territorin e Bashkisë Konispol.
Në auditimin e kryer në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra e ALUIZNI- Drejtoria Sarandë, u auditua i gjithë dokumentacioni për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2017, në zbatim të ligjit nr. 9482 datë 03.04.20106, "Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, neni 23, ku cilësohet: "Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë llogaritet dhe arkëtohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 2/1, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar".
Gjatë viti 2016 dhe vitit 2017 nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Sarandë, janë dërguar shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar Lejet e Legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të bashkisë Konispol.
Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale, konstatohet se nga Bashkia Konispol, nuk janë marrë masa të veçanta për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Sarandë.
Në vijim paraqiten pasqyra e personave të cilët janë pajisur me Leje Legalizimi, sipërfaqet ndërtimore sipas objekteve, vendndodhja e objektit dhe detyrimi sipas aneksit nr.B/1.4.6, bashkangjitur.

Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Konispol, konstatohet se deri më 31.12.2017, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 24 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 3,870 m^2 nga të cilat 2,419 m^2 për banim dhe 1,451 m^2 e kombinuar banim dhe social ekonomike. Veprimi dhe mosveprimi janë, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës se mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar dhe Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr. 3, datë 09.01.2017 "Për miratimin e taksave e

tarifave vendore për vitin 2017",sipas aneksit nr.B/1.4.4, bashkangjitur, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Konispol në vlerën **634,790 lekë.**

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që*:*

-Nga Bashkia Konispol, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Sarandë. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Konispol, konstatohet se deri më 31.12.2017, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 15 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 2435 m^2 përr banim dhe kombinuar banim dhe social ekonomike, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës se mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar dhe Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr. 3, datë 09.01.2017 "Për miratimin e taksave e tarifave vendore për vitin 2017", sipas aneksit nr.B/1.4.4, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën **399,814 lekë.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z.SH.B.i me detyrë, Kryetar i Bashkisë Konispol.

Z.H.S. me detyrë, specialist i tatim taksave vendore për periudhën 01.01-30.10.2016.

Znj.L.T. me detyrë specialiste e tatim taksave vendore për periudhën 30.10.2016 deri 31.12.2017.

<u>Për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave dhe tarifave vendore, realizimin e tarifave vendore për taksën e truallit të lirë funksional për objektet në pronësi ose në përdorimtë subjekteve në territorin e Bashkisë Konispol.</u>

Në auditimin e dokumenteve të paraqitura nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Konispol, për subjektet e biznesit të vogël dhe të madh, u krye auditimi për vendosjen, aplikimin e taksës së truallit nga Bashkia Konispol, për subjektet me aktivitet tregti, bare, restorante etj, që kanë detyrimin për pagesë e taksës së truallit, për periudhën e vitit 2016 dhe të vitit 2017 konstatohet se:

-Nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuar vlera e taksës së truallit për qëllime biznesi të subjektet të biznesit të vogël dhe të madh të cilat kanë detyrimin për të paguar taksën truallit, të cilat paraqiten në aneksin nr.B/1.4.5, bashkangjitur, ku paraqiten emri i subjektit, sipërfaqja e truallit funksional ose truall i lirë, detyrimi që duhej të llogaritej gjithsej, detyrimi i llogaritur nga inspektorët dhe diferenca për tu arkëtuar.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Nga specialistët e taksave dhe tarifave vendore Bashkia Konispol, Njësia Administrative Xarrë dhe Njësia Administrative Markat, nuk është vepruar, për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën e taksës së truallit për qëllime biznesi për 51 subjekte që kanë detyrimin për të paguar këtë lloj takse, veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Kreu II, nenit 9, pika 2; neni 21, pika 2; neni 23/1; dhe të Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.3, datë 09.01.2017, 05.01.2016, kreu III Taksa e truallit, germa "b", sipas aneksit nr.B.1.4.5, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Konispol, në vlerën **257,658 lekë.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z.SH.B.i me detyrë, Kryetar i Bashkisë Konispol.

Z.H.S. me detyrë, specialist i tatim taksave vendore për periudhën 01.01-30.10.2016.

Znj.V.Xh. me detyrë specialiste e tatim taksave vendore Njësia Administrative Xarrë.

Z.A.D. me detyrë specialiste e tatim taksave vendore Njësia Administrative Markat.

C. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797 datë 29.12.2017.

Në mënyrë shumë të përgjithshme rezulton se edhe pse bashki e vogël, ky subjekt ka hartuar projekte duke përfituar fonde, të cila janë në vlerën e prokuruar prej afro 600 milion lekë.
Nga tabela e paraqitur më poshtë rezulton se bashkia Konispol ka finalizuar 26 procedura prokurimi, nga të cilat:
-12 gjatë vitit 2016, për vlerën prej 271,008,254 lekë dhe vlerë të kontraktuar 267,034,249 lekë, me një diferencë nga fondi limit prej 3,974,005 lekë, ose 1.5%
-14 gjatë vitit 2017, për vlerën prej 273,925,075 lekë dhe vlerë të kontraktuar 269,570,356 lekë, me një diferencë nga fondi limit prej 4,354,719 lekë, ose 1.6%
Nga 26 procedura rezulton se kanë pjesë 53 Operatorë ose 2 operatorë për procedurë.
Gjatë të dy viteve janë lidhur edhe 5 kontrata për shtesë të punimeve në vlerën prej 9,854,741 lekë ose 16.7% të kontratave respektive (vlera e kontratave 58,968,621 lekë)
Nga 26 procedura prokurimi, ka rezultuar se:
12 janë të llojit "E Hapur", në vlerën 488,735,539 lekë, me diferencë nga fondi limit 6,918,504 lekë, ose 3.4%
12 janë të llojit "Kërkesë për propozim", në vlerën 28,849,144 lekë, me diferencë nga fondi limit 1,394,615 lekë ose 4.8%
02 janë të llojit "Ftesë për negocim", në vlerën 27,348,646 lekë me diferencë nga fondi limit 15,605 lekë ose 0%.
Nga Bashkia Konsipol janë realizuar edhe 5 procedura prokurimi të llojit "kërkesë për propozim", kryesisht për blerje automjete, mjete pune apo punime ndërtimi, për vlerën prej 17.529,383, procedura të cilat janë anuluar për mungesë ofertash në 3 raste apo tërheqje të OE të shpallur fitues në dy raste.

Auditimi i zbatimit të procedurave ligjore të prokurimit publik të realizuara nga Bashkia Konispol në vitin 2016.

Objekti prokuruar	Lloj procedure (me rradhe sipas procedurave)	Fondi limit pa tvsh në 000/lek	Operatori apo BOE I shpallur fitues	Vlera ofertës fitues pa tvsh në 000/lek	Audituar
Rikonstruksion +ndertimi i palestres "Bido Sejko" Konispol	E hapur	66983304	R...t	66906660	PO
Rikonstruksioni i rrjetit te furnizimit me uje te qytetit Konispol	E hapur	158339371	A...S	155750971	PO
Rikonstruksioni i rrjetit te furnizimit me uje Konispol (mbikëqyrje punimesh)	K/propozim	1624302	T...t	1460000	JO
Rehabilitimi i infrastruktures vaditese Sherret-Rraha	E hapur	27108226	M...S	26583238	PO
Blerje Automjeti Fuoristrade	K/propozim	3200000	H...a	2920000	PO
Blerje Automjete pune	Ftese/negocim	3500000	Z.L.	3.500.000	PO
Rikonstruksion rruge Fshati Mursi (Diga e Liqenit)	K/propozim	2402116	K...i	2303980	JO
Sistemim dhe rrethim i siperfaqes shtese te varrezave ne Fshatin Shales	K/propozim	1691132	I...D	1641320	JO
Rikonstruksion rruga e re lagjia e shkolles Konispol	K/propozim	3584395	I...D & K...	3417200	JO
Rikonstruksion i rrugëve te fshatit Ninat	K/propozim	1377145	M...s	1375980	JO

Rikonstruksion I rrugeve te fshatit xarre (Fusha e Sportit)	K/propozim	1198263	A...i	1174900	JO
Blerje karburanti	E hapur	2077000	E...A	2491065	JO

Më poshtë paraqiten procedurat e prokurimit të konstatuara më shkelje e parregullsi, si vijon:
Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "**"Rikonstruksioni i Rrjetit te Furnizimit me Ujë te Qytetit Konispol"**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i rrjetit te furnizimit me uje te qytetit Konispol		
1.Urdhër Prokurimi Nr Datë **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** **"**E hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr.9 , dt.26.09.2016 1. Z. L.B.- Ing 2. Znj. K.K.-Juriste 3. Z.E.K.-Ing	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 9-1dt. 26.09.2016 1. Z.E.D.-Kryetar (P.Finance) 2. Z.A.B.-Antar (Ing) 3. E.P.-Antar(Juriste)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 158339371lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 155750971 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 2,588,400 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 26.09.2016	**9.Burimi Financimit** Ministria e Transportit dhe Infrastruktures	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tenderNumër **__3__OE** b)S'kualifikuar __2___OE, c) Kualifikuar___1__ OE
11.Ankimime **AK**-s'ka/ka;**APP**–s'ka/ka;**KPP**-s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK Shkresa nr 1410 datë 11.10.2016 B-93 Shkresa nr 1411 datë 11.10.2016 LANDI-07	**13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim
Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë z. SH.B.i është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP).
-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu II pika 2/c, Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", nenet 15 dhe 22, çka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor.
Ka analizë mbi çmimin për njësi dhe llogaritja e vlerës limit të kontratës është realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore.
Njësia e prokurimit ka përgatitur dokumentet e tenderit

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga njësia e prokurimit (NJP).
a- Llogaritja e fondit limit: Llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike jane hartuar nga Ark.
b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. DST nuk janë firmosur nga NJHDT, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".
Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT. Mos argumentimi i kërkesave e pa argumentuara janë në veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), dhe neni 2 germa (a, b, c) dhe neni 20
Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:
Ne DST pika 1**8 J).** *Operatori ekonomik duhet te paraqese nje vertetim nga bashkia Konispol qe nuk ka detyrime prane saj. Mosparaqitja e ketij vertetimi perben kusht per skualifikim.*

Ndërkohë që ky kriter nuk është i nevojshëm pasi përfshihet në pikën 2 *Kapaciteti ekonomik dhe*

financiar: pika 4 , dhe AK e disponon kete informacion.
Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:
Ne dst pika 1**8 k)** *Do te zhvillohet nje vizite ne kantier ne datat 03-04/10/2016 , ora 10:00-12:00 per tu njohur me objektin e prokurimit per te cilen ofertuesit do te pajisen me nje dokument qe verteton se eshte njohur me kantierin e ndertimit dhe kushtet specifike per realizimin me sukses te kontrates. Mosparaqitja e ketij dokumenti ne tender perben kusht per skualifikim.*
Ky kriter eshte i paargumentuar dhe diskriminues .
Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:
4.2. Gjithashtu Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të zotërojë licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kultures per zbatim punimesh ne monumenteve të trashëgimisë së Kultures dhe Arkitekturës, e cila të përmbajë kategorine CZ.
Restauratori në cilësinë e drejtuesit teknik të shoqërisë duhet të zotërojë licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kultures per projektim e zbatim në punimet ne monumente të trashëgimisë së Kultures dhe Arkitekturës, e cila të përmbajë kategoritë AZ, dheAP.
Ne rastet e Bashkimit te operatoreve secili nga anetaret e ketij bashkimi duhet te plotesoje kushtin si me siper. Ky kriter eshte i paargumentuar dhe diskriminues
Ne piken 6. Te dst-ve eshte kerkuar:
Një punësim mesatar i të paktën **130** (njeqind e tridhjete) personave, për periudhën **Janar 2014 - Gusht 2016** të vërtetuar me:
6.2 List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi,te konfirmuara nga administrata tatimore, per periudhen **Janar 2014 – Gusht 2016** shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.
Rezulton se është një kërkesë e pa argumentuar dhe e fryrë paraqitja dhe e "Formularit të deklarimit të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore", pasi listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore, për pagimin e sigurimeve shoqërore, janë mëse të mjaftueshëm dhe të besueshëm për të vërtetuar kërkesën e punësimit dhe të sigurimit të punonjësve, kjo bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 23, datë 09.12.2014, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", të dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në të cilin në pikën 10 "Të tjera".
Ne piken 18. Te dst-ve eshte kerkuar Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 9):

Mjetet	*Sasia*	*Gjendja*
Kamion vetëshkarkues me aftesi mbajtese mbi 20 ton	(5)copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues aftesi mbajtese mbi 10 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion kapaciteti mbajtës 1 – 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç me aftësi mbajtëse minimumi 8 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompë për hedhje betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadromë	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrul	(1) copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	2 copë	Pronësi ose me qera
Mjet për prishje struktura betoni	2 copë	Pronësi ose me qera
Fabrikë betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinc kulle me lartesi min 45 ml me peshembajtje 850 kg ne 38 ml distance.	(1) copë	Pronësi ose me qera
Aparat Saldimi Monofoze	(5) copë	Pronësi ose me qera
Aparat Saldimi Trefazore	(2)copë	Pronësi ose me qera
Aparat ngjitje tubash PE me elektrofuzion	(6)copë	Pronësi ose me qera

Batipal per punimet e germimit	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	3 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me Goma	1 copë	Pronësi ose me qera

Kërkesa për makineri nuk është e argumentuar me numrin e punonjësve të kërkuar (130 punonjës) dhe volumin e punimeve.

Kriteret e mësipërme nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtimie me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Këto veprime janë jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP, z.E.K., znj. K.K. dhe z.L.B, si dhe Titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.i

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit nr.2/1, datë 13.04.2016 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO). KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Në datën 26.10.2016 është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të tre operatorëve ekonomik. Nga vlerësimi rezulton se jane skualifikuar dy operatorë ekonomik dhe kualifikuar një operatorë, OE "A...S" sh.p.k i cili është shpallur fitues. Kualifikimet dhe skualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar	Klasifikimi
1	A...S SHPK	**155.750.971**	Kualifikohet	Vlera e shpallur fituese
2	SH...I SHPK	0	S'Kualifikuar	
3	A...K SHPK	0	S'Kualifikuar	Vlera e shpallur fituese

Janë skualifikuar:

OE e skualifikuar jane OE "A...K & CO" SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky OE nuk permbush kriteret e Dst-ve dhe eshte skualifikuar me të drejte nga KVO-ja, dhe OE "SH...I" SHPK, nga auditimi rezulton nuk permbush kriteret e Dst-ve dhe eshte skualifikuar po me të drejte nga KVO-ja.

OE e kualifikuar

Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe e shpallur fituese "A...S" sh.p.k nga auditimi rezulton se kjo OE ka keto mangesi:

Ne DST eshte kerkuar pika 4. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2014,2015,2016, nga te gjitha njesite ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas Ekstraktit te QKR;

Ne rastin e nje B.O.E secili nga anetaret e bashkimit te shoqerise duhet ta plotesoje me vete kete kriter.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e paraqitur nga OE "A...S" sh.p.k shpk u konstatua se:

-Subjekti "A...S" shpk me seli në Tirane, sipas ekstraktit të paraqitur ka pasur si vend të zhvillimit të aktivitetit edhe adresa të tjera në të cilat ka hapur NIPT sekondar dhe konkretisht: Bashkine Kukes. Vërtetimi për pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për Bashkine Kukes nuk është paraqitur.

Dokumentet që ka paraqitur OE "A...S" sh.p.k për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në adresat me NIPT sekondar, nuk plotësojnë këtë kërkesë dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE "A...S" sh.p.k. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.B. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

1. Ne DST Kapaciteti Teknik eshte kerkuar Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogel se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është te pakten sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Nga auditimi i dokumentacionit i OE "A...S" SHPK rezulton se asnjë kontrate e paraqitur nga kjo OE nuk ka si natyre objektin e prokurimit .

Banese 4 kat me podrum dhe nencati, Vila 2 dhe 3 kate me podrum dhe nencati, Godine banimi 3 kat me 2 kat bodrum, Godine Banimi 2,3,4 kate + nencati me 1 kat nentoke, Godine banimi 2 dhe 5 kate me podrum etj .

KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 "*Shqyrtimi i ofertave*" të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit"*. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi KVO, nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.B. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit"* dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.B. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt " **REHABILITIM I INFRASTRUKTURËS VADITËSE TË FUSHËS SË "SHERRET-RRAHA"**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rehabilitimi i infrastruktures vaditese Sherret-Rraha		
1.Urdhër Prokurimi Nr Datë	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr.10 , dt.25.10.2016 1.Z. A.B.- Ing 2.Znj. K.K.-Juriste 3.Z. L.B.- Ing	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 10-1 , dt. 25.10.2016 1.Z.E.D.-Kryetar (P.Finance) 2. E.P.-Antar(Juriste) 3. Z. E.K.- Ing
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit **"**E hapur"		

5.Fondi Limit (pa tvsh) 27108226lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 26583238lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 524,988 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 25.10.2016	**9.Burimi Financimit** Ministria e Transportit dhe Infrastruktures	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tenderNumër **__2__OE** b)S'kualifikuar __1___OE, c) Kualifikuar___1__ OE
11.Ankimime **AK**-s'ka/ka;**APP**–s'ka/ka;**KPP**-s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK Shkresa Nr.1585 prot, date 2.11.2016 H...i shpk	**13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë z. SH.B. është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP).

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike duke vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu II pika 2/c, Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" , nenet 15 dhe 22, çka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor.

Ka analizë mbi çmimin për njësi dhe llogaritja e vlerës limit të kontratës është realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore.

Njësia e prokurimit ka përgatitur dokumentet e tenderit

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga njësia e prokurimit (NJP).

a- Llogaritja e fondit limit: Llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike jane hartuar nga Ark.

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat e për kualifikim të hartuara nga NJHDT. Mos argumentimi i kërkesave e pa argumentuara janë jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), dhe neni 2 germa (a, b, c) dhe neni 20

Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhte:

Punime te pergjithshme ndertimi

N.P - 1 - A Punime gërmimi në tokë.
N.P - 5 - A Punime nëntokësore, ura e vepra A...I.
N.P - 7 - A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.
N.P - 9 - B Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.
N.P -12- A Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Punime speciale ndertimi

N.S -1- A Punime për prishjen e ndërtimeve.
N.S-8 - A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.
N.S-9- A Punime strukturore speciale
N.S-18- A Punime topogjeodezike.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës. Duke u Bazuar në preventivin e hedhur në tender shume nga keto kategori licensash nuk jane te nevojshme pasi nuk kane si natyre abjektin qe prokurohet konkretisht: Pika N.S-9-A qe eshte per Punime strukturore speciale ku ne preventivin e punimeve nuk ka asnje ze te tille qe te jete e nevojshme kjo kategori punimesh.

Ne Dst pika **2.2.** **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** pika 4 eshte kerkuar:

Te paraqitet vertetim qe verteton se operatori ekonomik nuk ka asnje lloj detyrimi kundrejt Bashkise Konispol percaktuar sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Per Taksat Vendore ne Republiken e Shqiperise" te ndryshuar si dhe detyrime te tjera te mundshme qe rrjedhin nga kontrata te caktuara, leshuar jo me pare se 5 (pese) dite perpara dates se zhvillimit te tenderit. Vertetimi leshohet kundrejt kerkeses se bere nga operatori ekonomik ne Bashkine Konispol, Drejtoria e Financave.

Ndërkohë që ky kriter nuk është i nevojshëm pasi përfshihet në pikën 2.2 pika "3", dhe AK e disponon kete informacion.

Në pikën 2 germa C AK ka kërkuar:

Kandidati/ofertuesi duhet te percaktoje me ane te nje deklarate me shkrim(nga administratori i shoqerise) **drejtuesin teknik te punimeve** ne objekt perfshire ne licencen e shoqerise dhe te deklaroje se ai do te jete i pranishem gjate gjithe kohes qe do te kryhen ne objekt, shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem.

. Diploma
. CV
. Kontrate pune te vleshme

Ndërkohë që për punime deri në 30.000.000 lekë nuk është e detyrueshme që drejtuesi teknik të jetë gjithe kohës i pranishëm në kantier kjo sipas Kreut I/2.1 te Udhezimit nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"

Ne piken 3. Te dst-ve eshte kerkuar Disponimi i mjeteve te meposhtme:

Mjetet	*Sasia*	*Gjendja*
Kamionvetëshkarkuesipajisurdhe me vinc (kapaciteti 18 ton)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine(kapaciteti 1.4ton)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine(kapaciteti 3.5-7ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
Ngarkues me zinxhire	1copë	Pronësi ose me qera
Rimorkiator per levizjen e mjeteve	1copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire me kove 0.25m3	1copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1copë	Pronësi ose me qera
Tabela sigurie ne rruge	10 copë	Pronësi ose me qera
Kokore	40 copë	Pronësi ose me qera
Doreza pune	40 copë	Pronësi ose me qera
Jeleke fosfori	40 copë	Pronësi ose me qera
Fikese zjarri	10 copë	Pronësi ose me qera
Rrjete rrethimi mbrojtese	1000m2	Pronësi ose me qera
Aparat nivelimi automatik	1cope	Pronësi ose me qera
Total station shoqeruar me certfikate kontrolli	1cope	Pronësi ose me qera
Autobote uji i pajisur me pasaporten e mjetit	1copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2copë	Pronësi ose me qera
Fabrike betoni e pajisur me QKL ne nje distance jo me te madhe se 60 km se objekti	1copë	Pronësi ose me qera
Fabrike inerti ne e pajisur me QKL	1copë	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshes	*1 cope*	*Pronesi ose me qera*

Kërkesa për makineri nuk është e argumentuar me numrin e punonjësve të kërkuar (60 punonjës) dhe volumin e punimeve.Gjithashtu Njesia e prokurimit nuk ka vepruar ne baze te dispozitave ligjore pasi per:

Fabrike betoni e pajisur me QKL ne nje distance jo me te madhe se 60 km se objekti
Fabrike inerti ne e pajisur me QKL

Duhet te kishte kerkuar dhe kontrate furnizimi. Sa më sipër për mos argumentimin e kërkesave për kualifikim mban përgjegjësi NJHDT, bazuar në Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3,

"Informacione të veçanta", të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, "Për rregullat e prokurimit publik", në të cilën përcaktohet se: "Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: "Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues" .
Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga A.B., L.B. dhe K.K.

Vlerësimi i ofertave nga KVO
Me urdhër e titullarit nr.2/1, datë 13.04.2016 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO). KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.
Në datën 25.10.2016 është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të dy operatorëve ekonomik. Nga vlerësimi rezulton se eshte skualifikuar nje operatorë ekonomik dhe kualifikuar nje operatorë, OE "M...S"sh.p.k i cili është shpallur fitues. Kualifikimet dhe skualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar	Klasifikimi
1	B...B	24 124 913	S,Kualifikohet	
2	M...S	26 583 238	Kualifikuar	Vlera e shpallur fituese

Janë skualifikuar:
OE e skualifikuara jane OE "B...U" SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky OE nuk përmbush kriteret e DST-ve dhe eshte skualifikuar me të drejte nga KVO-ja.
OE e kualifikuar
Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe e shpallur fituese "M...S" sh.p.k nga, pas kundërshtimeve të bëra nga subjekti, rezulton se është kualifikuar drejtë nga KVO.

Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "**Rikonstruksion + ndertim i palestres se shkolles «Bido Sejko» Konispol"**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : *Rikonstruksion +ndertimi i palestres "Bido Sejko" Konispol*		
1.Urdhër Prokurimi Nr Datë **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** **"**E hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr.4 , dt.3.6.2016 1.Z. L.B.- Ing 2.Znj. K.K.-Juriste 3.Z.E.K.-Ing	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 4-1 dt. 3.6.2016 1.Z.E.D.-Kryetar (P.Finance) 2.Z.A.B.-Antar (Ing) 3. E.P.-Antar(Juriste)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 66983304 lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 66906660lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 76,644 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 3.6.2016	**9.Burimi Financimit** Grandi i Arsimit	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tenderNumër **__4__OE** b)S'kualifikuar __3___OE, c) Kualifikuar___1__ OE
11.Ankimime **AK**-s'ka/ka;**APP**–s'ka/ka;**KPP**-s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK 1.Shkresa nr 872 datë13.6.2016 M...S 2.Shkresa nr 873 datë13.6.2016 B-93	**13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim
Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë z. SH.B. është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP).
-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike veprimi jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu II pika 2/c, Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", nenet 15 dhe 22, çka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor.
Ka analizë mbi çmimin për njësi dhe llogaritja e vlerës limit të kontratës është realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore.

Njësia e prokurimit ka përgatitur dokumentet e tenderit

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga njësia e prokurimit (NJP).
a- Llogaritja e fondit limit: Llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike jane hartuar nga Ark.
b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat e për kualifikim të hartuara nga NJHDT. Mos argumentimi i kërkesave e pa argumentuara janë veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), dhe neni 2 germa (a, b, c) dhe neni 20
Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:

- **3** "Liçensa profesionale e shoqerise lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Licensa profesionale e shoqerise lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates me kategorite:
N.P – 1 A Punime gërmimi në tokë.
N.P – 2 A Ndërtime civile dhe industrial.
N.P - 3 B Rikonstruksione dhe mirëmbajtje godinash.
N.P – 4 A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, ...
N.P – 7 A Ujesjellsa, gazesjellesa, vajesjellesa, ...
N.P – 12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
N.S - 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.
N.S - 2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina....
N.S - 4 A Punime rifiniture të muratures dhe të lidhura me to
N.S - 8 B Ndertime parafabrikat beton arme, ...
N.S - 9 A Punime strukturore speciale.
N.S - 14 A Impiante te brendshme,elektrike,telefoni....
N.S – 18 A Punime topogjeodezike.
N.S – 19 A Sisteme kundra zhurmes per infrastrukture.
Duke u Bazuar në preventivin e hedhur në tender shume nga keto kategori licencash nuk jane te nevojshme pasi nuk kane si natyre objektin qe prokurohet konkretisht: Piaka NS-12/A qe eshte per Punime të inxhinierisë së mjedisit ku ne preventivin e punimeve nuk ka asnje ze te tille qe te jete e nevojshme kjo kategori punimesh.

- Ne DST pika **11** eshte kerkuar:

Operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim qe nuk ka detyrime nda Bashkise Konispol dhe te gjitha njesive administrative te saj.
V.O: Do të konsiderohen detyrime të gjitha shumat që janë rrjedhoj e një detyrimi të lindur në saj të zbatimit të ligjit për taksat vendore, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" gjobat e ndryshme nga institucionet audituese legjitime, e cdo lloj detyrimi tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi apo kontrata të mëparshme të nënshkruara me institucionin tonë.Vërtetimi duhet të jetë lëshuar jo më parë se 5 ditë nga data e parashikuar për hapjen e ofertave. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin. Ndërkohë që ky kriter nuk është i nevojshëm pasi përfshihet në pikën 2, dhe AK e disponon kete informacion.

- ***Ne piken 7 . te DST-ve eshte kerkuar Stafi Drejtues i shoqerise te perbehet nga:***

Drejtues Teknik inxhinier ndërtimi, 2 të punësuar. Kontratë individuale të punës, diplomë, si dhe CV.
Drejtues Teknik inxhinier hidroteknik, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës, diplomë, si dhe CV.
Drejtues Teknik inxhinier mekanik, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës, diplomë, si dhe CV.
Drejtues Teknik inxhinier elektrik, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës, diplomë, si dhe CV.

Drejtues Teknik inxhinier topograf/gjeodet, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës, diplomë, si dhe CV.
Drejtues Teknik inxhinier gjeolog, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës , diplomë, si dhe CV.
Drejtues Teknik inxhinier mjedisi, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës , diplomë, si dhe CV.
Drejtuesi/t teknik i/të shoqërisë nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër shtetëror apo privat. Për këtë shoqëria duhet të paraqese një deklaratë nga Administratori ishoqërisë dhe të deklarojë se autorizon Autoritetin Kontraktor për verifikimin e informacionit të dhënë. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kushtë për skualifikim.

Nga auditimi rezulton se:
Në lidhje me disponueshmërinë e inxhinierit mjedisi, e në Hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kritere kualifikuese në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Parakushti kyç *sine qua non* për Hartimin dhe vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimve. Sa më sipër, referuar dhe natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuar,si edhe kategorizimit të pikave të licencës, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmëria e një inxhinieri mjedisi si pjesë e stafit teknik
Kerkesa per nje inxhinier gjeologo ne zbatim te nenit 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Per Kontrollin dhe Disiplinimin E Punimeve Te Ndertimit" parashikohet se "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore." Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit." Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë (drejtuesit teknik të shoqërisë), të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, kriteri i mësipërm nuk është në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe si një kriter i tillë nuk duhej vendosur .

4. Ne piken 10. Te dst-ve eshte kerkuar qe Autoriteti Kontraktor Bashkia Konispol, do te zhvilloje vizite ne kantier 2 (dy) dite perpara zhvillimit te procedures. Të gjithe operatoret ekonomike te interesuar per te marre pjese ne procedure duhet te paraqiten ne kantier per te cilen do te pajisen me vertetim nga Bashkia Konispol, mosparaqitja e ketij vertetimi eshte kusht skualifikues. *Kriter i paargumentuar, i palidhur me objektin e kontratës.*
Ne piken 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, eshte kerkuar: Operatori Ekonomik duhet të disponojë vlera të mjaftueshme monetare për të realizuar objektin e tenderit pa marrë paradhënie. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të gjëndjes financiare, me nr. I llogari, iban-i dhe nipt i subjektit, nga një ose më shumë banka ku vlera në lekë (apo ekuivalentja në valutë) në llogarinë e operatorit të jetë jo më të vogël se 50% të fondit limit (meqenese per vitin 2016 financimi eshte sa 50% e fondit limit dhe objekti duhet perfunduar brena 60 diteve),, të lëshuar jo më shumë se 5 ditë nga data e hapjes së ofertave. Kjo shume duhet te jete e ngurtesuar ne banke deri ne momentin e nenshkrimit te kontrates ne rast shpallje fitues te operstorit ekonomik. *Kriter i paargumentuar dhe diskriminues.*
Ne piken 5. Te dst-ve eshte kerkuar Disponimi i mjeteve te meposhtme:

Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

1.	Kamion vetëshkarkues, ngarkese mbi 30 ton+foto	copë 5
2.	Kamion vetëshkarkues, ngarkese 15-20 ton+foto	copë 2
3.	Kamioncina, ngarkese deri 5 ton +foto	cope 2
4.	Eskavator 15-30 ton+foto	copë 3
5.	Fadrome+foto	copë 1
6.	Mini eskavator+foto	copë 1
7.	Rrul+foto	copë 1
8.	Rrul i vogel deri 500 kg+foto	cope 1
9.	Kamion me vinç+foto	copë 1
10.	Autovinc me kosh	cope 1
11.	Autobetoniere+foto	copë 3
12.	Autopompe betoni	copë 2
13.	Tokmak per ngjeshje	copë 2
14.	Betoniere 0.5 m3	copë 10
15.	Vibrator betoni sipërfaqësor	copë 2
16.	Motosaldatriçe	copë 2
17.	Gjenerator	copë 2
18.	Depozita 1.000 - 5.000 liter	copë 3
19.	Matrapik	copë 5
20.	Kompresor	copë 5
21.	Freze	copë 2
22.	Vinç	copë 3
23.	Pompe uji+foto	copë 5
24.	Makineri per suvatim (pompe suvatimi)	cope 3
25.	Makineri per punim hekuri	cope 1
26.	Armatur (derrase ose panele)	m2 2000
27.	Skela	m2 3000
28.	Aparate saldimi tubo celiku	copë 1
29.	Aparate saldimi tubo plastike	copë 1
30.	Aparate kontroll saldimi	copë 1
31.	Prerese hekuri	copë 1
32.	Kapanon sanduic per stafin	copë 2
33.	Nyje për prodhimin e betonit jome larg se 25 km	copë 1
34.	Nyje inerte	copë 1
35.	Vidjator	cope 1
36.	Saldatrice me korent 3 fazor	cope 1
37.	Pajisje saldimi me argon	cope 1
38.	Pajisje elektrike 3 fazore me sh vende	cope 1
39.	Elektro motogjenerator	cope 1
40.	Ndricues elektrik i levizshem+foto	cope 1
41.	Ngrites pirun teleskopik	cope 1
42.	Sharre elektrike	cope 1
43.	Vinc Kolone Ninvie dhe Comtec	cope 1

Kërkesa për makineri nuk është e argumentuar me numrin e punonjësve të kërkuar (160 punonjës) dhe volumin e punimeve.

Kriteret e mësipërme nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtimie me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Këto veprime janë në mospërputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe

ngarkojnë me përgjegjësi NJP, z.E.K., znj. K.K. dhe z.A.A., si dhe Titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit nr.2/1, datë 13.04.2016 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO).

KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Në datën 25.10.2016 është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të shtate operatorëve ekonomik. Nga vlerësimi rezulton se jane skualifikuar tre operatorë ekonomik dhe kualifikuar nje operatorë, BOE "R...I" & "V...T" sh.p.k i cili është shpallur fitues. Kualifikimet dhe skualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar	Klasifikimi
1	SH...I	0	S'Kualifikohet	
2	R...T	66.906.660	Kualifikuar	Vlera e shpallur fituese
3	Z...B	0	S'Kualifikohet	
4	E...N	0	S'Kualifikohet	

Janë skualifikuar:

OE e skualifikuara jane OE "SH...I" SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky OE nuk permbush kriteret e DST dhe eshte skualifikuar drejte nga KVO. Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

OE i skualifikuar "Z...B" SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky OE nuk permbush kriteret e DST-ve dhe eshte skualifikuar drejte nga KVO-ja. Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

OE i skualifikuar "E...N" SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky OE nuk permbush kriteret e DST dhe eshte skualifikuar drejte nga KVO. Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

OE e kualifikuar

Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe e shpallur fituese "R...I" & "V...T" sh.p.k nga auditimi rezulton se kjo OE ka keto mangesi:

Ne DST eshte kërkuar ne piken 3.5 Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Eskavator 15-30 ton+foto copë 3

Fabrika për prodhimin e betonit te jete në pronësi/qera ose ne forme tjeter ligjore me emertim te objektit qe prokurohet, jo me larg se 25 km nga vendodhja e objektit, shoqeruar me dokumente që vertetojnë pronësinë, planin e vendosjes dhe lejen mjedisore (duhet të paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B lëshuar nga Qëndra Kombëtare e Licencimit)

Nga dokumentat e paraqitura nga kjo BOE nuk vërtetohet largesia jo me larg se 25 km. Pasi vendodhja e kësaj fabrike betoni eshte ne Elbasan.

Ne DST eshte kerkuar Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, pranë te gjitha njësive të qeverisjes vendore (sipas QKR) ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet për vitet 2015, 2016 dhe 2017.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Njesit e Qeverisjes Vendore.
Nga auditimi mbi dokumentacionin e paraqitur nga BOE "R...I" & "V...T" sh.p.k shpk u konstatua se:
-Subjekti "R...I" shpk me seli në Tiranë, sipas ekstraktit të paraqitur ka pasur si vend të zhvillimit të aktivitetit edhe adresa të tjera në të cilat ka hapur NIPT sekondar dhe konkretisht: Bashkine Kruje. Vërtetimi për pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për Bashkine Kruje nuk është paraqitur.

Dokumentet që ka paraqitur BOE "R...I" & "V...T" sh.p.k për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në adresat me NIPT sekondar, nuk plotësojnë këtë kërkesë dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE "R...I" & "V...T" sh.p.k. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.B. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.
KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 "*Shqyrtimi i ofertave*" të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit"*. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi KVO, nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.B. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.
Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit"* dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.B. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

Auditimi i zbatimit të procedurave ligjore të prokurimit publik të realizuara nga Bashkia Konispol në vitin 2017.

Objekti prokuruar	Lloj procedure (me rradhe sipas procedurave)	Fondi limit pa tvsh në 000/lek	Operatori apo BOE I shpallur fitues	Vlera ofertës fitues pa tvsh në 000/lek	Audituar
Ndertimi i linjes ujesjellesit depo tharese fshati Mursi	E hapur	8371120	A...S	8279310	PO
Rikonstruksioni i shkolles Mehmet Xhaferi Xarre	E hapur	57931934	R...i & V...t	57863092	PO
Nderhyrje Emergjente ne Argjinaturen e Lumit Pavell	Ftesë/negocim	23848646	E...i	23833041	PO

Ndertimi i linjes se ujesjellesit ne fshatin Ninat	E hapur	23134125	A...s	22942320	PO
Rikonstruksioni I Kanalit furnizues V 55 ne Fushen e Vrines	E hapur	9722221	M...S	9399999	PO
Rijetezimi i Ansamblit Urban te Qendres Konispol	E hapur	65697705	G...G C...	64665200	PO
Rehabilitimi i Unazes Ekonomike (loti I) Shkalle-Mursi	E hapur	50222533	A...i & I...D	49005820	PO
Ndertim pusetash kolektive ne fshatin Shales	K/propozim	4037898	I...D & K...	3929668	JO
Rehabilitimi i kanalit vadites Shales-Markat	E hapur	11750000	Sh...i & J...i C...	10945425	PO
Blerje karburanti	E hapur	9475000	EP D.A.	9475000	PO
Blerje automjeti	K/propozim	960000	T...a A...	910000	JO
Rikonstruksion i rrugeve te fshatit Xarre dhe Ciflik	K/propozim	5698449	J...y c...	5519303	JO
Ndertimi Ure kalimi dhe vendosje tombino ne Fshatin Janjar	K/propozim	1327812	I...D	1303587	JO
Rikonstruksion rruge te brendeshme Konispol	K/propozim	1747632	K...I	1498591	JO

Më poshtë paraqiten procedurat e prokurimit të konstatuara më shkelje e parregullsi, si vijon:

Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "**RIJETEZIMI I ANSAMBLIT URBAN TE QENDRES KONISPOL"**

b. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rijetezimi i Ansamblit Urban te Qendres Konispol		
1.Urdhër Prokurimi Nr Datë **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** **"**E hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr.10 , dt.05.05.2017 1.Z.A.B. - Ing 2.L.B. Ing 3.Znj.K.K. Juriste	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 10-1 , dt. 05.05.2017 1.Z.E.D.-Kryetar (P.Finance) 2. Znj.E.P.- Antar 3-Z.A.A.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 65697705lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 64665200 leke	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 1,032,505 leke
8. Data e hapjes së tenderit 05.05.2017	**9.Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tenderNumër **__5_OE** b)S'kualifikuar __4___OE, c) Kualifikuar___1__ OE
11.Ankimime **AK**-s'ka/ka;**APP**–s'ka/ka;**KPP**-s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK	**13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë z. SH.B.i është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP).

Nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu II pika 2/c, Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", nenet 15 dhe 22, çka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor.

Ka analizë mbi çmimin për njësi dhe llogaritja e vlerës limit të kontratës është realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore.

Njësia e prokurimit ka përgatitur dokumentet e tenderit

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga njësia e prokurimit (NJP).

a- Llogaritja e fondit limit: Llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike jane hartuar nga Ark.

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat e për kualifikim të hartuara nga NJHDT. Mos argumentimi i kërkesave e pa argumentuara janë veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 8 e

18, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), dhe neni 2 germa (a, b, c) dhe neni 20

Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:

Ne piken 8 te dst eshte kerkuar Disponimi i mjeteve te meposhtme:

Skrep	Cope 2	Pronësi ose me qera
Mjete transporti veteshkarkues mbi 20 ton	Cope 4	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	Cope 2	Pronësi ose me qera
Autopompe Betoni	Cope 1	Pronësi ose me qera
Kamioncine	Cope 2	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	Cope 1	Pronesi ose me qera
Rimorkiator	Cope 1	Pronësi ose me qera
Autovinc	Cope 1	Pronesi ose me qera
Autobot uji	Cope 1	Pronesi ose me qera
Makineri Shtrim Bordura	Cope 1	Pronesi ose me qera

Gjenerator	Cope 2	Pronesi ose me qera
Matrapik	Cope 1	Pronesi ose me qera
Aparat GPS per punimet topogjeodezike	Cope 1	Pronesi ose me qera
Skele	200 m2	Pronesi ose me qera
Ndricues me Gjenerator	1 cope	Pronesi ose me qera
Fabrike Betoni	Cope 1	Pronesi ose me qera
Fabrike Inertesh	Cope 1	Pronesi ose me qera

Kërkesa për makineri nuk është e argumentuar me numrin e punonjësve të kërkuar (140 punonjës) dhe volumin e punimeve.

5. Ne piken 4 te dst-ve eshte kerkuar qe Autoriteti Kontraktor Bashkia Konispol, do te zhvilloje vizite ne kantier 5 (pese) dite perpara zhvillimit te procedures. Te gjithe operatoret ekonomike te interesuar per te marre pjese ne procedure duhet te paraqiten ne kantier per te cilen do te pajisen me vertetim nga Bashkia Konispol, mosparaqitja e ketij vertetimi eshte kusht skualifikues. *Ky eshte nje kriteri pa argumentuar dhe diskriminues.*

Sa më sipër për mos argumentimin e kërkesave për kualifikim mban përgjegjësi NJHDT, bazuar në Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta", të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, "Për rregullat e prokurimit publik", në të cilën përcaktohet se:

"Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: "Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues".

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga A.B., A.A. dhe K.K..

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO).

KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të pese operatorëve ekonomik. Nga vlerësimi rezulton se jane skualifikuar kater operatorë ekonomik dhe kualifikuar dynje operatorë, OE "G...Y" i cili është shpallur fitues. Kualifikimet dhe skualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/ s'kualifikuar	Klasifikimi
1	C... & B...U	**52.878.426**	S,Kualifikohet	
2	SH...I	0	S,Kualifikohet	
3	U...M	**65,630,644**	S,Kualifikohet	
4	"M...S" &' B...S"	**60.666.666**	S,Kualifikohet	

5	"G...Y"	**64.665.200**	Kualifikohet	Vlera e shpallur fituese

Janë skualifikuar:
BOE e skualifikuara jane BOE C...i sh.p.k & B...U SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky BOE nuk permbush kriteret e DST-ve dhe eshte skualifikuar drejte nga KVO-ja.
OE e skualifikuara jane OE SH...I SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky OE nuk permbush kriteret e DST-ve dhe eshte skualifikuar drejte nga KVO-ja.
OE e skualifikuara jane OE U...M SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky OE nuk permbush kriteret e DST-ve dhe eshte skualifikuar drejte nga KVO-ja.
BOE e skualifikuara eshte edhe BOE "M...S" &' B...S" SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky BOE **eshte terhequr me kerkesen protokolluar date 09.06.2017**.

OE e kualifikuar
Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe e shpallur fituese "G...Y" sh.p.k nga auditimi rezulton se ky OE ka keto mangësi:
OE "G...Y" SHPK nuk ka pasqyruar ne Ektraktin e QKR-se te gjitha vendet ku ka zhvilluar biznes dhe per rrjedhoje e nuk ka paguar detyrimet vendore ne te gjitha njesite ku ka zhvilluar biznes.
Referuar dokumentacionti te paraqitur per pune te ngjashme rezulton se operatori ka realizuar punime sipas kontrates lidhur me me objekt: Rikonstruksion i sheshit qendror te qytetit, Konispol pra ka zhvilluar aktivitett biznesi edhe ne Njesine Vendore Konispol ne vitin 2015-2016 dhe per rrjedhoje duhet te pasqyronte ne QKR edhe kete vend te zhvillimit te biznesit si dhe hapjen e niptit sekondar. Pra, operatori ndonese zhvillon aktivitet biznesi ne vendndodhje te ndryshme nga selia Fier, Lushnje, nuk i ka pasqyruar ne ekstraktin e QKRse, si vende zhvillimi te biznesit ku do te duhej te pajisej edhe me NIPT sekondar per keto vende te tjera zhvillimi biznesi, e me tej te paguante detyrimet vendore e te pajisej me veretetim per sejcilin prej ketyre njesive. Personi i tatueshem qe ushtron veprimtari ne adresa (vendndodhje) te ndryshme bisnesi, pajiset me certificate regjistrimi per cdo adrese, e cila ka nje NIPT unik", Mosrregjistrimi vjen ne kundershtim me ligjin nr 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" nenin 40, nenin 3.1/a.b.c te ligjit Nr. 131/2015" Për qendrën kombëtare të biznesit" si dhe ligjin nr. 9723 dt.03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit.
KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 "*Shqyrtimi i ofertave*" të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit"*. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi KVO, z. A.A. , znj.E.P. dhe z. E.D.
Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit"* dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, z. A.A., znj.E.P. dhe z. E.D.

Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "**REHABILITIMI I UNAZES EKONOMIKE (LOT1), SHKALLE - MURSI"**

c. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rehabilitimi i Unazes Ekonomike (loti I) Shkalle - Mursi		
1.Urdhër Prokurimi Nr Datë	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr.1 , dt.20.01.2017 1.Z.A.B. 2.Z.A.A. 3-Znj K.K. Anetar	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 1-1 , dt.20.01.2017 1.Z.E.D. (P.Finance) 2. Znj.E.P.- Antar 3-Z.E.K. Anetar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur		

5.Fondi Limit (pa tvsh) 50222533 lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 49005820leke	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**1,216,713 leke
8. Data e hapjes së tenderit 20.01.2017	**9.Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tenderNumër **__3_OE** b)S'kualifikuar __2___OE, c) Kualifikuar___1__ OE
11.Ankimime **AK**-ka;**APP**–s'ka/ka;**KPP**-s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK Nr 144 date 31.01.2017	**13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë z. SH.B. është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP).

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu II pika 2/c, Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", nenet 15 dhe 22, çka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor.

Ka analizë mbi çmimin për njësi dhe llogaritja e vlerës limit të kontratës është realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore.

Njësia e prokurimit ka përgatitur dokumentet e tenderit

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga njësia e prokurimit (NJP).

a- Llogaritja e fondit limit: Llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike jane hartuar nga Ark.

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat e për kualifikim të hartuara nga NJHDT. Mos argumentimi i kërkesave e pa argumentuara janë jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), dhe neni 2 germa (a, b, c) dhe neni 20

Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:

- **Ne piken 4.3 kapaciteti teknik pika 1** "Liçensa profesionale e shoqerise lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Licensa profesionale e shoqerise lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates me kategorite:

NP-1 - A (Punime germimi ne toke)
NP-4- C(Rruge,autostrada,mbikalime,hekurudha,tramëai,metro,pista a eroportuale)
NP-5- A (Punime nentoksore, ura e vepra A...I)
NP-12- A (Punime te inxhinierise se mjedisit)
NP-9 – A (Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hisraulike dhe bonifikime)
NS-6 - A (Sinjalistika rrugore jo ndricuese)
NS-7 – A (Barriera dhe mbrojtje rrugore)
NS-8 – A (Punime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri)
NS-18 - A (Punime topogjeodezike)

Duke u Bazuar në preventivin e hedhur në tender shume nga keto kategori licensash nuk jane te nevojshme pasi nuk kane si natyre abjektin qe prokurohet konkretisht: Piaka NP-9 – A qe eshte per Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hisraulike dhe bonifikime ku ne preventivin e punimeve nuk ka asnje ze te till qe te jete e nevojshme kjo katigori punimesh.

Ne dst pika **2.2.** **Kapaciteti ekonomik dhe financiar te DST-ve** eshte kerkuar:

Te paraqitet vertetim qe verteton se operatori ekonomik nuk ka asnje lloj detyrimi kundrejt Bashkise Konispol percaktuar sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Per Taksat Vendore ne Republiken e Shqiperise" te ndryshuar. si dhe detyrime te tjera te mundshme qe rrjedhin nga kontrata te caktuara,leshuar jo me pare se 5 (pese) dite perpara dates se zhvillimit te tenderit.

Vertetimi leshohet kundrejt kerkeses se bere nga operatori ekonomik ne Bashkine Konispol, Drejtoria e Financave. Ne rastin e nje B.O.E secili nga anetaret e bashkimit te shoqerise duhet ta plotesoje me vete kete kriter

Ndërkohë që ky kriter nuk është i nevojshëm pasi përfshihet në pikën 2, dhe AK e disponon kete informacion.

Ne DST Kapaciteti teknik pika **6.** eshte kerkuar :

Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin/(t) Teknik** të punimeve në objekt dhe të deklaroje se ai/ata do të jetë/jenë i/ të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe duhet të ketë një përvojë pune prej 15 vjet, të shoqëruar me:

i. Diplomë
ii. CV
iii. Kontrate pune të vlefshme
iv. Libreze Pune

Është kërkuar në DST që drejtuesi teknik i shoqërisë të jetë me përvojë jo më pak se 15 vjet, në kundërshtim më kreun IV të VKM nr.42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që zhvillojnë veprimtari ndërtimi", ku citohet se "*Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomim. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 vjet nga diplomimi*".

Ne piken 6 te dst-ve eshte kërkuar Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, Shoqëria të ketë në stafin per kryerjen e punimeve minimumi:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier per Ndërtim Rruge-Ura
- 1 (nje) inxhinier topograf
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier mekanik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Gjeollog

(me kontratë pune të vlefshme, cv,diplome)

Në lidhje me diponueshmërinë e inxhinierit Gjeollog dhe mekanik, e në Hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kritere kualifikuese në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Parakushti kyç sine qua non për Hartimin dhe vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimve. Sa më sipër, referuar dhe natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuar,si edhe kategorizimit të pikave të licencës, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmëria e një inxhinieri mjedisi si pjesë e stafit teknik.

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Per Kontrollin Dhe Disiplinimin E Punimeve Te Ndertimit" parashikohet se "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore." Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit." Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë (drejtuesit teknik të shoqërisë), të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e

punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, kriteri i mësipërm nuk është në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe si një kriter i tillë nuk duhej vendosur.

Ne piken 7 . Te dst-ve eshte kerkuar Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 9):

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA
1.	Kamiona: Kamion me kapacitet mbajtes minimumi 15 ton	ne pronesi ose me qera	cope 2
2.	Eskavator me kove	ne pronesi ose me qera	Cope 2
3.	Eskavator me matrapik	ne pronesi ose me qera	Cope 1
4.	Kamion vetshkarkues me vinc	ne pronesi ose me qera	Cope 1
5.	Auto Betoniere	ne pronesi ose me qera	cope 2
6.	Pompe per hedhje betoni	ne pronesi ose me qera	Cope 1
7.	Buldozier	ne pronesi ose me qera	cope 1
8.	Grejder	ne pronesi ose me qera	cope 2
9.	Rul per bazamente	ne pronesi ose me qera	cope 2
10.	Rul asfalti	ne pronesi ose me qera	cope 1
11.	Asfaltoshtruese	ne pronesi ose me qera	cope 1
12.	Makineri pastrim dhe skarifikim asfalti	ne pronesi ose me qera	cope 1
13.	Makineri shpuese Ëagodrill	ne pronesi ose me qera	cope 1
14.	Aparat GPS per punime Topogjeodezike	ne pronesi ose me qera	cope 1
15.	Autobot Uji	ne pronesi ose me qera	cope 1
16.	Minibuldozer	ne pronesi ose me qera	cope 1
17.	Fabrike prodhimi Asfalto betoni pajisur me leje mjedisore nga QKL jo me larg se 50 km nga kantieri	ne pronesi ose me qera	cope 1
18.	Fabrike per prodhim betoni pajisur me leje mjedisore nga QKL jo me larg se 50 km nga kantieri	ne pronesi ose me qera	cope 1
19.	Linje per prodhim inertesh pajisur me leje mjedisore nga QKL	ne pronesi ose me qera	cope 1

Kërkesa për makineri nuk është e argumentuar me numrin e punonjësve të kërkuar (50 punonjës) dhe volumin e punimeve.
Kriteret e mësipërme nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtimie me natyrën dhe përmasat e kontratës.
Këto veprime janë jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP, z.A.B., znj. K.K. dhe z.A.A., si dhe Titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

Vlerësimi i ofertave nga KVO
Me urdhër të titullarit është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO).
KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.
Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, që ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të shtate operatorëve ekonomik. Nga vlerësimi rezulton se jane skualifikuar dy operatorë ekonomik dhe kualifikuar nje operatorë, BOE "A...I" & "I...D" sh.p.k i cili është shpallur fitues. Kualifikimet dhe skualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar	Klasifikimi
1	B...B SHPK	**40 249 450**	S,Kualifikohet	
2	SH...I & J...Y	36 823 673	S'Kualifikuar	

3	A...I & I...D	49 005 820	Kualifikuar	Vlera e shpallur fituese

Janë skualifikuar:
OE e skualifikuara jane OE "B...B" SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky OE nuk ka permbushur kriteret e DST-ve dhe eshte skualifikuar drejte nga KVO-ja, si dhe BOE "S...I" & "J...Y" SHPK e cila ka **hequr dore vete nga procedura**.
OE e kualifikuar
Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe e shpallur fituese "A...I" & "I...D " sh.p.k nga auditimi rezulton se kjo OE ka keto mangesi:
Ne DST eshte kerkuar 2. Vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2014, 2015 dhe 2016 prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit ne QKR.

Ne rastin e nje B.O.E secili nga anetaret e bashkimit te shoqerise duhet ta plotesoje me vete kete kriter.
Nga auditimi mbi dokumentacionin e paraqitur nga BOE "A...I" & "I...D" sh.p.k shpk u konstatua se:
-Subjekti "I...D" shpk me seli në Sarande, sipas ekstraktit të paraqitur ka pasur si vend të zhvillimit të aktivitetit edhe adresa të tjera në të cilat ka hapur NIPT sekondar dhe konkretisht: Bashkine Delvine. Vërtetimi për pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për Bashkine Delvine nuk është paraqitur.
Dokumentet që ka paraqitur BOE "A...I" & "I...D " sh.p.k për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në adresat me NIPT sekondar, nuk plotësojnë këtë kërkesë dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE "A...I" & "I...D " sh.p.k. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.A. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.
KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 "*Shqyrtimi i ofertave*" të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit"*. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi KVO, nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.A. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.
Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit"* dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.A. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.I.

Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "**NDËRTIM I LINJËS SË UJËSJELLËSIT NË FSHATIN NINAT"**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Ndertimi i linjes se ujesjellesit ne fshatin Ninat		
1.Urdhër Prokurimi Nr Datë **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** **"**E hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr.12 , dt.11.05.2017 1.Z.A.B. 2.Z.A.A. 3-Znj K.K. Anetar	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 12-1 , dt. 11.05.2017 1.Z.E.D. (P.Finance) 2. Znj.E.P.- Antar 3-Z.A.A. Anetar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 23134125lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 22,942,320 leke	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**191,805 leke
8. Data e hapjes së tenderit	**9.Burimi Financimit**	**10.Operatoret Ekonomike**

11.05.2017	Buxheti i shtetit	**a)**Pjesëmarrës në tenderNumër **__3_OE** b)S'kualifikuar __2___OE, c) Kualifikuar___1__ OE
11.Ankimime **AK**-s'ka/ka;**APP**–s'ka/ka;**KPP**-s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK	**13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim
Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë z. SH.B.i është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP).
-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike veprimi jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu II pika 2/c, Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", nenet 15 dhe 22, çka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor.
Ka analizë mbi çmimin për njësi dhe llogaritja e vlerës limit të kontratës është realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore.
Njësia e prokurimit ka përgatitur dokumentet e tenderit

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga njësia e prokurimit (NJP).
a- Llogaritja e fondit limit: Llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike jane hartuar nga Ark.
b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT. Mos argumentimi i kërkesave e pa argumentuara janë veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), dhe neni 2 germa (a, b, c) dhe neni 20.
Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:
Ne DST eshte kerkuar *Operatori ekonomik duhet te paraqese nje vertetim nga Bashkia Konispol, qe nuk ka detyrime prane ketij institucioni, si dhe njesive administrative ne varesi te saj.*
Mosparaqitja e ketij vertetimi perben kusht per skualifikim. Ky dokument duhet te jete leshuar, qe nga momenti pas shpalljes se procedures se prokurimit, ne sistemin elektronik.
Ndërkohë që ky kriter nuk është i nevojshëm pasi përfshihet në pikën 2 *Kapaciteti ekonomik dhe financiar*: pika 4 , dhe AK e disponon kete informacion.
Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:
Një punësim i të paktën **65** *(gjashtëdhjetë e pesë)* personave, per secilin muaj te kerkuar, për periudhën **Janar 2015 - Mars 2017** të vërtetuar me:
List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi, te konfirmuara nga administrata tatimore, per periudhen **Janar 2015-Mars 2017,** shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.
Rezulton se është një kërkesë e pa argumentuar dhe e fryrë paraqitja dhe e "Formularit të deklarimit të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore", pasi listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore, për pagimin e sigurimeve shoqërore, janë mëse të mjaftueshëm dhe të besueshëm për të vërtetuar kërkesën e punësimit dhe të sigurimit të punonjësve, kjo bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 23, datë 09.12.2014, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", të dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në të cilin në pikën 10 "Të tjera".
Ne dst eshte kerkuar qe Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar si drejtues teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (me afat

vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt), diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqerise, si dhe ne licensen e shoqerise, si më poshtë:

- 1 (nje) inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) inxhinier gjeolog, profili hidrogjeologji
- 1 (nje) inxhinier mjedisi

Nga auditimi rezulton se :

Në lidhje me diponueshmërinë e inxhinierit Gjeolog, e në Hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kritere kualifikuese në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Parakushti kyç sine qua non për Hartimin dhe vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimve. Sa më sipër, referuar dhe natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuar,si edhe kategorizimit të pikave të licencës, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmëria e një inxhinieri gjeolog si pjesë e stafit teknik

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Per Kontrollin Dhe Disiplinimin E Punimeve Te Ndertimit" parashikohet se "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore." Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit." Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë (drejtuesit teknik të shoqërisë), të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Në lidhje me disponueshmërinë e inxhinierit gjeolog, për sa kohë që autoriteti kontraktor, në preventivin e punimeve nuk ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria dhe drejtimi i punimeve nga një inxhinier gjeolog, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, kriteri i mësipërm nuk është në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe si një kriter i tillë nuk duhej vendosur .

<u>Ne dst-ve eshte kerkuar</u> Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 9):

Mjetet	***Sasia***	***Gjendja***
Kamion vetëshkarkues me aftesi mbajtese mbi 20 ton	4 copë	Pronësi ose me qera
Kamion kapaciteti mbajtës 1 – 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	3 cope	Pronesi ose me qera
Autovinç me aftësi mbajtëse minimumi 8 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	3 cope	Pronesi ose me qera
Fadroma me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrula ngjeshes	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	2 cope	Pronesi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparat ngjitje tubash PE me elektrofuzion	2 copë	Pronësi ose me qera
Batipal per punimet e germimit	1 copë	Pronësi ose me qera
Tokmak elektrik	1 cope	Pronesi ose me qera

Kamion veteshkarkues me aftesi mbajtese mbi 10 ton	2 cope	Pronesi ose me qera

Kërkesa për makineri nuk është e argumentuar me numrin e punonjësve të kërkuar (65 punonjës) dhe volumin e punimeve.
Kriteret e mësipërme nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtimie me natyrën dhe përmasat e kontratës.
Këto veprime janë jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP, z.E.K., znj. K.K. dhe z.A.A., si dhe Titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit nr.2/1, datë 13.04.2016 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO).
KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.
Në datën 26.10.2017 është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të tre operatorëve ekonomik. Nga vlerësimi rezulton se jane skualifikuar dy operatorë ekonomik dhe kualifikuar nje operatorë, OE "A...S"sh.p.k i cili është shpallur fitues. Kualifikimet dhe skualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar	Klasifikimi
1	A...S SHPK	**22.942.320**	Kualifikohet	Vlera e shpallur fituese
2	A...D SHPK	0	S'Kualifikuar	
3	A...K & Co	0	S'Kualifikuar	

Janë skualifikuar:

OE e skualifikuara jane OE "A...D" SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky OE nuk ka permbushur kriteret e DST-ve dhe eshte skualifikuar drejte nga KVO-ja, dhe OE "SH...I" SHPK po ashtu rezulton se nuk ka permbushur kriteret e DST-ve dhe eshte skualifikuar drejte nga KVO-ja.

OE e kualifikuar

Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe e shpallur fituese "A...S " sh.p.k nga auditimi rezulton se kjo OE ka keto mangesi.:
Ne DST eshte kerkuar pika 4. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2014,2015,2016, nga te gjitha njesite ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas Ekstraktit te QKR;
Ne rastin e nje B.O.E secili nga anetaret e bashkimit te shoqerise duhet ta plotesoje me vete kete kriter.
Nga auditimi mbi dokumentacionin e paraqitur nga OE "A...S " sh.p.k shpk u konstatua se:
-Subjekti "A...S" shpk me seli në Tirane, sipas ekstraktit të paraqitur ka pasur si vend të zhvillimit të aktivitetit edhe adresa të tjera në të cilat ka hapur NIPT sekondar dhe konkretisht: Bashkine Kukes. Vërtetimi për pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për Bashkine Kukes nuk është paraqitur.

Dokumentet që ka paraqitur OE "A...S" sh.p.k për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në adresat me NIPT sekondar, nuk plotësojnë këtë kërkesë dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, tenderi duhet të ishte anuluar. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.A. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

2. Ne dst Kapaciteti Teknik eshte kerkuar Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogel se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është te pakten sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Nga auditimi i dokumentacionit i OE "A...S" SHPK rezulton se asnjë kontrate e paraqitur nga kjo OE nuk ka si natyre objektin e prokurimit .

Banese 4 kat me podrum dhe nencati, Vila 2 dhe 3 kate me podrum dhe nencati, Godine banimi 3 kat me 2 kat bodrum, Godine Banimi 2,3,4 kate + nencati me 1 kat nentoke, Godine banimi 2 dhe 5 kate me podrum etj.

Ne DST eshte kërkuar:

Eskavator me goma	2 cope	Pronesi ose me qera

Nga auditimi rezulton se kjo OE ka paraqitur vetem nje eskavator me goma ndersa eskavatori tjeter i mare me qira nga OE "B...S" SHPK me nr.2620 Rep dhe Nr.652 Kol po nuk ka paraqitur lejen e qarkullimit , siguracionin por vetem kontrollin teknik.

KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 "*Shqyrtimi i ofertave*" të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit"*. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi KVO, nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.A. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit"* dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.A. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "**RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLES "MEHMET XHAFERI" XARRE"**

a.	**Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :** Rikonstruksioni I shkolles Mehmet Xhaferi Xarre

1.Urdhër Prokurimi Nr Datë **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** **"**E hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr.8 , dt.04.05.2017 1.Z.A.B. - Ing 2.A.A. Ing 3.Znj.K.K. Juriste	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 8-1 , dt. 04.05.2017 1.Z.E.D.-Kryetar (P.Finance) 2. Znj.E.P.- Antar 3-Z.A.A.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 57.931.934lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 57863092 leke	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 68,842 leke
8. Data e hapjes së tenderit 04.05.2017	**9.Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tenderNumër **__2_OE** b)S'kualifikuar __1___OE, c) Kualifikuar___1__ OE
11.Ankimime **AK**-s'ka/ka;**APP**–s'ka/ka;**KPP-**s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK	**13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë z. SH.B. është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP).

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu II pika 2/c, Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" , nenet 15 dhe 22, çka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor.

Ka analizë mbi çmimin për njësi dhe llogaritja e vlerës limit të kontratës është realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore.

Njësia e prokurimit ka përgatitur dokumentet e tenderit

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga njësia e prokurimit (NJP).

a- Llogaritja e fondit limit: Llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike jane hartuar nga Ark.

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat e për kualifikim të hartuara nga NJHDT. Mos argumentimi i kërkesave e pa argumentuara janë në kundërshtim me nenin 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), dhe neni 2 germa (a, b, c) dhe neni 20

Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:

- **3** "Liçensa profesionale e shoqerise lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Licensa profesionale e shoqerise lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates me kategorite:

N.P – 1 A Punime gërmimi në tokë.
N.P – 2 B Ndërtime civile dhe industrial.
N.P - 3 C Rikonstruksione dhe mirëmbajtje godinash.
N.P – 12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
N.S - 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.
N.S - 2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina....
N.S - 4 B Punime rifiniture të muratures dhe të lidhura me to
N.S- 12 A Impiante teknologjike ,termike dhe te kondicionimit.
N.S - 14 A Impiante te brendshme, elektrike,telefoni....
N.S – 18 B Punime topogjeodezike.

Duke u Bazuar në preventivin e hedhur në tender shume nga keto kategori licensash nuk jane te nevojshme pasi nuk kane si natyre abjektin qe prokurohet konkretisht: Piaka NS-12/A qe eshte per Punime të inxhinierisë së mjedisit ku ne preventivin e punimeve nuk ka asnje ze te till qe te jete e nevojshme kjo katigori punimesh.

- Ne dst pika **44 te dst-ve** eshte kerkuar:

Operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim qe nuk ka detyrime ndaj Bashkise Konispol dhe te gjitha njesive administrative te saj.

V.O: Do të konsiderohen detyrime të gjitha shumat që janë rrjedhoj e një detyrimi të lindur në saj të zbatimit të ligjit për taksat vendore, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" gjobat e ndryshme nga institucionet audituese legjitime, e cdo lloj detyrimi tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi apo kontrata të mëparshme të nënshkruara me institucionin tonë.Vërtetimi duhet të jetë lëshuar jo më parë se 5 ditë nga data e parashikuar për hapjen e ofertave. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin.Ndërkohë që ky kriter nuk është i nevojshëm pasi përfshihet në pikën 2, dhe AK e disponon kete informacion.

- ***Ne piken 41 . te dst-ve eshte kerkuar Stafi Drejtues i shoqerise te perbehet nga:***

Drejtues Teknik inxhinier ndërtimi, 2 të punësuar. Kontratë individuale të punës, diplomë e CV.

Drejtues Teknik inxhinier hidroteknik, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës, diplomë e CV.

Drejtues Teknik inxhinier mekanik, 1të punësuar. Kontratë individuale të punës, diplomë e CV.

Drejtues Teknik inxhinier elektrik, 1të punësuar. Kontratë individuale të punës, diplomë e CV.

Drejtues Teknik inxhinier topograf/gjeodet, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës, diplomë dhe CV.

Drejtues Teknik inxhinier mjedisi,1të punësuar. Kontratë individuale të punës, diplomë, dhe CV.

Drejtuesi/t teknik i/të shoqërisë nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër shtetëror apo privat. Për këtë shoqëria duhet të paraqese një deklaratë nga Administratori ishoqërisë dhe të deklarojë se autorizon Autoritetin Kontraktor për verifikimin e informacionit të dhënë. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kushtë për skualifikim.*Nga auditimi rezulton se :*

Në lidhje me diponueshmërinë e inxhinierit mjedisi, e në Hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kritere kualifikuese në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Parakushti kyç sine qua non për Hartimin dhe vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimve. Sa më sipër, referuar dhe natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuar,si edhe kategorizimit të pikave të licencës, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmëria e një inxhinieri mjedisi si pjesë e stafit teknik

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Per Kontrollin Dhe Disiplinimin E Punimeve Te Ndertimit" parashikohet se "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore." Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit." Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë (drejtuesit teknik të shoqërisë), të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, kriteri i mësipërm nuk është në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe si një kriter i tillë nuk duhej vendosur.

Ne piken 43. Te dst-ve eshte kerkuar qe Autoriteti Kontraktor Bashkia Konispol, do te zhvilloje vizite ne kantier 5 (pese) dite perpara zhvillimit te procedures. Te gjithe operatoret ekonomike te interesuar per te marre pjese ne procedure duhet te paraqiten ne kantier per te cilen do te pajisen me vertetim nga Bashkia Konispol, mosparaqitja e ketij vertetimi eshte kusht skualifikues. Kriter i paargumentuar, i palidhur me objektin e kontratës.

Ne piken 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, eshte kerkuar: Operatori Ekonomik duhet të disponojë vlera të mjaftueshme monetare për të realizuarobjektin e tenderit pa marrë

paradhënie. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të gjëndjes financiare, me nr. I llogari, iban-i dhe nipt i subjektit, nga një ose më shumë banka ku vlera në lekë (apo ekuivalentja në valutë) nëllogarinë e operatorit të jetëjo më të vogël se 50% të fondit limit (meqenese per vitin 2017 financimi eshte sa 50% e fondit limit dhe objekti duhet perfunduar brena 60 diteve),të lëshuar jo më shumë se 5 ditë nga data e hapjes së ofertave. Kjo shume duhet te jete e ngurtesuar ne banke deri ne momentin e nenshkrimit te kontrates ne rast shpallje fitues te operstorit ekonomik. Kriter i paargumentuar dhe diskriminues .

Ne piken 5. Te dst-ve eshte kerkuar Disponimi i mjeteve te meposhtme:

Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Kamion me tonazh mbi 30 ton	cope 3
Kamion me tonazh deri 30ton	copë 2
Kamioncina, ngarkese deri 5 ton	cope 2
Eskavator 15-30 ton	copë 1
Fadrome jo nuk ka shoqeruar dokun	copë 1
Autovinc me kosh	cope 1
Autobetoniere	copë 2
Autopompe betoni	copë 1
Tokmak per ngjeshje	copë 2
Betoniere 0.5 m3	copë 3
Vibrator betoni sipërfaqësor	copë 2
Motosaldatriçe	copë 2
Gjenerator	copë 2
Depozita 1.000 - 5.000 liter	copë 3
Matrapik	copë 5
Kompresor	copë 5
Autovinç	copë 1
Makineri per suvatim (pompe suvatimi)	cope 3
Makineri per punim hekuri	cope 1
Armaturë (derrase ose panele)	1500 m2
Skela	3000 m2
Aparate saldimi tubo celiku	copë 1
Aparate saldimi tubo plastike	copë 1
Aparate kontroll saldimi	copë 1
Prerese hekuri	copë 1
Nyje për prodhimin e betoni	copë 1
Nyje inerte	copë 1
Saldatrice me korent 3 fazor	cope 1
Pajisje saldimi me argon	cope 1
Ndricues elektrik i levizshem	cope 1
Ngrites pirun teleskopik	cope 1
Sharre elektrike	cope 1
Vinc Kolone	cope 1

Kërkesa për makineri nuk është e argumentuar me numrin e punonjësve të kërkuar (120 punonjës) dhe volumin e punimeve.

Kriteret e mësipërme nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtimie me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Këto veprime janë jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP, z.A.B. znj.K.K. dhe z.A.A. si dhe Titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.i

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit nr.2/1, datë 13.04.2017 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO).

KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të shtate operatorëve ekonomik. Nga vlerësimi rezulton se eshte skualifikuar nje operatorë ekonomik dhe kualifikuar nje operatorë, BOE "REGLI" & "VIKTORIA INVEST"sh.p.k i cili është shpallur fitues. Kualifikimet dhe skualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar	Klasifikimi
1	SH...I SHPK	0	S'Kualifikohet	
2	R...I & V...T SHPK	57 931 934	Kualifikuar	Vlera e shpallur fituese

Janë skualifikuar:
OE i skualifikuar është "SH...I" SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky OE nuk ka permbushur kriteret e DST dhe eshte skualifikuar drejte nga KVO. Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

OE e kualifikuar
Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe e shpallur fituese "R...I" & "V...T" sh.p.k nga auditimi rezulton se kjo OE ka keto mangesi:
Ne dst eshte kërkuar ne piken 3.5 Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:
Fadrome cope 1
Per te përmbushur kete kriter kjo BOE ka paraqitur nje kontrate qiraje ndermjet OE "R...I" SHPK ne rolin e Qiramarresi dhe shoqerise "K...I" SHPK ne rolin e Qirradhenesi me nr 1273 Rep dhe nr.398 Kol per mjetin lloji Fadrome, Marka 400/129 MKG, Nr.shasie 706 e cila eshte e shoqeruar me nje vërtetim zhdoganimi dhe foto, por mungon leja e qarkullimit, figuracioni i mjetit, kontrolli teknik.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINACAVE
Nr 157763
VERTETIM ZHDOGANIMI

Ne DST eshte kërkuar Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, pranë te gjitha njësive të qeverisjes vendore (sipas QKR) ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet për vitet 2015-2016 dhe 2017. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Njesit e Qeverisjes Vendore.
Nga auditimi mbi dokumentacionin e paraqitur nga BOE "R...I" & "V...T" sh.p.k shpk u konstatua se:
-Subjekti "R...I" shpk me seli në Tiranë, sipas ekstraktit të paraqitur ka pasur si vend të zhvillimit të aktivitetit edhe adresa të tjera në të cilat ka hapur NIPT sekondar dhe konkretisht: Bashkine Durres. Vërtetimi për pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për Bashkine Durres nuk është paraqitur.

Dokumentet që ka paraqitur BOE "R...I" & "V...T" sh.p.k për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në adresat me NIPT sekondar, nuk plotësojnë këtë kërkesë dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, tenderi duhet të ishte anuluar. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.A. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 "*Shqyrtimi i ofertave*" të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit"*. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi KVO, nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.A. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit"* dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.A. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "**REHABILITIM I KANALIT VADITËS "SHALES-MARKAT"**

d. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rehabilitimi i kanalit vadites Shales-Markat		
1.Urdhër Prokurimi Nr Datë **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** E hapur	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr.2, dt.06.02.2017 1.Z.A.B. - Ing 2.A.A. Ing 3.Znj.K.K. Juriste	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. Nr.2-1, dt.06.02.2017 1.E.D. Kryetar -(P.Finance) 2. Znj.E.P.- Antar 3-Z.E.K.- Antar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 11750000lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 10,945,425 leke	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 804,575 leke
8. Data e hapjes së tenderit 06.02.2017	**9.Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tenderNumër **__3_OE** b)S'kualifikuar __2___OE, c) Kualifikuar___1__ OE
11.Ankimime **AK**-s'ka/ka;**APP**–s'ka/ka;**KPP**-s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK	**13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë z. SH.B. është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP).

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu II pika 2/c, Ligji Nr. 10296, datë

08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" , nenet 15 dhe 22, çka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor.
Ka analizë mbi çmimin për njësi dhe llogaritja e vlerës limit të kontratës është realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore.
Njësia e prokurimit ka përgatitur dokumentet e tenderit

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga njësia e prokurimit (NJP).
a- Llogaritja e fondit limit: Llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike jane hartuar nga Ark.
b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat e për kualifikim të hartuara nga NJHDT. Mos argumentimi i kërkesave e pa argumentuara është veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), dhe neni 2 germa (a, b, c) dhe neni 20.
Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:
2"Liçensa profesionale e shoqerise lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:
Licensa profesionale e shoqerise lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates me kategorite:
N.P - 1 – A Punime gërmimi në tokë.
N.P - 4 - A Punime ne rruge
N.P - 5 - A Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
N.P - 7 - A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.
N.P - 9 - A Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.
N.P -12- A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
Punime speciale ndertimi
N.S-8 - A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.
N.S-18- A Punime topogjeodezike.
N.S-20- A Shpime gjeologe-inxhinerike
Duke u Bazuar në preventivin e hedhur në tender shume nga keto kategori licensash nuk jane te nevojshme pasi nuk kane si natyre abjektin qe prokurohet konkretisht: Piaka NS-20/A qe eshte per **Shpime gjeologe-inxhinerike** ku ne preventivin e punimeve nuk ka asnje ze te till qe te jete e nevojshme kjo katigori punimesh.
Piaka **N.P - 5 - A Punime nëntokësore, ura e vepra arti** ku ne preventivin e punimeve nuk ka asnje ze te till qe te jete e nevojshme kjo katigori punimesh.
Ne dst pika **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** pika 4 eshte kerkuar :
Te paraqitet vertetim qe verteton se operatori ekonomik nuk ka asnje lloj detyrimi kundrejt Bashkise Konispol percaktuar sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Per Taksat Vendore ne Republiken e Shqiperise" te ndryshuar si dhe detyrime te tjera te mundshme qe rrjedhin nga kontrata te caktuara,leshuar jo me pare se 5 (pese) dite perpara dates se zhvillimit te tenderit. Vertetimi leshohet kundrejt kerkeses se bere nga operatori ekonomik ne Bashkine Konispol,Drejtoria e Financave.
Ndërkohë që ky kriter nuk është i nevojshëm pasi përfshihet në pikën 2.1 pika "3", dhe AK e disponon kete informacion.
Në pikën 2.a pika tretë AK ka kërkuar:
Kandidati/ofertuesi duhet te percaktoje me ane te nje deklarate me shkrim(nga administratori i shoqerise) **drejtuesin teknik te punimeve** ne objekt perfshire ne licencen e shoqerise dhe te deklaroje se ai do te jete i pranishem gjate gjithe kohes qe do te kryhen ne objekt,shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem.
. Diploma
. CV
. Kontrate pune te vleshme

Ndërkohë që për punime deri në 30.000.000 lekë nuk është e detyrueshme që drejtuesi teknik të jetë gjithe kohës i pranishëm në kantier kjo sipas Kreut I/2.1 te Udhezimit nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

- ***Ne piken 2.a te dst-ve eshte kerkuar Stafi Drejtues i shoqerise te perbehet nga:***

- Inxhinier ndertimi -1nje me eksperience pune jo me pak se 10 vjet
- Inxhnier hidroteknik-1(nje) (drejtues teknik).
- Inxhinier gjeodet (topograf) -1 (nje) (drejtues teknik).
- Inxhiner mekanik-1nje (drejtues teknik).
- Inxhiner mjedisi -1nje (drejtues teknik).
- Inxhiner Gjeolog -1nje (drejtues teknik).

Per stafin te paraqese kontrat e punes te vlefshme, cv, diplome, si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi per periudhen e mesiperme te kërkuar.

Nga auditimi rezulton se:

Në lidhje me diponueshmërinë e inxhinierit mekanik e në Hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kritere kualifikuese në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Parakushti kyç sine qua non për Hartimin dhe vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimve. Sa më sipër, referuar dhe natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuar,si edhe kategorizimit të pikave të licencës, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmëria e një inxhinieri mekanik si pjesë e stafit teknik.

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" parashikohet se "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore." Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit." Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë (drejtuesit teknik të shoqërisë), të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Në lidhje me disponueshmërinë e inxhinierit gjeolog, për sa kohë që autoriteti kontraktor, në preventivin e punimeve nuk ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria dhe drejtimi i punimeve nga një inxhinier gjeolog, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, kriteri i mësipërm nuk është në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe si një kriter i tillë nuk duhej vendosur .

<u>Ne piken 3. Te dst-ve eshte kerkuar Disponimi i mjeteve te meposhtme:</u>

Kamion vetëshkarkues i pajisur dhe me vinc	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamiona vetshkarkues mbi 15 ton	1copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire me kove	1copë	Pronësi ose me qera
Minibuldozer	1copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1copë	Pronësi ose me qera
Tabela sigurie ne rruge	10 copë	Pronësi ose me qera
Kokore	10 copë	Pronësi ose me qera
Total station	1cope	Pronësi ose me qera
Autobote uji	1copë	Pronësi ose me qera
Pompe per hedhje betoni	1copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2copë	Pronësi ose me qera

Fabrike betoni e pajisur me QKL kodi III.1.Adhe certifikate ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit te cilesise), ne nje distance jo me te madhe se 50 km nga objekti.	1copë	Pronësi ose me qera
Fabrike inerti ne e pajisur me QKL kodi II.1.Bdhe certifikate ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit te cilesise).	1copë	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshes	*1 cope*	*Pronesi ose me qera*

Kërkesa për makineri nuk është e argumentuar me numrin e punonjësve të kërkuar (16 punonjës) dhe volumin e punimeve.Gjithashtu Njesia e prokurimit nuk ka vepruar ne baze te dispozitave ligjore pasi per:

Fabrike betoni e pajisur me QKL kodi III.1.Adhe certifikate ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit te cilesise), ne nje distance jo me te madhe se 50 km nga objekti.
Fabrike inerti ne e pajisur me QKL kodi II.1.Bdhe certifikate ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit te cilesise).

Duhet te kishte kerkuar dhe kontrate furnizimi.

Sa më sipër për mos argumentimin e kërkesave për kualifikim mban përgjegjësi NJHDT, bazuar në Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta", të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, "Për rregullat e prokurimit publik", në të cilën përcaktohet se: "Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: "Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues".

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga A.B. A.A. dhe K.K.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit nr.2/1, datë 13.04.2016 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO).

KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, i cili ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të shtate operatorëve ekonomik. Nga vlerësimi rezulton se eshte skualifikuar nje operatorë ekonomik dhe kualifikuar dy operatorë, BOE "I...D" & "K...I" SHPK dhe OE "J...Y" & "SH...I" sh.p.k i cili është shpallur fitues. Kualifikimet dhe skualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar	Klasifikimi
1	B...U SHPK	9 441 562	S'Kualifikohet	
2	SH...I & J...Y	10 945 425	Kualifikuar	Vlera e shpallur fituese
3	I...D & K...I	11 448 359	Kualifikuar	

Janë skualifikuar:

OE i skualifikuar është "B...U" SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky OE nuk ka permbushur kriteret e DST-ve dhe eshte skualifikuar drejte nga KVO-ja.

OE e kualifikuar

Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe e shpallur fituese "SH...I" & "J...K...Y" sh.p.k nga auditimi rezulton se kjo OE ka keto mangesi:

Nuk përmbush kritere e dst-ve konkretisht shumica e drejtueseve teknik te kësaj OE "J... K...Y" SHPK Ing.J.P. me kontrate te rregullt pune me date 28.10.2013 dhe me rroge 35 000 mje leke figurone ne listepagesat e shoqerise me rroge 22000, Ing.N.C. me kontrate te rregullt pune me date 06.01.2014 dhe me rroge 30 000 mje leke figurone ne listepagesat e shoqerise me rroge 22 000, Ing. F.G.N. me kontrate te rregullt pune me date 03.12.2012 dhe me rroge 35 000 mje leke figurone ne listepagesat e shoqerise me rroge 22 000 per. Ne dst eshte shprehur qart rastet e dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kusht per skualifkim dhe ne kete rast te gjitha kontratat e me drejtuesit teknik te siper cituar jane te pasakta.

Nga auditimi rezulton se BOE nuk ka permbushr piken 3 te dst-ve Disponimi i mjeteve te mëposhtme :
Eskavator me goma 1 cope (Pronesi ose me Qira)
Kjo BOE nga auditimi i dokumentacionit rezulton se ky mjete nuk eshte paraqitur.
OE "SH...I" SHPK nuk ka pasqyruar ne Ektraktin e QKRse te gjitha vendet ku ka zhvilluar biznes dhe per rrjedhoje e nuk ka paguar detyrimet vendore ne te gjitha njesite ku ka zhvilluar biznes.
Referuar dokumentacionti te paraqitur per pune te ngjashme rezulton se operatori ka realizuar punime sipas kontrates lidhur me objekt: Rikonstruksion rruga e Fermereve, fshati Metoq" pra ka zhvilluar aktivitett biznesi edhe ne Njesine Vendore Sarande ne vitin 2015 dhe per rrjedhoje duhet te pasqyronte ne QKR edhe kete vend te zhvillimit te biznesit si dhe hapjen e niptit sekondar, "Ndertimi i Kanalizimeve te ujerave te zeza lagj.Kodra e Vreshit"- Bashkia Mamuras pra, operatori ndonese zhvillon aktivitet biznesi ne vendndodhje te ndryshme nga selia Fier, nuk i ka pasqyruar ne ekstraktin e QKR-se, si vende zhvillimi te biznesit ku do te duhej te pajisej edhe me NIPT sekondar per keto vende te tjera zhvillimi biznesi, e me tej te paguante detyrimet vendore e te pajisej me veretetim per sejcilin prej ketyre njesive. Personi i tatueshem qe ushtron veprimtari ne adresa (vendndodhje) te ndryshme bisnesi, pajiset me certificate regjistrimi per cdo adrese, e cila ka nje NIPT unik", Mosrregjistrimi vjen ne kundershtim me ligjin nr 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" nenin 40, nenin 3.1/a.b.c te ligjit Nr. 131/2015" Për qendrën kombëtare të biznesit" si dhe ligjin nr. 9723 dt.03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Ne lidhje me BOE e kualifikuar "I...D" & "K...I" SHPK nga auditimi rezulton se ka keto mangësi:
BOE nuk ka permbushr piken 3 te dst-ve Disponimi i mjeteve te mëposhtme :
Eskavator me goma 1 cope (Pronesi ose me Qira)
BOE ka paraqitur nje eskavator me goma shoqeruar me nje veretim zhdoganimi por mungon policia e mjetit, leja e qarkullimit, kontrolli teknik , certifikata e pronesise se mjetit,

Nuk përmbush kritere e DST-ve konkretisht shumica e drejtueseve teknik te kësaj OE "K...I" SHPK Ing.K.M. me kontrate te rregullt pune me date 04.04.2007 dhe me rroge 40 000 mje leke figurone ne listepagesat e shoqerise me rroge 5000, Ing.G.L. me kontrate te rregullt pune me date15.04.2015 dhe me rroge 40 000 mje leke figurone ne listepagesat e shoqerise me rroge 10 000. Ne dst eshte shprehur qart rastet e dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kusht per skualifkim dhe ne kete rast te gjitha kontratat e me drejtuesit teknik te siper cituar jane te pasakta dhe te rreme.

Asnjera nga ofertat e kualifikuara nuk duhej te kualifikoheshin , duhet te ishin skualifikuar. KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 "*Shqyrtimi i ofertave*" të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit"*. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi KVO, z. E.K. , znj.E.P. dhe z. E.D.

Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit"* dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, z. E.K., znj.E.P. dhe z. E.D.

Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "**REHABILITIM I KANALIT FURNIZUES TE V-55 NE FUSHEN E VRINES"**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rikonstruksioni I Kanalit furnizues V 55 ne Fushen e Vrines		
1.Urdhër Prokurimi Nr Datë **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** **"**E hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr.15 , dt.18.10.2017 1.Z.A.B. 2.Z.A.A. 3-Znj K.K. Anetar	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 15-1 , dt. 18.10.2017 1.Z.E.D. (P.Finance) 2. Znj.E.P.- Antar 3-Z.A.A. Anetar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 9722221lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** Mane sh.p.k 9.399.999leke	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 322,222 leke
8. Data e hapjes së tenderit 18.10.2017	**9.Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tenderNumër **__3_OE** b)S'kualifikuar __2___OE, c) Kualifikuar___1__ OE
11.Ankimime **AK**-s'ka/ka;**APP**–s'ka/ka;**KPP**-s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK	**13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë z. SH.B.i është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP).

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike në veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu II pika 2/c, Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", nenet 15 dhe 22, çka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor.

Ka analizë mbi çmimin për njësi dhe llogaritja e vlerës limit të kontratës është realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore.

Njësia e prokurimit ka përgatitur dokumentet e tenderit

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga njësia e prokurimit (NJP).

a- Llogaritja e fondit limit: Llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike jane hartuar nga Ark.

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat e për kualifikim të hartuara nga NJHDT. Mos argumentimi i kërkesave e pa argumentuara janë veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), dhe neni 2 germa (a, b, c) dhe neni 20
Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:
Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhte:
Punime te pergjithshme ndertimi
N.P - 1 - A Punime gërmimi në tokë.
N.P - 4 - A Punime ne rruge
N.P - 5 - A Punime nëntokësore, ura e vepra arti
N.P - 7 - A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.
N.P - 9 - A Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.
N.P -12- A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
Punime speciale ndertimi
N.S-8 - A Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.
N.S-18- A Punime topogjeodezike.
Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.Duke u Bazuar në preventivin e hedhur në tender shume nga keto kategori licensash nuk jane te nevojshme pasi nuk kane si natyre abjektin qe prokurohet konkretisht: Piaka N.S-9- A qe eshte per Punime strukturore speciale ku ne preventivin e punimeve nuk ka asnje ze te till qe te jete e nevojshme kjo katigori punimesh.
Ne dst pika **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** pika 4 eshte kerkuar:
Te paraqitet vertetim qe verteton se operatori ekonomik nuk ka asnje lloj detyrimi kundrejt Bashkise Konispol percaktuar sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Per Taksat Vendore ne Republiken e Shqiperise" te ndryshuar si dhe detyrime te tjera te mundshme qe rrjedhin nga kontrata te caktuara, leshuar jo me pare se 5 (pese) dite perpara dates se zhvillimit te tenderit. Vertetimi leshohet kundrejt kerkeses se bere nga operatori ekonomik ne Bashkine Konispol, Drejtoria e Financave.
Ndërkohë që ky kriter nuk është i nevojshëm pasi përfshihet në pikën 2.2 pika "3", dhe AK e disponon kete informacion.
Në pikën 2 germa C AK ka kërkuar:
Kandidati/ofertuesi duhet te percaktoje me ane te nje deklarate me shkrim(nga administratori i shoqerise) **drejtuesin teknik te punimeve** ne objekt perfshire ne licencen e shoqerise dhe te deklaroje se ai do te jete i pranishem gjate gjithe kohes qe do te kryhen ne objekt,shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem.

. Diploma
. CV
. Kontrate pune te vleshme
Ndërkohë që për punime deri në 30.000.000 lekë nuk është e detyrueshme që drejtuesi teknik të jetë gjithe kohës i pranishëm në kantier kjo sipas Kreut I/2.1 te Udhezimit nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"
Ne piken 3. Te dst-ve eshte kerkuar. Disponimi i mjeteve te meposhtme:

Mjetet	*Sasia*	*Gjendja*
Kamiona vetshkarkues mbi 15 ton	1copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire me kove	1copë	Pronësi ose me qera
Minibuldozer	1copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1copë	Pronësi ose me qera
Tabela sigurie ne rruge	10 copë	Pronësi ose me qera

Kokore	10 copë	Pronësi ose me qera
Total station	1cope	Pronësi ose me qera
Autobote uji	1copë	Pronësi ose me qera
Pompe per hedhje betoni	1copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2copë	Pronësi ose me qera
Fabrike betoni e pajisur me QKL kodi III.1.Adhe certifikate ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit te cilesise), ne nje distance jo me te madhe se 50 km nga objekti.	1copë	Pronësi ose me qera

Kërkesa për makineri nuk është e argumentuar me numrin e punonjësve të kërkuar (30 punonjës) dhe volumin e punimeve.Gjithashtu Njesia e prokurimit nuk ka vepruar ne baze te dispozitave ligjore Pasi per:

Fabrike betoni e pajisur me QKL ne nje distance jo me te madhe se 50 km se objekti

Duhet te kishte kerkuar dhe kontrate furnizimi.

Sa më sipër për mos argumentimin e kërkesave për kualifikim mban përgjegjësi NJHDT, bazuar në Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta", të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, "Për rregullat e prokurimit publik", në të cilën përcaktohet se: "Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: "Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues"

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga A.B. , A.A. dhe K.K.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër të titullarit është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO).

KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të tre operatorëve ekonomik. Nga vlerësimi rezulton se jane skualifikuar dy operatorë ekonomik dhe kualifikuar nje operatorë, OE "M...S"sh.p.k i cili është shpallur fitues. Kualifikimet dhe skualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar	Klasifikimi
1	SH...I SHPK	0	S,Kualifikohet	
2	M...S SHPK	**9 399 999**	Kualifikuar	Vlera e shpallur fituese
3	K...I SHPK	**8 099 185**	S,Kualifikohet	

Janë skualifikuar:

OE e skualifikuar është "SH...I" SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky OE nuk ka permbushur kriteret e DST dhe eshte skualifikuar drejte nga KVO-ja pasi nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

OE "K...I" SHPK eshte skualifikuar pasi ka paraqitur deklarate doreheqje nga kjo procedure prokurimi.

OE e kualifikuar

Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe e shpallur fituese "M...S" sh.p.k pas kundërshtimeve rezulton se është kualifikuar drejtë nga KVO.

Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "**NDËRTIM I LINJËS SË UJËSJELLËSIT DEPO THARRESE NË FSHATIN MURSI"**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Ndertimi i linjes se ujesjellesit depo tharese fshati Mursi		
1.Urdhër Prokurimi Nr Datë **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** **"**E hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr.14 , dt.03.08.2017 1.Z.A.B. - Ing 2.A.A. Ing 3.Znj.K.K. Juriste	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 14-1 , dt. 03.08.2017 1.Z.E.D.-Kryetar (P.Finance) 2. Znj.E.P.- Antar 3-Z.A.A.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 8.371.120lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 8279310lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**91,810 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 03.08.2017	**9.Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tenderNumër **__1_OE** b)S'kualifikuar __0___OE, c) Kualifikuar___1__ OE

11.Ankimime **AK**-s'ka/ka;**APP**–s'ka/ka;**KPP**-s'ka/ka	12. **Përgjigje Ankesës** nga AK	13.**Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë z. SH.B. është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP).

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu II pika 2/c, Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" , nenet 15 dhe 22, çka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor.

Ka analizë mbi çmimin për njësi dhe llogaritja e vlerës limit të kontratës është realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore.

Njësia e prokurimit ka përgatitur dokumentet e tenderit

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga njësia e prokurimit (NJP).

a- Llogaritja e fondit limit: Llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike jane hartuar nga Ark.

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat e për kualifikim të hartuara nga NJHDT. Mos argumentimi i kërkesave e pa argumentuara janë jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), dhe neni 2 germa (a, b, c) dhe neni 20

Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:

Ne DST eshte kerkuar *Operatori ekonomik duhet te paraqese nje vertetim nga Bashkia Konispol, qe nuk ka detyrime prane ketij institucioni, si dhe njesive administrative ne varesi te saj.*

Mosparaqitja e ketij vertetimi perben kusht per skualifikim. Ky dokument duhet te jete leshuar, qe nga momenti pas shpalljes se procedures se prokurimit, ne sistemin elektronik.

Ndërkohë që ky kriter nuk është i nevojshëm pasi përfshihet në pikën 2 *Kapaciteti ekonomik dhe financiar*: pika 4 , dhe AK e disponon kete informacion.

Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:

Një punësim i të paktën **40** *(gjashtëdhjetë e pesë)*personave, per secilin muaj te kerkuar, për periudhën **Janar 2015 - Qershor 2017** të vërtetuar me:

List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi, te konfirmuara nga administrata tatimore, per periudhen **Janar 2015 - Qershor 2017,** shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

Rezulton se është një kërkesë e pa argumentuar dhe e fryrë paraqitja dhe e "Formularit të deklarimit të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore", pasi listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore, për pagimin e sigurimeve shoqërore, janë mëse të mjaftueshëm dhe të besueshëm për të vërtetuar kërkesën e punësimit dhe të sigurimit të punonjësve, kjo bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 23, datë 09.12.2014, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", të dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në të cilin në pikën 10 "Të tjera".

Ne dst eshte kerkuar qe Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar si staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt), diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqerise, si më poshtë:

- 1 (nje) inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) inxhinier Ndertimi
- 1 (nje) inxhinier gjeolog, profili hidrogjeologji
- 1 (nje) inxhinier mjedisi
- 1 (nje) Inxhinier topograf

Nga auditimi rezulton se :

Në lidhje me diponueshmërinë e inxhinierit Gjeolog, e në Hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kritere kualifikuese në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Parakushti kyç sine qua non për Hartimin dhe vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimve. Sa më sipër, referuar dhe natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuar,si edhe kategorizimit të pikave të licencës, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmëria e një inxhinieri gjeolog si pjesë e stafit teknik

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" parashikohet se "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore." Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit." Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë (drejtuesit teknik të shoqërisë), të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Në lidhje me disponueshmërinë e inxhinierit gjeolog, për sa kohë që autoriteti kontraktor, në preventivin e punimeve nuk ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria dhe drejtimi i punimeve nga një inxhinier gjeolog, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, kriteri i mësipërm nuk është në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe si një kriter i tillë nuk duhej vendosur .

<u>Ne dst-ve eshte kerkuar</u> Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 9):

Mjetet	***Sasia***	***Gjendja***
Kamion vetëshkarkues me aftesi mbajtese mbi 20 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion kapaciteti mbajtës 1 – 3.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	1 cope	Pronesi ose me qera
Autovinç me aftësi mbajtëse minimumi 8 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	2 cope	Pronesi ose me qera
Fadroma me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshes	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 cope	Pronesi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparat ngjitje tubash PE me elektrofuzion	2 copë	Pronësi ose me qera
Batipal per punimet e germimit	1 copë	Pronësi ose me qera
Tokmak elektrik	1 cope	Pronesi ose me qera
Kamion veteshkarkues me aftesi mbajtese mbi 10 ton	1 cope	Pronesi ose me qera

Kërkesa për makineri nuk është e argumentuar me numrin e punonjësve të kërkuar (40 punonjës) dhe volumin e punimeve.

Kriteret e mësipërme nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtimie me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Këto veprime janë jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP, z.A.B., znj. K.K. dhe z.A.A. si dhe Titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO).

KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të tre operatorëve ekonomik. Nga vlerësimi rezulton se jane skualifikuar dy operatorë ekonomik dhe kualifikuar nje operatorë, OE "A...S"sh.p.k i cili është shpallur fitues. Kualifikimet dhe skualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar	Klasifikimi
1	A...S SHPK	**22.942.320**	Kualifikohet	Vlera e shpallur fituese
2	A...D SHPK	0	S'Kualifikuar	
3	A...K & C... SHPK	0	S'Kualifikuar	

Janë skualifikuar:

OE e skualifikuara jane OE "A...D" SHPK, dhe nga auditimi rezulton se ky OE nuk ka permbushur kriteret e DST dhe eshte skualifikuar drejte nga KVO-ja, po ashtu dhe OE "SH...I" SHPK nuk permbush kriteret dhe eshte skualifikuar drejte nga KVO-ja.

OE e kualifikuar

Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe e shpallur fituese "A...S" sh.p.k nga auditimi rezulton se kjo OE ka keto mangesi:

Ne dst eshte kerkuar pika 4. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2014,2015,2016, nga te gjitha njesite ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas Ekstraktit te QKR;

Ne rastin e nje B.O.E secili nga anetaret e bashkimit te shoqerise duhet ta plotesoje me vete kete kriter.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e paraqitur nga OE "A...S " sh.p.k shpk u konstatua se:

-Subjekti "A...S" shpk me seli në Tirane , sipas ekstraktit të paraqitur ka pasur si vend të zhvillimit të aktivitetit edhe adresa të tjera në të cilat ka hapur NIPT sekondar dhe konkretisht: Bashkine Kukes. Vërtetimi për pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për Bashkine Kukes nuk është paraqitur.

Dokumentet që ka paraqitur OE "A...S" sh.p.k për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në adresat me NIPT sekondar, nuk plotësojnë këtë kërkesë dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE "A...S" sh.p.k. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.A. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

3. Ne dst Kapaciteti Teknik eshte kerkuar Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogel se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.
b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është te pakten sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
Nga auditimi i dokumentacionit i OE "A...S"SHPK rezulton se asnjë kontrate e paraqitur nga kjo OE nuk ka si natyre objektin e prokurimit.
Banese 4 kat me podrum dhe nencati, Vila 2 dhe 3 kate me podrum dhe nencati, Godine banimi 3 kat me 2 kat bodrum, Godine Banimi 2,3,4 kate + nencati me 1 kat nentoke, Godine banimi 2 dhe 5 kate me podrum etj.
KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 "*Shqyrtimi i ofertave*" të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit"*. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi KVO, nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.A. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.
Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit"* dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.A. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "**NDËRHYRJE EMERGJENTE NË ARGJINATURËN E LUMIT PAVËLL"**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Nderhyrje Emergjente ne Argjinaturen e Lumit Pavell		
1.Urdhër Prokurimi Nr Datë **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** **"**Ftese per negocim"	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr.7 , dt.27.04.2017 1.Z.E.D.Kryetar 2.E.P. Anetar 3-A.A. Anetar	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 7-1 , dt. 27.04.2017 1.Z.A.B. (P.Finance) 2. Znj.K.K.- Antar 3-Z.O.Gj.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 23.848.646lekë	**6.Oferta fituese (pa tvsh)** 23.833.041 leke	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 15,605 leke
8. Data e hapjes së tenderit 27.04.2017	**9.Burimi Financimit** Nga Fondi i Emergjencave Civile	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tenderNumër **__1_OE** b)S'kualifikuar __0___OE, c) Kualifikuar___1__ OE
11.Ankimime **AK**-s'ka/ka;**APP**–s'ka/ka;**KPP-**s'ka/ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK	**13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim
Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë z. SH.B.i është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP).
-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu II pika 2/c, Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" , nenet 15 dhe 22, çka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor.
Ka analizë mbi çmimin për njësi dhe llogaritja e vlerës limit të kontratës është realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore.
Njësia e prokurimit ka përgatitur dokumentet e tenderit
Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga njësia e prokurimit (NJP).

a- Llogaritja e fondit limit: Llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike janë hartuar nga studio projektimi private.

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat e për kualifikim të hartuara nga NJHDT. Mos argumentimi i kërkesave e pa argumentuara janë jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), dhe neni 2 germa (a, b, c) dhe neni 20.

Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:

Lidhur me arsyen e përdorimit të procedurës "Me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës", procedura i referohej dhe ishte në zbatim të LPP. Ky konkluzion I referohet shkresës nr. 1848/6, datë 28.04.2017 të Ministrisë së Punëve të Brendshme, drejtuar Bashkisë Konispol dhe për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, është bërë kalimi I fondit prej 28,618,375 lekë "Ndërhyrje emergjente, argjinatura e lumit Pavëll".

Lidhur me përcaktimin e Kriterit të përdorur nga NJP, për ftesë të OE "Kalivioti" shpk, "A...I" shpk, "S...l" shpk, "E...i" shpk dhe "V...t" shpk, nuk rezulton të ketë një analizë mbi arsyet e thirrjes të ketyre OE, apo nuk është dokumentuar kjo ftesë, edhe pse rezulton se dy prej OE "E....i" shpk dhe "V...t" nuk kanë kontrata të mëparshme me Njësinë, madje nuk janë as OE të cilët ushtrojnë aktivitetin në apo pranë njësisë.

Lidhur me marrjen dijeni të OE të ftuar, nuk dokumentohet ftesa e bërë për asnjë nga OE, po ashtu nuk dokumentohet nëse kanë marrë dijeni secili prej OE të ftuar, pavarësisht shprehjes apo jo të interesit prej tyre.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO).

KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të tre operatorëve ekonomik. Nga vlerësimi rezulton se ka shprehur interes vetëm një OE "E...i" SHPK.

Lidhur me kriteret teknike të kërkuara nga NJP në DST rezulton se Lidhur me kriterin e përcaktuar në DST, nga AK, kreu II "Kritere të vecanta të kualifikimit", pika 1.3 "Kapaciteti teknik": Përvojë e sukseshme në ekzekutimin e të paktën:

Lidhur me kriterin e përcaktuar në DST, nga AK, kreu II "Kritere të vecanta të kualifikimit", pika 1.3 "Kapaciteti teknik": Përvojë e sukseshme në ekzekutimin e të paktën:

1. *Punë të ngjashme për një kontratë të vetme, të së njëjtës natyrë me objektin që prokurohet, të realizuara vetëm me institucione shtetërore, në një vlerë jo më pak se 50% të fondit limit; ose*
2. *Punë të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë viteve të fundit të jetë jo më pak se 200% e fondit limit, kontrata të së njëjtës natyrë me objektin që prokurohet të realizuara vetëm me institucione shtetërore.*

Nga auditimi i dosjes fizike të procedurë, dosje e cila rezulton ende e pa inventarizuar, konstatohet se OE nuk plotëson këtë kriter.

Nga OE është paraqitur si punë e ngjashme "Kontratë punë civile ndërtimi I shkollës 9 vjeçare Shtrazë, Gjepalaj", lidhur më datë 10.08.2016, ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Shijak dhe BOE "V....t" shpk dhe "R...i" shpk, për vlerën 38,454,452 lekë, ose 46,145,342 lekë me tvsh.

Lidhur më këë kontratë, subjekti "E...i" shpk është nënkontraktor me subjektin "R...i" i cili në kontratën e mësipërme ka pasur 90% të vlerës së punimeve (Kontrata 15.08.2016), dhe vlerë punimesh në shumën prej 16,531,250 lekë me tvsh ose 13,776,042 lekë.

Sa sipër rezulton në mospërputhje me kriterin e përcaktuar në DST, "Punë të ngjashme për një kontratë të vetme, të së njëjtës natyrë me objektin që prokurohet, të realizuara vetëm me institucione shtetërore", përsa ky operator nuk është nënshkrues me autoritetin kontraktor (Bashkia Shijak), por kontraktorin (R...i).

Lidhur me kriteret teknike të kërkuara nga NJP në DST rezulton se Lidhur me kriterin e përcaktuar në DST, nga AK, kreu II "Kritere të veçanta të kualifikimit", pika 1.4 "Kapaciteti teknik": "Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën IS) 9001:2008, ISO 14001:2004, ISO 19001:2007 dhe ISO 39001-2012….", nga auditimi i dosjes fizike të procedurës, konstatohet se OE nuk plotëson këtë kriter, për pikën ISO 9001:2008. Sipas dokumentit të paraqitur nga OE është për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN ISO 9001:2008, dhe nuk përkon me punimet e ndërtimit, por sipas përshkrimit të dokumentit certifikata është lëshuar për "Tregtim me shumicë dhe Pakicë I produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore. Përgatitje të ushqimeve të gatshme për menca….etj, shërbime kateringu", pra nuk përkon me investimin e cili kërkohet të realizohet, pasi nuk kemi të bëjmë me blerje e përpunim produktesh ushqimore por punime në ndërtim.
KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 "*Shqyrtimi i ofertave*" të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit"*. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi KVO, nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.A. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.
Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit"* dhe ngarkon me përgjegjësi KVO, nga z. E.D. në cilësinë e kryetarit të KVO z. A.A. dhe znj. E.P. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. SH.B.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
*Për **vitin 2016, nga** 12 procedura të realizuara, janë audituar 5 prej tyre ose 90% e fondeve të prokuruar, dhe nga auditimi janë konstatuar shkelje e parregullsi në 2 prej tyre, si vijon:*
Konkretisht për procedurat e prokurimit:
"Rikonstruksion i rrjetit të furnizimit me ujë të qytetit Konispol", për vlerën prej **158,339,371 lekë**, me OE të shpallur fitues **"A...s"**, për vlerën prej 155,750,971 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 2,588,400 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 3 OE, nga të cilët vetëm OE i shpallur fitues ka paraqitur ofertë ekonomike, ndërsa dy OE nuk kanë ngarkuar dokumentet por jo oferta ekonomike. OE i shpallur fitues rezulton se nuk ka plotësuar një kriter të DST dhe konkretisht për punë të ngjashme pasi ka paraqitur punime ndërtimi objektesh dhe në këto kushte tenderi duhej të anullohej dhe procedura të përsëritej. Mos paraqitja e ofertës ekonomike nga OE e tjerë tregon për fiktivitet të procesit dhe prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej **158,339,371 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar
"Rikonstruksion + Ndërtim i palestrës Bido Sejko", për vlerën prej **66,983,304** lekë, me OE të shpallur fitues BOE **"R...i & V...t"**, për vlerën prej 66,906,660 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 76,644 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 4 OE, nga të cilët vetëm BOE i shpallur fitues ka paraqitur ofertë ekonomike. OE të skualifikuar kanë rezultuar me mangësi të shumta në dokumentacion, ndërsa lidhur me OE të shpallur fitues ka rezultuar se nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje taksa vendore në bashkinë Krujë (nipt sekondar) dhe njëri prej mjeteve eskavator nuk ka të ngarkuar në sistem lejen e qarkullimit dhe në këto kushte tenderi duhej të anullohej dhe procedura të përsëritej. Mos paraqitja e ofertës ekonomike nga OE e tjerë tregon për fiktivitet të procesit, si dhe për prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë

dhe efektivitet për vlerën prej **66,983,304 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar

*Për **vitin 2017**, nga 14 procedura të realizuara, janë audituar 9 prej tyre ose mbi 85% e fondeve të prokuruar, dhe nga auditimi janë konstatuar shkelje e parregullsi në 7 prej tyre, si vijon:*

"Rijetëzim i Ansamblit Urban të Qendrës Konispol", për vlerën prej **65,697,705 lekë**, me OE të shpallur fitues **"G...G"**, për vlerën prej 64,665,200 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 1,032,505 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 4 OE. 2 nga OE të skualifikuar kanë rezultuar me mangësi të shumta në dokumentacion, 1 OE është tërhequr nga prokurimi për shkak të shpalljes fitues në një tjetër procedurë e cila ka kukuar angazhimin e të njëjtave mjeteve, ndërsa lidhur me OE të shpallur fitues ka rezultuar se nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje taksa vendore në bashkinë Konispol (nipt sekondar) dhe në këto kushte tenderi duhej të anullohej dhe procedura të përsëritej. Skualifikimi i OE **"Ç...I"**, me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 52,878,426 lekë, ka shkaktuar përdorim e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 12,818,279 lekë (diferencë ndërmjet ofertës fituese dhe asaj të skualifikuar), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

"Rikonstruksion i shkollës Mehmet Xhaferri Xarrë", për vlerën prej **57,931,934** lekë, me OE të shpallur fitues BOE **"R...i & V...T"**, për vlerën prej 57,863,092 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 68,842 lekë ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 2 OE, nga të cilët vetëm BOE i shpallur fitues ka paraqitur ofertë ekonomike ndërsa OE tjetër nuk ka ngarkuar ofertën ekonomike ndërsa lidhur me OE të shpallur fitues ka rezultuar se nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje taksa vendore në bashkinë Durrës (nipt sekondar) si dhe nuk ka paraqitur leje qarkullimi për mjetin ekskavator dhe në këto kushte tenderi duhej të anullohej dhe procedura të përsëritej. Mos paraqitja e ofertës ekonomike nga OE e tjerë tregon për fiktivitet të procesit, si dhe shpallja e OE fitues për prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej **57,931,934 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar

"Rehabilitim i Unazës Ekonomike (loti 1) Shkallë Mursi", për vlerën prej **50,6222,533 lekë**, me BOE të shpallur fitues **"A...I & I...D"**, për vlerën prej 49,005,820 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 1,216,713 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 3 OE. 1 nga OE të skualifikuar kanë rezultuar me mangësi të shumta në dokumentacion, 1 OE është tërhequr nga prokurimi për shkak të shpalljes fitues në një tjetër procedurë, ndërsa lidhur me OE të shpallur fitues ka rezultuar se nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje taksa vendore në bashkinë Delvinë (nipt sekondar) dhe në këto kushte tenderi duhej të anullohej e tenderi ripërsëritur. Skualifikimi i OE **"B...U B"**, me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 40,249,450 lekë, ka shkaktuar përdorim e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 9,973,083 lekë (diferencë ndërmjet ofertës fituese dhe asaj të skualifikuar), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

"Ndërhyrje emergjente në argjinaturën e Lumit Pavëll", për vlerën prej **23,848,646** lekë, me OE të shpallur fitues **"E...i"**, për vlerën prej 23,833,041 lekë, ose më pak për vlerën prej 15,605 lekë, ka rezultuar se AK ka përdorur procedurën e prokurimit "Me negocim pa shpallje paraprake të Njoftimit të Kontratës". Në këtë procedurë janë ftuar 5 OE nga ku vetëm OE i shpallur fitues ka paraqitur interes për procedurën, lidhur me EO ka rezultuar se nuk ka paraqitur kontrata për punë të ngjashme si dhe nuk ka plotësuar kriterin për ISO 9001:2008 dhe në këto kushte tenderi duhej të anullohej dhe procedura tw pwrswritej. Mos paraqitja e ofertës ekonomike nga OE e tjerë tregon për fiktivitet të procesit, si dhe shpallja e OE fitues për prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej **23,848,646 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin

publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

"Ndërtim i linjës së ujësjellësit të fshatit Ninat", për vlerën prej **23,134,125 lekë**, me OE të shpallur fitues **"A...s"**, për vlerën prej 22,942,320 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 191,805 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 3 OE, nga të cilët vetëm BOE i shpallur fitues ka paraqitur ofertë ekonomike ndërsa 2 OE tjetër nuk kanë ngarkuar ofertën ekonomike, ndërsa lidhur me OE të shpallur fitues ka rezultuar se nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje taksa vendore në bashkinë Kukës (nipt sekondar) si dhe nuk ka paraqitur punë të ngjashme sipas llojit të objektit të prokurimit dhe në këto kushte tenderi duhej të anullohej dhe procedura të përsëritej. Mos paraqitja e ofertës ekonomike nga OE e tjerë tregon për fiktivitet të procesit, si dhe shpallja e OE fitues për prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej **23,134,125 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

"Rehabilitim i Kanalit vaditës Shalës-Markat", për vlerën prej **11,750,000 lekë**, me BOE të shpallur fitues **"Sh...i & J...y"**, për vlerën prej 10,945,425 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 804,575 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 3 OE apo BOE. Është skulifikuar me të drejtë për mungesë dokumentacioni OE me ofertë më të ulët dhe janë kualifikuar dy OE me ofertë më të lartë, nga ku rezulton se asnjëra prej ofertave si ajo fituese ashtu edhe ajo e renditur e dyta, nuk kanë plotësuar kriteret dhe duhet të ishin skualifikuar dhe procedura duhej anuluar e ripërsëritur. OE i shpallur fitues nuk ka plotësuar numri e punonjësve si dhe se nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje taksa vendore në bashkinë Mamurras (nipt sekondar). Skualifikimi i OE **"B...U B"**, me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 9,441,562 lekë, ka shkaktuar përdorim e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 2,308,438 lekë (diferencë ndërmjet ofertës fituese dhe asaj të skualifikuar), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 76-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

"Ndërtim i linjës ujësjellësit depo tharrëse fshati Mursi", për vlerën prej **8,371,120 lekë**, me OE të shpallur fitues **"A...s"**, për vlerën prej 8,279,310 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 91,810 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 3 OE, nga të cilët vetëm BOE i shpallur fitues ka paraqitur ofertë ekonomike ndërsa 2 OE tjetër nuk kanë ngarkuar ofertën ekonomike, ndërsa lidhur me OE të shpallur fitues ka rezultuar se nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje taksa vendore në bashkinë Kukës (nipt sekondar) si dhe nuk ka paraqitur punë të ngjashme sipas llojit të objektit të prokurimit dhe në këto kushte tenderi duhej të anullohej dhe procedura të përsëritej. Mos paraqitja e ofertës ekonomike nga OE e tjerë tregon për fiktivitet të procesit, si dhe shpallja e OE fitues për prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej **8,371,120 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar

*Lidhur me kriteret e vendosura nga NJP ka rezultuar se ato **kanë kufizuar numrin e OE pjesëmarrës** pasi në Hartimin e kritereve të kualifikimit, **NjP nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së kritereve**, siç kërkohet shprehimisht nga VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Gjithashtu, disa nga **kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim me llojin e punës së kërkuar** (psh: numri prej 100 punonjësish duket shumë i madh dhe diskriminues dhe jo në përpjesëtim me volumin e punës dhe afatin e punimeve; gjendja në llogari bankare, numri i mjeteve apo certifikatave të cilat nuk kanë lidhje me zërat e punimeve që do të kryhen etj).*

Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi NJP, KVO dhe Titullari i AK, sipas praktikave respektive të përshkruara më sipër.

Komente nga subjekti i audituar: *subjekti i audituar, (Titullari i AK SH.B.i, KVO e E.D., E.P., A.A., A.B. dhe E.K. dhe NJP L.B, K.K., Kula dhe A.B.), me shkresën nr. 276/3, datë 05.06.2018, administruar nga KLSH me nr. 247/4, datë 08.06.2018, duke sqaruar:*
Objekti: Rikonstruksioni i rrjetit te furnizimit me uje qyteti Konispol
Subjekti "A...S" ka pasur adrese sekondare ne Bashkine Kukes dhe ne 16.01.2014 ka aplikuar ne QKR per mbyllje te adreses sekondare. Kjo do te thote qe detyrimi per vitin 2014 ne konsideraten tone si KVO eshte shume i vogel dhe mosparaqitja e vertetimit per detyrimet per kete vit nuk perben kusht per skualifikim sipas nenit 15 te ligjit nr. 182/2014 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "për prokurimin publik", të ndryshuar. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.".
Pra nuk eshte konsideruar si kusht per skualifkim detyrimi per 15 dite te fillimvitit qe mund te mos jete maturuar si detyrim nga pakaeta fiskale e bashkise Kukes.
Sipas VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, pika 6:

Për të provuar përvojëne mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:
a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.
b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.
Ne rastin konkret shoqeria "A...S SH.P.K" ka paraqitur si pune te ngjashme ndertimin e kompleksit rezidencial Kodra e Diellit me pjeset perberese te tij me rreth 400 apartamente dhe vila nderkohe qe rikonstruksioni i ujesjellesit Konispol perfshin nje rrjet me rreth 600 piklidhje. Ne situacionet e paraqitura nga subjekti dhe nga akt kolaudimet perkatese perfshihen ne volume dhe ne vleren perkatese dhe zerat e preventivit objekt prokurimi, si punime germimi, punime shtresash, punime hidraulike, sistemi i kanalizimeve, pompa etj, krahasimisht të ngjashme, të krahasueshme në volume dhe në zëra konkretë punimesh.
Pika 6 e ketij vendimi nuk kërkon detyrimisht që të jenë të njëjta, por të ngjashme.

REHABILITIMI I INFRASTRUKTURES VADITESE TE FUSHES SE "SHERRET RRAHA"
Vlerësimi i ofertave nga KVO
Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe e shpallur fituese "M...S" sh.p.k nga auditimi rezulton se kjo OE ka keto mangesi.:
Ky OE "M...S" SH.P.K nuk ploteson kapacitetin teknik pika 4 pasi drejtuesi teknik Gj.K me kontrate pune te rregullt dhe me page 40 000 leke ne muaj ne listepagesat e shoqerise rezulton te paguhet me 22 000 leke ne muaj, drejtuesi teknik A.M. me kontrate pune te rregullt dhe me page 25 000 leke ne muaj ne listepagesat e shoqeris rezulton me 22 000 leke ne muaj etj.
Ne piken 2 te DST kerkohet:
2.a Stafi Drejtues i shoqerise te perbehet nga:
- *Inxhinier -1 (nje) Me master profesional për menaxhim trafiku*
- *Inxhnier hidroteknik-1(nje) (drejtues teknik)*
- *Inxhinier gjeodet (topograf) -1 (nje) (drejtues teknik)*
- *Inxhiner mjedisi -1nje (drejtues teknik*

Per stafin te paraqese kontrat e punes te vlefshme, cv, diplome , dhe Kartelat e sigurise ne pune, si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi per periudhen e mesiperme te kërkuar.
Nisur nga kjo kerkese operatori ekonomik ploteson kushtin e kerkuar pasi drejtuesit deknik perkates figurojne ne listepagesat dhe ne licensen e shoqerise me dokumentacionin perkates dhe KVO eshte mjaftuar me kete fakt dhe nuk eshte futur ne detaje te metejshme duke u bazuar ne nenin 53 te ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, pika 4 duke permbushur thelbin qe operatori ka drejtuesit teknik perkates dhe permbush kapacitetin teknik. Drejtuesi teknik Gj.K. eshte inxhinjer elektrik dhe nuk eshte kerkuar nga ana jone si drejtues teknik.
Persa i perket mjetit eskavator me goma mjeti figuron i kompletuar ne dokumentat e tenderit me emrin "Mjete ne pronesi" me leje qarkullimi nr SRD0056316 dhe targa AA537NG
Ne piken 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar eshte kerkuar:
. Vertetim per shlyerjen e taksave vendore ne te gjitha njesite e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka seline dhe ku zhvillon veprimtarine e tij (sipas rregjistrimit ne QKR). Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te dorezoj vertetimin per shlyerjen e taksave Vendore te parashikuara nga Pushteti Vendor.per vitin 2015, 2016.
Sipas ekstraktit te QKR subjekti ushtron aktivitetin vetem ne kete adrese dhe per kete ka paraqitur vertetimet me nr 30 date 01.11.2016, nr 37/15 date 07.08.2015 nga Bashkia Sarande.
Ne keto kushte, ne gjykimin e KVO operatori ka permbushur piken 3 te kapacitetit ekonomike dhe financiar dhe persa i perket regjistrimit apo jo ne Bashkine Himare nuk eshte detyre e KVO per te konstatuar keto veprime.

OBJEKTI: RIKONSTRUKSION I SHKOLLES BIDO SEJKO KONISPOL+ NDERTIM PALESTRE
<u>Në lidhje me mungesen e dokumentacionit te mjeteve eskavator te paraqitur nga shoqeria "R...I"Shpk , ju bejme me dije se :</u>
Ne DST pika 2.3 Kapaciteti teknik: nder te tjerat eshte eshte kerkuar:
Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:
Makineritë – pajisjet në pronësi të vërtetohen me anë të aktit të pronësisë. Ato të marra me qera të shoqërohen me kontratë noteriale qiraje (ose formë tjeter huaje) si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit. Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve. Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet edhe: leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, certifikatë për transport mallrash, policën e sigurimit të mjeteve. Per kamionet me tonazh mbi 30 ton te paraqiten dokumentet: leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, certifikatë për transport mallrash, policën e sigurimit të mjeteve si dhe Certifikate Euro5 per sejcilin mjet.
Ne plotesim te ketij kriteri Shoqeria "Victoria Invest"Shpk ka paraqitur 3 eskavatore me goma, shoqeruar me foto dhe vertetim zhdoganimi.
Sqarojme se dokumentacioni perkates per keto mjete eshte vetem akti i zhdoganimit pasi keto jane te vetmet dokumenta qe vertetojne pronesine e tyre pasi jane mjete qe qarkullojne vetem brenda kantierit dhe nuk targohen. Keto mjete jane makineri te renda qe punojne ne kantier dhe nuk ka detyrim ligjor per tu pajisur me leje qarkullimi, siguracion, certifikate kontrolli teknik etj. Fakti qe kane goma nuk do te thote qe kane detyrim ligjor per tu pajisur me leje qarkullimi, siguracion, certifikate kontrolli teknik etj.
Ne lidhje me arsyetimin e mesiperm mjafton ti referoheni Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik VENDIM K.P.P. 583/2017 date 28.07.2017, ku KPP ka vendosur te pranoje ankesen e operatorit ekonomik per proceduren e prokurimit.
Ne kete procedure te zhvilluar po nga AK Bashkia Tirane operatori ekonimik eshte skualifikuar per arsyet se:
• <u>Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik: "Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten</u>

<u>për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)", pasi për fadromat përvec faturës së zhdoganimit nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar.</u>

KPP ne vendimin 583/2017 date 28.07.2017 ne faqen 23 pika II.4.6 ka arsyetuar:

.....nga interpretimi literal i nenit te sipercituar, konstatohet qarte se per regjistrimin e mjeteve teknollogjike ne zyrat e Drejtorise se Pegjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor si dhe per pajisjen me targe njohje, leje qarkullimi dhe te gjithe dokumentacionin lidhur me to, detyrimi logjor lind vetem ne rastet, kur mjetet teknollogjike qarkullojne ne menyre vetelevizese ne rruge. Pra, ne asnje rast, legjislacioni ne fuqi per transportin rrugor ne Republiken e Shqiperise, nuk detyron pronaret e mjeteve teknollogjike qe ti regjistrojne ato prane zyrave Drejtorise se Pegjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor e per rrjedhoje te pajisen me targe njohje, leje qarkullimi ejt, persa kohe ato transportohen me mjete te tjera dhe perdoren vetem ne kantier. Ne keto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues e ka plotesuar kerkesen e autoritetit kontraktor ne drejtim te disponueshmerise se makinerive tip eskavator me goma, shoqeruar me dokumentacionin e kerkuar nga autoriteti kontraktor ne zbatim te kritereve te vecant ate kualifikimit te procedures se prokurimit objekt ankimi, sipas pikes 16.b te shtojces 10 te dokumentave te tenderit, pasi persa kohe keto mjete eskavator me goma qe disponon operatori ekonomik ankimues nuk jane te regjistruara ne regjistrin e Drejtorise se Pegjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor, nuk kane sit e pajisen me targe njohjeje e si rrjedhoje me doklumentacionin perkates…….

Gjithashtu per raste të tilla analoge mund ti referohemi dhe vendimeve te tjera te KPP ku KPP ka sqaruar si më poshtë :

Vendimi i K.P.P-së 25/2016 në datë 13/01/2016 ka sqaruar se :

Në rastin e shqyrtimit administrative në fjalë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se mjeti Eskavator me goma tip Fiat Allis 645B me nr. Shasie 14004913 shoqëruar me Dokument zhdoganimi Nr.33725 shoqëruar me fotogarfi të mjetit, si edhe mjeti Fadromë Zetcat shoqëruar me dokument zhdoganimi Nr. Sashie 410269 shoqëruar me fotografi të mjetiti të deklaruar si i disponueshëm për kryerjen e punimeve si mjete (eskatavator me goma dhe fadromë) janë mjete kantieri, për të cilin nuk parashikohet nga Kodi Rrugor detyrimi për paisje me leje qarkullimi dhe dokumentacionin tjetër shoqërues. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin e shqyrtimit administrative në fjalë, operatori ekonomik ankimues ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor në drejtim të disponueshmërisë së makinerive tip eksavator me goma, fadromë shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në zbatim të kriteve të veçanta të kualifikimit të procedures.

<u>Per mospagimin e takse vendore per Bashkine Kruje, sqarojme se:</u>

Ne Ekstraktin e Regjistrit Tregtar dhe Ekstraktin Historik te Regjistrit Tregtar te dates 30.05.2016, te paraqitur nga shoqeria "R...I" Shpk, ne rruge elektronike ne faqen zyrtare te app-se per kete procedure prokurimi, per vitet 2015-2016-2017 nuk ka nipt sekondar per ushtrim aktiviteti ne Bashkine Kruje. (bashkelidhur Ekstraktet e shoqerise te dates 30.05.2016

<u>Ne lidhje me vendodhjen e fabrikes se prodhimit te betonit te shoqerise "V...t"shpk, sqarojme se;</u>

Ne DST pika 2.3 Kapaciteti teknik: nder te tjerat eshte eshte kerkuar:

Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Fabrika për prodhimin e betonit te jete në pronësi/qera ose ne forme tjeter ligjore me emertim te objektit qe prokurohet, jo me larg se 25 km nga vendodhja e objektit, shoqeruar me dokumente që vertetojnë pronësinë, planin e vendosjes dhe lejen mjedisore (duhet të paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B lëshuar nga Qëndra Kombëtare e Licencimit)

Per permbushjen e ketij kriteri BOE "R...I" Shpk & "V...t"shpk, ka paraqitur Kontraten e Furnizimit me nr.1253 rep, 428 kol date 01.07.2016 te shoqerise : "R...I" Shpk me shoqerine K...i shpk, kjo e fundit disponon Linje per prodhimin e betonit me adrese ne fshatin Livadhja Konispol, qe eshte 20.7 km nga objekti .

Sa me lart ky kriter eshte permbushur katerciperisht nga BOE "R...I"Shpk & "V... I..."shpk.

OBJEKTI : RIJETEZIMI I ANSAMBLIT URBAN TE QENDRES KONISPOL
KLSH: 'OE G...Y" SH.P.K nuk ka pasqyruar ne ekstraktin e QKR te gjitha vendet ku ka zhvilluar biznes dhe per rrjedhoje e nuk ka paguar detyrimet vendore ne te gjitha njesite ku ka zhvilluar bizneS.
KVO: Ne piken 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar eshte kerkuar:
Vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2015,2016 dhe 2017 prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit ne QKR.
Ne dokumentat e dorezuara ne sistemin elektronik te prokurimeve ne ekstraktin e QKR operatori gjate 2015, 2016 2017 ka ushtruar aktivitet vetem ne Tepelene, Berat,Lushnje dhe Korce.
Per te gjitha keto vendodhje gjeni bashkangjitur vertetimet perkatese nga tatim taksat e bashkive perkatese.
Ne keto kushte per KVO pika 4 e kapacitetit ekonomik dhe financiar quhet I plotesuar.

OBJEKTI: REHABILITMI I UNAZES EKONOMIKE
KLSH : Subjekti "I...D" shpk me seli në Sarande, sipas ekstraktit të paraqitur ka pasur si vend të zhvillimit të aktivitetit edhe adresa të tjera në të cilat ka hapur NIPT sekondar dhe konkretisht: Bashkine Delvine. Vërtetimi për pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për Bashkine Delvine nuk është paraqitur.
KVO:
Ne piken 2.2 per kapacitetin ekonomik dhe financiar kerkohet:
Vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2014, 2015 dhe 2016 prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit ne QKR.
Ne rastin e nje B.O.E secili nga anetaret e bashkimit te shoqerise duhet ta plotesoje me vete kete kriter.
Sipas dokumentit te QKR dorezuar ne sistemin elektronik operatori I...D per vitet 2014, 2015, 2016 ka ushtruar aktivitet vetem ne Sarande dhe per kete ka dorezuar vertetimet per pagesen e detyrimeve perkatese.
Ne keto kushte kjo pike e kapacitetit ekonomik dhe financiar per KVO eshte permbushur dhe nuk perben kusht per skualifikim sipas nenit 15 te ligjit nr. 182/2014. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

OBJEKTI: NDERTIMI I LINJES UJESJELLESIT FSHATI NINAT
KLSH: Subjekti "A...S" shpk me seli në Tirane, sipas ekstraktit të paraqitur ka pasur si vend të zhvillimit të aktivitetit edhe adresa të tjera në të cilat ka hapur NIPT sekondar dhe konkretisht: Bashkine Kukes. Vërtetimi për pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për Bashkine Kukes nuk është paraqitur.
KVO: Ne piken 4 te kapacitetit ekonomik dhe financiar eshte kerkuar vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2014,2015,2016, nga te gjitha njesite ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas Ekstraktit te QKR/QKB
Subjekti "A...S" ka pasur adrese sekondare ne Bashkine Kukes dhe ne 16.01.2014 ka aplikuar ne QKR per mbyllje te adreses sekondare. Kjo do te thote qe detyrimi per vitin 2014 ne konsideraten tone si KVO eshte shume i vogel dhe mosparaqitjae vertetimit per detyrimet per kete vit nuk perben kusht per skualifikim sipas nenit 15 te ligjit nr. 182/2014. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.".
Pra nuk eshte konsideruar si kusht per skualifkim detyrimi per 15 dite te fillimvitit.

KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit i OE "A...S"SHPK rezulton se asnjë kontrate e paraqitur nga kjo OE nuk ka si natyre objektin e prokurimit .
Banese 4 kat me podrum dhe nencati, Vila 2 dhe 3 kate me podrum dhe nencati, Godine banimi 3 kat me 2 kat bodrum, Godine Banimi 2,3,4 kate + nencati me 1 kat nentoke, Godine banimi 2 dhe 5 kate me podrum etj.KVO: Ne rastin konkret shoqeria "A...S SH.P.K" ka paraqitur si pune te ngjashme ndertimin e kompleksit rezidencial Kodra e Diellit me pjeset perberese te tij me rreth 400 apartamente dhe vila nderkohe qe rikonstruksioni I ujesjellesit Konispol perfshin nje rrjet me rreth 600 piklidhje. Ne situacionet e paraqitura nga subjekti dhe nga akt kolaudimet perkatese perfshihen ne volume dhe ne vleren perkatese dhe zerat e preventivit objekt prokurimi, si punime germimi, punime shtresash, punime hidraulike, sistemi i kanalizimeve, pompa etj, krahasimisht të ngjashme, të krahasueshme në volume dhe në zëra konkretë punimesh.
Pika 6 e ketij vendimi nuk kërkon detyrimisht që të jenë të njëjta, por të ngjashme
KLSH: Ne DST eshte kërkuar:
Nga auditimi rezulton se kjo OE ka paraqitur vetem nje eskavator me goma ndersa eskavatori tjeter i mare me qira nga OE "B...S"SHPK me nr.2620 Rep dhe Nr.652 Kol po nuk ka paraqitur lejen e qarkullimit , siguracionin por vetem kontrollin teknik.
KVO: Ne dokumentacionin e operatorit ekonomik dorezuar ne sistemin elektronik jane dorezuar dokumentat per dy eskavatora. Nje eskavator eshte me kontrate qeraje nga shoqeria "B...i" sipas kontrates nr 2623 rep, kol 655 date 02.06.2017, leje qarkullimi nr TRF1018912, si dhe gjithe dokumneacionin e nevojshem bashkangjitur.
Eskavatori tjeter me goma eshte ne pronesi te A...S me dokumentacion te kompletuar.
OBJEKTI : RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLES "MEHMET XHAFERI" XARRE
KLSH: Ne dst eshte kërkuar ne piken 3.5 Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:
Fadrome cope 1
Per te përmbushur kete kriter kjo BOE ka paraqitur nje kontrate qiraje ndermjet OE "R...I" SHPK ne rolin e Qiramarresi dhe shoqerise "K...I"shpk ne rolin e Qirradhenesi me nr 1273 Rep dhe nr.398 Kol per mjetin lloji Fadrome, Marka 400/129 MKG, Nr.shasie 706 e cila eshte e shoqeruar me nje vërtetim zhdoganimi dhe foto, por mungon leja e qarkullimit, figuracioni i mjetit , kontrolli teknik.
KVO:<u>Per mospagimin e takse vendore per Bashkine Durres, sqarojme se:</u>
Ne Ekstraktin Historik te Regjistrit Tregtar te dates 15.05.2017, te paraqitur nga shoqeria "R...I"Shpk, ne rruge elektronike ne faqen zyrtare te app-se per kete procedure prokurimi, per vitet 2015-2016-2017 nuk ka nipt sekondar per ushtrim aktiviteti ne Bashkine Durres.
Nga shqyrtimi i ekstrakti kjo shoqeri ka patur nipt sekondar ne Bashkine Durres per vitet 2011,2012 dhe 2013 te cilat jane mbyllur dhe nuk kane qene te hapura per asnje nga vitet 2015-2016-2017.
Per aplikimin me 28.10.2016 behet fjale per ndertimin e shkolle 9 vjecare fshati Shtraze, Bashkia Shijak.
Per detyrimet vendore te bashkise Shijak eshte vertetimi si me poshte:
<u>Në lidhje me mungesen e dokumentacionit te mjetit fadrome te paraqitur nga shoqeria "R...I"Shpk , ju bejme me dije se :</u>
Ne DST pika 2.3 Kapaciteti teknik: nder te tjerat eshte eshte kerkuar:
Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:
Makineritë – pajisjet në pronësi të vërtetohen me anë të aktit të pronësisë. Ato të marra me qera të shoqërohen me kontratë noteriale qiraje (ose formë tjeter huaje) si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit. Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve. Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet edhe: leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, certifikatë për transport mallrash, policën e sigurimit të mjeteve. Per kamionet me tonazh mbi 30 ton te paraqiten dokumentet: leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik,

certifikatë për transport mallrash, policën e sigurimit të mjeteve si dhe Certifikate Euro5 per sejcilin mjet.
Ne plotesim te ketij kriteri Shoqeria "REGLI"Shpk ka paraqitur ne spe dokumentin ne format pdf me mbishkrimin egli Autobetoniere autopompebetoni eskavator fadrome, per mjetin Fadrome shoqeruar me Vertetim zhdoganimi dhe foto.
Sqarojme se dokumentacioni perkates per mjetin Fadrome me goma Marka 400/129 MKG nr.shasie 706 eshte vetem akti i zhdoganimit pasi keto jane te vetmet dokumenta qe vertetojne pronesine e tyre pasi jane mjete qe qarkullojne vetem brenda kantierit dhe nuk targohen. Keto mjete jane makineri te renda qe punojne ne kantier dhe nuk ka detyrim ligjor per tu pajisur me leje qarkullimi, siguracion, certifikate kontrolli teknik etj. Fakti qe kane goma nuk do te thote qe kane detyrim ligjor per tu pajisur me leje qarkullimi, siguracion, certifikate kontrolli teknik etj.
Ne lidhje me arsyetimin e mesiperm mjafton ti referoheni Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik VENDIM K.P.P. 583/2017 date 28.07.2017, ku KPP ka vendosur te pranoje ankesen e operatorit ekonomik per proceduren e prokurimit..
Ne kete procedure te zhvilluar po nga AK Bashkia Tirane operatori ekonimik eshte skualifikuar per arsyet se :
• Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik: "Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)", pasi për fadromat përvec faturës së zhdoganimit nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar.

KPP ne vendimin 583/2017 date 28.07.2017 ne faqen 23 pika II.4.6 ka arsyetuar:
.....nga interpretimi literal i nenit te sipercituar, konstatohet qarte se per regjistrimin e mjeteve teknollogjike ne zyrat e Drejtorise se Pegjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor si dhe per pajisjen me targe njohje, leje qarkullimi dhe te gjithe dokumentacionin lidhur me to, detyrimi logjor lind vetem ne rastet, kur mjetet teknollogjike qarkullojne ne menyre vetelevizese ne rruge. Pra, ne asnje rast, legjislacioni ne fuqi per transportin rrugor ne Republiken e Shqiperise, nuk detyron pronaret e mjeteve teknollogjike qe ti regjistrojne ato prane zyrave Drejtorise se Pegjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor e per rrjedhoje te pajisen me targe njohje, leje qarkullimi ejt, persa kohe ato transportohen me mjete te tjera dhe perdoren vetem ne kantier. Ne keto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues e ka plotesuar kerkesen e autoritetit kontraktor ne drejtim te disponueshmerise se makinerive tip eskavator me goma, shoqeruar me dokumentacionin e kerkuar nga autoriteti kontraktor ne zbatim te kritereve te vecant ate kualifikimit te procedures se prokurimit objekt ankimi, sipas pikes 16.b te shtojces 10 te dokumentave te tenderit, pasi persa kohe keto mjete eskavator me goma qe disponon operatori ekonomik ankimues nuk jane te regjistruara ne regjistrin e Drejtorise se Pegjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor, nuk kane sit e pajisen me targe njohjeje e si rrjedhoje me doklumentacionin perkates…….
Gjithashtu per raste të tilla analoge mund ti referohemi dhe vendimeve te tjera te KPP ku KPP ka sqaruar si më poshtë :
Vendimi i K.P.P-së 25/2016 në datë 13/01/2016 ka sqaruar se :
Në rastin e shqyrtimit administrative në fjalë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se mjeti Eskavator me goma tip Fiat Allis 645B me nr. Shasie 14004913 shoqëruar me Dokument zhdoganimi Nr.33725 shoqëruar me fotogarfi të mjetit, si edhe mjeti Fadromë Zetcat shoqëruar me dokument zhdoganimi Nr. Sashie 410269 shoqëruar me fotografi të mjetiti të deklaruar si i disponueshëm për kryerjen e punimeve si mjete (eskatavator me goma dhe fadromë) janë mjete kantieri, për të cilin nuk parashikohet nga Kodi Rrugor detyrimi për paisje me leje qarkullimi dhe dokumentacionin tjetër shoqërues. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin e shqyrtimit administrative në fjalë, operatori ekonomik ankimues ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor në drejtim të disponueshmërisë së makinerive tip eksavator me goma, fadromë shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në zbatim të kriteve të veçanta të kualifikimit të procedures.

Vendim i K.P.P-së 240/2014 datë 20.05.2014 (faqe 5 e tij),
Komisioni sqaron se, në lidhje me mjetet Rul vibrues, Rul me Hekur me goma, Eskavator, këto mjete janë makinerie për punë të rënda e si të tilla nuk pajisen me leje qarkullimi dhe si rrjedhojë nuk lejohet të qarkullojnë veçse të transportuara me rimorkiator.
Vendimi i K.P.P-së 166/2016 datë 25.03.2016 (faqe 23 e tij)
Për automjetin tip Rimorkio për subjektin "A...I" sh.p.k;Mandat Arkëtimi. K.P.P. konstaton se mjeti i mësipërm nuk është regjistruar në regjsitrat publikë e për rrjedhojë shërbën si mjet tip kantieri, për të cilin referuar legjislacionit në fuqi dhe kërkesave të autoritetit kontraktor nuk shfaqet nevoja e paisjes me leje qarkullimi (regjistrim në regjistrat publikë) e njëherazi për paisjen e tij me certifikatë (leje) transporti lëshuar nga bashkia komuna.
Vendimi Nr.1035/3.prot, datë 24.10.2013 (faqe 8 - 10 e tij)
KPP gjykon se, mjeti rrul, për hir të faktit që nuk bën pjesë në kategorinë e mjete qarkulluese, nuk pajiset me leje qarkullimi. Në momentin kur këto mjete nuk janë të pajisur me leje qarkullimi dhe rrjedhimisht me targën përkatëse, nuk lëshohet akti i kolaudimit, siguracioni, taksa vjetore dhe leja e transportit, siç është kërkuar në pjesën e parë, në kriterin e përkatës për kualifikim.
Duke qenë se mjeti i mësipërm është i shoqëruar me aktet e zhdoganimit, në përputhje mesa përcaktuar në kriterin e mësipërm për kualifikim, ky kriter konsiderohet i plotësuar nga ky bashkimim operatorësh ekonomikë.

OBJEKTI: REHABILITIMI I KANALIT VADITES SHALES MARKAT
KLSH: Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe e shpallur fituese "SH...I" & "J...Y" sh.p.k nga auditimi rezulton se kjo OE ka keto mangesi:
Nuk përmbush kritere e dst-ve konkretisht shumica e drejtueseve teknik te kësaj OE "J... Y" SHPK Ing.J.P. me kontrate te rregullt pune me date 28.10.2013 dhe me rroge 35 000 mje leke figurone ne listepagesat e shoqerise me rroge 22000, Ing.N.C. me kontrate te rregullt pune me date 06.01.2014 dhe me rroge 30 000 mje leke figurone ne listepagesat e shoqerise me rroge 22 000, Ing. F.G.N. me kontrate te rregullt pune me date 03.12.2012 dhe me rroge 35 000 mje leke figurone ne listepagesat e shoqerise me rroge 22 000 lek.
KVO: Ne piken 2.a eshte kerkuar qe:
Stafi Drejtues i shoqerise te perbehet nga:
- Inxhinier ndertimi -1nje me eksperience pune jo me pak se 10 vjet
- Inxhnier hidroteknik-1(nje) (drejtues teknik).
- Inxhinier gjeodet (topograf) -1 (nje) (drejtues teknik).
- Inxhiner mekanik-1nje (drejtues teknik).
- Inxhiner mjedisi -1nje (drejtues teknik).
- Inxhiner Gjeolog -1nje (drejtues teknik).
Per stafin te paraqese kontrat e punes te vlefshme, cv, diplome , si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi per periudhen e mesiperme te kerkuar
Nga ana e KVO eshte konstatuar qe stafi drejtues I shoqerise J...C... eshte I perbere nga:D.C. F.N. K.L. T.M. J.P. N.Ç.
Punonjesit e mesiperm figurojne ne listepagesat e kompanise, me kontrata pune dhe ne opinionin e KVO eshte permbushur kriteri i kapacitetit teknik per stafin drejtues dhe ne baze te nenit 53, pika 4 e ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "per prokurimin public" ku citohet "autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj" nuk perben shka per skualifkim.
KLSH: Nga auditimi rezulton se BOE nuk ka permbushr piken 3 te dst-ve Disponimi i mjeteve te mëposhtme:
Eskavator me goma 1 cope (Pronesi ose me Qira)
Kjo BOE nga auditimi i dokumentacionit rezulton se ky mjete nuk eshte paraqitur

KVO: Ne dokumentacionin e dorezuar elektronikisht nga operatori eshte dhe eskavatori me goma i pajisur me gjithe dokumentacionin perkates.
KLSH: OE "SH...I" SHPK nuk ka pasqyruar ne Ektraktin e QKRse te gjitha vendet ku ka zhvilluar biznes dhe per rrjedhoje e nuk ka paguar detyrimet vendore ne te gjitha njesite ku ka zhvilluar biznes
KVO: OE "SH...I" SHPK ka paraqitur vertetim per te gjitha selite ku ka ushtruar aktivitet sipas ekstraktit te QKR. Ne dokumentin e QKR rezulton se operatori per vitet 2015, 2016 kapasur seli vetem ne Bashkine Fier e per pasoje ka paraqitur vertetimet vetem nga Bashkia Fier. Ne piken 2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar eshte kerkuar "Vertetim per shlyerjen e taksave vendore ne te gjitha njesite e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka seline dhe ku zhvillon veprimtarine e tij (sipas rregjistrimit ne QKR) per pasoje kushti eshte plotesuar dhe nuk eshte pjese e punes se KVO te detyroje operatorin te kryeje regjistrime te adresave sekondare.
KLSH: Ne lidhje me BOE e kualifikuar "I...D" & "K...I"SHPK nga auditimi rezulton se ka keto mangësi:
BOE nuk ka permbushr piken 3 te dst-ve Disponimi i mjeteve te mëposhtme :
Eskavator me goma 1 cope (Pronesi ose me Qira)
BOE ka paraqitur nje eskavator me goma shoqeruar me nje veretim zhdoganimi por mungon policia e mjetit, leja e qarkullimit, kontrolli teknik , certifikata e pronesise se mjetit,
KVO: Sqarojme se operatoret kane paraqitur mjetin eskavator me goma nje mjet te rende me zhdoganimin perkates si dhe foto te mjetit. Duke qene mjete te renda jane per perdorim kantjeri dhe nuk e kane detyrimin per tu pajisur me leje qarkullimi. Per analogji mund ti referohemi edhe Vendimit te K.P.P-së 25/2016 në datë 13/01/2016 ku ka sqaruar se :
Në rastin e shqyrtimit administrative në fjalë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se mjeti Eskavator me goma tip Fiat Allis 645B me nr. Shasie 14004913 shoqëruar me Dokument zhdoganimi Nr.33725 shoqëruar me fotogarfi të mjetit, si edhe mjeti Fadromë Zetcat shoqëruar me dokument zhdoganimi Nr. Sashie 410269 shoqëruar me fotografi të mjetiti të deklaruar si i disponueshëm për kryerjen e punimeve si mjete (eskatavator me goma dhe fadromë) janë mjete kantieri, për të cilin nuk parashikohet nga Kodi Rrugor detyrimi për paisje me leje qarkullimi dhe dokumentacionin tjetër shoqërues. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin e shqyrtimit administrative në fjalë, operatori ekonomik ankimues ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor në drejtim të disponueshmërisë së makinerive tip eksavator me goma, fadromë shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në zbatim të kriteve të veçanta të kualifikimit të procedure.
Duke qenë se mjeti i mësipërm është i shoqëruar me aktet e zhdoganimit, në përputhje mesa përcaktuar në kriterin e mësipërm për kualifikim, ky kriter konsiderohet i plotësuar nga ky bashkimim operatorësh ekonomikë.
KLSH: Nuk përmbush kritere e DST-ve konkretisht shumica e drejtueseve teknik te kësaj OE "K...I" SHPK Ing.K.M. me kontrate te rregullt pune me date 04.04.2007 dhe me rroge 40 000 mje leke figurone ne listepagesat e shoqerise me rroge 5000, Ing.G.L. me kontrate te rregullt pune me date15.04.2015 dhe me rroge 40 000 mje leke figurone ne listepagesat e shoqerise me rroge 10 000.
KVO: Ne piken 2.a eshte kerkuar qe Stafi Drejtues i shoqerise te perbehet nga:
- Inxhinier ndertimi -1nje me eksperience pune jo me pak se 10 vjet
- Inxhnier hidroteknik-1(nje) (drejtues teknik).
- Inxhinier gjeodet (topograf) -1 (nje) (drejtues teknik).
- Inxhiner mekanik-1nje (drejtues teknik).
- Inxhiner mjedisi -1nje (drejtues teknik).
- Inxhiner Gjeolog -1nje (drejtues teknik).
Per stafin te paraqese kontrat e punes te vlefshme, cv, diplome, si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise.
Nga ana e KVO eshte konstatuar se BOE e ploteson kete kusht duke pare drejtuesit teknik ne licensen e shoqerive si dhe CV-te perkatese e kontratat e punes. Ne kete aspket nese do te

mungonte nje nga drejtuesit teknik te kerkuar atehere nuk do te permbushej kriteri per kapacitetin teknik por ne kete rast mosdeklarimi I pages se kontrates eshte ceshtje qe i takon ta zgjidhe punemarresi me punedhenesin sipas kushteve te kontrates dhe legjislacionit ne fuqi.
Duke qene se kushti plotesohet KVO eshte mjaftuar dhe nuk ka hyre ne detaje te cilat nuk jane ne thelbesore sipas te nenit 53, pika 4 e ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ku citohet "autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj"
Ne kete aspekt nuk perben kusht per skualifikim.

OBJEKTI : REHABILITIM I KANALIT FURNIZUES TE V-55 NE FUSHEN E VRINES
KLSH: Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe e shpallur fituese "M...S" sh.p.k nga auditimi rezulton se kjo OE ka keto mangesi:
Kjo OE "M...S" nuk ploteson kapacitetin teknik pika 3.Disponimi i mjeteve te meposhtme:
Eskavator me goma 1 cope
Nga auditimi rezulton se per te vertetuar kete pike kjo OE nuk ka paraqitur eskavator me goma por nje mjete JCB.
KVO: Ne kuptimin teknik eskavatori eshte nje makineri qe germon dhe leviz dhera me ane te koves qe vihet ne levizje nga nje sitem hidraulik. Pershkrimi JCB eshte emri tregtar sic mund te jete Caterpilar ose Neë Holland etj. Ne rastin konkret operatori ka paraqitur eskavator te markes JCB qe ploteson kriterin teknik dhe nuk perben kusht per skualifkim sipas nenit 15 te ligjit nr. 182/2014 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "për prokurimin publik", të ndryshuar. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj

NDËRTIM I LINJËS SË UJËSJELLËSIT DEPO THARRESE NË FSHATIN MURSI
KLSH: Nga auditimi mbi dokumentacionin e paraqitur nga OE "A...S " sh.p.k shpk u konstatua se:
-Subjekti "A...S" shpk me seli në Tirane , sipas ekstraktit të paraqitur ka pasur si vend të zhvillimit të aktivitetit edhe adresa të tjera në të cilat ka hapur NIPT sekondar dhe konkretisht: Bashkine Kukes. Vërtetimi për pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për Bashkine Kukes nuk është paraqitur.
KVO: Subjekti "A...S" ka pasur adrese sekondare ne Bashkine Kukes dhe ne 16.01.2014 ka aplikuar ne QKR per mbyllje te adreses sekondare. Kjo do te thote qe detyrimi per vitin 2014 ne konsideraten tone si KVO eshte shume i vogel dhe mosparaqitja e vertetimit per detyrimet per kete vit nuk perben kusht per skualifikim sipas nenit 15 te ligjit nr. 182/2014 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "për prokurimin publik", të ndryshuar. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.".
Pra nuk eshte konsideruar si kusht per skualifkim detyrimi per 15 dite te fillimvitit qe mund te mos jete maturuar si detyrim nga pakaeta fiskale e bashkise Kukes.
KLSH: Nga auditimi i dokumentacionit i OE "A...S"SHPK rezulton se asnjë kontrate e paraqitur nga kjo OE nuk ka si natyre objektin e prokurimit.
Banese 4 kat me podrum dhe nencati, Vila 2 dhe 3 kate me podrum dhe nencati, Godine banimi 3 kat me 2 kat bodrum, Godine Banimi 2,3,4 kate + nencati me 1 kat nentoke, Godine banimi 2 dhe 5 kate me podrum etj.
KVO: Sipas VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, pika 6:

Për të provuar përvojëne mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:
a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.
b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.
Ne rastin konkret shoqeria "A...S" ka paraqitur si pune te ngjashme ndertimin e kompleksit rezidencial Kodra e Diellit me pjeset perberese te tij me rreth 400 apartamente dhe vila nderkohe qe rikonstruksioni I ujesjellesit Konispol perfshin nje rrjet me rreth 600 piklidhje. Ne situacionet e paraqitura nga subjekti dhe nga akt kolaudimet perkatese perfshihen ne volume dhe ne vleren perkatese dhe zerat e preventivit objekt prokurimi, si punime germimi, punime shtresash, punime hidraulike, sistemi i kanalizimeve, pompa etj, krahasimisht të ngjashme, të krahasueshme në volume dhe në zëra konkretë punimesh.
Pika 6 e ketij vendimi nuk kërkon detyrimisht që të jenë të njëjta, por të ngjashme.

NDËRHYRJE EMERGJENTE NË ARGJINATURËN E LUMIT PAVËLL
KLSH: Nga auditimi i dosjes fizike të procedurë, dosje e cila rezulton ende e pa inventarizuar, konstatohet se OE nuk plotëson këtë kriter.
Nga OE është paraqitur si punë e ngjashme "Kontratë punë civile ndërtimi I shkollës 9 vjecare Shtrazë, Gjepalaj", lidhur më datë 10.08.2016, ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Shijak dhe BOE "V...T" shpk dhe "R...I" shpk, për vlerën 38,454,452 lekë, ose 46,145,342 lekë me tvsh.
KVO: Operatori ka sjelle si pune te ngashme ne nje kontrate te vetme "Ndërtimi I shkollës 9 vjecare Shtrazë, Gjepalaj" me nje vlere prej 16,531,250 lek qe eshte me shume se 50 % e fondit limit (28618375x 50% = 14309188)
KLSH: Lidhur me kriteret teknike të kërkuara nga NJP në DST rezulton se Lidhur me kriterin e përcaktuar në DST, nga AK, kreu II "Kritere të vecanta të kualifikimit", pika 1.4 "Kapaciteti teknik": "Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën IS) 9001:2008, ISO 14001:2004, ISO 19001:2007 dhe ISO 39001-2012….", nga auditimi i dosjes fizike të procedurës, konstatohet se OE nuk plotëson këtë kriter, për pikën ISO 9001:2008. Sipas dokumentit të paraqitur nga OE është për Sistemin e Menaxhimit të CIlësisë EN ISO 9001:2008, dhe nuk përkon me punimet e ndërtimit, por sipas përshkrimit të dokumentit certifikata është lëshuar për "Tregtim me shumicë dhe Pakicë I produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore.
KVO: certifikata iso 9001;2008 eshte leshuar me 09.02.2016 me objekt "Tregtim me shumicë dhe Pakicë I produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazore"
Certifikata ISO leshohen me objekt sipas objektit te QKR dhe ne QKR – ne perkatese objekti eshte :
Duke pare veprimet kronologjike te ceshtjeve ne QKR duket se operatori nuk e ka shtuar me vone se data 09.02.2016 objektin per ndertime civile e tregtare.
***Qëndrimi i grupit të auditimit:** - Lidhur me problematikën e konstatuar në vendosjen e kritereve të DST ka rezultuar se Njësia e Prokurimit në procesverbalin përkatës të miratimit të DST, nuk ka bërë argumentimin e vendosjes së kritereve mbi kapacitetet teknike, sipas kërkesave të pikës 2 të nenit 61 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, sipas të cilit këkrohet që çdo kriter i vendosur të argumentohet, si dhe pikës 1 të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, ku kërkohet që kritert e kualifikimit të jenë në "përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodsikriminuese/përjashtuese". Në këto kushte kundërshtimet e bëra nga ana juaj nuk merren në konsideratë.*
Lidhur me procedurat për të cilat KVO ka shpallur fitues OE apo BOE të cilat nga grupi i auditimit janë konsideruar si vlerësime të bëra në kushtet e mungesës së dokumentacionit e për

rrjedhojë në mos plotësim të DST, bazuar në dokumentacionin bashkëlidhur, kundërshtimet e bëra, të shoqëruar edhe me referenca të marra nga APP, për procedurat e prokurimit "Rehabilitim i infrastrukturës vaditëse Sherret Rraha" dhe "Rikonstruksion i kanalit furnizues v55 në fushë Vrinë" dhe "Rikonstruksion + ndertim i palestres se shkolles «Bido Sejko» Konispol", janë marrë parasysh duke mos u bërë pjesë e raportit përfundimtar të auditimit. Për sa i përket praktikave të tjera të trajtuara me shkelje apo parregullsi, në asnjë rast KVO nuk ka evidentuar mungesën e tyre, duke mos i trajtuar si devijime të vogla, por ka vlerësuar dokumentacionin e ngarkuar në sistem nga secili OE duke e konsideruar si të plotë e të rregullt. Lidhur me praktikat e konstatuar se OE kanë paraqitur punë të ngjashme të realizuara në NJQV në të cilat nuk kanë qenë të regjistruar në QKR dhe nga ana juaj është kërkuar vërtetim për shlyerje të detyrimeve vendore, dhe se nuk përbën shkak për skualifikim, qëndrimi i grupit të auditimit është po i njëjti me atë të bëë gjatë trajtimit rast pas rast, pra ku KVO mund ti kishte kualifikuar ato vetëm pas konstatimit dhe trajtimit të tyre si raste të vlërësuara si devijime të vogla, për sa nuk është në përgjegjësinë e KVO regjistrimi me NIPT sekondar e OE në ato vende ku ushtrojnë potësisht apo pjesërisht aktivitetin e tyre ekonomik

<u>Nga auditimi për Hartimi, zbatimi i kontratave për punë publike.</u>

I. Zbatimi i kontratës "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat" Konispol.

Objekti i këtij akt verifikimi është:
Auditimi i zbatimit të punimeve sipas kontratës me objekt "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat" Bashkia Konispol.

Nga verifikimi rezultoi që:
Gjetje 1. Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor **Bashkisë Konispol** dhe shoqërisë "**A...S**" shpk me përfaqësues z. A.Ç., u konstatua se janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume zëra punimesh në shumën **2,692,562 lekë me TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar.

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor mbi zbatimin e punimeve civile të kontratës me objekt **"**Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat", Konispol, u konstatua se në dosje nuk ka leje ndërtimi për zbatimin e objektit "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat", veprim ky në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" pika 4 ku citohet se: *" ... Për çdo objekt që ndërtohet, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve administrojnë në kantier dokumentacionin teknik të mëposhtëm:*
a) lejen e ndërtimit, së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi, i cili e ka këtë të drejtë".

a. Mbi nënshkrimin e kontratës dhe realizimin e grafikut të punimeve.
Kontrata e sipërmarrjes me objekt "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat", Bashkia Konispol, është lidhur me datë 24.07.2017 dhe nr. prot. 838, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Konispol, përfaqësuar nga z. SH.B. dhe nga Kontraktuesi shoqëria **"A...S" shpk,** përfaqësuar nga administratori z. A.Ç. Vlera e kontratës është 27,530,784 lekë me TVSH. Sigurimi i kontratës në masën 10 % ose në vlerën 2,753,078 lekë .
Afati maksimal i realizimit të punimeve do të jetë 45 ditë pune nga data e lidhjes së kontratës.
- Për shërbimin e mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat", Bashkia Konispol është lidhur kontratë mbikëqyrje me datë 16.08.2017 dhe nr.

prot. 937 midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Konispol, përfaqësuar nga z. SH.B. dhe Operatorit Ekonomik "Z...6" sh.p.k, përfaqësuar nga z. R.T. me nr. licence MK 1208/8, datë 21.12.2015 dhe me vlerë 474,000 lekë me TVSH.

- Për shërbimin e kolaudimit të punimeve të kontratës me "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat", Bashkia Konispol është lidhur kontratë mbikëqyrje me datë 25.10.2017 dhe nr. prot. 1210 midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Konispol, përfaqësuar nga z. SH.B. dhe Operatorit Ekonomik "T...t" sh.p.k, përfaqësuar nga Ing. D.Q.

Me përfundimin e punimeve me datë 29.09.2017 sipërmarrësi shoqëria "A...S" sh.p.k përfaqësuar nga administratori z. A.Ç. dhe drejtuesi teknik ing. R.Thanasi, kanë bërë deklaratën teknike dhe kanë mbajtur procesverbalin mbi përfundimin e punimeve të ndërtimit.

- Në 29.09.2017 është mbajtur Dokumenti "Çertifikatë e marrjes në dorëzim e përkohshme" për objektin "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat", Bashkia Konispol me deklarimin se objekti është i gatshëm për shfrytëzim të plotë dhe se grupi i marrjes në dorëzim e konsideron objektin të përfunduar dhe e merr në dorëzim. Procesverbali i marrjes në dorëzim, është nënshkruar nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria "A...S" sh.p.k përfaqësuar nga z. A.Ç. dhe drejtuesi teknik ing. R.Th. nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria "Z...6" sh.p.k përfaqësuar nga ing. R.T. nga Kolaudatori shoqëria "T...t" sh.p.k., përfaqësuar nga Ing. D.Q. si dhe nga Bashkia e Konispolit, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë.

b. Nga auditimi mbi likuidimet rezulton.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se punimet e projektit të kontratës bazë janë pasyruar në situacionet në vlerën 26,154,245 lekë me TVSH ose në masën 99.9 99 % dhe është ndaluar 5 % garanci punimesh në vlerën 1,376,539 lekë, të detajuara si më poshtë vijon:

Situacionet	Vlera e situacionit (lekë)	Vlera e Likuiduar	Vlera e palikuiduar
Situacioni nr. 1	24,330,245	24,330,245	-
Situacioni nr. 2	1,824,000	1,824,000	
Garanci punimesh			1,376,539
Shuma	26,154,245	26,154,245	1,376,539

Janë likuiduar nga autoriteti kontraktor vlerën 5,320,000 lekë.

c. Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera deri në momentin e auditimit, rezultojnë diferenca për punime të pakryera në vlerën prej **2,692,562 lekë me TVSH.**

Argumentimi i kësaj diference në volum punimesh, pasqyrohet si vijon:

Rrjeti shpërndarës nga Depo 100 m^3 në fshatin Ninat.

Zëri 2. 2.47/an Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator.

Preventivi bazë dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë volumin 1,161 m^3 gërmim shkëmbi gjithsej [678 m^3 të preventivit bazë + 483 m^3 shtesë të miratuar nga AK] me çmim 1390 lekë.

Nga auditimi i librezës së masave rezulton se janë realizuar 1,161 m^3 gërmim shkëmbi. Në fakt nga përllogaritja e bërë për gjatësinë totale të tubave 1144 ml tuba [PE Ø110 mm me l= 280 ml dhe PE, Ø=90mm me l = 864 ml] nga grupi i auditimit rezulton se janë realizuar 1,121 m^3 dhe jo 1,161 m^3, sepse në realizimin e zërit "hedhje, rrafshim, mbushje dheu" është marrë thellësia 100 cm + 20 cm shtresë zhavorri + 20 cm shtresë rëre, pra rezulton se thellësia e gërmimit është 140 cm dhe jo 150 cm siç jepet në librezën e masave.

Sa më sipër diferenca në volumin prej 40 m^3 është situacionuar dhe përfituar më tepër nga sipërmarrësi i punimeve ose në vlerën **55,720 lekë** [40 m^3 x 1390 lekë x 1.2 (20% TVSH)].

Zëri 4. 3.182/c Shtresë rëre natyrore t= 20 cm (mbushje kanali).
Preventivi i ndryshuar pasqyron volumin 1,144 m^2 shtresë rëre gjithsej [892 m^2 shtresë rëre të preventivit bazë + 252 m^2 shtesë rëre të miratuar nga AK] me çmim 400 lekë.
Situacioni përfundimtar, pasqyron 1,144 m^2 shtresë rëre. Nga auditimi i librezës së masave rezulton se janë realizuar 1,144 m^2 shtresë rëre. Në fakt nga përllogaritja e bërë nga grupi i auditimit rezulton se janë realizuar 800 m^2 shtresë rëre [1,144 ml tubacion x 0.7 m gjerësia e kanalit] dhe jo 1,144 m^2.
Sa më sipër diferenca prej 344 m^2 shtresë rëre [1,144 m^2 sipas librezës – 800 m^2 sipas përllogaritjes] është situacionuar dhe përfituar më tepër nga sipërmarrësi i punimeve ose në vlerën **137,600 lekë** [344 m^2 x 400 lekë].

Zëri 5. 3.183/c Shtresë zhavorr lumi t= 20 cm (mbushje kanali).
Preventivi pasqyron 892 m^2 shtresë zhavorri gjithsej, me çmim 160 lekë.
Situacioni përfundimtar, pasqyron 892 m^2 shtresë zhavorri. Nga auditimi i librezës së masave rezulton se janë realizuar 892 m^2 shtresë zhavorri. Në fakt nga përllogaritja e bërë nga grupi i auditimit rezulton se janë realizuar 800 m^2 shtresë rëre [1144 ml tubacion x 0.7 m gjerësia e kanalit] dhe jo 892 m^2.
Sa më sipër diferenca prej 92 m^2 shtresë zhavorri [892 m^2 sipas librezës – 800 m^2 sipas përllogaritjes] është situacionuar dhe përfituar më tepër nga sipërmarrësi i punimeve ose në vlerën **14,720 lekë** [92 m^2 x 160 lekë].

LINJA SEKONDARE SHPËRNDARËSE.
Zëri 2. 2.47/an Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me eskavator.
Preventivi i ndryshuar 7280.943 m^3 gërmim shkëmbi gjithsej [678.5 m^3 të preventivit bazë + 689.36 m3 punime që shtohen, të miratuar nga AK] me çmim 1390 lekë.
Situacioni përfundimtar, pasqyron 7,280 m^3 gërmim shkëmbi.

a) **Përllogaritja e gërmimit për tub PE d= 50 cm, l = 425 ml + tub PE d=40cm, l = 522 ml.**
Nga auditimi i librezës së masave rezulton se janë realizuar 7,280 m^3 gërmim shkëmbi. Në fakt nga përllogaritja e bërë nga grupi i auditimit rezulton se janë realizuar 795 m^3 [947 ml tubacion (PE d= 50 cm + PE d=40cm) x 0.7 m gjerësia e kanalit x 1.2 m thellësia e gërmimit] sepse në realizimin e zërit "hedhje, rrafshim, mbushje dheu" është marrë thellësia 80 cm + 20 cm shtresë zhavorri + 20 cm shtresë rëre, pra rezulton se thellësia e gërmimit është 120 cm dhe jo 150 cm siç jepet në librezën e masave.
b) **Përllogaritja e gërmimit për PE d= 25 mm, l = 540 ml + PE d=20 mm, l = 6784 ml.**
Nga përllogaritja e bërë nga grupi i auditimit rezulton se janë realizuar 5127 m^3 [7324 ml tubacion (PE d= 25 mm, l = 540 ml + PE d=20 mm, l = 6784 ml) x 0.7 m gjerësia e kanalit x 1 m thellësia e gërmimit]. Sa më sipër nga sipërmarrësi janë realizuar 5922 m^3 gërmim (795 m^3 + 5127 m^3) dhe jo 7280 m^3 siç është librezuar dhe situacionuar.
Sa më sipër diferenca prej 1358 m^3 (7280 m3 – 5922 m3 nga përllogaritja) është situacionuar dhe përfituar më tepër nga sipërmarrësi i punimeve, ose në vlerën **1,887,620 lekë** [1358 m^3 x 1390 lekë].
Nga kontrolli në objekt mbi zbatimin e punimeve për zërin F.V Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d = 25 mm dhe zërin F.V Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d = 20 mm, punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar sipas projektit të zbatimit dhe kushteve teknike. Në projektin e zbatimit të azhurnuar konstatohet se tubat PE me d=20 mm dhe d=25 mm, nuk janë pasqyruar fare dhe sistemi i linjës së shpërndarjes dhe rrjeti përfundon deri tek pusetat e shpërndarjes; P20/3; P3/9; P17/4; P4/9;P18/5; P19/4; P16/3; P12/5; P13/4; P14/7; P15/5; P1/5; P7/9; P8/7; P9/4; P10/3; P11/6; P2/3; P5/5. Në disa raste, tubat PE me d=20 mm dhe d=25 mm u konstatuan se ishin në sipërfaqe.

Zëri 3. 2.19/a Hedhje, rrafshim, mbushje dheu kat IV.

Preventivi i ndryshuar 4280 m^3 mbushje kanali gjithsej.
Situacioni përfundimtar, pasqyron 4280 m^3 mbushje kanali.

a) **Përllogaritja e mbushjes për tub PE d= 50 cm, l = 425 ml + tub PE d=40cm, l = 522 ml.**
Nga auditimi i librezës së masave rezulton se janë realizuar 7,280 m^3 gërmim shkëmbi. Në fakt nga përllogaritja e bërë nga grupi i auditimit rezulton se janë realizuar 530 m^3 [947 ml tubacion (PE d= 50 cm + PE d=40cm) x 0.7 m gjerësia e kanalit x 0.8 m thellësia e gërmimit] sepse në realizimin e zërit "hedhje, rrafshim, mbushje dheu" është marrë thellësia 80 cm + 20 cm shtresë zhavorri + 20 cm shtresë rëre, pra rezulton se thellësia e mbushjes së kanalit është 80 cm(kjo e konstatuar në objekt).
b) **Përllogaritja e mbushjes për tub PE d= 25 mm, l = 540 ml + tub PE d=20 mm, l = 6784 ml.**
Nga përllogaritja e bërë nga grupi i auditimit rezulton se janë realizuar 5127 m^3 [7324 ml tubacion (PE d= 25 mm, l = 540 ml + PE d=20 mm, l = 6784 ml) x 0.7 m gjerësia e kanalit x 0.6 m thellësia e gërmimit, kjo e konstatuar nga auditimi në objekt].
Sa më sipër nga sipërmarrësi janë realizuar 3606 m3 gërmim (530 m^3 + 3076 m^3) dhe jo 7280 m^3 mbushje kanali siç është librezuar dhe situacionuar.
Sa më sipër diferenca prej 1358 m^3 (4280 m^3 sipas situacionit – 3606 m^3 nga përllogaritja sipas faktit në terren) është situacionuar dhe përfituar më tepër nga sipërmarrësi i punimeve, ose në vlerën **148,262 lekë** [679 m^3 x 220 lekë].

Si përfundim ngau auditimi rezulton se:
1. Vlera **2,692,562 lekë me TVSH** është shkelje financiare me dëm efektiv ndaj buxhetit të Bashkisë dhe duhet të zhdëmtohet nga shoqëria "A...S" SHPK me përfaqësues z. A.Ç.
Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve.
2. Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor, u konstatua se në dosje nuk ka leje ndërtimi për zbatimin e objektit "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat", bashkia Konispol, veprim ky në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" pika 4 ku citohet se: *" ... Për çdo objekt që ndërtohet, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve administrojnë në kantier dokumentacionin teknik të mëposhtëm:*
a) lejen e ndërtimit, së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi, i cili e ka këtë të drejtë".

Komente nga subjekti i audituar: *Sipërmarrësi i punimeve shoqëria "A...S" SHPK përfaqësuar nga z. A.Ç. në observacionin me nr. 672/1 prot., datë 30.05.2018, administruar nga KLSH me nr. 276/3, datë 05.06.2018, pretendon se konstatimet e bëra nga grupi i auditimit nuk qëndrojnë për zërat e punimeve në rrjetin shpërndarës nga Depo 100 m3 në fshatin Ninat dhe konkretisht: 2.47/an Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator; 3.182/c Shtresë rëre natyrore t= 20 cm (mbushje kanali); 3.183/c Shtresë zhavorr lumi t= 20 cm (mbushje kanali) si dhe zërat në linjën sekondare shpërndarëse: 2.47/an Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me eskavator; Zëri 3. 2.19/a Hedhje, rrafshim, mbushje dheu kat IV.*
Qëndrimi i grupit të auditimit: *- Lidhur me problematikën e konstatuar për zërin, "2.47/an Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator" ritheksojmë edhe një herë se diferenca prej 40 m^3 ka ardhur nga mos gërmimi në thellësinë 150 cm siç jepet në librezën e masave. Pra keni gërmuar në thellësinë 140 cm dhe ky fakt është konstatuar nga auditimi në terren i realizimit të punimeve.*
- Lidhur me problematikën e konstatuar për zërin, "3.182/c Shtresë rëre natyrore t= 20 cm (mbushje kanali)" zbatuesi i punimeve e argumenton thjeshtë duke mbledhur sipërfaqen sipas ofertës 892 m^2 me sipërfaqen e shtuar 252 m^2 të miratuar më procesverbal nga investitori. Në fakt nuk është kështu sepse llogaritja e sipërfaqes së rërës bëhet në funksion të gjatësisë 1144 ml tubacion, ku nga përllogaritja e bërë nga grupi i auditimit rezulton se janë realizuar 800 m^2

shtresë rëre [1,144 ml tubacion x 0.7 m gjerësia e kanalit] dhe jo 1,144 m^2. Argumenti i paraqitur nga Ju nuk qëndron dhe nuk mund të merret në konsideratë,
- Lidhur me problematikën e konstatuar për zërin, "3.183/c Shtresë zhavorr lumi t= 20 cm (mbushje kanali)" argumentoni thjeshtë duke bërë veprimet 1144 ml x 0.8 m. Në fakt nuk është kështu sepse llogaritja e shtresës së zhavorrit me trashësi 20 cm bëhet në funksion të gjatësisë 1144 ml tubacion dhe gjerësisë mesatare 70 cm (referuar librezës së masave dhe projektit të zbatimit) dhe nga përllogaritja e bërë nga grupi i auditimit rezulton se janë realizuar 800 m^2 shtresë zhavorri [1,144 ml tubacion x 0.7 m gjerësia mesatare] dhe jo 892 m^2. Argumenti i paraqitur nga Ju nuk qëndron dhe nuk mund të merret në konsideratë.
- Lidhur me problematikën e konstatuar për zërin, "2.47/an Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me eskavator" shpjegoni se, zona ku shtrihen linjat ka një disnivel të konsiderushëm kuotash dhe në gërmim shkëmbi mesatar përfshihet hapje e trasesë + hapje e kanalit për shtrim linjash furnizimi dhe se shoqëria ka pasqyruar vetëm gërmimin në gjurmën e linjave siç jepet në profilin gjatësor të projektit të zbatimit. Në fakt nuk është kështu sepse po ti referohemi librezës së masave thellësia e gërmimit është marrë 120 cm dhe jo 150 cm dhe kjo duket shumë qartë në realizimin e zërit "Hedhje, rrafshim, mbushje dheu" ku është marrë thellësia 80 cm + 20 cm shtresë zhavorri + 20 cm shtresë rëre.
Pra thjeshtë keni bërë një shpjegim dhe nuk keni sjellë argument për të marrë në konsideratë observacionin tuaj. Ky veprim është në kundërshtim me UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: "Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit".
- Lidhur me problematikën e konstatuar për zërin, "2.19/a Hedhje, rrafshim, mbushje dheu kat IV" ju nuk jeni shprehur mbi ndryshimin e seksionit therthor të gërmimit, ndryshim i cili ka shkaktuar efekt negativ në realizimin e këtij zëri punimesh "Hedhje, rrafshim, mbushje dheu kat IV". Për shkak të ndryshimit të seksionit në gërmim rezultojnë 1358 m^3 të cilat janë librezuar dhe situacionuar më tepër nga zbatuesi i punimeve.
Për sa më sipër trajtuar grupi i auditimit nuk merr në konsideratë shpjegimet e paraqitura në observacion, prandaj nuk i qëndron konkluzioneve të trajtuara në këtë Raport përfundimtar.
- Gjithashtu ju kujtojmë se, nga kontrolli në objekt mbi zbatimin e punimeve për zërin F.V Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d = 25 mm dhe zërin F.V Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d = 20 mm, punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar sipas projektit të zbatimit dhe kushteve teknike. Në projektin e zbatimit të azhurnuar konstatohet se tubat PE me d=20 mm dhe d=25 mm, nuk janë pasqyruar fare dhe sistemi i linjës së shpërndarjes dhe rrjeti përfundon deri tek pusetat e shpërndarjes; P20/3; P3/9; P17/4; P4/9;P18/5; P19/4; P16/3; P12/5; P13/4; P14/7; P15/5; P1/5; P7/9; P8/7; P9/4; P10/3; P11/6; P2/3; P5/5. Në disa raste, tubat PE me d=20 mm dhe d=25 mm u konstatuan se ishin në sipërfaqe. Lidhur sa sipër trajtuar, nuk jeni shprehur fare në observacion dhe nuk keni paraqitur projektin e ndryshuar dhe te miratuar nga AK.

II. Zbatimi i kontratës "Ndërhyrje emergjente në argjinaturën pranë lumit Pavell", Bashkia Konispol.

Objekti i këtij akt verifikimi është:

Auditimi i zbatimit të punimeve sipas kontratës me objekt "Ndërhyrje emergjente në argjinaturën pranë lumit Pavell".

Nga verifikimi rezultoi që:

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor mbi zbatimin e punimeve civile të kontratës me objekt "Ndërhyrje emergjente në argjinaturën pranë lumit Pavell" Konispol, u konstatua se në

dosje nuk ka leje zhvillimore/ndërtimi për zbatimin e objektit "Ndërhyrje emergjente në argjinaturën pranë lumit Pavell", veprim ky në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" pika 4 ku citohet se: *" ... Për çdo objekt që ndërtohet, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve administrojnë në kantier dokumentacionin teknik të mëposhtëm:*
a) lejen e ndërtimit, së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi, i cili e ka këtë të drejtë".
Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit u konstatuan këto defekte:
- Në segmentin rrugor ndërmjet seksionit 8 dhe seksionit 9, u konstatuan se është dëmtuar shtresa e binderit me sipërfaqe 13.5 m^2 si dhe shtresa e asfaltobetonit me sipërfaqe 13.5 m^2.
- Në segmentin rrugor ndërmjet nga kryqëzimi i rrugës deri te kombino 1, u konstatua se bankina me gjatësi 22 ml dhe gjerësi 100 cm nuk është e mbushur me shtresë stabilizanti.

a. Mbi nënshkrimin e kontratës dhe realizimin e grafikut të punimeve.
Kontrata e sipërmarrjes me objekt "Ndërhyrje emergjente në argjinaturën pranë lumit Pavell", bashkia Konispol, është lidhur me datë 10.05.2017 dhe nr. prot. 457, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Konispol, përfaqësuar nga z. SH.B. dhe nga Kontraktuesi shoqëria **"E...I" shpk,** përfaqësuar nga administratori z. I.M. Vlera e kontratës është 28,599,649 lekë me TVSH. Sigurimi i kontratës në masën 10 % ose në vlerën 2,859,965 lekë.
Afati maksimal i realizimit të punimeve do të jetë 50 kalendarike nga data e dorëzimit të kantierit të ndërtimit.
-Për shërbimin e mbikëqyrjes të punimeve të kontratës Ndërhyrje emergjente në argjinaturën pranë lumit Pavell", Bashkia Konispol është lidhur kontratë mbikëqyrje me datë 09.05.2017 dhe nr. prot. 453 midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Konispol, përfaqësuar nga z. SH.B. dhe Operatorit Ekonomik "XH& M..." sh.p.k, përfaqësuar nga znj. Xh.D. me nr. licence MK 1322/5/8, datë 21.12.2015 dhe me vlerë 474,000 lekë me TVSH.
- Punimet e ndërtimit kanë filluar me datë 10.05.2017 dhe kanë përfunduar me datë 28.06.2017.
- Për shërbimin e kolaudimit të punimeve të kontratës me "Ndërhyrje emergjente në argjinaturën pranë lumit Pavell", Bashkia Konispol është lidhur kontratë mbikëqyrje me midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Konispol, përfaqësuar nga z. SH.B. dhe Operatorit Ekonomik "B...4" sh.p.k, përfaqësuar nga Ing. E.B.
- Në datë 30.06.2017 është mbajtur Dokumenti "Akt Kolaudimi" për objektin "Ndërhyrje emergjente në argjinaturën pranë lumit Pavell", bashkia Konispol me deklarimin se punimet kanë përfunduar dhe janë zbatuar sipas projektit të zbatimit.
- Në datë 03.07.2017 dhe nr. prot. 717 është mbajtur Dokumenti "Çertifikatë e marrjes në dorëzim e përkohshme" për objektin "Ndërhyrje emergjente në argjinaturën pranë lumit Pavell", bashkia Konispol me deklarimin se objekti është i gatshëm për shfrytëzim të plotë dhe se grupi i marrjes në dorëzim e konsideron objektin të përfunduar dhe e merr në dorëzim. Procesverbali i marrjes në dorëzim, është nënshkruar nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria "EGLENTI" sh.p.k përfaqësuar nga z. I.M. dhe drejtuesi teknik ing. Vilma KATAROSHI, nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria "XH.&M." sh.p.k përfaqësuar nga ing. Xh.D., nga Kolaudatori shoqëria "B...4" sh.p.k., përfaqësuar nga Ing. E.B. si dhe nga Bashkia e Konispolit, përfaqësuar nga Kryetari Konispol.
b. Nga auditimi mbi likuidimet rezulton.
Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se punimet e projektit të kontratës janë situacionuar në vlerën 28,598,65 lekë me TVSH.

Si përfundim nga auditimi rezulton se:
1. Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor, u konstatua se në dosje nuk ka leje ndërtimi për zbatimin e objektit "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat", bashkia Konispol, veprim ky në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin

e punimeve të ndërtimit" pika 4 ku citohet se: *" ... Për çdo objekt që ndërtohet, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve administrojnë në kantier dokumentacionin teknik të mëposhtëm:*
a) lejen e ndërtimit, së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi, i cili e ka këtë të drejtë".
2. Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit u konstatuan këto defekte:
- Në segmentin rrugor ndërmjet seksionit 8 dhe seksionit 9, u konstatuan se është dëmtuar shtresa e binderit me sipërfaqe 13.5 m^2 si dhe shtresa e asfaltobetonit me sipërfaqe 13.5 m^2.
- Në segmentin rrugor ndërmjet nga kryqëzimi i rrugës deri te kombino 1, u konstatua se bankina me gjatësi 22 ml dhe gjerësi 100 cm nuk është e mbushur me shtresë stabilizanti.

D. Mbi administrimin e aseteve, procedurën e dhënies me qira të aseteve të qëndrueshme në varësi të bashkisë dhe shitja e trojeve publike.
1.1. Menaxhimi i aseteve, identifikimi i gjendjes fizike, teknike dhe juridike për përdorimin e vënien në eficencë për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë të tyre nga bashkia në plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave nga përdorimi i tyre.
1.2. Ligjshmëria dhe rregullariteti i veprimeve të kryera me asetet e qëndrueshme. Administrimi, marrja në dorëzim, dokumentacioni përkatës, hartat etj, mbikëqyrja nga bashkia e aseteve në varësi të saj, kontrollet e ushtruara, konstatimet, masat e marra. Inventarizimi dhe krijimi i regjistrit/data base të aseteve të bashkisë, auditimi i ndryshimeve të kryera në asete (dhënie me qira, shitje troje etj). Nxjerrja jashtë përdorimit e aseteve.
1.3. Auditimi i procedurave të dhënies me qira të aseteve të bashkisë apo njësive administrative. Lidhja e kontratave dhe zbatimi i tyre. Analizë e të ardhurave nga qiraja dhe përdorimi i tyre.
1.4. Auditimi mbi menaxhimin dhe administrimin e objekte ndërtimore, social kulturore, objektet me funksion ekonomik, infrastrukturor, mbrojtës, toka bujqësore e pandarë, rrugët e brendshme, objekte të ndërtuara, si dhe resurse natyrore të çdo lloji. Verifikimi i statusit juridik të tyre, regjistrimi në ZVRPP, administrimi i trojeve dhe shesheve publike të zëna nga ndërtimet pa leje, procedurat e ndjekura për vlerësimin dhe shitjen e tyre (nëse janë kryer).
1.5. Vlerësimi i nivelit të kontrollit të territorit bazuar në organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).
1.6. Zbatimi i procedurave ligjore për dhënien me qira dhe arkëtimin e vlerës qirave të tokave shtetërore bujqësore te pandara, që nga data e lidhjes së kontratave.
<u>1.1. Menaxhimi i aseteve, identifikimi i gjendjes fizike, teknike dhe juridike për përdorimin e vënien në eficencë për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë të tyre nga bashkia në plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave nga përdorimi i tyre.</u>
<u>*Për administrimin e aseteve të Bashkisë Konispol.*</u>
Në lidhje me menaxhimin e aseteve, identifikimi i gjendjes fizike, teknike dhe juridike për përdorimin e vënien në eficencë për krijimin e të mirave publike, administrimin e plotë të tyre nga bashkia në plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave nga përdorimi i tyre, në zbatim të Ligjit nr.8744, datë 22.02.2011 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar; Ligjit nr.33/2012, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme"; të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", të Udhëzimit nr. 3, datë 18.07.2002 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore" për periudhën 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017, rezulton sa më poshtë vijon:
Nga auditimi i dokumenteve të paraqitur nga specialistët e Bashkisë dhe evidenca e paraqitur për qëllim të auditimit rezulton se në Bashkinë Konispol, për llogari të ish-Bashkisë Konispol, ekzistojnë Vendime të Këshillit të Ministrave përkatësisht:
VKM nr.113, datë 13.02.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, të paluajtshme publike, shtetërore në pronësi ose në përdorim të Bashkiasë Konispol të qarkut të Vlorës", të cilët trajtojnë pronat publike, shtetërore që transferohen në pronësi të ish-Bashkisë Konispol.

Në këtë VKM është miratuar, lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Konispol të qarkut të Vlorës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie. Sipas lidhjes nr. 1, numrat rendorë të pronave në listën e inventarit, fusha e përdorimit të pronës dhe lloji i transferimit, paraqiten si në vijim:

Nr.1 (vetëm pronën e bashkisë) Prona që përdoren për realizimin e funksioneve të administratës në pronësi

Nr.5-10 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e arsimit, në pronësi

Nr.11, 12 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik, në pronësi

Nr.13-14 Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive, në pronësi

Nr.23-26 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit funeral, në pronësi

Nr.27-71, 99-104, 362-364, 470-716 Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike), në pronësi

Nr.105-108, 140-361 Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim

Nr.365-371 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civilen, në pronësi

Nr.469 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi

VKM nr.433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive". Në këtë VKM në pikën nr.60 janë përcaktuar sipërfaqet pyjore dhe kullosore, sipas listës së inventarit, që transferohen në pronësi të Bashkisë Konispol, e cila përmban listën e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 125 (njëqind e njëzet e pesë).

Në Bashkinë Konispol, për llogari të ish komunës Markat u paraqitën VKM për transferimin e pronave shtetërore nga njësitë e qeverisjes qendrore në atë të qeverisjes vendore ku rezulton:

Me VKM nr.892 datë 11.06.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që do të transferohen, në pronësi, të Njësisë së Qeverisjes Vendore, Komuna Markat, të Qarkut të Vlorës".

-Me VKM nr.1287 datë 23.12.2009 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Markat, të Qarkut të Vlorës". Në këtë VKM është miratuar, lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Markat të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi. Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Markat të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.576, datë 28.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Markat të qarkut të Vlorës". Sipas lidhjes nr.1, lloji i transferimit, paraqiten si në vijim:

Nr.96-102 Pyje dhe kullota, në pronësi

Nr.103-107 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve administrative, në pronësi

Nr.108-112 Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, në pronësi

Nr.113-118 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik, në pronësi

Nr.120-125 Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike, në pronësi

Nr.126-142 Prona që përdoren në fushën e kullimit dhe ujitjes, në pronësi

Nr.143-144 Prona që përdoren në fushën e bujqësisë, tokë bujqësore, në përdorim

Nr.144-157 Prona që përdoren në fushën e ujësjellës kanalizimeve, në pronësi

Nr.272-278 Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm, në pronësi

Nga auditimi i dokumentacionit për menaxhimin e aseteve, rezulton se nuk është krijuar dhe nuk funksionon si zyrë e veçantë, Zyra e Menaxhimit të Aseteve, e cila të kryejë inventarizimin,

vlerësimin, regjistrimin e tyre në ZVRPP, marrjen në dorëzim të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, dhënien e tyre me qira dhe regjistrimin e aseteve në bilancin kontabël sipas ligjit për kontabiliteti. Nuk janë çelur libra të veçanta sipas fushës së përdorimit. Nuk ka të dhëna për ndryshimet që kanë pësuar pronat, në zbatim me kërkesat e VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore". *Pika 9. Çdo institucion i pushtetit qendror dhe çdo njësi e qeverisjes vendore, në strukturën e administratës së vet, krijon, me miratimin e këshillit përkatës, një njësi të veçantë (zyrë ose sektor), me karakter të përkohshëm. Emërimi i personelit bëhet nga titullari i institucionit apo nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore. Seksioni apo zyra funksionon vetëm për kohën dhe problematikën e parashikuar në këtë vendim dhe përgjigjet përpara titullarit apo personit të autorizuar nga ai.*

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se Bashkia Konispol:

-Nuk ka krijuar dhe nuk funksionon si zyrë e veçantë, Zyra e Menaxhimit të Aseteve, e cila të kryejë inventarizimin, vlerësimin, regjistrimin e tyre në ZVRPP, marrjen në dorëzim të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, dhënien e tyre me qira dhe regjistrimin e aseteve në bilancin kontabël sipas ligjit për kontabiliteti. Nuk janë çelur libra të veçanta sipas fushës së përdorimit. Nuk ka të dhëna për ndryshimet që kanë pësuar pronat, në zbatim me kërkesat e VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore". *Pika 9.*

1.2. Ligjshmëria dhe rregullariteti i veprimeve të kryera me asetet e qëndrueshme. Administrimi, marrja në dorëzim, dokumentacioni përkatës, hartat etj, mbikëqyrja nga bashkia e aseteve në varësi të saj, kontrollet e ushtruara, konstatimet, masat e marra. Inventarizimi dhe krijimi i regjistrit/data base të aseteve të bashkisë, auditimi i ndryshimeve të kryera në asete (dhënie me qira, shitje troje etj). Nxjerrja jashtë përdorimit e aseteve.

Në lidhje me auditimin për marrjen në dorëzim të aseteve të përcaktuara dhe të transferuara për llogari të Bashkisë Konispol konstatohet se:

-Nga Bashkia Konispol nuk është vepruar për marrjen në dorëzim të aseteve të qëndrueshme me komision dhe me procesverbal të nënshkruar nga përfituesi Bashkia Konispol dhe nga institucionet qendrore si dorëzues të aseteve, institucione këto, në pronësi të të cilave kanë qenë pronat dhe asetet, sipas fushave përkatëse të përdorimit të pronës, arsim, shëndetësi, kulturë, sport, monumente historike e kulturore, funeral, strehim dhe mbrojtje civile, infrastrukturë, bujqësi e ushqim, ujësjellës, troje dhe hapësira publike, pyje kullota, për të cilat do të duhej të ishin shoqëruar me harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre, etj, sipas listave të VKM nr.113, datë 13.02.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, të paluajtshme publike, shtetërore në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Konispol të qarkut të Vlorës", të cilët trajtojnë pronat publike, shtetërore që transferohen në pronësi të ish-Bashkisë Konispol dhe të VKM nr.433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive." Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 500, datë 14.8.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap. III, pika 30.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se Bashkia Konispol ;

-Nuk ka vepruar për marrjen në dorëzim të aseteve të qëndrueshme me komision dhe me procesverbal të nënshkruar nga përfituesi Bashkia Konispol dhe nga institucionet qendrore si dorëzues të aseteve, institucione këto, në pronësi të të cilave kanë qenë pronat dhe asetet, sipas fushave përkatëse të përdorimit të pronës, arsim, shëndetësi, kulturë, sport, monumente historike e kulturore, shërbime publike, infrastrukturë, bujqësi e ushqim, ujësjellës, troje dhe hapësira publike, pyje kullota, për të cilat do të duhej të ishin shoqëruar me harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre, etj, sipas listave të VKM nr.113, datë 13.02.2013 dhe të VKM nr.433, datë 8.6.2016, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e

VKM nr. 500, datë 14.8.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" në VKM nr.433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive."pika 66 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap. III, pika 30,35/a.

1.3. Auditimi i procedurave të dhënies me qira të aseteve të bashkisë apo njësive administrative. Lidhja e kontratave dhe zbatimi i tyre. Analizë e të ardhurave nga qiraja dhe përdorimi i tyre.
Për dhënien me qira të pyjeve kullotave për antena të telefonisë celulare në territorin e Bashkisë Konispol.

Në auditimin e kryer për procedurat e dhënies me qira të objekteve pronë e bashkisë dhe e ndërmarrjeve shtetërore në varësi ose nën juridiksionin e bashkisë, në zbatim të VKM nr. 529, datë 8.6.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar, u auditua dokumentacioni për periudhën objekt auditimi. Gjatë auditivit të dokumentacionit të paraqitur nga punonjësit e bashkisë për dhënien me qira të pasurive të institucionit të qeverisjes vendore dhe konkretisht kontratat e qirave të lidhura midis Bashkisë Konispol dhe shoqërive private të telefonisë celulare si "V...A" sh.a, dhe të shoqërisë "A...C" (T.A...) sh.a, për periudhën objekt auditimi. Nga auditimi i kryer për mënyrën e lidhjes së kontratave, të përcaktimit të tarifave, të arkëtimit të detyrimeve nga dhënia e objekteve të ndryshme me qira rezulton se nga ana e Bashkisë Konispol dhe ish Komunës Markat sot Njësi Administrative e Bashkisë Konispol, janë lidhur 3 kontrata qiraje të cilat paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

Pasqyra e aseteve të dhëna me qira shoqërive të telefonisë celulare për periudhën 01.01.2016-31.12.2017.

Nr	Emri Shoqërisë	Vendndodhja	Data e lidhjes së kontratës	Afati	Sipërfaqja në m²	Detyrimi vjetor në lekë
1	"V...A..." sha	Konispol	06.05.2014	5 vjet	20	300,000
2	"A...C"(T...Albania) sha	Konispol	31.03.2014	5 vjet	200	400,000
3	"V... Albania" sha	Markat	02.02.2015	9 vjet	300	400,000

Në auditimin e kryer për procedurat e dhënies me qira të objekteve pronë e bashkisë që ndodhen në juridiksionin e bashkisë, në zbatim të VKM nr. 529, datë 8.6.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar, u auditua dokumentacioni për dhënien me qira e konkretisht kontratat e qirave të lidhura midis bashkisë dhe shoqërive të telefonisë celulare.

Në auditivin e kryer për aplikimin e tarifave në kontratat e lidhura midis Bashkisë Konispol dhe Kompanive private të telefonisë celulare sipas pasqyrës së mësipërme të kompanive private "Vodafon Albania" sh.a, dhe shoqërisë "A...C" (T...Albania) sh.a u konstatua se janë në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar.

Nga shoqëritë të telefonisë celulare "V...Albania" sh.a, "A...C" (T...Albania) sh.a u konstatua se arkëtimet janë kryer rregullisht dhe në masën 100%, për konratat e lidhura me Bashkinë Konispol për antenat ne territorin e saj respektivisht për sipërfaqet 20m² dhe 200 m² si dhe detyrimi i kontratës me vendndodhje në Markat për sipërfaqen 300 m².

Krahas sa më sipër u konstatua se:

Kontrata e qirasë me nr.123 Rep, nr.33/3 Kol, datë 02.02.2015 lidhur midis palëve, ish Komuna Markat përfaqësuar nga ish Kryetari i Komunës z.I...M... dhe Shoqërisë "V...A..." sha, me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe prej 300 m² të llojit "pyll prodhues". Kohëzgjatja e qirasë jepet me afat prej 9 vjetësh dhe i shtrin efektet juridike nga data 27.09.2010 deri në 26.09.2019. Vlera e qirasë vjetore për sipërfaqen e dhënë me qira është 400,000 lekë.
Në nenin 6 "Pagesa dhe regjimi i saj", pika 6.1. citohet:
Palët bien dakort që pagesat e qirasë për periudhën 27/9/2010-17/2/2014 do të mbahet pezull nga qiramarrësi dhe do ti kalohet qiradhënësit në një këst të vetëm, në përfundim të procesit gjyqësor kundër përfituesit për shkak ligjor, z.L.A. dhe kthimin e shumës së qirasë që ky i fundit ka përfituar në mënyrë të pa drejtë për periudhën kohore të mësipërme.
pika 6.3. citohet: Pagesa e qirasë për periudhën në vijim e deri në përfundim të kontratës do të kryhet në dy këste 6 (gjashtë) mujore të barabarta, brenda 21 ditëve pune nga data e fillimit të periudhë përkatëse në llogarinë bankare të qiradhënësit.
Pika 6.4: Për çdo pagesë qiradhënësi është i detyruar të lëshojë faturë për arkëtim dhe faturë të thjeshtë tatimore.
Konstatohet se nga Bashkia nuk është zbatuar arkëtuar, detyrimi financiar sipas nenit 6/1 të kontratës, për periudhën 27/9/2010-17/2/2014 ose 3 vjet, 4 muaj dhe 21 ditë. Nga përllogaritjet rezulton detyrimi për periudhën prej 3 vjet, 4 muaj dhe 21 ditë rezulton të jetë përkatësisht: (3 vjet x 400,000 + 4 muaj x (400,000/12 x 4 muaj) + 21 ditë (400,000/365 ditë x 21 ditë) = 1,356,330 lekë), me pasojë, dëm ekonomik në Buxhetin e Bashkisë në vlerën **1,356,330 lekë.**
Si përfundim konstatohet se:
-Nga Bashkia Konispol, nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratës së qirasë, për kontratat e lidhur midis Bashkisë Konispol, ish Komunës Markat dhe Kompanisë të telefonisë celulare, Vodafone sha, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar, kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", me pasojë, dëm ekonomik në Buxhetin e Bashkisë në vlerën **1,356,330 lekë.**
Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
-Nga Bashkia Konispol, nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratës së qirasë me nr.123 Rep, nr.33/3 Kol, datë 02.02.2015 nenet 6/1, për kontratën e lidhur midis ish Komunës Markat, sot Njësi Administrative e Bashkisë Konispol dhe Kompanisë të telefonisë celulare shoqërisë V...A... sha, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar, kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", me pasojë, dëm ekonomik në Buxhetin e Bashkisë në vlerën **1,356,330 lekë.**
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Z.SH.B. me detyrë, Kryetar i Bashkisë Konispol, për periudhën e gusht viti 2015–31.12.2017.
Znj.I.M. me detyrë, ish Kryetar i Komunës Markat, për periudhën e vitit 2013, vitit 2014 dhe Janar-Korrik të vitit 2015.

1.4. Auditimi mbi menaxhimin dhe administrimin e objekte ndërtimore, social kulturore, objektet me funksion ekonomik, infrastrukturor, mbrojtës, toka bujqësore e pandarë, rrugët e brendshme, objekte të ndërtuara, si dhe resurse natyrore të çdo lloji. Verifikimi i statusit juridik të tyre, regjistrimi në ZVRPP, administrimi i trojeve dhe shesheve publike të zëna nga ndërtimet pa leje, procedurat e ndjekura për vlerësimin dhe shitjen e tyre (nëse janë kryer).
Në lidhje me menaxhimin dhe administrimin e objekte ndërtimore, social kulturore, objektet me funksion ekonomik, infrastrukturor, mbrojtës, toka bujqësore e pandarë, rrugët e brendshme, objekte të ndërtuara, si dhe resurse natyrore të çdo lloji, verifikimi i statusit juridik të tyre, regjistrimi në ZVRPP, konstatohet se:

Sipas dokumenteve vënë në dispozicion nga specialisti i pyjeve dhe kullotave të Bashkisë, rezulton se gjatë vitit 2014 janë aplikuar dhe regjistruar në ZVRPP Sarandë 16 pasuri me sipërfaqe totale 3,844,855 m², të llojit Kullotë me vendndodhje në Konispol dhe 1 pasuri me sipërfaqe 110,000 m² me vendndodhje në fshatin Çiflik. Në total janë regjistruar 17 pasuri me sipërfaqe 3,954,855 m² të llojit Kullotë, për të cilat ka dalë edhe certifikata e pronësisë në emër të Bashkisë Konispol.

Për pronat e tjera nuk ka administrim dhe menaxhim të mirë nga Bashkia të aseteve pasi:

-nuk ka ngritur komision për marrjen në dorëzim të aseteve të qëndrueshme me procesverbale të nënshkruara nga përfituesi bashkia Konispol dhe nga institucionet qendrore si dorëzues të aseteve, institucione këto, në pronësi të të cilave kanë qenë pronat dhe asetet, sipas fushave përkatëse të përdorimit të pronës, administratë, arsim, shëndetësi, kulturë, sport, funeral, zhvillim ekonomik, troje të lira, infrastrukturë, strehim dhe mbrojte civile dhe bujqësi e ushqim. Këto proces-verbale do të duhej të ishin shoqëruar me harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre, etj.

-nuk ka kryer kolaudimin dhe vlerësimin e aseteve,

-nuk ka kryer inventarizimin kontabël dhe fizik të aseteve,

-nuk ka aplikuar në ZVRPP Sarandë për regjistrimin e plotë të aseteve, mosveprime këto, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", me pikat 20, 21 dhe 22, në ligjin nr. 33-2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", në VKM nr. 500, datë 14.8.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" , në VKM nr.433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive."pika 66 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap. III, pika 30.

-Rezulton se nga Bashkia Konispol, nuk është hartuar përmbledhja dhe bashkimi i listave të aseteve të saj dhe të dy Njësive Administrative ish-komunat, Markat dhe Xarrë, për të përpiluar në këtë mënyrë një pasqyrë të qartë të pasurive të paluajtshme të bashkisë, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe dokumentimin në pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Konispol, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial",* Kreu III, pika 1.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që, Bashkia Konispol:

-Nuk ka kryer kolaudimin dhe vlerësimin e aseteve, nuk ka kryer inventarizimin kontabël dhe fizik të aseteve, nuk ka aplikuar në ZVRPP Sarandë për regjistrimin e aseteve, veprimet dhe mosveprimet jan, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", me pikat 20, 21 dhe 22, në ligjin nr. 33-2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", në VKM nr. 500, datë 14.8.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" në VKM nr.433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive."pika 66 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap. III, pika 30.

-Nuk ka hartuar përmbledhjen dhe bashkimin e listave të aseteve të dy Njësive Administrative ish-komunat, Markat dhe Xarrë, për të përpiluar në këtë mënyrë një pasqyrë të qartë të pasurive të paluajtshme të bashkisë, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe dokumentimin në pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Konispol, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për

miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial", Kreu III, pika 1.

1.5. Vlerësimi i nivelit të kontrollit të territorit bazuar në organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).

Në lidhje me auditimin e kryer për vlerësimin e nivelit të kontrollit të territorit bazuar në organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV), u kërkua informacion me shkrim nga specialistët e IMTV për aktivitetin e punës për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2017. Bazuar në informacionin e datës 12.04.2018 të z. A.A. dhe z.E.Z.ish inspektorit të IMTV, rezulton se nuk ka ndërtime pa leje ndërtimi në territorin e Bashkisë Konispol, për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z.SH.B.i me detyrë, Kryetar i Bashkisë,

Z.O.H. me detyrë specialist i Pyjeve e Kullotave, periudha 23.11.2016 e në vazhdim,

Z.Sh.Sh. me detyrë ish specialist i Pyjeve dhe Kullotave për periudhën 01.01.2016 deri 11.05.2016, larguar nga puna,

Z.H.M. me detyrë ish specialist i Pyjeve dhe Kullotave për periudhën 11.05.2016 deri 01.10.2016, larguar nga puna,

Z.E.Z. me detyrë inspektor i IMTV për periudhën 01.02.2017 e në vazhdim,

Z.A.K. me detyrë ish inspektor i IMTV për periudhën 01.01.2016 deri 01.12.2016, larguar nga puna,

Z.A.A. me detyrë ish inspektor i IMTV për periudhën 01.01.2016 deri 18.05.2017, aktualisht me detyrë arkitekt në zyrën e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit,

Znj.M.S. me detyrë Drejtore e Bujqësisë.

Znj.E.P. me detyrë Juriste.

1.6. Zbatimi i procedurave ligjore për dhënien me qira dhe arkëtimin e vlerës qirave të tokave shtetërore bujqësore te pandara, që nga data e lidhjes së kontratave.

Në lidhje me auditimin e kryer për zbatimin e procedurave, ligjore për dhënien me qira dhe arkëtimin e vlerës qirave të tokave shtetërore bujqësore te pandara, që nga data e lidhjes së kontratave, e në vazhdim, konstatohet se në Bashkinë Konispol nuk ka toka bujqësore apo asete të tjera të dhëna me qira, për periudhën objekt auditimi, përveç atyre të trashëguara nga ish-bashkia dhe nga ish-Komunat.

Sipas dokumenteve të paraqitura nga zyra e bujqësisë, Bashkia Konispol, u krye auditimi për realizimin e të radhuarve nga dhënia me qira e tokave bujqësore për të cilat janë lidhur kontrata qiraje në vitet e mëparshme të cilat administrohen nga Bashkia.

Në kontratën tip të qirasë janë përcaktuar sanksione ku citohet: "Palët duhet të respektojnë kohën dhe mënyrën e dhënies me qira dhe të pagesave që bëhet në këtë kontratë për detyrimet që marrin përsipër. Në rast se qiradhënësi vonon pagesën sipas kësaj kontrate do të paguaj gjobë 1% të çmimit të kontratës për çdo ditë vonesë".

Në auditimin e kryer të kontratave të dhënies me qira të tokave bujqësore, konstatohet se jo në të gjitha rastet janë zbatuar detyrimet sipas kontratave për të kryer arkëtimin e vlerat e përaktuara pasi, në 10 raste, nuk janë arkëtuar vlera e detyrimit dhe kamat vonesa përkatëse. Nga përllogaritjet e kryera bazuar në kontratat e qirasë për sipërfaqen e dhënë me qira rezulton diferencë e pa arkëtuar dhe kamat vonesa të pa llogaritura dhe të pa arkëtuara të cilat paraqiten në aneksin nr. D/1.6.1, bashkangjitur Raportit të Auditimit.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Nga Bashkia Konispol, nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratave tip të qirave të tokave bujqësore të pandara të lidhur midis ish Bashkisë Konispol, ish Komunës Xarrë dhe ish Komunës Markat dhe personave fizik qiramarrës, gjithashtu nuk janë përllogaritur kamat vonesat përkatëse për çdo ditë vonesë për mosarkëtimin në kohë të detyrimeve, veprim jo në përputhje

me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", i ndryshuar, UKM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", kreu V, pika 1,2,4,5, sipas aneksit nr. D/1.6.1, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Konispol, në vlerën **3,258,936 lekë.** (detyrim vlera 347,093 lekë, kamat vonesë 2,911,843 lekë).

-Nga Bashkia Konispol, nuk është dërguar informacion me shkrim, për zyrën e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në Këshillin e Qarkut Vlorë, në lidhje me dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, në dhjetor të çdo viti, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në UKM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", kreu V, pika 4.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z.SH.B.i me detyrë, Kryetar i Bashkisë Konispol.

Znj.M.S. me detyrë përgjegjëse e zyrës së Bujqësisë.

Komente nga subjekti i audituar: *Në kundërshtimet me nr.276/3, datë 05.06.2018 të z.SH.B.i me detyrë Kryetar i Bashkisë Konispol dhe znj.M.S. me detyrë përgjegjëse e zyrës së Bujqësisë, citohet se:*

1.Drejtoria e Bujqësisë dhe e Blektorisë është drejtoria që monitoron zcurinë e kontratave apo problematikat që mund të dalin për shkak të kufijve të tyre dhe nuk ndjek arkëtimin e detyrimit të tyre apo përllogaritjen e kamat vonesave....kjo bëhet nga specialistët e tatim taksave të bashkisë dhe Njësive Administrativesipas zonave kujt i oërkasin ato.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit nuk merren në konsideratë pasi:*

1.Drejtoria e Bujqësisë dhe e Blektorisë përveç problematikave që mund të dalin për shkak të kufijve të tyre duhet të ndjek edhe arkëtimin e detyrimit të kontratave dhe përllogaritjen e kamat vonesave, për rastet e mospagimit në afat, në bashkëpunim edhe me Zyrën e Taksave dhe Tarifave vendore, bazuar kjo në kërkesat e VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", i ndryshuar dhe të UKM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", kreu V, pika 1,2,4,5.

2.Për sa i përket saktësimit të listës së kundërshtuar nga Juaj nuk qëndron pasi kjo listë është marrë nga zyra e tatim taksave ku personat janë edhe në listën e debitorëve gjendje në fund të vitit.

3.Arkëtimet e kryera gjatë vitit 2018, nga ana Juaj nuk janë llogaritur kamat vonesat për pagesat jashtë afatit të përcaktuar në kontratat e lidhura midis palëve.

E. Mbi vlerësimin e auditimit të brendshëm publik.

1.1. Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm publik.

1.2. Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor të auditimit nga ana sasiore dhe analiza sipas llojeve dhe gjetjeve si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit.

1.3. Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga Njësia e Auditit të Brendshëm publik të Bashkisë.

Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Konispol nuk është ngritur struktura e auditit të brendshëm.

F. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve në auditimin e mëparshëm.

1.Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".

Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) janë dërguar në Bashkinë Konispol me shkresën nr. 128/19 datë 01.06.2016, dhe Bashkia Konispol për zbatim e rekomandimeve të KLSH me nr. 928, datë 23.06.2016, ka kthyer përgjigje në përputhje me afatin kohor, 20 ditë nga data e dërgimit të shkresës, sipas nenit 15 germa (j), të ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Konispol është hartuar program (Plan veprimi) dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete, kjo sipas Urdhrit nr. 44, datë 15.06.2016 *"Plan i veprimeve për realizimin e masave të lëna nga KLSH"*.

Nga Bashkia Konispol është hartuar programi (planin e veprimit) dhe nxjerrë vendimi ekzekutiv, duke respektuar afatin ligjor të përgjigjes të rekomandimeve të KLSH *(brenda 20 ditëve)*.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014.

Bashkia Konispol nuk ka raportuar në KLSH pasi brenda afatit të raportimit për realizimin e programit dhe rekomandimeve sipas programit të auditimit nr. 1113, datë 04.11.2016 dhe autorizimit me nr. 1113/26, datë 04/11/2016, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë, nga KLSH, është ushtruar auditim mbi: *"Verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e kryer..."*.

Grupi i Auditimit të KLSH më datë 12.12.2016, ka mbajtur aktverifikimin nr. 1. Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

a. *Për përmirësimin e gjendjes janë lënë* ***16 masa organizative****, nga të cilat janë pranuar plotësisht 16 masa, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 3 masa (rekomandimet 2, 3 dhe 4) janë në proces zbatimi 8 masa (rekomandimet 1, 5, 9, 11, 12, 13, 14 dhe 16), si dhe janë pa zbatuar 5 masa (rekomandimet 6, 7, 8, 10 dhe 15).*

b. *Për* ***shpërblim dëmi*** *janë lënë 19 masa me vlerë* **92,464,818 lekë,** nga të cilat ***42,825,135 lekë dëm ekonomik dhe 49,639,683 lekë, dëme të likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve.***

Nga 19 masa të rekomanduara të cilat janë pranuar plotësisht 17 masa janë në proces zbatimi me vlerë 86,040 mijë lekë, (rekomandimet nr. 1, 2, 3, 4, 7, 8 ,9 10, 11, 12, 13,14, 15, 16, 17,18 dhe 19), (proces administrative e gjyqësore etj) dhe nuk janë pranuar 2 (dy) masa në vlerën 9,424 mijë lekë (rekomandimi nr. 5 dhe 6)

c. *Janë rekomanduar 10* ***masa disiplinore****, sipas "Kodit të Punës" dhe ligjit "Për nëpunësin Civil" janë 2 masa disiplinore e përkatësisht; "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra" për 4 punonjës dhe "Largim nga Puna ose ndërprerje të kontratës" për 6 punonjës,* ***masa*** *gjendja e të cilave paraqitet e pa zbatuar.*

d. *Janë rekomanduar masa administrative për Agjencinë e Prokurimit Publik, duke kërkuar marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për 7 persona; si dhe Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor dhe Urbanistik Vendor, Konispol, vendosja e gjobave për 1 mbikëqyrës punimesh dhe për 1 kolaudator punimesh, gjendja e të cilave paraqitet e pa zbatuar.*

*3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar***.**

Me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së me nr. 181, datë 31.12.2016, KLSH me shkresën nr. 1113/129, datë 31.01.2017 "Kërkesë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e fundit në Bashkinë Konispol", administruar nga Bashkia Konispol me nr. 176, datë 06.02.2017, ka rezultuar se pavarësisht nga puna e bërë, për disa nga masat janë nxjerrë vetëm urdhra për kryerjen e ndalesave, pa i shoqëruar përgjithësisht me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave,

duke u bërë shkak për kalimin e afateve ligjore të kërkimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115 të Kodit Civil dhe nenit 203 të Kodit Punës (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit "Për kundërvajtjet Administrative" (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

Bashkia Konispol në zbatim të shkresës së KLSH nr. 1113/129, datë 31.01.2017, me shkresën nr. 317, datë 26.02.2017, brenda afatit 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 30, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, ka raportuar mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.
Sipas shkresës Bashkia Konispol ka deklaruar se:

1. Nga ana e Bashkisë Konispol janë marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

2. Nga drejtoria e Tatim-Taksave është punuar me të gjitha subjektet të cilët kishin detyrime ende të papaguara. (Bizneset, fermerë, debitorët e ujit të pijshëm)

- Numri i debitorëve të ujit të pijshëm ka qenë 52 nga të cilët 23 kanë likuiduar totalisht detyrimet dhe 6 pjesërisht. Debia ka qenë 717.680 lekë nga e cila është paguar 296,880 lekë. Është duke u punuar me pjesën tjetër të debitorëve.

- Debia e krijuar nga bizneset është ulur me rreth 350,848 leke, është duke u punuar me ta duke ju lënë dhe një afat për likuidim vullnetar, nëse prej tyre nuk do të ketë përgjigje pozitive atëherë do të procedojmë me hapat e tjerë ligjore.

- Debia e krijuar nga fermerët është ulur me 227,347 lekë është duke u punuar me ta duke ju lënë dhe një afat për likuidim vullnetar, nëse prej tyre nuk do të ketë përgjigje pozitive atëherë do të procedojmë me hapat e tjerë ligjore.

- Kontratat e tokës me qira kanë ngelur pa likuiduar 4 persona nga 32 persona.

3. Për subjektet e tjerë për të cilët grupi i auditit ka lënë masa për shpërblim dëmi, nga ana e Drejtorisë Juridike janë bërë njoftimet përkatëse dhe si rezultat i mospagimit vullnetar nga ana e tyre i jemi drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë me një kërkesë për lëshim të urdhrit të ekzekutimit. Kjo kërkesë u rrëzua nga Gjykata dhe nga ana jonë po përgatiten kërkesëpadi themeli me objekt kthimin e shumës së lënë nga KLSH. Vetëm një subjekt, Z. I.S. është përgjigjur pozitivisht njoftimit duke u shprehur se do të bëjë pagesën e detyrimit deri në fund të muajit Mars.

4. Punonjësit T.C, E.D., Sh.Sh. të cilët kishin gjoba nga APP kanë ngritur padi në Gjykatën Administrative Gjirokastër për anulimin e Vendimin të APP dhe gjobë së vendosur ndaj tyre. Padia u pranua nga gjykata dhe vendimi i APP nr.89, datë 14.10.2016 pika IV është shfuqizuar.

5. Këshilltarët të cilët janë paguar dhe për mbledhje të Këshillit Bashkiak në të cilat nuk kanë marrë pjesë u është lënë afat deri në 10.03.2017 për pagimin vullnetar të detyrimeve të tyre duke qenë se ka pasur reagim pozitiv nga ana e tyre. Në rast të mosrespektimit të këtij afati do të ndërmerren hapa ligjor për arkëtimin e detyrueshëm.

6. Për rekomandimin 11.1 mbi detyrimin e kompanisë A...C, është bërë njoftimi për pagesën e detyrimit në shumën 20.000 lekë dhe në mars të vitit 2016 ky detyrim është paguar.

7. Lidhur me administrimin e pronave të Bashkisë Konispol janë marrë masa duke bërë shtesë në strukturën e vitit 2017 me një punonjës në Drejtorinë e Bujqësisë të cilit do ti ngarkohen këto detyra.

8. Përsa i përket dokumentacionit financiar ka përfunduar sistemimi, inventarizimi dhe arkivimi.

9. Është bërë plotësimi i dokumentacionit të të gjitha dosjeve teknike të investimeve si për bashkinë Konispol ashtu dhe për Njësinë Administrative Markat.

10. Janë marra masa për administrimin e automjetit Benz ML 400 CDI

Nga **54** masa të rekomanduara gjithsej, janë pranuar plotësisht **52** masa, dy masa rezultojnë të papranuara. Nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht **18** masa, realizuar pjesërisht dhe proces **34** masa dhe *nuk janë zbatuar* **2** masa të rekomanduara.

Masat e konsideruara si të pa zbatuara apo në proces zbatimi dhe të vlerësuara se duhet të rikërkohet zbatimi i tyre, dhe që janë objekt i auditimit aktual, paraqiten si vijon:

Aktualisht, pas auditimit të kryer, nga masat e rikërkuara për zbatim nga KLSH, gjendje paraqitet si vijon:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar përsëri **16 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar plotësisht 16 masa, nga të pranuarat janë zbatuar plotësisht 8 masa, janë në proces zbatimi 5 masa, si dhe janë pa zbatuar 3 masa.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë 19 masa me vlerë **92,464,818 lekë.** Nga 19 masa të rekomanduara të cilat janë pranuar plotësisht 15 masa janë në proces zbatimi (proces administrative e gjyqësore etj) nuk janë zbatuar 4 (katër) masa në vlerën prej 1,948,036 lekë dhe nuk janë pranuar 4 (katër) masa në vlerën 406,218 lekë.

c. Janë rekomanduar **10 masa disiplinore**, sipas "Kodit të Punës" dhe ligjit "Për nëpunësin Civil" janë 2 masa disiplinore e përkatësisht; "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra" për 4 punonjës dhe "Largim nga Puna ose ndërprerje të kontratës" për 6 punonjës, **masa** gjendja e të cilave paraqitet e zbatuar.

d. Janë rekomanduar masa administrative për Agjencinë e Prokurimit Publik, duke kërkuar marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për 7 persona; si dhe Kryeinspektorit të IMTV, Konispol, vendosja e gjobave për 1 mbikëqyrës punimesh dhe për 1 kolaudator punimesh, gjendja e të cilave paraqitet e pa zbatuar, për shkaqe të përligjura.

Më poshtë paraqiten masat të cilat nuk janë zbatuar, janë në proces zbatimi janë të pa pranuara.

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. 1 Rekomandimi: Bashkia Konispol për vitin 2016 të marrë masa që të kursejë dhe të reduktojë shpenzimet, të arkëtojë të ardhurat vendore, të vjelë vlerat debitore si dhe të shikojë çdo mundësi tjetër me miratim të Këshillit Bashkiak, me qëllim që të shlyej borxhin publik për vlerën 60,446,245 lekë ndaj të tretëve.

Kjo detyrë nuk është realizuar

5.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Konispol të merren masa për arkëtimin e detyrimeve debitore në vlerën ***6,066,551 lekë***, nga kjo në 35 raste nga biznesi Konispol në shumën 2.225.223 lekë, në 3 raste nga biznesi i transportit në shumën 116,412 lekë, në 45 raste në shumën 286,161 lekë nga fermerë të fshatit Ciflik, në 253 raste ne shumën 2.721.075 lekë, fermerë të Bashkisë Konispol, dhe debitorë tipikë për mospagimin e detyrimeve të ujit të pijshëm janë 52 persona në shumën totale prej 717,680 lekë.

Kjo detyrë rezulton pjesërisht e zbatuar

7.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol brenda mundësive të marrë masa për krijimin e një strukture të veçantë apo caktimin e një personi për inventarizimin, regjistrimin në ZVRPP dhe administrimin e të ardhurave nga asetet dhe pronat e tjera të kësaj bashkie, duke përfshirë dhe bashkimin e aseteve dhe pronave të ish-Komunave Xarrë dhe Markat, pjesë të kësaj Bashkie nga zbatimi i reformës së ndarjes territoriale.

Kjo detyrë rezulton ende e pazbatuar

8.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa për vlerësimin faktik të pronave të transferuara, të shoqëruara me harta, skica dhe dokumente shoqëruese të tyre duke bërë inventarizimin fizik, si dhe zgjidhjen e çështjes së mbivendosjes me AKKP Tiranë dhe ZVRPP Sarandë.

Kjo detyrë rezulton ende e pazbatuar

9.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të hartojë programe për trajtimin e këtyre pasurive, vlerësimin e kapaciteteve kullosore nga ekspertë të licencuar, ngritjen e komisionit të vlerësimit të tyre dhe regjistrimit në kontabilitet.

Kjo detyrë rezulton ende e pazbatuar

10.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa ligjore për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të 27 fermerëve në shumën **491,535 lekë** duke bërë njoftimet përkatëse dhe kërkimit në rrugë gjyqësore të zgjidhjes së kontratave.

Ky rekomandim është realizuar pjesërisht

11.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktor të vitit 2015, në shumën **200,000 lekë** nga V...A... Të negociojë me Kompaninë A...C me qëllim rishikimin e afatit, kushtet dhe referencat ligjore për kontratat e lidhura.

Kjo detyrë rezulton e zbatuar dhe vlera prej 200,000 lekë është arkëtuar

II. <u>Për Njësinë Administrative Markat</u> *<u>(ish-Komuna Markat)</u>*.

12.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol dhe Njësia Administrative Markat të marrë masa urgjente të sistemojë, inventarizojë dhe arkivojë dokumentacionin financiar të ish-komunës Markat.

Ky rekomandim është realizuar

13.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol dhe Njësia Administrative Markat të marrë masa për administrimin e Automjetit ***Benz fuoristradë ML 400 CDI***, duke e bërë hyrje, rivlerësuar me komision, zhvendosjen e saj nga ambientet private në bashki, për efekt të shfrytëzimit të saj për nevoja të bashkisë.

Ky rekomandim është realizuar, sipas urdhrit të kryetarit nr. 50, datë 16.06.2016

15.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol Njësia Administrative Markat të marrë masa për arkëtimin e qirave të papaguara të tokave në shumën **196,809** lekë nga 19 persona debitorë ndaj ish-Komunës Markat.

Ky rekomandim nuk është realizuar

B. <u>MASA SHPËRBLIM DËMI:</u>

2.1.Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **73,971 lekë**, nga M.A., *ish-Kryetare e Bashkisë*, për tejkalim normative të shpenzimeve celulare, për vitin 2013, 2014 dhe 2015.

Ky rekomandim rezulton i pranuar por i pa zbatuar plotësisht. Sipas vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. 23-2017-630 (317), datë 04.04.2017, me palë paditëse Bashkinë Konispol dhe palë të paditur I.B, I.M, A.I, dhe M.A, me objekt padie detyrimin e palëve të paditura për kthimin e shumave të përcaktuara në njoftimet e bëra nga paditësi "për shpërblim dëmi", në lidhje me rekomandimet e KLSH, gjykata ka vendosur kthimin e padisë paditësit për shkak të mos pagesës të taksës mbi aktet në varësi të shumës së detyrimit. Pas këtij vendimi bashkia nuk ka paraqitur kërkesë padi të re për mungesë të fondeve për pagesën e taksës prej 1% të vlerës së padisë.

3.1 Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **38,000 lekë,** nga përgjegjësja e shërbimeve **T.Ç. shpenzimi i pajustifikuar**, sipas urdhër shpenzimit nr. 196, datë 15.9.2014**,** për gërmim e transport dheu 60 m^3 rruga Postbllok-Konispol, pasi nuk ka projekt, nuk ka fotografime para punimeve dhe pas punimeve, nuk ka përmasime të kanalit për efekt të justifikimit të 60 m^3 dhe nuk ka kërkesë të sektorit shërbimeve dhe miratim të saj.

Ky rekomandim rezulton i pa pranuar dhe zbatuar

4.1 Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **106,250 lekë,** nga **M.A.** për mungesë inventari 1 Laptop HP pasi nuk është dorëzuar nga ish-kryetarja e bashkisë, sipas fletëdaljes nr. 2, datë 24.2.206, procesverbalit datë 3.8.2015 dhe shkresës nr. 560 datë 02.09.2015 të bashkisë.

Ky rekomandim nuk është pranuar

5.1 Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **189,360 lekë,** nga shoferi ***D.Z. 94,680 lekë*** dhe punonjësja e shërbimeve ***T.C. 94,680 lekë***, për **tejkalim normativave të karburantit** të mjetit tip *"Benz"* në përdorim të administratës me targa SR7319B, sipas rekordimit të fletudhëtimeve me sasinë e furnizuar dhe me normativat e miratuara, për vitin 2013 dhe për vitin 2014.

Ky rekomandim nuk është pranuar

7.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Konispol të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **7,918,215 lekë** pa t.v.sh, nga të cilat:

- *Vlera 1,341,882 lekë* *pa t.v.sh për punime të pakryera në fakt;*

- Vlera 6,603,333 lekë *dëme të likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve;*
nga operatori ekonomik *"M...S"* sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 514, datë 30.06.2014 me objekt: **"*Rikonstruksion Qendra e Qytetit Konispol*"**, Bashkia Konispol, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera dhe dëme për vonesa në zbatim të kontratës.

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar

8.1 Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **60,000 lekë** nga M.A. dhe S.B. me nga ***30,000 lekë secili.***

Ky rekomandim rezulton i pranuar por i pa zbatuar plotësisht.

9.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa për arkëtimin e shumën **72,708 lekë** nga F.B. për **pagë të dubluar.**

Ky rekomandim rezulton i pa pranuar e zbatuar

II. Për Njësinë Administrative Markat **paraget një dëm ekonomik në vlerën 74,136,802 lekë.**

10.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **7,432,624 lekë**, që përbëhet nga vlerësimi i gabuar i ofertës ekonomike të shpallur fitues në tenderin me objekt: "*Rruga Janjar-Ninat- Markat*", nga KVO, përkatësisht ***A.(I.)S. 1,858,156 lekë, E.R. 1,858,156 lekë, E.M. 1,858,156 lekë dhe ish Titullari i AK, I.M. 1,858,156 lekë.***

Ky rekomandim është pranuar nga Bashkia Konsipol.

Me vendimin nr. 23-2017-1830, datë 31.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me ankues KLSH dhe palë në Proces Prokuroria Sarandë, është kërkuar kundërshtimi i vendimit nr. 14.06.2017 i Prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. 312/2016. Sipas vendimit, gjykata në përfundim të sa sipër ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankuesit KLSH dhe lënien në fuqi të vendimit të pushimit të prokurorisë.

11.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Konispol të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **58,355,550 lekë pa t.v.sh** nga ***subjekti*** *"***N...A***"* sh.p.k., nga të cilat:
- vlera 15,319,200 lekë pa t.v.sh ***për punime të pakryera në fakt;***
-vlera 43,036,350 lekë dëme të likuidueshme për vonesën në mbarimin jo të plotë të punimeve;
Nga operatori ekonomik *"**N...**" sh.p.k*, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën për punë publike nr. 71, datë 12.09.2012 me objekt: **"Rruga Janjar-Ninat-Markat"**, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera dhe dëme për vonesa në zbatim të kontratës.

Ky rekomandim është pranuar nga Bashkia Konsipol.

Me vendimin nr. 23-2017-1830, datë 31.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me ankues KLSH dhe palë në Proces Prokuroria Sarandë, është kërkuar kundërshtimi i vendimit nr. 14.06.2017 i Prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. 312/2016. Sipas vendimit, gjykata në përfundim të sa sipër ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankuesit KLSH dhe lënien në fuqi të vendimit të pushimit të prokurorisë.

Lidhur me këtë problem me shkresën nr. 150/2, datë 15.02.2018, subjekti "N...a" shpk ka bërë me dije bashkinë mbi shkaqet për mos shlyerjen e detyrimeve, pasi sipas vendimeve gjyqësore është konstatuar fakti se nuk ekziston një dëm ekonomik, si dhe dëmi i KLSH është si rezultat i vlerësimit të gabuar nga ana tyre.

12.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **181,500 lekë** për **pagesa të paligjshme** të **22 këshilltarëve** të ish-komunës Markat, pasi nuk kanë marrë pjesë në disa mbledhje të këtij këshilli, për vitin 2013-2015, përkatësisht: B.O. 27,500 lekë, Sh.S. 27,500 lekë, A.A. 5,500 lekë, Y.E. 5,500 lekë, B.M. 33,000 lekë, F.C. 16,500 lekë, A.M. 22,000 lekë, L.D. 16,500 lekë, P.A. 11,000 lekë, K.M. 5,500 lekë, H.M. 11,000 lekë.

Ky rekomandim rezulton i pranuar dhe zbatuar

13.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **145,735 lekë**, pasi janë paguar në kundërshtim me VKM nr. 518, datë

16.08.2012 dhe VKM nr. 586 datë 17.07.2013, përkatësisht: ish-kryetari i Komunës ***I.M. 103,150 lekë***, ish-përgjegjësi financës ***I.B. 11,265 lekë*** dhe ish-punonjës i komunës ***I.(A.)S. 31,320 lekë.***

Ky rekomandim rezulton i pranuar por i pa zbatuar plotësisht.

14.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **195,500 lekë**, paga të pa tërhequra dhe të pa arkëtuara të punonjësve me kontratë, këshilltarëve dhe kryetarëve te Fshatit për muajt Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2012**,** sipas borderove ku mungojnë nënshkrimet e marrësve, përkatësisht: M.M. 13,500 lekë, O.H.13,500 lekë, N.D. 13,500 lekë, K.M. 13,500 lekë, A.M. 13,500 lekë, L.D. 24,000 lekë, A.S. 24,000 lekë, D.H. 24,000 lekë, R.R. 24,000 lekë, S.D. 16,000 lekë, F.E. 16,000 lekë.

Ky rekomandim rezulton i pazbatuar

15.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **550,661 lekë** *(330,661+220,000)*, përkatësisht ish-Kryetari i Komunës ***I.M. dhe I.B.*** shpenzime të pa justifikuara me dokumente në 2 raste, pasi mungon fatura, preventivi, situacioni, vendimi i Këshillit Komunës, procesverbali i komisionit shërbimeve te vogla, fotografimet para dhe pas meremetimit të objektit, akt marrja në dorëzim etj.

Ky rekomandim rezulton i pranuar por i pa zbatuar plotësisht.

16.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **102,000 lekë** përfitim **dieta të tepërta** për vitin 2013, 2014, 6-mujori 2015, pasi janë kryer pagesat për shpenzimet e hotelit pa faturën tatimore dhe pa kuponët tatimor elektronik, konkretisht:

-vlera 69,000 lekë, nga **I.M.** sipas urdhër shpenzimit për *dieta janar-shkurt 2015*.

-vlera 24,000 lekë, nga **I.B.** sipas urdhër shpenzimit për *dieta janar-shkurt 2015*.

-vlera 9,000 lekë, nga **A.I.** sipas urdhër shpenzimit për *dieta janar-shkurt 2015*.

Ky rekomandim rezulton i pranuar por i pa zbatuar plotësisht.

17.1 Rekomandimi: Rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve të mëparshme nga Bashkia Konispol, duke kontabilizuar dhe arkëtuar vlerën **774,498 lekë**, përkatësisht: subjekti ***"Alb Iea Internacional" shpk*** në vlerën ***289,150 lekë,*** subjekti *"**A...I" shpk*** në vlerën **337,600 lekë,** subjekti ***"E...E & C..." shpk*** në vlerën ***97,288 lekë*** dhe subjekti ***"E...I" shpk*** në vlerën ***50,000 lekë,*** sipas shkresës të KLSH nr. 380/6, datë 6.2.2012, për ish-Komunën Markat.

Ky rekomandim rezulton i pranuar por i pa zbatuar

18.1 Rekomandimi: Rikërkojmë Bashkisë Konispol, zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të Auditit të Prefekturës Vlorë, për ish-Komunën Markat, kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës **796,538 lekë** për subjektin ***"T...D"shpk,*** për **punë të pakryer** në 2 objekte kontraktore të komunës Markat, përkatësisht ***21,710 lekë*** për objektin "***Ambulancë fshati Janjar***" dhe ***774,828 lekë*** për objektin "***shkolla 9-vjeçare fshati Janjar***".

Ky rekomandim rezulton i pranuar po i pa zbatuar

19.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa për arkëtimin e shumën **5,302,780** lekë nga ***I.M.*** ish-Kryetar i Komunës Markat dhe ***I.B.*** ish-përgjegjës i financës**.**

Ky rekomandim rezulton i pranuar por i pa zbatuar plotësisht.

Sipas vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. 23-2017-630 (317), datë 04.04.2017, me palë paditëse Bashkinë Konispol dhe palë të paditur I.B, I.M, A.I. dhe M.A, me objekt padie detyrimin e palëve të padituara për kthimin e shumave të përcaktuara në njoftimet e bëra nga paditësi "për shpërblim dëmi", në lidhje me rekomandimet e KLSH, gjykata ka vendosur kthimin e padisë paditësit për shkak të mos pagesës të taksës mbi aktet në varësi të shumës së detyrimit. Pas këtij vendimi bashkia nuk ka paraqitur kërkesë padi të re për mungesë të fondeve për pagesën e taksës prej 1% të vlerës së padisë.

C. <u>MASA ADMINISTRATIVE</u>

<u>D.1 Mbi gjobat e rekomanduara për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV)</u>.

Bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 15 ndryshuar me nenin 2 të ligjit nr. 9826, datë 01.11.2007, për shkelje të nenit

7, pikat 1, 3, 4, 17, 18 dhe 19 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001" Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pikat, 8, 8/1, 8/2 dhe 10 të Kreut II dhe pikat 4, 5 të Kreut III të UKM nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", **nga KLSH, i është propozuar** Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor dhe Urbanistik Vendor, Konispol vendosja e gjobave për 1 mbikëqyrësit të punimeve dhe 1 kolaudatori të punimeve, ***si vijon:***

1. Ing. M.Çavo në vlerën 200,000 lekë në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, dhe
2. Ing. Dh.L. në vlerën 100,000 lekë në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara, në procedurën e zbatimit të kontratës *"Rikonstruksion Qendra e Qytetit Konispol"*, Bashkia Konispol, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore *në vlerën* 7,945,215 lekë pa tvsh, *nga të cilat vlera* 1,341,882 lekë pa TVSH *për punime të pakryera në fakt dhe vlera* 6,603,333 lekë *si pasojë e dëmeve të likujdueshme për vonesën në mbarimin e punimeve.*

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Konispol, në cilësinë e Eprorit, ti kërkojë **Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor dhe Urbanistik Vendor, Konispol** zbatimi i rekomandimeve të KLSH, duke marrë vendim për dënimin me gjobë për 2 subjektet private, të marrë masat duke nxjerrë njoftimet përkatëse, vendimet për dënimin me gjobë, kontabilizimin e vlerave dhe në rast se nga subjektet ushtrohet e drejta e ankimit gjyqësor ndaj vendimit, ti kërkohet përfaqësuesve/it ligjor të institucionit të bëjnë ndjekjen e tij me profesionalizëm, paanshmëri e skepticizëm profesional, në zbatim të plotë të referencave ligjore dhe rekomandimit të KLSH.

Kjo detyrë rezulton e ende e pa zbatuar. Mos zbatimi ka ardhur si pasojë e procesit gjyqësor në proces (Gjykatën e Apelit Administrativ) ndërmjet Shoqërisë Sipërmarrëse të punimeve "M...S" shpk dhe Bashkisë, në përfundim të të cilit, sipas dispozitivit të vendimit gjyqësor, nga IMTV duhet të bëhet vlerësimi mbi aplikimin apo jo të penaliteteve.

Detyrë në proces zbatimi

Agjencia e Prokurimit Publik, me Vendimin nr. 89, datë 14.10.2016 ka marre vendimin duke u mbështetur në propozimin e ardhur nga KLSH, **ndaj 8 personave,** për vendosjen e gjobave si më poshtë:

1. E.D, Përgjegjës i Financës të Bashkisë,anëtar i KVO, në vlerën 50,000 lekë ;
2. T.Ç, në cilësinë e anëtarit të KVO, Teknike e mesme, në vlerën 50,000 lekë ;
3. M.A, titullar i AK, në vlerën 100,000 lekë
4. **I.M**, titullar i AK, **në vlerën 70,000** lekë
5. I.B, në cilësinë e anëtarit të njësisë së Prokurimit, në vlerën 100,000 lekë
6. K.A, në cilësinë e anëtarit të njësisë së Prokurimit, në vlerën 100,000 lekë
7. A.B, në cilësinë e anëtarit të njësisë së Prokurimit, në vlerën 100,000 lekë ;
8. Sh.Sh, në cilësinë e anëtarit të KVO, Inspektor kullotash, në vlerën 50,000 lekë ;

Nga verifikimi rezultoi se këto gjoba nuk janë kontabilizuar dhe nuk kanë filluar procedurat ligjore për arkëtimin e tyre, dhe konkretisht për arsye se:

Lidhur me E.D., Sh.Sh. e T.C., rekomandimi konsiderohet i zbatuar pasi me vendimin nr. 85-2016-730, datë 01.11.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjirokastër, është pranuar kërkesë padia e punonjësve të mësipërm për anulimin e pjesshëm të vendimit të APP, duke bërë shfuqizimin e pjesshëm të vendimit lidhur me penalitetin prej 50,000 lekë për secilin anëtar të KVO.

Lidhur me M.A. dhe K.A, rekomandimi konsiderohet i zbatuar pasi me vendimin nr. 85-2016-710, datë 12.21.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjirokastër, është pranuar kërkesë padia e punonjësve të mësipërm për anulimin e pjesshëm të vendimit të APP, duke bërë shfuqizimin e pjesshëm të vendimit lidhur me penalitetin prej 100,000 lekë për secilin.

Për shtetasit A.B., rekomandimi konsiderohet i zbatuar pasi me vendimin nr. 80-2017-507, datë 17.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, është pranuar kërkesë padia e ish-punonjësit të mësipërm për anulimin e pjesshëm të vendimit të APP, duke bërë shfuqizimin e pikës 3 të vendimit.

Duke qenë se në pikën 3 të tij përfshihet edhe shtetasi Ibrahim Bastri pasi bëhet fjalë për të njëjtin institucion dhe procedura, atëherë edhe ky rekomandim konsiderohet i zbatuara.

Mbetet ende i pa zbatuar rekomandimi për I.M. ish-Titullar i AK.

3. Nxjerrja e akteve administrative përkatëse (urdhrat ekzekutivë për), nga Titullari i njësisë publike në lidhje me zbatimin e rekomandimeve sipas masave.

Mos zbatimi i rekomandimeve duke mos i argumentuar ato, nga nëpunësit e subjektit të audituar, mos regjistrimi në kontabilitet i vlerës së shpërblimit të dëmit, mos nxjerrja e urdhrave ekzekutive administrative në lidhje me vendosjen e gjobave, është në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914. Për mos zbatimin e rekomandimeve të KLSH dhe për ndjekje dhe mosrealizim të planit veprimit të miratuar, *mbajnë përgjegjësi:*
1. z. SH.B, me funksion Kryetar i Bashkisë
2. zj. K.K, me detyra Zv/Kryetar i Bashkisë
3. z. E.D, me funksion Përgjegjës i Zyrës së Financës
4. z. H.S, me funksion ish-Specialist i Tatim Taksave (për periudhën deri më 30.09.2016)
5. zj. L.T, me funksion Specialist i Tatim Taksave (për periudhën nga data 30.09.2016)
6. zj. E.P, me funksion Juriste

Për sa sipër, kërkojmë të zbatohen, masat organizative dhe masat për shpërblim dëmi të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe të pa zbatuara akoma respektivisht për Bashkinë Konispol dhe ish-Komunat, dërguar e ridërguar me shkresat nr. 128/19 datë 01.06.2016 dhe nr. 1113/129, datë 31.01.2017.

Nga grupi i auditimit rilihet detyrë që:
Nga Kryetari i Bashkisë Konispol, të nxirren aktet administrative dhe të *rikërkohen zbatimi i*:
7.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol brenda mundësive të marrë masa për krijimin e një strukture të veçantë apo caktimin e një personi për inventarizimin, regjistrimin në ZVRPP dhe administrimin e të ardhurave nga asetet dhe pronat e tjera të kësaj bashkie, duke përfshirë dhe bashkimin e aseteve dhe pronave të ish-Komunave Xarrë dhe Markat, pjesë të kësaj Bashkie nga zbatimi i reformës së ndarjes territoriale.
8.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa për vlerësimin faktik të pronave të transferuara, të shoqëruara me harta, skica dhe dokumente shoqëruese të tyre duke bërë inventarizimin fizik, si dhe zgjidhjen e çështjes së mbivendosjes me AKKP Tiranë dhe ZVRPP Sarandë.
9.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të hartojë programe për trajtimin e këtyre pasurive, vlerësimin e kapaciteteve kullosore nga ekspertë të licencuar, ngritjen e komisionit të vlerësimit të tyre dhe regjistrimit në kontabilitet.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI:
2.1.Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **73,971 lekë**, nga M.A. *ish-Kryetare e Bashkisë*, për tejkalim normative të shpenzimeve celulare**,** për vitin 2013, 2014 dhe 2015.
4.1 Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **106,250 lekë,** nga **M.A.** për mungesë inventari 1 Laptop HP pasi nuk është dorëzuar nga ish-kryetarja e bashkisë.
8.1 Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **60,000 lekë** nga M.A. dhe S.B. me nga ***30,000 lekë secili.***
10.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **7,432,624 lekë**, që përbëhet nga vlerësimi i gabuar i ofertës ekonomike të shpallur fitues në tenderin me objekt: "*Rruga Janjar-Ninat- Markat*", nga KVO, përkatësisht ***A.(I.)S, E.R, E.M. dhe ish Titullari i AK, I.M.***
13.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **145,735 lekë**, pasi janë paguar në kundërshtim me VKM nr. 518, datë 16.08.2012 dhe VKM nr. 586 datë 17.07.2013, përkatësisht: ish-kryetari i Komunës ***I.M.***

103,150 lekë, ish-përgjegjësi financës ***I.B. 11,265 lekë*** dhe ish-punonjës i komunës ***I.(A.)S. 31,320 lekë***.

14.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **195,500 lekë**, paga të pa tërhequra dhe të pa arkëtuara të punonjësve me kontratë, këshilltarëve dhe kryetarëve te Fshatit për muajt Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2012**,** sipas borderove ku mungojnë nënshkrimet e marrësve, përkatësisht: M.M. 13,500 lekë, O.H.13,500 lekë, N.D. 13,500 lekë, K.M. 13,500 lekë, A.M. 13,500 lekë, L.D. 24,000 lekë, A.S. 24,000 lekë, D.H. 24,000 lekë, R.R. 24,000 lekë, S.D. 16,000 lekë, F.E. 16,000 lekë.

15.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **550,661 lekë** *(330,661+220,000)*, përkatësisht ish-Kryetari i Komunës ***I.M. dhe I.B.*** shpenzime të pa justifikuara me dokumente në 2 raste, pasi mungon fatura, preventivi, situacioni, vendimi i Këshillit Komunës, procesverbali i komisionit shërbimeve te vogla, fotografimet para dhe pas meremetimit të objektit, akt marrja në dorëzim etj.

16.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **102,000 lekë** përfitim **dieta të tepërta** për vitin 2013, 2014, 6-mujori 2015, pasi janë kryer pagesat për shpenzimet e hotelit pa faturën tatimore dhe pa kuponët tatimor elektronik, konkretisht:

-vlera 69,000 lekë, nga **I.M.** sipas urdhër shpenzimit për *dieta janar-shkurt 2015*.

-vlera 24,000 lekë, nga **I.B.**sipas urdhër shpenzimit për *dieta janar-shkurt 2015*.

-vlera 9,000 lekë, nga **A.I.** sipas urdhër shpenzimit për *dieta janar-shkurt 2015*.

17.1 Rekomandimi: Rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve të mëparshme nga Bashkia Konispol, duke kontabilizuar dhe arkëtuar vlerën **774,498 lekë**, përkatësisht: subjekti ***"A....I.l" shpk*** në vlerën ***289,150 lekë,*** subjekti *"**A...I" shpk*** në vlerën **337,600 lekë,** subjekti ***"E...E & C..." shpk*** në vlerën ***97,288 lekë*** dhe subjekti ***"E...i" shpk*** në vlerën ***50,000 lekë,*** sipas shkresës të KLSH nr. 380/6, datë 6.2.2012, për ish-Komunën Markat.

18.1 Rekomandimi: Rikërkojmë Bashkisë Konispol, zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të Auditit të Prefekturës Vlorë, për ish-Komunën Markat, kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës **796,538 lekë** për subjektin ***"T...D"shpk,*** për **punë të pakryer** në 2 objekte kontraktore të komunës Markat, përkatësisht ***21,710 lekë*** për objektin "***Ambulancë fshati Janjar***" dhe ***774,828 lekë*** për objektin "***shkolla 9-vjeçare fshati Janjar***".

19.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol të marrë masa për arkëtimin e shumën **5,302,780** lekë nga ***I.M.*** ish-Kryetar i Komunës Markat dhe ***I.B.*** ish-përgjegjës i financës**.**

Zbatimin e vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik, nr. 89, datë 14.10.2016, për dënimin me gjobë në vlerën prej 70,000 lekë ndaj ish-Titullarit të AK Komuna Markat, **I.M.**

H. Gjetjet nga Auditimi dhe rekomandimet.

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi. Në auditimin e dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e fundit, konstatohet se nga Bashkia Konispol megjithëse është punuar në drejtim të zbatimit të tyre, akoma situata nuk është vlerësuar sa dhe si duhet, duke mos ndjekur deri në fund procedurat ligjore në zbatimin e rekomandimeve, kryesisht ato që kanë lidhje me shpërblim dëmi, veprime në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit"*, *konkretisht*:
Nga 54 masa të rekomanduara gjithsej, janë pranuar plotësisht 52 masa, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 18 masa, realizuar pjesërisht dhe proces 34 masa dhe *nuk janë zbatuar* 2 masa. Aktualisht, masat e rikërkuara për zbatim nga KLSH, gjendje paraqitet si vijon:
a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar përsëri 16 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, janë zbatuar plotësisht 8 masa, në proces zbatimi 5 masa, pa zbatuar 3 masa.
b. Për shpërblim dëmi janë lënë 19 masa me vlerë 92,464,818 lekë nga të cilat janë pranuar plotësisht 15 masa janë në proces zbatimi (proces administrative e gjyqësore) nuk janë zbatuar 4 (katër) masa në vlerën prej 1,948,036 lekë dhe nuk janë pranuar 4 (katër) masa në vlerën 406,218 lekë (*trajtuar më hollësisht në faqet 106-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Konispol, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me prioritet zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe risin përgjegjshmërinë e nëpunësve shtetërore. Për të gjitha detyrimet e mundshme për tu rikërkuar, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shpërblimit të dëmit, masave organizative me mungesë të ardhurash, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e parealizuara dhe rikërkuara nga KLSH-ja.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Konispol, nuk janë marrë masat e nevojshme për menaxhimin e aktiviteteve dhe mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
Bashkia e Konispolit, nuk ka miratuar kodin e etikës profesionale për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të njësisë. Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit, nuk është caktuar koordinatori i riskut dhe për rrjedhojë nuk janë identifikuar sistemet e kontrollit me më shumë risk, nuk është hapur regjistri i riskut dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij.
Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), por ai nuk ka funksionuar. GMS-ja nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet, mosveprime jo në përputhje me kërkesat e nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", nenet 4, 16, 20, 21, UMF nr. 2, datë 6.02.2012 "Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit" pika 40, ligjit nr. 68-2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 32 dhe UMF nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat e përgatitjes së Buxhetit afatmesëm", kap. V, pikat 93-116 (*trajtuar më hollësisht në faqet 7-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandim: Bashkia Konispol, të marrë masat e nevojshme administrative për menaxhimin e aktiviteteve në përputhje me kërkesat ligjore duke përmirësuar sistemin e kontrollit të brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut dhe menaxhimin e tij.

Menjëherë

3.1. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Konispol, treguesit kryesorë të buxhetit për dy vitet 2016 dhe 2017 janë:
Për vitin 2016, buxheti i Bashkisë Konispol, është miratuar me vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 7, datë 23.02.2016.
Në total, buxheti është programuar në shumën 474,983 mijë lekë, realizuar 325,705 mijë lekë ose 69%. Investimet janë realizuar në masën 61%.
Të ardhurat nga tatim taksat lokale për vitin 2016, janë programuar në shumën 43,907 mijë lekë ose 9,2 % e totalit të buxhetit.
Për vitin 2017, buxheti i Bashkisë Konispol, është miratuar me vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 11, datë 21.02.2017.

Në total, buxheti është programuar në shumën 483,733 mijë lekë, realizuar 424,974 mijë lekë ose 88%. Investimet janë realizuar në masën 102%.
Të ardhurat nga tatim taksat lokale për vitin 2017, janë programuar në shumën 66,270 mijë lekë ose 13,7 % e totalit të buxhetit.
Në programimin dhe zbatimin e buxhetit, u konstatuan në disa raste, veprime dhe mos veprime jo në përputhje me kërkesat ligjore:
Për vitet 2016 dhe 2017, miratimi i programeve të buxheteve, *nuk është bërë brenda afateve ligjore*, çka nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar neni 32, ku përcaktohet afati brenda muajit Nëntor të vitit paraardhës dhe UMF nr. 8, datë 29.3.2012 "Procedurat e përgatitjes së buxhetit afatmesëm", kap. V, pika 92 dhe ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 33.
Nuk është raportuar në Këshillin e Bashkisë brenda muajit Qershor mbi zbatimin e buxheteve vjetore, në pa pajtueshmëri me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar neni 47.
-*Nuk janë miratuar brenda muajit Qershor* në këshillin e Bashkisë kërkesat buxhetore afat mesëm për periudhën 3 vjeçare, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 29.3.2012 "Procedurat e përgatitjes së buxhetit afatmesëm", kap. IV, pika 76, kap. V pika 94, UMF nr. 4-1, datë 29.02.2016 "Për përgatitjen e buxhetit vendor" kap. II, IV.
Të gjitha objektet e tenderuara, *nuk janë miratuar më parë me nga Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS)* si dhe në kuadër të miratimit të Programeve Buxhetore Afatmesëm, në pa pajtueshmëri me kërkesat e UMF nr. 1, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016", pika 12/e.
Në vitin 2016, në dy raste të investimeve nga grandet e kushtëzuara për vlerë të fondit limit 94,091,530 lekë, dhe në vitin 2017, në 1 rast të investimit nga grandet e kushtëzuara për vlerë të fondit limit 23,134,125 lekë, *objektet e investuara, nuk janë miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë*, në pa pajtueshmëri me kërkesat e UMF nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat e përgatitjes së buxhetit afatmesëm" kap. I, pika 5, germa b.
Për vitin 2017, *nuk është miratuar nga këshilli i bashkisë buxheti faktik*, në pa pajtueshmëri me kërkesat e ligjit nr. 7776, datë 22.12.1993 "Për buxhetin lokal" i ndryshuar neni 25 (*trajtuar më hollësisht në faqet 10-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1. Rekomandim: Bashkia Konispol, të marrë masat e nevojshme për programimin dhe zbatimin e buxhetit në përputhje me kërkesat ligjore; miratimin e programit buxhetor brenda afateve ligjore si dhe monitorimin e zbatimit të buxhetit; si dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) me qëllim programimin e investimeve afat mesëm përfshi objektet që financohen nga grandet e kushtëzuara.

Menjëherë

4.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të Bashkisë Konispol për aktivitetin ekonomiko financiar të vitit 2017, disa llogari të aktivit të bilancit, nuk japin pamje të besueshme pasi për to, konstatohen disa pasaktësi materiale dhe për faktin se në vitet 2016 dhe 2017, nuk është bërë inventarizimi fizik i aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese, konkretisht:
1-Llogaria 202 *"Studime dhe kërkime"* për vlerën kontabile të bilancit për 5,263,601 lekë, nga të cilat vlera 4,470,467 lekë përfaqësojnë vlerën e studimeve dhe projekteve për 5 objekte kurse pjesa tjetër në vlerën 793,134 lekë, përfaqëson shpenzime në vite për mbikëqyrje të objekteve të investuara.
Nga Bashkia Konispol, *në vite, nuk janë kryer inventarizime fizike mbi ekzistencën studimeve dhe projektimeve të financuara.*
Mungesa e inventariale për sa janë regjistruar në debi të kësaj llogarie studime dhe projektime.
2-Llogaria 212 "*Ndërtime konstruksione*" për vlerën kontabile të bilancit 392,239,426 lekë.
Kjo llogari është e analizuar për 12 objekte të Bashkisë Konispol me vlerën 201,475,367 lekë. Në analizë të kësaj llogarie, është përfshirë vlera 31,586,314 lekë e analizuar për 17 objekte sipas të dhënave kontabël të trashëguara nga ish Komuna Xarrë.

Diferenca prej (392,239,426-233,061,681)= 96,177,745 lekë përfaqëson vlerën e kësaj llogarie sipas bilancit financiar të ish Komunës Markat për vitin 2015 *për të cilën nuk ka regjistër analitik se çfarë përfaqësojnë këto objekte.*

Nuk janë hapur regjistra përkatëse për çdo objekt të investuar ku të jenë shënuar viti i prodhimit, vlera kontabile, vlera e rikonstruksioneve të bëra në vite, amortizimi i objekteve etj.

Këto objekte nuk janë të regjistrua në ZVRPP Sarandë në pronësi të Bashkisë Konispol.

3-Llogaria 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" për vlerën kontable të bilancit 966,864,955 lekë. Kjo llogari është e analizuar për 33 objekte të Bashkisë Konispol me vlerën 586,053,470 lekë dhe për 21 objekte të ish Komunës Xarë për vlerën 109,451,649 lekë.

Diferenca prej 271,359,836 lekë përfaqëson vlerën kontabile të kësaj llogarie të trashëguar nga ish Komuna Markat për të cilën *nuk disponohen të dhëna analitike të objekteve që i përkasin*.

4-Llogaria 214 '*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"* për vlerën kontabile të bilancit 37,970,915 lekë. Kjo llogari është analizuar për 18 objekte pajisje dhe makineri në Bashkinë Konispol me vlerën 34,928,880 lekë, 7 objekte nga ish Komunën Xarrë për vlerën 3,042,035 lekë. Në këtë llogari bëjnë pjesë edhe 5 zëra "*makineri e pajisje*" të dhuruar nga binjakëzimi me Bashkinë Afjon (Turqi) të vlerësuara me komision në shumën 9,881,299 lekë.

5-Llogaria 215 "*Mjete transporti*" për vlerën kontabile të bilancit 21,166,910 lekë e analizuar për 12 lloje mjete transporti ku përfshihet dhe një autoambulancë me vlerë 7,000,000 lekë dhuruar nga Bashkia Afjon (Turqi).

Nuk ka kartelë inventariale se kush i ka në administrim këto mjete.

6-Llogaria 218 "*Inventar ekonomik*" për vlerën kontabile të bilancit 19,459,238 lekë. Kjo llogari për Bashkinë Konispol është e analizuar në 258 zëra, ku përfshihen dhe 12 zëra të dhuruar nga Bashkia Afjon në vlerën 677,000 lekë të vlerësuara me komision, për ish Komunën Xarrë, është e analizuar për 85 zëra në vlerën 4,161,416 lekë sipas të dhënave të inventarit fizik të vitit 2015, për ish Komunën Markat për 1,096,672, *nuk disponohen të dhëna analitike të objekteve dhe as kartela inventariale.*

7-Llogari 31 *"Materiale"* për vlerën kontabël 689,163 lekë për të cilën për vitet 2016 dhe 2017, *nuk është kryer inventarizimi fizik i tyre*.

8-Llogaria 32 "*Objekte inventari*" për vlerën kontabël 4,120,879 lekë për të cilën për vitet 2016 dhe 2017, *nuk është kryer inventarizimi fizik i tyre* (*trajtuar më hollësisht në faqet 18-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës, të marrë masat për kryerjen e inventarizimit fizik të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pika 74 dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për të sistemuar kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me qëllim që ato të pasqyrojnë gjendjen reale të aktiveve të Bashkisë Konispol.

Të identifikojë personat përgjegjës debitorë që e kanë pasur në ngarkim vlera inventariale duke ndjekur inventarizimet në vite deri në origjinën e krijimit të asetit dhe të ngarkojë me përgjegjësi materiale deri në kallëzim penal për debitorët e mundshëm.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste në zbatimin e kontratave për punë publike dhe konkretisht; "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat" dhe "Ndërhyrje emergjente në argjinaturën pranë lumit Pavell", Bashkia Konispol, në Bashkinë Konispol nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor, u konstatua se në dosje nuk ka leje zhvillimore/ndërtimi për zbatimin e objekteve të mësipërme në kundërshtim me pikën 4 të udhëzimit nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" (*trajtuar më hollësisht në faqet 89-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa që në vazhdimësi për zbatimin e kontratave për realizimin e investimeve publike të pajisë zhvilluesit me leje zhvillimore/ndërtimi.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik për zbatimin e punimeve të kontratës me objekt "Ndërhyrje emergjente në argjinaturën pranë lumit Pavell", Bashkia Konispol të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Konispol dhe shoqërisë "E...i" SHPK, u konstatua këto defekte:
- Në segmentin rrugor ndërmjet seksionit 8 dhe seksionit 9, u konstatuan se është dëmtuar shtresa e binderit me sipërfaqe 13.5 m^2 si dhe shtresa e asfaltobetonit me sipërfaqe 13.5 m^2.
- Në segmentin rrugor ndërmjet nga kryqëzimi i rrugës deri te kombino 1, u konstatua se bankina me gjatësi 22 ml dhe gjerësi 100 cm nuk është e mbushur me shtresë stabilizanti (*trajtuar më hollësisht në faqet 89-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Konispol duhet të njoftojë në rrugë zyrtare zbatuesit e punimeve të ndërtimit "E...i" SHPK që brenda periudhës së garancisë së punimeve të merren masa për riparimin e defekteve të ndodhura nga dalja e lumit, për riparimin e shtresës së binderit, të asfaltobetonit dhe të bankinës.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: a. Në Bashkinë Konispol, në fund të vitit 2017 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 23 subjekte të biznesit të vogël, 1 subjekt i biznesit të madh dhe 607 familje, për të cilat llogaritet mungesë të ardhurash ***në vlerën 14,837,000 lekë.***

b. Për detyrimet e pa paguar në afatet e përcaktuara në ligj dhe në Vendimet e Këshillit Bashkiak, nuk është llogaritur dhe as arkëtuar gjoba, kamat vonesat prej 0.06% për qind të shumës së detyrimit të papaguar, rezulton me mungesë të ardhurash ***në vlerën 3,249,303 lekë.***

c. Mbi vjeljen e detyrime për tatim taksat lokale, konstatohet se nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtoria e Sarandë, *në vlerën* ***399,814 lekë.*** Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Konispol, konstatohet se deri më 31.12.2017, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifën përkatëse 15 persona për sipërfaqe ndërtimore të legalizuar gjithsej 2,435 m^2, për banim dhe për aktivitet social ekonomik. Përsa më sipër, nuk janë zbatuar kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës se mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar dhe VKB nr. 3, datë 09.01.2017 "Për miratimin e taksave e tarifave vendore për vitin 2017".

Po ashtu Zyra e Tatim Taksave Bashkia Konispol për arkëtimin e debitorëve të taksave vendore dhe taksës ndikimit në infrastrukturë, nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim jo në përputhje me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, nenet 40, 41 90, 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 dhe nenin 12, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve" (*trajtuar më hollësisht në faqet 23-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

<u>7.1. Rekomandimi:</u> Zyra e Tatim Taksave në Bashkinë Konispol, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar, të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore:

-për 23 subjekte të biznesit të vogël, 1 subjekt të biznesit të madh dhe 607 familje, debitorë ***në shumën 14,837,000 lekë*** dhe

-për 15 persona në vlerën totale të pa arkëtuar prej ***399,814 lekë, e ardhur e munguar*** nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore të legalizuara.

-për 24 subjekte dhe 607 familje në vlerën totale prej ***3,249,303 lekë, e ardhur e munguar*** nga llogaritja e kamat vonesave për detyrimet e papaguara në afat.

Duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Tu dërgohen bankave (subjekteve që nuk u është dërguar) urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.
b- Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.
c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 %, kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.
d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

8.Gjetje nga auditimi: Nga administrata tatimore e bashkisë, nuk janë plotësuar njoftimet e detyrimit, nuk u janë dërguar në rrugë postare të gjithë subjekteve tatimpagues, që kanë detyrimin ligjor për të paguar, taksat dhe tarifat vendore si, për tarifën e pastrimit urban, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, taksën e tabelës dhe për taksën mbi ndërtesat dhe për pasojë nuk janë arkëtuar detyrimet ligjore nga subjektet taksapagues, veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 23, pika 2 (*trajtuar më hollësisht në faqet 23-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
8.1.Rekomandimi: Zyra e Tatim Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa në fillim të çdo viti buxhetor të plotësojë dhe të dërgojë njoftimet e detyrimeve në rrugë postare të gjithë subjekteve tatimpagues, ku të kërkojë arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Nga administrata tatimore e bashkisë, nuk është bërë miradministrimi i informacionit tatimor, të subjekteve tatimpagues të Biznesit të Vogël, për të gjitha detyrimet tatimore dhe nuk janë vendosur në dosjen e çdo tatim paguesi, ka mangësi përditësimi të të dhënave dhe mungesë të dokumentacionit, ku regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 29, pika 1 (*trajtuar më hollësisht në faqet 32-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
9.1.Rekomandimi: Zyra e Tatim Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për gjatë vitit ushtrimor të plotësojë dosje të veçantë për çdo subjekt tatimpagues ku të administrojë të gjithë informacioni tatimor për të gjitha detyrimet dhe në vijimësi të kryej përditësimin e të dhënave për detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, pagesat interesat, gjobat që i takojnë tatimpaguesit.

Menjëherë

10.Gjetje nga auditimi: Nga administrata tatimore e bashkisë, nuk është vepruar për inventarizimin e dokumentacionit që ndodheshin në dosjet e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore ku nga auditimi u konstatuan me mangësi si të gjitha praktikat nuk shoqërohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit, i gjithë dokumentacioni i subjektit mbahet në një dosje qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë, praktikat e përfunduara të viteve të mëparshëm nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" neni 24, dhe me Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, kapitulli II, nenet 21 dhe 27 (*trajtuar më hollësisht në faqet 23-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1.Rekomandimi: Zyra e Tatim Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për gjatë vitit ushtrimor të kryejnë inventarizimin e çdo dosje të veçantë për çdo subjekt tatimpagues për taksa dhe tarifa vendore, ku të plotësohet me fletë inventari i gjithë dokumentacioni që ka çdo subjekt tatimpagues.

Menjëherë

11.Gjetje nga auditimi: Nuk ka vepruar për marrjen në dorëzim të aseteve të qëndrueshme me komision dhe me procesverbal të nënshkruar nga përfituesi Bashkia Konispol dhe nga institucionet qendrore si dorëzues të aseteve, institucione këto, në pronësi të të cilave kanë qenë pronat dhe asetet, sipas fushave përkatëse të përdorimit të pronës, arsim, shëndetësi, kulturë, sport, monumente historike e kulturore, shërbime publike, infrastrukturë, bujqësi e ushqim, ujësjellës, troje dhe hapësira publike, pyje kullota, për të cilat do të duhej të ishin shoqëruar me harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre, etj, sipas listave të VKM nr.113, datë 13.02.2013 dhe të VKM nr. 433, datë 08.6.2016, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr. 500, datë 14.8.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" në VKM nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive", pika 66 dhe UMF nr. 30 datë **27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap. III,** pika 30,35/a (*trajtuar më hollësisht në faqet 95-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1.Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa dhe të krijojë komisionin për marrjen në dorëzim të aseteve nën administrim, duke hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim të pronave, akt i cili duhet të nënshkruhet nga dorëzuesi i pronës dhe përfituesi (Bashkia Konispol), si dhe duhet të shoqërohet me tregues dhe element teknikë si harta, të dhëna mbi infrastrukturën, sipërfaqen, gjendjen reale të tyre etj.

Menjëherë

12.Gjetje nga auditimi: Nuk ka kryer kolaudimin dhe vlerësimin e aseteve, nuk ka kryer inventarizimin kontabël dhe fizik të aseteve, nuk ka aplikuar në ZVRPP Sarandë për regjistrimin e aseteve, nuk ka hartuar përmbledhjen dhe bashkimin e listave të aseteve të dy Njësive Administrative ish-komunat, Markat dhe Xarrë, për të përpiluar në këtë mënyrë një pasqyrë të qartë të pasurive të paluajtshme të bashkisë, me qëllim inventarizimin, vlerësimin, administrimin, regjistrimin, kontabilizimin dhe dokumentimin në pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Konispol, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial", Kreu III, pika 1 (*trajtuar më hollësisht në faqet 93-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1.Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa për evidentimin e pronave të ish-Bashkisë Konispol dhe 2 Njësive Administrative, Xarrë dhe Markat, të kryej inventarizimin, vlerësimin, kontabilizimin, pasqyrimin në aktivet e qëndrueshme të pasqyrave financiare dhe të marrë masa për regjistrimin e të gjitha aseteve në ZVRPP Sarandë.

Menjëherë

13.Gjetje nga auditimi: Nuk është dërguar informacion me shkrim, për zyrën e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në Këshillin e Qarkut Vlorë, në lidhje me dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, në dhjetor të çdo viti, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në UKM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", kreu V, pika 4 (*trajtuar më hollësisht në faqet 93-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1.Rekomandimi: Bashkia Konispol, Zyra e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave, të marrë masa për të informuar mbi dhënien me qira të tokave bujqësore, në fund të çdo viti zyrën e DAMT në Qarkun Vlorë.

Brenda datës 31.12.2018

14.Gjetje nga auditimi: Nga Policia Bashkiake, nuk është vepruar për të arkëtuar vlerën e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara ndaj personave të ndryshëm, për lidhje të paligjshme të ujit të pijshëm, për zjarr vënie kullote, nuk është ndjekur rruga ligjore me padi në gjykatë, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" nenet 20, 30, sipas aneksit B/1.4.3 me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, ***në vlerën 123,500 lekë*** (*trajtuar më hollësisht në faqet 32-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Konispol, Policia Bashkiake dhe Zyra Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës ***123,500 lekë,*** për mos arkëtim gjoba të vendosura për shkeljet e konstatuara, sipas aneksit B/1.4.3 bashkangjitur *Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Brenda datës 31.12.2018

B.I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 germa (b) dhe (c) *–Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **28,011,462 lekë**, nga të cilat **2,692,562 lekë,** në zbatimin e kontratave për punë publike dhe **25,099,800 lekë** në procedurat e prokurimit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 2,911,662 lekë pa Tvsh**, si më poshtë:

B.I.1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor **Bashkisë Konispol** dhe shoqërisë "**A...S"** Shpk me përfaqësues z. A.Ç, u konstatua se janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume zëra punimesh në shumën **2,692,562 lekë** me Tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 89-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

B.I.1.1.Rekomandimi: Bashkia Konispol, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **2,692,562 lekë** me TVSH nga operatori ekonomik "A...S" Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 838, datë 24.07.2017 me objekt "Ndërtim i linjës së ujësjellësit në fshatin Ninat" Konispol, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera dhe diferenca në volume zëra punimesh në fakt.

Brenda datës 31.12.2018

B.I.2.Gjetje nga auditimi: Janë kryer shpenzime për organizime festash të ndryshme, si me rastin e festës së 5 majit, festës së çlirimit të Konispolit,të festave të 7-8 marsit, ku janë likuiduar me bankë për shpenzime për koktej, fondi i përdorur për përballimin e këtyre shpenzimeve nuk

është nga fondi i veçantë, por është përdorur Artikulli nr. 602, shpenzime operative, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 147/2015, datë 17.12.2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Ligjin nr. 130/2016, datë 15.12.2016, "Për buxhetin e vitit 2017", Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", i ndryshuar me VKM nr. 258 datë 3.6.1999 "Për një ndryshim ne vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, date 15.5.1995 "Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja" pasqyrat nr.1, 2 dhe 3, me pasojë dëmin ekonomik ***në vlerën 192,600 lekë*** (*trajtuar më hollësisht në faqet 31-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.I.2.1.Rekomandimi: Bashkia Konispol, Drejtoria e Financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës ***192,600 lekë,*** për shpenzime për organizime festash të ndryshme**,** sipas aneksit B/1.4, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2018

B.I.3.Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa për shpenzime udhëtimi e dieta, për punonjësit e Bashkisë, për ditët e shtuna dhe të diela të cilat janë ditë pushimi zyrtar, jo në përputhje me përcaktimet dhe kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997 datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", kapitulli I, sipas aneksit nr. B/1.4.1, me pasojë dëmin ekonomik ***në vlerën 26,500 lekë*** (*trajtuar më hollësisht në faqet 29-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.I.3.1.Rekomandimi: Bashkia Konispol, Drejtoria e Financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës ***26,500 lekë,*** për shpenzime udhëtimi e dieta**,** sipas aneksit nr.B/1.4 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2018

B.I.4.Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt *"Rijetëzim i Ansamblit Urban të Qendrës Konispol",* për vlerën prej **65,697,705 lekë**, me OE të shpallur fitues **"G...G C..."**, për vlerën prej 64,665,200 lekë, është skualifikuar OE **"Ç...I"**, me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 52,878,426 lekë, duke shkaktuar përdorim e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 12,818,279 lekë (diferencë ndërmjet ofertës fituese dhe asaj të skualifikuar), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 76-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.I.4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Konispol, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës **12,818,279 lekë**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

B.I.5.Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt *"Rehabilitim i Unazës Ekonomike (loti 1) Shkallë Mursi",* për vlerën prej **50,222,533 lekë**, me BOE të shpallur fitues **"A...I & I...D"**, për vlerën prej 49,005,820 lekë, është skualifikuar OE **"B...U B"**, me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 40,249,450 lekë, duke shkaktuar përdorim e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 9,973,083 lekë (diferencë ndërmjet ofertës fituese dhe asaj të skualifikuar), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 76-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.I.5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Konispol, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës **9,973,083 lekë**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

B.I.6.Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt "Rehabilitim i Kanalit vaditës Shalës-Markat", për vlerën prej **11,750,000 lekë**, me BOE të shpallur fitues **"Sh...i & J...y C..."**, për vlerën prej 10,945,425 lekë, është skualifikuar OE **"B...U.B"**, me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 9,441,562 lekë, duke shkaktuar përdorim e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 2,308,438 lekë (diferencë ndërmjet ofertës fituese dhe asaj të skualifikuar), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 76-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.I.6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Konispol, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës **2,308,438 lekë**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

B.II. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, në vlerën prej 338,608,500 lekë.

B.II.1.Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt *"Rikonstruksion i rrjetit të furnizimit me ujë të qytetit Konispol",* për vlerën prej **158,339,371 lekë**, me OE të shpallur fitues **"A....s"**, për vlerën prej 155,750,971 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 2,588,400 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 3 OE, nga të cilët vetëm OE i shpallur fitues ka paraqitur ofertë ekonomike, ndërsa dy OE nuk kanë ngarkuar dokumentet por jo oferta ekonomike. OE i shpallur fitues rezulton se nuk ka plotësuar një kriter të DST dhe konkretisht për punë të ngjashme pasi ka paraqitur punime ndërtimi objektesh dhe në këto kushte tenderi duhej të anullohej dhe procedura të përsëritej. Mos paraqitja e ofertës ekonomike nga OE e tjerë tregon për fiktivitet të procesit, si dhe për prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej 158,339,371 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 76-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.II.1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Konispol, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **158,339,371 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

B.II.2.Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt *"Rikonstruksion + Ndërtim i palestrës Bido Sejko",* për vlerën prej **66,983,304 lekë**, me OE të shpallur fitues BOE **"R...i & V...t"**, për vlerën prej 66,906,660 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 76,644 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 4 OE, nga të cilët vetëm BOE i shpallur fitues ka paraqitur ofertë ekonomike. OE të skualifikuar kanë rezultuar me mangësi të shumta në dokumentacion, ndërsa lidhur me OE të shpallur fitues ka rezultuar se nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje taksa vendore në bashkinë Krujë (nipt sekondar) dhe njëri prej mjeteve eskavator nuk ka të ngarkuar në sistem lejen e qarkullimit dhe në këto kushte tenderi duhej të anullohej dhe procedura të përsëritej. Mos paraqitja e ofertës ekonomike nga OE e tjerë tregon për fiktivitet të procesit, si dhe për prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej 66,983,304 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 76-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.II.2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Konispol, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën ***66,983,304 lekë***, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

B.II.3.Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt*"Rikonstruksion i shkollës Mehmet Xhaferri Xarrë",* për vlerën prej **57,931,934 lekë**, me OE të shpallur fitues BOE **"R...i & V...t"**, për vlerën prej 57,863,092 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 68,842 lekë ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 2 OE, nga të cilët vetëm BOE i shpallur fitues ka paraqitur ofertë ekonomike ndërsa OE tjetër nuk ka ngarkuar ofertën ekonomike ndërsa lidhur me OE të shpallur fitues ka rezultuar se nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje taksa vendore në bashkinë Durrës (nipt sekondar) si dhe nuk ka paraqitur leje qarkullimi për mjetin ekskavator dhe në këto kushte tenderi duhej të anullohej dhe procedura të përsëritej. Mos paraqitja e ofertës ekonomike nga OE e tjerë tregon për fiktivitet të procesit, si dhe për prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej 57,931,934 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 76-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.II.3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Konispol, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **57,931,934 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

B.II.4.Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt *"Ndërtim i linjës së ujësjellësit të fshatit Ninat",* për vlerën prej **23,134,125 lekë**, me OE të shpallur fitues **"A...s"**, për vlerën prej 22,942,320 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 191,805 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 3 OE, nga të cilët vetëm BOE i shpallur fitues ka paraqitur ofertë ekonomike ndërsa 2 OE tjetër nuk kanë ngarkuar ofertën ekonomike, ndërsa lidhur me OE të shpallur fitues ka rezultuar se nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje taksa vendore në bashkinë Kukës (nipt sekondar) si dhe nuk ka paraqitur punë të ngjashme sipas llojit të objektit të prokurimit dhe në

këto kushte tenderi duhej të anullohej dhe procedura të përsëritej. Mos paraqitja e ofertës ekonomike nga OE e tjerë tregon për fiktivitet të procesit, si dhe për prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej 23,134,125 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 76-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.II.4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Konispol, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **23,134,125 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

B.II.5.Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt *"Ndërtim i linjës ujësjellësit depo tharrëse fshati Mursi",* për vlerën prej **8,371,120 lekë**, me OE të shpallur fitues **"A...s"**, për vlerën prej 8,279,310 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 91,810 lekë, ka rezultuar se kanë marrë pjesë në prokurim 3 OE, nga të cilët vetëm BOE i shpallur fitues ka paraqitur ofertë ekonomike ndërsa 2 OE tjetër nuk kanë ngarkuar ofertën ekonomike, ndërsa lidhur me OE të shpallur fitues ka rezultuar se nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje taksa vendore në bashkinë Kukës (nipt sekondar) si dhe nuk ka paraqitur punë të ngjashme sipas llojit të objektit të prokurimit dhe në këto kushte tenderi duhej të anullohej dhe procedura të përsëritej. Mos paraqitja e ofertës ekonomike nga OE e tjerë tregon për fiktivitet të procesit, si dhe për prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej 8,371,120 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 76-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.II.5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Konispol, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **8,371,120 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

B.II.6.Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt *"Ndërhyrje emergjente në argjinaturën e Lumit Pavëll"*, për vlerën prej **23,848,646 lekë**, OE i shpallur fitues **"E...i"**, me vlerë 23,833,041 lekë ose më pak për vlerën prej 15,605 lekë, ka rezultuar se AK ka përdorur procedurën e prokurimit *"Me negocim pa shpallje paraprake të Njoftimit të Kontratës"*, procedurë në të cilën ka vetëm një OE ofertues. OE i shpallur fitues se nuk ka paraqitur kontrata për punë të ngjashme si dhe nuk ka plotësuar kriterin për ISO 9001:2008 dhe në këto kushte tenderi duhej të anullohej dhe procedura të përsëritej. Mos paraqitja e interesit nga OE të ftuar në prokurim tregon për fiktivitet të procesit, si dhe për prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet për vlerën prej 23,848,646 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 76-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.II.6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Konispol, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për

vlerën **23,848,646 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.12.2018

B.III. TË ARDHURA TË MUNGUARA ME DËM EKONOMIK në vlerën 23,135,267 lekë, si më poshtë:

B.III.1.Gjetje nga auditimi: a. Në Bashkinë Konispol, në fund të vitit 2017 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 23 subjekte të biznesit të vogël, 1 subjekt i biznesit të madh dhe 607 familje, për të cilat llogaritet mungesë të ardhurash ***në vlerën 14,837,000 lekë.***

b. Për detyrimet e pa paguar në afatet e përcaktuara në ligj dhe në Vendimet e Këshillit Bashkiak, nuk është llogaritur dhe as arkëtuar gjoba, kamat vonesat prej 0.06% për qind të shumës së detyrimit të papaguar, rezulton me mungesë të ardhurash ***në vlerën 3,249,303 lekë.***

c. Mbi vjeljen e detyrime për tatim taksat lokale, konstatohet se nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtoria e Sarandë, *në vlerën* ***399,814 lekë.*** Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Konispol, konstatohet se deri më 31.12.2017, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifën përkatëse 15 persona për sipërfaqe ndërtimore të legalizuar gjithsej 2,435 m^2, për banim dhe për aktivitet social ekonomik. Përsa më sipër, nuk janë zbatuar kërkesat e nenit 23 të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës se mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar dhe VKB nr. 3, datë 09.01.2017 "Për miratimin e taksave e tarifave vendore për vitin 2017".

Po ashtu Zyra e Tatim Taksave Bashkia Konispol për arkëtimin e debitorëve të taksave vendore dhe taksës ndikimit në infrastrukturë, nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim jo në përputhje me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, nenet 40, 41 90, 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 dhe nenin 12, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve" (*trajtuar më hollësisht në faqet 23-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.III.1.1.Rekomandimi: Zyra e Tatim Taksave në Bashkinë Konispol, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar, të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore:

-për 23 subjekte të biznesit të vogël, 1 subjekt të biznesit të madh dhe 607 familje, debitorë ***në shumën 14,837,000 lekë*** dhe

-për 15 persona në vlerën totale të pa arkëtuar prej ***399,814 lekë, e ardhur e munguar*** nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore të legalizuara.

-për 24 subjekte dhe 607 familje në vlerën totale prej ***3,249,303 lekë, e ardhur e munguar*** nga llogaritja e kamat vonesave për detyrimet e papaguara në afat.

Duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Tu dërgohen bankave (subjekteve që nuk u është dërguar) urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

b- Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 %, kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

B.III.2.Gjetje nga auditimi: Nga Policia Bashkiake, nuk është vepruar për të arkëtuar vlerën e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara ndaj personave të ndryshëm, për lidhje të paligjshme të ujit të pijshëm, për zjarr vënie kullote, nuk është ndjekur rruga ligjore me padi në gjykatë, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" nenet 20, 30, sipas aneksit B/1.4.3 me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, ***në vlerën 123,500 lekë*** (*trajtuar më hollësisht në faqet 32-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.III.2.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Konispol, Policia Bashkiake dhe Zyra Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës ***123,500 lekë,*** për mos arkëtim gjoba të vendosura për shkeljet e konstatuara, sipas aneksit B/1.4.3 bashkangjitur *Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Brenda datës 31.12.2018

B.III.3.Gjetje nga auditimi: Nga specialistët e taksave dhe tarifave vendore Bashkia Konispol, Njësia Administrative Xarrë dhe Njësia Administrative Markat, nuk është vepruar, për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën e taksës së truallit për qëllime biznesi për 51 subjekte që kanë detyrimin për të paguar këtë lloj takse, veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Kreu II, nenit 9, pika 2; neni 21, pika 2; neni 23/1; dhe VKB nr.3, datë 09.01.2017, 05.01.2016, kreu III Taksa e truallit, germa "b", sipas aneksit nr.B.1.4.5, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Konispol, ***në vlerën 257,658 lekë*** (*trajtuar më hollësisht në faqet 34-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.III.3.1.Rekomandimi: Bashkia Konispol, Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës ***257,658 lekë,*** për mos arkëtim takse trualli për subjektet që kanë detyrimin për taksë trualli**,** sipas aneksit nr.B.1.4.5 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2018

B.III.4.Gjetje nga auditimi: Nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratës së qirasë me nr.123 Rep, nr.33/3 Kol, datë 02.02.2015 nenet 6/1 dhe 6/2, për kontratën e lidhur midis ish Komunës Markat, sot Njësi Administrative dhe Kompanisë të telefonisë celulare shoqërisë V...e Sha, jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar, kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", *me pasojë, dëm ekonomik në Buxhetin e Bashkisë* ***në vlerën 1,356,330 lekë*** (*trajtuar më hollësisht në faqet 98-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.III.4.1.Rekomandimi: Bashkia Konispol, Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës ***1,356,330 lekë,*** nga Subjekti "V...e" Sha, për mos zbatim të detyrimeve sipas kontratës së qirasë lidhur mes palëve.

Brenda datës 31.12.2018

B.III.5.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Konispol, nuk është arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, të cilat janë pajisur me licenca dhe autorizimet përkatëse, të trajtuara në aneksin nr.B/1.4.2, veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr.170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e

procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 10, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Konispol, ***në vlerën 300,000 lekë*** (*trajtuar më hollësisht në faqet 32-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.III.5.1.Rekomandimi: Bashkia Konispol, Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës ***300,000 lekë,*** për mos arkëtim tarife për dhënien dhe përsëritjen e licencave për subjektet private**,** sipas aneksit nr.B/1.4.2, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2018

B.III.6.Gjetje nga auditimi: Nuk është arkëtuar detyrimi sipas kontratave tip të qirave të tokave bujqësore të pandara të lidhur midis ish Bashkisë Konispol, ish Komunës Xarrë dhe ish Komunës Markat dhe personave fizik qiramarrës, gjithashtu nuk janë përllogaritur kamat vonesat përkatëse për çdo ditë vonesë për mosarkëtimin në kohë të detyrimeve, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar, UKM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", kreu V, pika 1,2,4,5, sipas aneksit nr. D/1.6.1, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Konispol, ***në vlerën 3,258,936 lekë*** (*trajtuar më hollësisht në faqet 101-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.III.6.1.Rekomandimi: Bashkia Konispol, Drejtoria e Bujqësisë, Blegtorisë dhe Zyra Juridike, të marren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës ***3,258,936*** **lekë,** për mos arkëtim të detyrimeve nga kontratat e qirave të tokave bujqësore, sipas aneksit nr. D/1.6.1, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2018

IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITITIMIT

Bazuar në ISSAI 400 "parimet Themeloe të Auditimit të Përputhshmërisë", ISSAI 4100 dhe 4200, "Udhëzues për auditimin e përputhshmërisë", "Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë",

llojin e opinioneve të audituesit në auditimin e përputhshmërisë, si dhe bazuar në punën e kryer ë subjekt mbi bazën e evidencave, rezultatet e auditimit, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në seksonin "Gjetjer rekomandime", opinioni ynë si auditues është:

Baza për opinion të kualifikuar

Raportimi Financiar, ka anomali apo raste mospërputhshmërie materiale për të cilat shprehim një opinion të kualifikuar për llogaritë vjetore të Bashkisë Konispol, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë për llogaritë vjetore të Bashkisë Konispol, janë materiale, por jo të përhapura:

-Bashkia Konispol, ka nxjerrë pasqyrat financiare pa kryer më parë inventarizimin fizik të aktiveve të qëndrueshme dhe aktiveve qarkulluese.

Për disa llogari të aktivit të bilancit, mungojnë të dhënat analitike mbi përmbajtjen e tyre:

-Llogaria 212 "*Ndërtime konstruksione*" me vlerën kontabile të bilancit 392,239,426 lekë.

Mungojnë të dhënat analitike dhe regjistrat përkatës për "*Ndërtime dhe konstruksione*" në vlerën 96,177,745 lekë sipas bilancit të vitit 2015 të ish Komunës Markat, sot Njësi Administrative.

-Llogaria 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" për vlerën kontabile të bilancit 966,864,955 lekë.

Mungojnë të dhënat analitike dhe regjistrat përkatës për "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" në vlerën 271,359,836 lekë sipas bilancit të vitit 2015 të ish Komunës Markat, sot Njësi Administrative.

-Llogaria 218 "*Inventar ekonomik*" për vlerën kontabile të bilancit 19,459,238 lekë.

Mungojnë të dhënat analitike të objekteve dhe kartelat inventariale për "*Inventar ekonomik*" në vlerën 1,096,672 lekë sipas bilancit të vitit 2015 të ish Komunës Markat.

- Në mos zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi në fushën e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, e cila ka të bëjë me vendosje të kritereve jo në përputhje me natyrën e prokurimit apo të kritereve të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e OE, si dhe kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomikë kur nuk plotësojnë kriteret e DST, janë përdorur fonde publike, pa ekonomicitet, eficence dhe efektivitet.

-Nga të dhënat konstatohet se detyrimet nga bisneset janë rritur nga viti në vit. Kështu detyrimet e vitit 2017 krahasuar me ato të vitit 2016 (*sipas të dhënave të bilanceve*) janë rritur me 4 (katër) herë, tregues të cilët flasin për vështirësitë financiare të buxheti të bashkisë dhe për një performancë jo të mirë likuiditetesh, ku detyrimeve paraqitet prej 13,799 mijë lekë.

Influencë negative në realizimin e treguesve financiarë të vitit 2016-2017, kanë dhënë mosrealizimi i të ardhurave të vetë bashkia.

-Në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve, në 2 raste u konstatuan shkelje për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt dhe llogaritje të gabuar të fondit limit, të cilat kanë shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të njësisë vendore në vlerën totale 2,692,562 lekë.

- Në mos ndjekjen e procedurave të duhura ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, duke krijuar debitor në vlerën totale 14,837 mijë lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë.

- Në fushën e administrimit të aseteve, konstatohet se nuk janë marrë në dorëzim me procesverbal nga dorëzuesi i pronës, nuk janë inventarizuar, nuk janë regjistruar në ZVRPP, nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare të bashkisë.

Opinion i kualifikuar:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Bashkia Konispol, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit të kualifikuar.

"*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi*".

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ANEKSET

Aneksi nr. B.1.4 Për pagesat e shpenzimeve për organizimin e festave nga llogaria 602 të Bashkisë Konispol, trajtuar në faqet nr. 31-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Nr	Emer Mbiemer	Vlera
1	SH.B.	96,300
2	E.D.	96,300
	TOTALI	**192,600**

Aneksi nr. B 1.4.1 Për pagesat për shpenzime udhëtim e dieta të Bashkisë Konispol, trajtuar në faqet nr. 29-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Nr	Emer Mbiemer	Vlera
1	SH.B.	12,500
2	D.Z.	12,500
3	A.S.	1,500
	TOTALI	**26,500**

Aneksi nr. B 1.4.2. Për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Konispol, trajtuar në faqet nr. 32-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Nr	Subjekti	Vlera
1	"H...a"shpk	100,000
2	"I...i" shpk	100,000
3	"L...i"shpk	100,000
	TOTALI	**300,000**

Aneksi B/1.4.3 Për realizimin e të ardhurave nga gjobat e Policisë Bashkiake të Bashkisë Konispol, trajtuar në faqet nr. 33-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Nr.	Emri Mbiemri	Gjoba vendosur	Arkëtuar gjatë periudhës	Diferenca e pa arkëtuar
1	F.A.	15,000	0	15,000
2	R.Sh.	5,000	0	5,000
3	M.O.	5,000	0	5,000
4	N.T.	5,000	0	5,000
5	I.O.	5,000	0	5,000
6	A.K.	5,000	0	5,000
7	D.B.	5,000	0	5,000
8	R.I.	5,000	0	5,000
9	S.I.	30,000	6,500	23,500
10	A.P.	5,000	0	5,000
11	H.Xh.	5,000	0	5,000
12	Y.Xh.	5,000	0	5,000
13	N.F.	5,000	0	5,000
14	R.B.	5,000	0	5,000
15	L.M.	20,000	0	20,000
16	A.I.	5,000	0	5,000
		130,000	**6,500**	**123,500**

Aneksi B/1.4.4, *Për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e infrastrukturës të ndërtimeve informate që ndodhen në territorin e Bashkisë Konispol, trajtuar në faqet nr. 34-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Sip ndërtimore	Vendndodhja	Detyrimi në lekë
1	Sh.Sh.	394	Konispol	64,602
2	I.Z.	97	Konispol	15,904
3	E.A.	86	Konispol	14,077
4	J.I.	45	Konispol	7,366
5	Xh.C.	76	Konispol	12,440
6	A.S.	334	Konispol	54,674
7	R.I.	24	Konispol	3,928
8	A.Z.	145	Konispol	23,738
9	V.B.	241	Konispol	40,455
10	L.U.	54	Konispol	8,840
11	M.I.	229	Konispol	37,490
12	P.B.	230	Konispol	37,654
13	P.H.	261	Konispol	42,730
14	K.M.	45	Mursi	7,364
15	Z.T.	174	Konispol	28,552
	TOTALI	**2435**		**399,814**

Aneksi B/1.4.5. Për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave dhe tarifave vendore,realizimin e tarifave vendore për taksën e truallit të lirë funksional për objektet në pronësi ose në përdorimtë subjekteve në territorin e Bashkisë Konispol, trajtuar në faqet nr. 34-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

nr	Emir mbiemri	Sip Trualli Funksional	Detyrimi gjithsej duhet në lekë	Detyrimi i aplikuar në lekë	Diferenca për tu aplikuar e arktuar, në lekë
1	Sh.Sh.	200	2,400	0	2,400
2	Q.T.	300	3,600	0	3,600
3	R.G.	100	1,200	0	1,200
4	Q.M.	100	1,200	0	1,200
5	A.D.	200	2,400	0	2,400
6	H.I.	100	1,200	0	1,200
7	I.M.	300	3,600	0	3,600
8	A.M.	213	2,556	0	2,556
9	S.B.	60	720	0	720
10	G.K.	90	1,080	0	1,080
11	G.B.	870	10,440	0	10,440
12	K.M.	200	2,400	0	2,400
13	A.P.	300	3,600	0	3,600
14	J.K.	300	3,600	0	3,600
15	P.B.	132	1,584	0	1,584
16	H.T.	20	240	0	240
17	H.A.	100	1,200	0	1,200
18	A.A.	25	300	0	300
19	R.M.	28	336	0	336
20	K.K.	30	360	0	360
21	E.A.	40	480	0	480
22	V.L.	180	2,160	0	2,160
23	E.Sh.	78	936	0	936
24	T.D.	3,000	36,000	0	36,000
25	F.H.	300	3,600	0	3,600
26	A.G.	300	3,600	0	3,600
27	T.K.	300	3,600	0	3,600
28	B.D.	200	2,400	0	2,400
29	B.Sh.	140	1,680	0	1,680
30	A.L.	70	840	0	840
31	S.L.	100	1,200	0	1,200

32	F.K.	50	600	0	600
33	G.K.	120	1,440	0	1,440
34	A.E.	1,000	12,000	0	12,000
35	F.Sh.	300	3,600	0	3,600
36	A.L.	100	1,200	0	1,200
37	A.D.	50	600	0	600
38	D.K.	1,000	12,000	0	12,000
39	H.D.	40	480	0	480
40	Sh.Sh.	300	3,600	0	3,600
41	A.S.	300	3,600	0	3,600
42	D.Z.	500	6,000	0	6,000
43	F.P.	2,000	24,000	0	24,000
44	F.L.	18	210	0	210
45	A.Sh.	300	3,600	0	3,600
46	A.M.	250	3,000	0	3,000
47	"H...a" shpk	1,500	18,000	0	18,000
48	"F...e" shpk	2,600	31,200	0	31,200
49	"D...i" shpk	1,168	14,016	0	14,016
50	"I...i" shpk	1,500	18,000	0	18,000
	TOTALI				**257,658**

Aneksi D/1.6.1 *Vlerësimi i nivelit të kontrollit të territorit bazuar në organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV), trajtuar në faqet nr. 101-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

Nr	**Emri Mbiemri**	**Nr. datë**	**Afati vite**	**sip ha**	**Detyrimet sipas viteve**			**Gjithsej Detyrim**	**Kamat Vonesa**	**Total Detyrim**
					para vitit 2015	**viti 2016**	**viti 2017**			
1	F.B.	12.04.2013	10	5	41,850	21,600	10,463	73,913	1,408,043	1,481,956
2	M.D. etj	25.04.2013	30	31	0	0	122,000	122,000	445,300	567,300
3	D.A.	15.05.2012	99	2	0	29,700	29,700	59,400	433,620	493,020
4	Sh.S.	21.03.2012	99	1	0	0	7,194	7,194	26,258	33,452
5	K.L.	15.05.2012	99	1	0	0	6,072	6,072	22,163	28,235
6	F.L.	12.06.2012	99	1	0	0	3,217	3,217	11,742	14,959
7	D.A.	14.06.2012	99	3	0	29,700	29,700	59,400	433,620	493,020
8	Sh.S.	21.06.2012	99	1	0	0	2,552	2,552	9,315	11,867
9	D.M.	14.06.2012	99	2	2,225	2,225	2,225	6,675	73,091	79,766
10	A.A.	15.05.2012	99	1	0	3,335	3,335	6,670	48,691	55,361
					44,075	86,560	216,458	**347,093**	**2,911,843**	**3,258,936**

Aneksi B/1.4.6 *Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të institucionit dhe të njësive të varësisë, si dhe zbatimi i dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre, Mbi Evidencat e realizimit të ardhurave për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2017, trajtuar në faqet nr. 23-35 të Raportit Përfundimtar të Audiitmit*

Në 000 lekë

Nr	Emertimi	Viti 2016			Viti 2017		
		Plani	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	Te ardhura shitja-Toke,Troje e terrene	400	0	0	10,400	0	0
2	Takse vendore mbi biznesin Vogel	1312	347	26.4	1,312	19	1.4
3	Tatim I thjeshtuar mbi fitimin	585	718	122.7	750	276	36.8
4	Tatim mbi token bujqesore	11,662	12,930	110.9	14,469	10,096	69.8
5	Tatim mbi ndertesat Subjektet	1,633	983	60.2	2,104	1,649	78.4
6	Tatim mbi ndertesat Familje	1,591	1,114	70.0	1,753	1,924	109.8
7	Takse Truall Ndertese	0	0	0	180	140	77.8
7	Takse vendore per regjistrim biznesi	140	98	70	100	30	30
8	Takse vendore per zenien e haps.publ.	50	121	242	50	3	6

9	Takse e ndikimit ne infrastrukture	0	1,081	0	3,500	3,047	87
10	Takse vendore per fjetjen ne hotel	15	13	86.7	15	13	87
11	Takse per therjen e bagative	7	1	14.3	7	17	243
12	Takse tabele	50	16	32	50	15	30
13	Te ardhura nga qera per troje	700	900	128.6	700	700	100
14	Tarife qera kullote	1,701	2,183	128.3	2,200	2,030	92.3
15	Tarife qera toke bujqesore	452	607	134.3	752	716	95.2
16	Tarifa per leje cert transporti	324	118	36.4	324	174	53.7
18	Tarife pastrimi dhe higjene Subjekte	703	572	81.4	983	567	57.7
19	Tarife pastrimi dhe higjene Familje	928	1,547	166.7	1,178	827	70.2
20	Te ardhura nga parkingu	1,120	504	45	1,120	499	44.6
21	Te tjera tarifa administrative	19,934	19,025	95.4	23,403	19,424	83
	a- Tarif Shërbimi	100	180	180	135	232	171.9
	b - " Miremb. Vorreza Publike	1,476	1,796	121.7	2,230	1,758	78.8
	c- " Ndriçimi Publik	894	921	103	941	844	89.7
	d - " Komunale (Ujra te Zeza)	92	49	53.3	92	39	42.4
	e- " Pike lidhje uji	0	395	0	0	65	0
	f - " Leje veterinare	5	0	0	5	1	20.0
	g- " Pagese uji pijshëm	17,367	15,684	90.3	20,000	16,485	82.4
	S h u m a	43907	44,004	100.2	66,270	43,532	65.7

***Aneksi B/1.4.**7 Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të institucionit dhe të njësive të varësisë, si dhe zbatimi i dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre, Përmbledhja e debitorëve për familjarët sipas NjA vitet 2016-2017 trajtuar në faqet nr. 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

Nr	Njësia Adminstrative	Viti 2016		Viti 2017	
		Nr Fam	Vlera në 000 lekë	Nr Fam	Vlera në 000 lekë
1	Bashkia Konispol	198	1,044	331	2,189
2	Nj A Xarrë	0	0	467	7,006
3	Nj A Markat	409	2,244	405	4,064
	TOTALI	**607**	**3,288**	**1,203**	**13,799**

Aneksi B/1.4.8 Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të institucionit dhe të njësive të varësisë, si dhe zbatimi i dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre, Pasqyra debitorëve familjarë për taksa,tarifa 2016-2017, trajtuar në faqet nr. 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Në 000 /lekë.

Nr	Njësia	Nr Familje	Vlera viti 2016	Nr familje	Vlera viti 2017
1	Konispol	166	907	261	1,777
2	Ciflik	32	137	70	412
Shuma Konispol		198	1,044	331	2,189
3	Xarre			141	2,212
4	Mursi			180	2,714
5	Shkalle			55	773
6	Vrine			91	1,307
Shuma Xarre				467	7,006
7	Vërvë	48	251	49	622
8	Dishat	44	281	55	725

9	Shales	82	412	114	1,027
10	Markat	123	747	99	1,380
11	Ninat	51	264	49	563
12	Janjar	61	289	39	287
Shuma Markat		409	2,244	405	4,064
TOTALI		607	3,288	1203	13,799

Aneksi B/1.4.9*Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të institucionit dhe të njësive të varësisë, si dhe zbatimi i dispozitave nënligjore në përdorimin e tyre, Pasqyra e debitorëve për bizneset Bashkia Konispol vitet 2010 – 2017, trajtuar në faqet nr. 23-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

Nr.	Emri	Mbiemri	lloji aktivitetit	vend ndodhja	NIPTI	PAPAG 2010-2016	PAPAG "10-2017
1	A	D	treg me pakice	Konispol	K 64006823 C	16,000	16,000
2	M	B	treg me pakice	Konispol	K 64713823 M	96,560	96,560
3	A	C	treg me pakice	Konispol	Pa regjistruar	38,480	38,480
4	I	A	treg me pakice	Konispol	L 14631801 T	56,160	56,160
5	B	H	bar kafe	Konispol	K 64713825 F	180,610	180,610
6	P	B	bar kafe	Konispol	K 33710915 H	78,220	78,220
7	V	B	bar kafe	Konispol	K 33710915 H	39,020	39,020
8	E	A	treg mishi	Konispol	L 34513803 N	41,920	28,888
9	Z	A	germ ime transp	Konispol	K 84511802 A	223,070	18,942
10	T	K	punime hekuri	Konispol	L 54703804 C	22,000	22,000
11	B	D	perp druri	Konispol	K 33713927 Ë	125,065	13,280
12	N	D	floktore	Konispol	L 54502801 N	91,640	14,120
13	M	Sh	rrobaqepësi	Konispol	Pa regjistruar	82,560	9,420
14	S	C	transp udhëtaresh	Konispol	L 34303802 S	13,240	19,120
15	J	S	transp udhëtaresh	Konispol	K76721525J	6,120	12,240
16	G	M	transp udhëtaresh	Konispol	L 13818801 E	35,018	13,364
17	G	K	lavazho	Konispol	Pa regjistruar	145,024	44,630
18	A	T	treg ambulante	Konispol	Pa regjistruar	15,824	5,824
19	G	U	bar kafe	Konispol	Pa regjistruar	0	24,120
20	J	K	bar kafe	Konispol	K 34122887 S	40,820	46,976
21	P	H	treg peshku	Çiflik	K 83804801 J	148,252	148,252
22	"y...a " sh.p.k.		transp udhëtaresh	Konispol	K 34107820 G	28,313	27,623
23	D	Z	treg mat bujq	Konispol	Pa regjistruar	0	33,120
24	F	P	treg pleh kimike	Konispol	Pa regjistruar	0	51,116
	Shuma e Debise					**1,523,916**	**1,038,085**